Ismail Kadare

GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR

roman

Onufri

Përgatiti për botim:
Bujar Hudhri

© Onufri, 2011

Të gjitha të drejtat e botimit, në gjuhën shqipe,
brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë,
i takojnë Shtëpisë Botuese Onufri

ISBN 978-99956-87-20-5

Shtëpia Botuese Onufri
Rr. "S. Pasha", Tiranë, Tel&Fax 00355 4 2220 017
http: //www.Onufri.com
E-mail: onufri@abissnet.com.al

Shkruar në fillim si tregim, është botuar në revistën "Nëntori", më 1962, me të njëjtin titull. Më pas, më 1963, është botuar në trajtë romani. Në botimet e mëvonshme ka pësuar ripunime të ndjeshme, të gjitha të natyrës artistike. Më 1967 dhe 1968 është përkthyer e botuar në Bullgari dhe në Jugosllavi. Por ka qenë botimi francez i vitit 1970, që i ka siguruar njohje ndërkombëtare.

ARKEOLOGJIA E VDEKJES

Romani - i shkëlqyer - i këtij shkrimtari të ri shqiptar ngrihet, qysh në fillim, mbi anekdotën makabre. Ai i largohet humorit të zymtë, që vetë subjekti duket sikur e kërkon, dhe nëse, për mënyrën e procedimit, të kujton Buzzati-n, nuk mund të mos vihet re, njëherazi, se "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" nuk është, pavarësisht nga përshtypja e parë, një parabolë e mirëfilltë dhe, aq më pak, një përsiatje metafizike.

Në rastin më të skajshëm, ky gjeneral që zhvarros ushtarë, të cilët nuk i ka njohur ndonjëherë, për t'i rigrupuar në një ushtri fantazmash, mund të ishte pothuajse një simbol, me kusht që kërkimi i marrosur të mos mbante vulën e një realizmi të rreptë, por, gjithsesi, të çuditshëm. Por, të mos ngutemi në gjykimin tonë: ajo çka gjallon thellësisht, në mënyrë njëherazi magjepsëse - siç mund të ndodhë me një magji - dhe robëruese, është vetë ky vend, Shqipëria, dhe populli i saj. Me fjalë të tjera, Ismail Kadareja, edhe pse i përmbahet stilit pavetor të rrëfimit, në të vërtetë, na sjell një tregim subjektiv. Ajo çka shohim ne nuk është, fjala vjen, Shqipëria e autorit, por ajo e gjeneralit. (...)

Robert Escarpit-i, në parathënien e tij për këtë roman, vëren me një nuhatje shumë të hollë se: "Përgjatë dy vjet gërmimesh endacake, ai (gjenerali) nuk sheh gjë tjetër nga ky vend mesdhetar veç baltërave të vjeshtës dhe dëborërave të dimrit. Përmes kronologjisë së rreptë dhe dramatike të rrëfimit, Ismail Kadareja i mohon atij pranverën, po ashtu siç i mohon dhe buzëqeshjen. Gjithçka fillon me shiun dhe dëborën, gjithçka përfundon me erën".

I mohon... *Jo vetëm që termi i përdorur është plotësisht i saktë, por dhe përkon (përveç efektshmërisë në planin rrëfimtar) me qëndrimin* afektiv *të autorit: nëse fola më sipër për roman subjektiv, duhet pranuar se ky subjektivizëm është mjaft i veçantë. Ismail Kadareja i lejon të shohë "heroit" të vet - pra, të tregojë - vetëm çka i përshtatet atij, domethënë, atë që përputhet me natyrën e tij dhe, posaçërisht, atë të një gjenerali që vjen në një tokë të huaj, njësoj siç kishin ardhur ushtritë fashiste, mbledhjen e pasojave dhe të provave të pakundërshtueshme të humbjes së tij. Tërë shkallëzimi dramatik i romanit mbështetet mbi këtë përmbysje / inversion: një gjeneral (që mund të kishte marrë pjesë në këtë luftë) vjen për të mbledhur fantazmat e një ushtrie të vdekur njësoj si gjeneralë të tjerë kishin grumbulluar dikur, në kufijtë e Shqipërisë, mijëra njerëz të bindur për fitoren e tyre. Drama dhe, për gjeneralin, makthi i tërë kësaj historie qëndrojnë në faktin se është fjala për të njëjtën ushtri dhe për të njëjtët ushtarë. Ajo çka është mizore në rrethanat ku ndodhet ai, lidhet me atë se misioni i tij është, sa i përçudnuar, aq dhe logjik me po të njëjtën përpikëri: me dëshirën e tij ose jo, ky oficer i lartë kryen misionin për të cilin është formuar. Nëse ushtria që komandon tani e tutje mund të strehohet e gjitha nën mushamanë e një kamioni, kjo nuk ndryshon asgjë: në një tjetër botë, ai është, negativisht, gjenerali. Por, mos vallë, ekziston ai më tepër apo ndryshe nga këto batalione skeletesh që tërheq pas vetes? Kjo nuk është e sigurt, aq shumë përzihen, në romanin e Ismail Kadaresë, njeriu dhe detyra e tij (nga ku kuptohet, pa kaluar domosdoshmërisht në simbol,*

se përse heroi i tij nuk ka as emër, as mbiemër: ai ka qenë dhe do të mbetet përherë vetëm gjenerali). Në krye të ushtarëve të vdekur, ai humbet, gjithashtu, çdo lloj ekzistence. Lufta e pavetëdijshme e njeriut për të mos e lënë veten që, në një mënyrë a një tjetër, të përthithet apo të gllabërohet nga kufomat që zhvarros, që të mos shndërrohet në gjeneral ushtrie të vdekur, siç e ka cilësuar autori, përbën një nga linjat vepruese më dramatike të librit.

Gjithsesi, vlen të përmendet se Ismail Kadareja nuk e drejton asnjëherë romanin e tij në anën e përmasës fantastike dhe se konflikti i brendshëm i heroit të tij, njësoj si dhe angushtia e tij janë krejtësisht logjike, edhe pse e shohim atë të kryejë, të paktën dy herë, veprime irracionale: i pari, i diktuar nga një frikë thuajse e mbinatyrshme, kur vërvit në lumë eshtrat e kolonelit Z., të vlerësuar, madje, si "gjetjen" e tij më të rëndësishme, dhe tjetri, i kundërt, kur shkon, si për të shpëtuar nga të vdekurit e vet, në një dasmë fshatare (çka na ka dhënë një nga skenat më të habitshme të këtij romani). Me përjashtim të këtyre dy shtysave instinktive, gjenerali e zotëron veten e vet, aq sa mund ta bëjë këtë një njeri buzë greminës, në atë masë sa këta të vdekur, të gjetur me vështirësi njëri pas tjetrit, do të kthehen në shenja absolute të dështimit të tij. Gjetja gjeniale e Kadaresë është imponimi i një vazhdimësie të dukshme midis kësaj lufte, të zhvilluar para njëzet vjetësh, dhe kësaj paqeje, e cila, me gjithë shenjat e jashtme, nuk është një paqe e vërtetë, për arsyen e thjeshtë se vazhdon të jetë e mbarsur me vdekjen, e groposur, si dhe ky grumbull kufomash, vetëm fare pak metra nën sipërfaqe: vdekja e Reizit, punëtorit që gërvishti dorën me kopsën e uniformës së një ushtari të varrosur para disa dhjetëvjeçarësh, kthehet në simbol të goditur të asaj paqeje që, përherë, vetëm në pamje të jashtme është e tillë. Kufomat, edhe pas njëzet vjetësh, mund të vrasin sërish, mund të kryejnë ende, tinëzisht, rolin e tyre prej ushtari. (...)

Që nëpërmjet këtij gjenerali italian, i cili vjen të kërkojë "të vetët" dhe që, gjatë endjeve të tij, takohet me një gjenerallejtënant gjerman të ngarkuar me të njëjtin mision, ka një kritikë therëse ndaj të gjitha

llojeve të fashizmit, kjo duket fare hapur. Por Ismail Kadareja, përtej ushtrive musoliniane apo hitleriane, që dogjën dhe gjakosën Shqipërinë, vë në shënjestër të gjitha llojet e ushtrive. Dhe jo vetëm që i denoncon ato, por, në një kuptim, i bën dhe qesharake. (...)

Por, përtej personazhit qendror, ajo çka bie në sy në këtë roman është Shqipëria ashtu siç e sheh ai, armiqësore, e sertë dhe aspak mikpritëse për të: ai jo vetëm që është i huaj (dhe Kadareja u bën një portret të mprehtë bashkatdhetarëve të gjeneralit), por është dhe ai, nëpërmjet të cilit, njëzet vjet më pas, rilind skandali. Dhe, nëse është e vërtetë se për këtë gjeneral, siç e ka vënë në dukje Robert Escarpit-i, nuk ekziston pranvera, kjo ndodh ngaqë elementet, gjithashtu, nuk e pranojnë. Me këtë epope dramatike dhe shpotitëse, në skajin ku mezi dallohet shpërfillja nga përbuzja, Ismail Kadareja ka ditur të shkruajë një libër tronditës, i cili, për mendimin tim, është ndër më të bukurit që kam mundur të lexoj qysh prej shumë kohe.

TRISTAN RENAUD*

* Tristan Renaud është studiues francez, autor i kritikës së parë të romanit në Francë. Botuar në Lettres françaises, 1 prill 1970.

Gjenerali i ushtrisë së vdekur

Merrini, jua solla!
Ishte një truall i vështirë dhe
vazhdimisht bënte mot i keq.

PJESA E PARË

KREU I PARË

Mbi tokën e huaj binte shi përzier me dëborë. Sqota kishte qullur betonin e pistës së aeroportit, ndërtesat, rojat. Ajo lagte fushën dhe brigjet dhe shkëlqente mbi asfaltin e zi të udhës automobilistike. Sikur të mos ishte fillimi i vjeshtës, çdo njeriu tjetër, përveç gjeneralit të porsaardhur, do t'i dukej ky shi monoton një përkim i trishtuar. Ai po vinte në Shqipëri, nga një shtet i huaj, për tërheqjen e eshtrave të ushtarëve të vrarë këtu në luftën e fundit botërore. Bisedimet midis dy qeverive kishin filluar që në pranverë, por marrëveshja përfundimtare u nënshkrua vetëm në fund të gushtit, në kohën e vranësirave të para. Pra, ishte vjeshtë dhe shiu kishte kohën e tij. Gjenerali e dinte këtë. Para se të nisej, kishte mësuar, midis të tjerash, edhe diçka për klimën e Shqipërisë. Gjenerali e dinte që në Shqipëri vjeshta ishte e lagësht dhe

me shi. Por, edhe sikur në librin që kishte lexuar të shkruhej se në Shqipëri vjeshta ishte e thatë, atij nuk do t'i dukej ky shi i papritur. Përkundrazi. Dhe shkaku ishte se atij i ishte dukur gjithmonë se misioni i tij mund të kryhej vetëm në shi.

Për një kohë të gjatë, nga dritareza e aeroplanit kishte vështruar pamjen kërcënuese të maleve. Majat e tyre të mprehta dukej sikur do të gërricnin në çdo çast barkun e avionit. Tokë e pjerrët kudo. Pllaja të zymta, që rrëshqisnin me shpejtësi poshtë mjegullës. Në ato hone e pjerrësira dhe nëpër gjithë rrafshnaltën dimërore dergjej nën shi ushtria që ai po vinte ta zhvarroste. Tani që për herë të parë po shihte tokën e huaj, ai provonte shumë më qartë atë frikë të turbullt që i shkaktonte, qysh prej disa muajsh, ndjesia e pamundësisë, me të cilën ishte lidhur misioni i tij. Ushtria ishte atje poshtë, jashtë kohës, e ngrirë, e kalcifikuar, e mbuluar me dhé. Ai kishte marrë detyrën ta ngrinte nga balta këtë ushtri. Ngritja e saj i shkaktonte frikë. Ishte një mision i panatyrshëm, ku do të kishte shumë verbëri, shurdhim dhe mosgjë. Pasojat mund të ishin të papritura.

Toka që ishte shfaqur, më në fund, atje poshtë, në vend që t'i jepte njëfarë sigurie me pamjen e saj të rrokshme, përkundrazi, i kishte shtuar frikën. Mospërfilljes së të vdekurve po i shtohej shpërfillja e saj. Madje, jo vetëm ajo. Ishte diçka më tepër. Ai vrapim i çmendur nën mjegull, ato shpate të përthyera si nga dhembjet nuk tregonin veçse armiqësi.

Për disa çaste i qe dukur e pamundur kryerja e misionit. Pastaj, me mundim, ishte përpjekur të merrte veten. Trysninë e pamjes armiqësore të tokës, e sidomos të maleve, ishte

munduar ta përballte me ndjenjën e krenarisë për misionin e tij. Copëra fjalimesh e artikujsh, dromca bisedash, himne, kuadro filmash, ceremoni, fletë kujtimesh, kambana; e gjithë kjo rezervë e fundosur në ndërgjegjen e tij po ngrihej ngadalë në sipërfaqe. Mijëra nëna në vendin e tij prisnin eshtrat e bijve të tyre. E, pra, ai do t'ua shpinte. Ai do ta kryente mirë detyrën e tij madhore e të shenjtë. Nuk do të kursente asgjë. Asnjë i vrarë nuk duhej të harrohej, asnjë të mos mbetej në dhé të huaj. O, ky ishte një mision i lartë! Dhe ai disa herë gjatë udhëtimit kishte përsëritur fjalët e një zonje të madhe përpara nisjes: "Si një shpend krenar e i vetmuar, ti do të fluturosh mbi ato male tragjike që të shkëpusësh nga grykat dhe kthetrat e tyre djemtë tanë të mjerë."

Dhe ja, tani udhëtimi po mbaronte. Qëkurse malet i lanë prapa dhe fluturuan mbi lugina e pastaj mbi fusha, gjenerali e ndjeu veten më të lehtësuar.

Avioni po ulej mbi pistën e lagur. Dritëzat e kuqe e ngjyrëmanushaqe po mënjanoheshin nga të dyja anët. Drurët pa gjethe, një ushtar me kapotë, një tjetër, më i ngrirë se i pari, gjithçka largohej si e frikësuar. Vetëm njerëzit që kishin dalë t'i prisnin po vinin grumbull drejt aeroplanit.

Gjenerali zbriti i pari. Pas tij, prifti që e shoqëronte. Era e lagur iu përplas me forcë në fytyrë dhe ata ngritën qafëzat.

Pas gjysmë ore, makinat e tyre ecnin me shpeitësi drejt Tiranës.

Gjenerali ktheu kokën nga prifti, që vështronte i heshtur përjashta. Fytyra e këtij ishte e nemitur dhe pa asnjë shprehje. Gjenerali e kuptoi se nuk kishte asgjë për t'i thënë dhe ndezi një cigare. Pastaj vështroi përsëri tutje. Spikamat e tokës së

huaj i shihte të përthyera e të shtrembëruara nga vijat e ujit, që rridhnin nëpër qelq.

Që larg u dëgjua një vërshëllimë lokomotive. Gjenerali u mundua të kuptonte nga do të kalonte treni, nga ana e tij apo nga ana e priftit. Treni kaloi nga ana e tij. Ai e ndoqi me sy gjersa u zhduk në mjegull. Pastaj u kthye nga prifti, por fytyra e priftit ishte po aq e nemitur dhe pa shprehje. Gjeneralit iu duk përsëri se nuk kishte asgjë për të thënë. Madje, ai e kuptoi se nuk kishte asgjë për të menduar më. Çdo gjë e kishte përbluar në kokë gjatë udhëtimit. Tani ishte lodhur. Më mirë të mos bluante asnjë mendim të ri. Mjaft më. Më mirë të shikonte në pasqyrën e vogël në e kishte në rregull uniformën.

Kur hynë në Tiranë, po binte mbrëmja. Mjegulla rrinte pezull mbi pallatet, dritat dhe drurët e zhveshur të parqeve. Gjenerali u gjallërua. Nga qelqet e makinës shihte kalimtarët e shumtë, që shpejtonin në shi. Këtu ka shumë ombrella, mendoi. Ai donte t'i fliste priftit, sepse heshtja e kishte mërzitur, por nuk dinte ç't'i thoshte. Nga krahu i tij pa një kishë, më tutje, një xhami. Nga krahu i priftit ngriheshin pallate të pambaruara, të veshura me skela. Vinçat, me ca drita si sy të kuq, lëviznin nëpër mjegull si përbindësha. Gjenerali i tregoi priftit kishën dhe xhaminë. Por prifti nuk u tregua kureshtar. Kjo do të thotë se është vështirë t'i interesojë gjë tjetër, mendoi gjenerali. Tani sikur ndihej mirë, por s'kishte me kë të bisedonte. Shoqëruesi shqiptar rrinte përpara priftit, kurse deputeti shqiptar dhe një përfaqësues i ministrisë, që i kishin pritur në aeroport, vinin pas tyre, në një makinë tjetër.

Në hotel "Dajti" gjenerali e ndjeu veten mirë. Ai shkoi në dhomën e tij dhe ndërroi uniformën. Pastaj zbriti në holl dhe porositi një bisedim telefonik me shtëpinë.

Gjenerali, prifti dhe tre shqiptarët u ulën në një tryezë. Flisnin për gjëra të ndryshme dhe të parëndësishme. U shmangeshin sidomos bisedave politike. Gjenerali ishte shumë serioz dhe i sjellshëm. Prifti fliste pak. Gjenerali dha të kuptonte se ai ishte kryesori, ndonëse prifti fliste më pak. Ai foli për traditat e bukura që kishte krijuar njerëzimi në lidhje me varrimin e ushtarëve. Përmendi grekët e trojanët, që varrosnin njerëzit me aq madhështi në pushimet midis luftërave. Ai kishte shumë besim në misionin e tij. Do ta kryente patjetër këtë mision të rëndë dhe të shenjtë. Mijëra nëna prisnin bijtë e tyre. Ato kishin njëzet e ca vjet që prisnin. Është e vërtetë se kjo pritje ndryshonte pak nga ajo pritja tjetër, kur ato shpresonin t'u ktheheshin gjallë bijtë e tyre, por, sidoqoftë, edhe të vdekurit priten. Ai do t'u çonte nënave eshtrat e bijve të tyre, që gjeneralët e paaftë nuk ditën t'i udhëhiqnin në luftë. Ai ishte krenar për këtë. Ai do të bënte çmos.

- Zoti gjeneral, telefoni...

Gjenerali u ngrit plot gjallëri.

- Më falni, zotërinj. - Me hapa të gjatë shkoi në portinerinë e hotelit.

Po aq madhështor u kthye. Shkëlqente i tëri. Në tryezë pinin konjak dhe kafe. Biseda ishte më e ngrohtë. Gjenerali përsëri dha të kuptohej se ai ishte kryesori në këtë mision, sepse prifti, ndonëse kishte gradën kolonel, në këtë rast ishte vetëm një përfaqësues shpirtëror. Ai ishte kryesori dhe mund të hapte çfarë bisede që të donte: për konjakët, kryeqytetet, cigaret. E ndiente veten shumë mirë në këtë sallon hoteli, me këto perde të rënda, me këtë muzikë të huaj, madje, më tepër

se të huaj. Ai u habit edhe vetë nga i erdhi, kështu papritur, kjo dashuri për të gjitha orenditë e sendet që shikonte rreth e rrotull, që nga ndenjëset e buta e gjer te makina e ekspresit të kafesë, me zhurmën e saj të këndshme. Më tepër se dashuri, ndoshta, ishte një ndjenjë malli e parakohshme për diçka që e ndiente se do ta braktiste për një kohë të gjatë.

Gjenerali ishte i gëzuar. Shumë i gëzuar. As vetë nuk e dinte përse i erdhi kjo valë ngazëllimi e papritur. Ky ishte ngazëllimi i udhëtarit që gjen një strehë pas një udhe të rrezikshme në mot të keq. Ajo gota e vogël e konjakut nisi t'ia dëbonte përherë e më shumë pamjen e irnosur e kërcënuese të maleve, që edhe tani në tryezë e shqetësonte herë pas here. "Si një shpend krenar e i vetmuar..." Befas e ndjeu veten tepër të fuqishëm. Trupat e dhjetëra-mijëra ushtarëve, të futur në tokë, kishin pritur kaq vjet ardhjen e tij dhe ja, ai kishte ardhur që t'i ngrinte ata nga balta dhe t'ua kthente prindërve dhe të dashurve. Ai kishte ardhur si një Krisht i ri, i pajisur me harta, lista dhe shënime të pagabueshme. Gjeneralët e tjerë i kishin udhëhequr këto aradhe të pafundme ushtarësh drejt humbjes dhe asgjësimit, kurse ai kishte ardhur që t'ua shkëputste harrimit dhe vdekjes atë diçka që kishte mbetur prej tyre. Ai do të endej varrezë më varrezë, kudo, mbi ish-fushat e luftërave, me qëllim që t'i gjente të gjithë të humburit. Në luftën e tij me baltën nuk do të njihte sprapsje, sepse ai ishte pajisur me forcën magjike të të dhënave të përpikta.

Ai përfaqësonte një vend të madh e të qytetëruar dhe prandaj puna e tij do të ishte madhështore. Në punën e tij kishte diçka nga madhështia e grekëve dhe e trojanëve, diçka

nga funeralet homerike. O, si do të mbeteshin me gojë hapur shqiptarët, që mbanin kaq shumë ombrella në duar.

Gjenerali ktheu edhe një gotë. Dhe, që atë natë e tutje, çdo ditë, çdo mbrëmje, atje larg në vendin e tij, të gjithë ata që prisnin do të thoshin për të: ai tani kërkon. Ne shkojmë nëpër kinema, në restorante, në kafene, ndërsa ai i bie kryq e tërthor tokës së huaj dhe kërkon. Kërkon, hap varre. Oh, punë të rëndë ka, por ai do të dijë t'ia dalë mbanë. Jo më kot dërguan atë. Zoti e ndihmoftë!

KREU I DYTË

Zhvarrimi i ushtrisë filloi më 29 tetor, në orën 14.00.

Hekuri lëshoi një tingull të shurdhër. Prifti bëri kryq. Gjenerali nderoi ushtarakisht. Punëtori i vjetër i komunales e ngriti mihësen lart dhe goditi përsëri.

Domethënë, filloi, mendoi i tronditur gjenerali, duke vështruar plisat e parë të lagur, që u rrokullisën në këmbët e tyre. Ky ishte varri i parë që po hapnin. Të gjithë rrinin përreth si të ngrirë. Specialisti shqiptar, një djalë i hollë me flokë të verdhë dhe pak i hequr në fytyrë, se ç'po shënonte në bllokun e tij. Dy nga varrmihësit pinin cigare, i treti thithte llullën, kurse më i riu qe mbështetur mbi bishtin e veglës dhe shikonte me një vështrim të menduar. Po ndiqnin me vëmendje hapjen e varrit të parë, për të mësuar rregullat që do të ndiqeshin gjatë gërmimit. Hollësitë ishin shënuar në nyjat 7 dhe 8 të shtojcës së katërt të marrëveshjes.

Gjenerali ia kishte ngulur sytë grumbullit të plisave, që sa vinte, rritej në këmbët e punëtorit. Plisat ishin të zinj, të shkrifët dhe lëshonin avull.

Ja ajo, toka e huaj, tha me vete. Tokë si çdo tokë. Po ajo baltë e zezë si kudo, po ata guralecë midis, po ato rrënjë barërash dhe po ai avull. E, megjithatë, e huaj.

Prapa krahëve të tyre dëgjoheshin herë pas here makinat që shkonin me shpejtësi. Varreza gjendej ndanë udhës automobilistike, si shumica e varrezave të ushtarëve. Matanë kullosnin lopët dhe pëllitja e tyre e rrallë përhapej qetësisht në luginë.

Gjenerali ndihej gjithnjë i tronditur. Grumbulli i plisave po rritej vazhdimisht dhe, pas njëfarë kohe, gërmuesi u fut gjer në gju në tokë. Ai doli më pas nga gropa dhe pushoi ndanë saj për aq kohë sa shoku i tij hoqi me lopatë baltën ▪ gërmuar.

Lart në qiell fluturonte një tufë patash të egra.

Një fshatar i vetëm po kalonte në udhë, duke tërhequr një kalë prej kapistalli.

- Puna mbarë! - tha fshatari, që, siç duket, nuk e dinte ç'po bënin. Asnjë nga ata që rrinin rrotull varrit, nuk u përgjigj. Fshatari iku tutje.

Gjenerali vështronte herë tokën e gërmuar, herë fytyrat e varrmihësve. Ato ishin të qeta dhe hijerënda.

Ç'mendojnë vallë? tha me vete. Këta të pestë do të nxjerrin nga varri një ushtri të tërë.

Por nga fytyrat e tyre s'mund të kuptohej gjë. Dy prej tyre ndezën prapë nga një cigare, i treti thithte ende llullën, kurse tjetri, më i riu, vazhdonte të qëndronte mbështetur mbi bishtin e mihëses dhe dukej që e kishte mendjen gjetkë.

Punëtori i vjetër tani ishte futur në gropë gjer në brez dhe specialisti i shpjegonte diçka. Ata folën një copë herë, pastaj tjetri nisi të rrëmihte përsëri.

- Ç'thotë? - pyeti gjenerali.

- Nuk e dëgjova mirë, - tha prifti.

Të gjithë qëndronin në heshtje si në ndonjë varrim.

- Sa mirë që s'po fillon shiu! - tha prifti.

Gjenerali ngriti sytë. Horizontet ishin të mbytura në mjegull dhe larg, shumë larg, nuk kuptoheshin a ishin maja malesh ato që çoheshin përpjetë apo trajta të mjegullës.

Varrmihësi po futej më thellë në tokë. Gjenerali vështronte kokën e tij të përhime, që lëvizte sipas shpeshtisë së goditjes së veglës. Nga mënyra se si gërmonte, dukej që ishte një punëtor me përvojë. S'e kishin caktuar më kot përgjegjës. Gjenerali donte që punëtori të mihte më shpejt, që varret të hapeshin sa më parë dhe sa më parë të gjendeshin të gjithë të rënët. Atij nuk i durohej sa të fillonin nga gropsharët e tjerë. Atëherë, ai do të nxirrte listat dhe listat do të mbusheshin me kryqe të vogla dhe çdo kryqth do të ishte një ushtar i gjetur.

Tingulli i goditjes së hekurit tani vinte i thellë, si nga fundi i dheut, dhe, befas, gjenerali ndjeu një ankth në gjithë qenien e tij.

Po sikur ushtari të mos gjendet? mendoi. Po sikur hartat të mos jenë të sakta dhe të detyrohemi të gërmojmë në dy vende, në tre, në dhjetë, për të gjetur një skelet?

- Po sikur të mos gjejmë gjë? - i tha priftit.

- Do të gërmojmë prapë. Do të paguajmë dyfish.

- S'është puna te paret. Kryesorja është të gjejmë.

- Duhet të gjejmë, - tha prifti. - S'ka si të mos gjejmë.

Gjenerali e vështroi në sy i shqetësuar.

- Të duket sikur këtu s'është bërë luftë kurrë, - tha ai, por vetëm kanë kullotur këto lopë të qeta ngjyrëkafe.

- Ashtu duket gjithmonë më pas, - tha prifti, - kanë kaluar njëzet vjet që atëherë.

- Është e vërtetë, ka kaluar shumë kohë. Prandaj dhe shqetësohem.

- Përse të shqetësoheni? - tha prifti. - Toka këtu është e qëndrueshme, atë ç'ka brenda e ruan për shumë vjet.

- Po, ashtu është. Nuk e di as vetë përse nuk më besohet që ata janë diku pranë, vetëm dy metra thellë, nën këmbët tona.

- Nuk ju besohet, sepse nuk keni qenë ndonjëherë këtu.

- Ishte e tmerrshme?

Prifti bëri "po" me krye.

Tani varrmihësi i vjetër ishte futur pothuaj i tëri në tokë. Të tjerët ishin afruar rrotull tij. Specialisti shqiptar seç i thoshte vazhdimisht, duke i treguar me dorë diçka, i përkulur i tëri te buza e gropës.

Toka ishte plot gurë të vegjël, që lëshonin një tingull të mbytur kur preknin në metalin e lopatës. Gjeneralit i kujtoheshin copëza tregimesh të ushtarëve veteranë, që i kishin shkuar në shtëpi përpara nisjes së tij për t'u interesuar për varret e shokëve të tyre të mbetur nëpër Shqipëri.

Kama ime ndeshte nëpër gurët e vegjël dhe, duke u fërkuar me ta, lëshonte një tingull ngjethës. Unë e shqyeja dheun me sa fuqi që kisha, por kama ishte e pafuqishme përpara tokës. Ajo shkulte me zor një grusht baltë dhe unë thosha me vete:

Ah, sikur të kisha qenë në trupat e xhenierëve që të kisha me vete një lopatë dhe të gërmoja shpejt, shpejt, shpejt. Sepse atje pranë, me këmbë të varura në një hulli me ujë, ishte shtrirë përmbys shoku im më i ngushtë. Ia hoqa edhe atij kamën nga brezi dhe nisa të gërmoja me të dyja duart përnjëherësh. Doja t'i bëja një gropë të thellë, sepse kështu kishte qenë dëshira e tij. Po të vdes, më thoshte gjithnjë, varrosmë thellë, se kam frikë mos më zbulojnë qentë, si atëherë në Tepelenë. Të kujtohet ç'kishin bërë qentë në Tepelenë? Më kujtohet, i thosha unë dhe pija cigare. Dhe tani që ishte vrarë, duke gërmuar tokën, unë thosha me vete: mos ki frikë, gropën po ta bëj të thellë, shumë të thellë. Kur mbarova, e sheshova si munda tokën dhe sipër nuk i vura asnjë shenjë, asnjë gur, sepse ai trembej nga çdo shenjë, ngaqë i dukej se do ta gjenin e do ta nxirrnin prapë nga dheu. Ika nëpër natë në drejtimin e kundërt të mitralozëve dhe, tek po ikja, ktheva kokën nga errësira, ku lashë shokun tim dhe mendova: mos u tremb, nuk do të të gjejnë dot.

- Nuk po gjejmë gjë, me sa duket, - tha gjenerali, duke u munduar të fshihte nervozizmin.

- S'dihet, - tha prifti. - Ka ende shpresë.

- Në luftë nuk varrosin kaq thellë.

- Ndoshta është varrimi i dytë, - tha prifti. - Ka qëlluar shpesh që i varrosnim për të dytën herë, madje, dhe për të tretën.

- Ndoshta. Por, në qoftë se varret do të jenë kaq të thella, ne nuk do të mbarojmë kurrë.

- Disa herë do të na duhet, ndoshta, të marrim edhe punëtorë të tjerë të përkohshëm, - tha prifti.

- Ndoshta. Ç'po bëjnë këta? - tha gjenerali. - Ende s'po gjendet gjë.

- Tani është thellësia më e madhe, - tha prifti. - Tani duhet të gjendet, në qoftë se ka gjë.

- Më duket se po na fillon mbrapsht.

- Ndoshta ka lëvizur toka, - tha prifti. - Ndonëse harta nuk tregon zonë sizmike.

Specialisti shqiptar u përkul prapë te gropa dhe të tjerët u afruan.

- E gjeta, - tha gërmuesi i vjetër dhe zëri i erdhi i thellë e i mbytur, sepse foli me kokën të ulur brenda në gropë.

- E gjeti, - tha prifti.

Gjenerali mori frymë thellë. Varrmihësit lëvizën të gjithë. Më i riu, ai që rrinte menduar, i mbështetur te bishti i veglës, i kërkoi një cigare shokut dhe ■ ndezi.

Gërmuesi filloi të nxirrte eshtrat jashtë me lopatë. Në pamjen e tyre s'kishte asgjë të frikshme. Ato ishin përzier me dheun e shkrifët dhe dukeshin si copa drunjsh të thatë brenda në të. Përreth ndihej era e këndshme e dheut të hapur.

- Dezinfektantin, - thirri specialisti, - sillni dezinfektantin.

Dy punëtorë vrapuan te kamioni.

Specialisti gjeti diçka të vogël midis eshtrave.

- Ja medaljoni, - tha dhe ia tregoi gjeneralit, duke e mbajtur me një pincë. - Mos e prekni, ju lutem.

Gjenerali afroi fytyrën dhe mezi dalloi kokën e Shën Mërisë.

- Medaljoni i ushtarëve tanë, - tha ngadalë.

- E di përse e kemi këtë medaljon? - më tha një ditë. - Që të na gjejnë trupin, në qoftë se vritemi. - Dhe buzëqeshi me

shpoti. - Ti kujton se do të na kërkojnë vërtet eshtrat? Dhe ja, ta zëmë se do të na i kërkojnë. Kujton se më ngushëllon kjo gjë? S'ka dyfytyrësi më të madhe se kërkimi i eshtrave pasi mbaron lufta. Unë për veten time nuk do ta doja këtë venom. Le të mos më trazojnë më atje ku do të bie. Këtë medaljon të poshtër do ta flak ndonjë ditë. - Dhe ai e flaku vërtet një ditë dhe mbeti pa të.

Pas dezinfektimit, specialisti i mati një nga një disa eshtra dhe pastaj një copë herë seç njehsoi në bllokun e tij, duke e mbajtur stilografin shtrembër midis gishtave të hollë.

- Gjatësia një e shtatëdhjetë e tre, - tha.

- E saktë, - tha gjenerali, pasi hetoi listën.

- Paketojini eshtrat, - u tha specialisti punëtorëve.

Gjenerali ndoqi me sy varrmihësin e vjetër, që shkoi e u ul mbi një gur buzë udhës, nxori qesen e duhanit dhe zuri të dridhte një cigare, i lodhur.

Pse vallë më shikon në këtë mënyrë ky njeri? tha me vete gjenerali.

Pas disa minutash, toka filloi të hapej në pesë vende përnjëherësh.

Krye pa numër

Gjenerali zuri ballin me dorë.

- U ngatërruam, - tha, - hymë në shteg të verbër.

- Të shohim edhe një herë hartat.

- Asgjë s'merret vesh. Janë ngatërruar numrat e kuotave.

- Ç'pret nga skica varresh të bëra me ngut, në tërheqje e sipër.

- Natyrisht.

- Pa ta provojmë njëherë nga e djathta. Ku të çon kjo rrugë fushe?

- Në tokat e fermës fqinjë.

- Të provojmë njëherë këndej.

- Është e kotë.

- Ç'baltë!

- Sidoqoftë, duhet provuar njëherë nga e djathta.

- Kjo rrugë fushe s'ka për të na nxjerrë asgjëkund.
- Ky nuk është kërkim, ky është panik.
- Çfarë the?
- Baltovinë e mallkuar.
- Mbetëm në vend.

Zërat e tyre të shqetësuar largoheshin bashkë me hapat nëpër fushë.

KREU I TRETË

Pas tri javësh u kthyen. Ishte mbrëmje. Vetura ngjyrë bari u ndal përpara hyrjes së hotel "Dajtit", nën pishat e larta. Gjenerali zbriti i pari. Kishte një pamje të lodhur e të topitur. Madje, ishte hequr në fytyrë. Vështrimi i tij i mpirë u ndal një hop te vetura. Së paku, t'i kishin fshirë baltën, mendoi me nervozizëm. E dinte që shoferi nuk kishte faj, por s'donte të arsyetonte.

Ngjiti shpejt shkallët, mori letrat që i kishin ardhur, porositi një bisedim telefonik me shtëpinë dhe shkoi ngadalë në dhomën e tij.

Prifti bëri të njëjtën gjë.

Pas një ore kishin zbritur në sallon. Të dy kishin bërë banjë dhe ishin ndërruar.

Gjenerali porositi raki. Prifti kërkoi kakao. Ishte e shtunë. Nga taverna poshtë dëgjohej muzikë. Herë pas here

dukeshin djem e vajza që kalonin përmes sallonit në tavernë dhe anasjelltas. Edhe në holl kalonin vazhdimisht njerëz. Salloni ishte hijerëndë, me perdet e errëta dhe ndenjëset me shpinore të larta.

- Mbaroi, më në fund, edhe turneu i parë, - tha gjenerali.

Ata përsëritën të njëjtat fjalë që kishin thënë dhjetëra herë në ditët e mërzitshme të udhëtimit, hamendjet se a do t'ia dilnin mbanë kësaj pune brenda vitit, siç ishte parashikuar, vështirësitë e papritura, keqësimet e befta të motit.

- Në male do ta kemi keq.

- E besoj.

- Nesër do të merrem përsëri me hartat dhe do të rishikoj planin për turneun e dytë.

- Veç mos bëjë mot i keq!

- Ç't'i bësh? Është vjeshtë.

Prifti pinte kakao i qetë, duke e mbajtur kupën me dy gishtat e gjatë.

Është i bukur, mendoi gjenerali, tek vështronte vjedhurazi profilin e ngurtë dhe të palëvizshëm të tjetrit. Pastaj, papritur, tha me vete: ç'të ketë bërë vallë me gruan e ve të kolonelit? Midis tyre duhet të ketë ndodhur diçka. Ajo ishte e bukur, sidomos në plazh. Kur ai i kishte përmendur atëherë emrin e priftit, ajo ishte skuqur dhe kishte ulur sytë. Ç'të ketë pasur vallë midis tyre? pyeti përsëri veten gjenerali, pa ia hequr sytë.

- Kolonelin Z. s'e gjetëm që s'e gjetëm dot, - tha me zë të shkujdesur.

- Ndoshta, do ta gjejmë, - tha prifti dhe uli sytë. - Besoj se do ta gjejmë.

- Është vështirë, si gjithmonë kur rrethanat e zhdukjes janë të panjohura.

- Vështirë është, - pohoi prifti me një ton të thatë, - por ende jemi në fillim. Kemi kaq kohë përpara.

Ç'ka bërë me të venë e tij? mendoi gjenerali. Ai ishte kureshtar të dinte sa larg mund të shkonte ky atë i shenjtë me një grua.

- Duhet t'i gjejmë eshtrat e kolonelit patjetër, - tha gjenerali. - Ai është i vetmi oficer madhor i padeportuar gjer më sot. Kur mendoj se si familja e tij u bë copë, sidomos e shoqja...

- Po, - tha prifti. - Ajo u interesua shumë.

- A e patë varrin e bukur prej mermeri që kanë përgatitur për kolonelin?

- Po, - tha prifti, - ma treguan para se të niseshim.

- Një varr me të vërtetë madhështor, me përmendore dhe rrënjë trëndafilash të kuq e të bardhë, - tha gjenerali. - Vetëm se është i zbrazët.

Ata qëndruan një kohë të gjatë në heshtje. Gjenerali pinte raki dhe vështronte e ndiente përreth jetën e huaj. Papritur e ndjeu veten fare të vetëm. Të vetëm me varret e ushtarëve. Nuk deshi të kujtonte "varret e vëllezërve". Në asnjë mënyrë s'deshi. Mjaft ishte vërtitur tri javë rresht midis tyre. Tri javë rresht, ditë e natë, çdo orë, çdo minutë, vetëm me ta. Tani donte të ishte i lirë prej tyre. Mezi e kishte pritur këtë ditë pushimi. Ishte e shtunë. Ai donte të çlodhej. Ishte i gjallë. Ishte e drejta e tij e natyrshme.

Që poshtë vinin të mbytur tingujt e muzikës. Atje poshtë pihej, vallëzohej.

- Duhet të çlodhemi, - tha ngadalë, duke menduar prapa fjalës "çlodhje" fjalën "dëfrim".

Prifti ngriti sytë. Jo.

Kjo ishte e vërtetë. Ai ishte një gjeneral i huaj. Për më tepër, i ngarkuar me një mision qeveritar. Veç kësaj, ky mision ishte tepër i përzishëm. Dhe, më në fund, rreth e rrotull ishte po ai popull, me të cilin ushtarët e tij ishin përfytur për vdekje.

Gjenerali uli sytë mbi hirnoren e mbushur me bishta cigaresh. Ai e kuptoi se në javët dhe në muajt e ardhshëm të këtij shtegtimi të gjatë, që porsa kishte nisur, ai nuk do t'i përsëriste më këto fjalë. Rebelimi i shkurtër ishte shtypur menjëherë. Këndej e tutje ai do të ishte me ta. Vazhdimisht.

Po, ishte lodhur shumë. Gjithë ato rrugë të vështira, ato varre të lagura, aty-këtu grumbuj-grumbuj, aty-këtu të vetmuara, gjithë ajo baltë e mërzitshme, ato fortino gjysmë të shkatërruara (edhe fortinove, si ushtarëve, u kishin mbetur vetëm skeletet). Pastaj ngatërresat me varret e ushtarëve të kombeve të tjera, procesverbalet, shkresurinat dhe ecejaket e pafundme në zyrat vendëse. Si ishte përzier gjithçka. Sidomos ishte vështirë të ndanin të vrarët e ushtrive të ndryshme. Mes dëshmitarëve kishte shpesh kundërthënie; pleqtë ngatërronin ngjarjet dhe luftërat. Asgjë nuk ishte e saktë. Vetëm balta e dinte të vërtetën.

Gjenerali ktheu përsëri gotën.

- Ajo barakë, atje në fushë, - murmuriti me vete. - Me atë magazinier të zymtë...

Përpara se të hynin në Tiranë, kishin bërë dorëzimin e tyre, diku në një rrethinë, te baraka e grumbullimit, e ngritur enkas për këtë gjë në bazë të marrëveshjes.

- Barakë, magazinier... Dhe një qen te dera...

Prifti nuk foli.

Gjatë bisedimeve paraprake me zyrtarët shqiptarë, një nga pikat e vështira për t'u marrë vesh kishte qenë moslejimi i kalimit të eshtrave mespërmes qyteteve. Nuk e kishin kuptuar asnjëherë arsyen e këmbënguljes së vendësve, gjersa kishin qenë të detyruar të lëshonin pé. Sa herë që në hyrje të qyteteve e linin rrugën kryesore, për të kërkuar barakën e trishtë në mes të një rrëgalline, gjenerali psherëtinte gjithë pezëm.

Edhe tani që iu kujtua ndalesa e fundit lëshoi një aht.

Në sallon, si zakonisht, ishte qetësi. Vetëm atje tej, në qoshe, ca djem të rinj seç tregonin dhe qeshnin herë pas here. Atyre u dukeshin vetëm shpinat. Më tutje rrinin një djalë e një vajzë, siç duket, të fejuar. Ata më tepër vështronin njëri-tjetrin, sesa bisedonin. Djali kishte kokë të rregullt, ballë të pjerrët e të madh dhe nofullën e poshtme të gjerë. Tip alpin, mendoi gjenerali.

Pas banakut rrinte banakieri. Koka e tij e rrumbullakët dukej fare e qetë midis dy pjatave me portokaj.

Hyri një burrë i imët, me një çantë në dorë dhe u ul në tryezën pranë radios.

- Të zakonshmen, - i tha kamerierit.

Ndërsa kamerieri i përgatiste kafenë, burri i imët nxori nga çanta një fletore të trashë dhe nisi të shkruante. Ai kishte nofulla të ngushta dhe mollëzat pothuaj nuk i dukeshin fare. Kur thithte cigaren, në faqe i krijoheshin dy gropa, që tregonin qartë trajtën e nofullave.

- Ja, pra, këta qenkan shqiptarët! - tha gjenerali, sikur

të vazhdonte një bisedë të lënë përgjysmë. - Njerëz fare të zakonshëm. As që e merr dot me mend se në luftë ikin nga mendja.

- O, si bëhen ata kur gjejnë armë.

- Dhe të mendosh që janë aq pak!

- S'janë dhe aq pak, - tha prifti.

Hyri prapë një njeri me ballë të pjerrët.

- Ç'është kjo dreq pune që na kanë ngarkuar të bëjmë? - tha gjenerali. - Kudo, kur shikoj fytyra njerëzish, në rrugë apo në kafene, aty për aty, padashur, përfytyroj si do ta kenë kafkën.

- Më falni, ju po pini pak si tepër, - tha prifti me një ton të njerëzishëm dhe e vështroi me sytë e tij ngjyrë hiri. Në atë çast, gjeneralit iu duk se sytë e priftit kishin ngjyrën e ekranit të televizorit në fund të sallonit. Si një televizor që nuk punon kurrë, mendoi. Ose, më mirë, si një ekran që vazhdimisht merr të njëjtin program, krejt të pakuptueshëm.

Vështroi një copë herë gotën e bardhë, që e vërtiste nëpër gishtërinj.

- Po ç'të bëj, sipas jush? - tha me një ton nervoz. - Ç'më këshilloni të bëj? Mos vallë duhet të marr aparatin fotografik dhe të bëj poza për t'ia treguar gruas kur të kthehem? Apo të mbaj ditar dhe të shkruaj kureshtira? Ë? Si thoni ju?

- Unë nuk thashë asgjë të tillë. Thashë vetëm se ju po pini pak si tepër.

- Kurse unë habitem si nuk pini ju. Madje, habitem fort.

- Unë s'kam pirë kurrë alkool, - tha prifti.

- Megjithatë, çuditem se si nuk filloni të pini tani. Të pini çdo natë, kështu si unë, që të harroni atë që shikoni ditën.

- Përse duhet të harroj atë që shikoj ditën? - tha prifti.

- Sepse ne kemi një atdhe me këta të mjerë. - Gjenerali i ra me gisht çantës. - Nuk ju vjen keq për ta?

- Mos më fyeni, - tha prifti. - Edhe unë jam patriot.

Gjenerali buzëqeshi.

- A e dini? - tha. - Këto tri ditë kam vënë re se bisedat tona u ngjajnë dialogëve të mërzitshëm të ca dramave moderne.

Edhe prifti buzëqeshi.

- S'ke ç'i bën. Në një mënyrë ose në një tjetër bisedat njerëzore u ngjajnë dramave ose komedive.

- Ju pëlqen teatri i sotshëm?

- Njëfarësoj.

Gjenerali e vështroi në sy një copë herë. Pastaj i hoqi sytë.

- Ushtarë të mjerë, - tha papritur, sikur zgjohej nga gjumi. - Më dhemb shpirti për ta. Më duket vetja si ai prindi që rrit fëmijët e braktisur nga të tjerët. Nganjëherë, këta fëmijë duhen më shumë. Ç'mund të bëj unë për ta?

- Edhe mua më dhemb shpirti, - tha prifti. - Më pikon helm.

- Jemi të pafuqishëm me këto lista dhe procesverbalet tona. Bredhim dhe bredhim prapa vdekjes së tyre. I qëmtojmë një e nga një. Si u katandisëm kështu?

- Fati.

Gjenerali tundi kokën.

Prapë si në dramë, tha me vete.

Ky prift është prej metali, mendoi. Megjithatë, do të doja të dija se sa i ftohtë ka qenë me gruan e bukur të kolonelit Z., tha me vete, pa ia hequr sytë. U mundua të merrte me mend si

mund ta hiqte atë rrobën e zezë, kur të ulej pranë gjunjëve të saj. Vërtet t'i ketë pëlqyer prifti asaj apo... Në qoftë se vërtet midis tyre kishte pasur ndonjë gjë... E ç'i duhej, në fund të fundit, atij?

I vuri veshin radios së madhe të sallonit. Gjuha shqipe i dukej e rëndë. E kishte dëgjuar kaq herë ta flisnin fshatarët shqiptarë pranë varrezave, ku mblidheshin për t'u ndihmuar. Edhe gjithë ata të vrarë, me siguri, e kanë dëgjuar këtë gjuhë fatale, mendoi. Tani, me sa duket, po jepnin lajmet, sepse spikerja përsëriste fjalë të njohura. Tel-Aviv, Bon, Laos.

Qytete të ndryshme kishte bota. Iu kujtuan prapë ushtarët e kombeve të ndryshme, që kishin qenë në Shqipëri. Dërrasa, hekura të ndryshkur, kryqe, shenja, emra të shkruar shtrembër. Shumica i kishin varret pa asnjë shenjë. Madje, një pjesë nuk kishin fare varre. Ndodheshin nëpër gropa të përbashkëta, hedhur drejt e në baltë. Kishte nga ata që s'ndodheshin as në baltë, por vetëm në lista.

Eshtrat e një ushtari i kishin gjetur në muzeun e një qyteti fare të vogël në Jug. Muzeun e kishin ngritur ca qytetarë. Në kështjellën e vjetër të qytetit, në një qeli të thellë, ata kishin gjetur, midis të tjerash, edhe eshtrat e një njeriu. Për disa javë rresht, në kafenenë e qytetit, arkeologët amatorë bënin çdo ditë hamendje të ndryshme për këto eshtra. Madje, dy prej tyre ishin duke shkruar një artikull mjaft të guximshëm për ta botuar në ndonjë revistë, kur në qytetin e vogël mbërriti grupi i kërkuesve të eshtrave të ushtarëve. Specialisti kishte kaluar rastësisht nga muzeu dhe menjëherë e kishte njohur skeletin, nga medaljoni. (Në artikullin e amatorëve për medaljonin kishte dy parashtrime: medaljoni ishte ose mjet zbukurimi

ilir, ose monedhë e kohës romake.) Por kalimi i specialistit nga muzeu u kishte dhënë fund të gjithave. Një gjë ishte e çuditshme: si kishte mundur të futej ushtari në labirinthet e pashkelura të kështjellës dhe pse?

E pyeti priftin, por as atij nuk i kujtohej mirë kjo histori.

- Ke të drejtë, - tha gjenerali. - U bënë kaq historira dhe shumë prej tyre ngjajnë çuditërisht. Ashtu siç ngjajnë emrat. Listat janë përnjimend tepër të gjata dhe nganjëherë më duket se s'mbaj mend kurrgjë.

- Ushtar si çdo ushtar ka qenë, - tha prifti.

- Ç'është nevoja më për këto emra e për këto nofka? - tha gjenerali. - Dhe, në fund të fundit, ç'emër mund të kenë një grumbull eshtrash?

Prifti tundi kokën sikur të thoshte: S'ke ç'i bën, ja që kështu është.

- Emrat e tyre duhet të ishin të njëllojtë, ashtu si medaljoni që mbanin në qafë, - vazhdoi gjenerali.

Prifti nuk u përgjigj. Nga taverna dëgjohej muzika dhe gjenerali tymoste vazhdimisht.

- Na kanë vrarë jo pak, - tha si nëpër gjumë.

- Është e vërtetë.

- Edhe ne kemi vrarë.

Prifti heshti.

- Edhe ne kemi vrarë, - përsëriti gjenerali. - Varret e tyre janë kudo. Do të ishte shumë e turpshme dhe e trishtueshme, sikur varrezat e ushtarëve tanë të ishin fare të vetmuara.

Prifti tundi kokën në një mënyrë të atillë, që nuk u kuptua nëse bëri "po" apo "jo".

- Ngushëllim i vogël, - tha gjenerali.

Prifti prapë tundi kokën sikur të thoshte: S'ke ç'i bën.

- Nuk ju kuptova, - tha gjenerali, - është apo s'është kjo gjë një ngushëllim për ne?!

Prifti hapi pëllëmbët.

- Unë jam fetar, - tha, - unë nuk e përkrah vrasjen.

- O, - ia bëri gjenerali.

Dy të fejuarit u ngritën e dolën nga salloni.

- Jemi therur me njëri-tjetrin egërsisht, - vazhdoi gjenerali. - Këta mezi e paskëshin pritur një çikë kacafytje.

- Kjo shpjegohet, - tha prifti. - Nuk është punë trimërie të ndërgjegjshme. Është çështje e psikikës së tyre.

- Nuk e kuptova, - tha gjenerali.

- Kjo është e thjeshtë, - vazhdoi prifti. - Në luftë, disa i udhëheq arsyeja e dobët ose e fortë, kurse disa të tjerë, shtysa parake.

- Po ju dëgjoj, - tha gjenerali, kur iu duk se prifti po mëdyshej të vazhdonte.

- Shqiptarët janë një popull i ashpër e i prapambetur. Atyre, që kur janë foshnja, u vënë në djep pushkën, kështu që pushka bëhet pjesë e pandarë e jetës së tyre.

- Duket, - tha gjenerali, - edhe hijëzat i mbajnë sikur të ishin pushkë.

- Duke u bërë që në vogëli një pjesë e qenies së tyre, - vazhdoi prifti, - si një gjësend-bazë i jetës së tyre, pushka ndikon drejtpërdrejt në krijimin e psikikës së shqiptarit.

- Pa shih.

- Por një gjë që njeriu e do dhe e adhuron me gjithë shpirt, natyrisht që ka edhe dëshirë ta përdorë. Po përse mund të përdoret më mirë se për çdo gjë pushka?

- Ajo dihet, për të vrarë njerëz, - tha gjenerali.

- Ashtu është. Shqiptarët gjithmonë kanë pasur dëshirë të vrasin ose të vriten. Ata janë vrarë me njëri-tjetrin, kur nuk kanë pasur me kë të luftojnë. Keni dëgjuar për gjakmarrjen e tyre?

- Po.

- Ata në luftë i shtyn thirrja e vjetër. Kjo është një nevojë e diktuar nga natyra e tyre. Në paqe ata trullosen e përgjumen ashtu si gjarpri në stinën e dimrit. Vetëm në luftë e tregojnë veten plotësisht.

Gjenerali tundi kokën.

- Lufta është gjendja natyrale e këtij vendi. Prandaj ata në luftë janë të egër, të rrezikshëm dhe bëjnë dëm më tepër se ç'duhet.

- Domethënë, ky popull, me këtë etje që ka për asgjësim ose vetasgjësim, është i dënuar të zhduket, - tha gjenerali.

- Natyrisht.

Gjenerali piu. Tani ai i shqiptonte fjalët me ngathtësi.

- Ju i urreni shqiptarët? - pyeti ai papritur.

Prifti buzëqeshi hidhur.

- Jo. Pse?

Gjenerali i afroi fytyrën te veshi. Prifti bëri një shenjë të lehtë neverie, kur ndjeu erën e alkoolit.

- Si pse? - ia bëri me zë të ulët gjenerali sikur të thoshte një të fshehtë. - Ne të dy i urrejmë ata, por, tani për tani, nuk e themi, se kështu është puna...

KREU I KATËRT

I thanë natën e mirë njëri-tjetrit dhe gjenerali mbylli derën ■ dhomës së tij dhe u ul pranë abazhurit. Nuk i flihej, ndonëse ishte vonë. Mbi tryezë ishte çanta. Zgjati dorën dhe e hapi. Nxori listat me emrat e ushtarëve dhe po i shfletonte. Ishin shumë fletë, të qepura nga katër, pesë ose dhjetë fije bashkë. Ai po i shfletonte, duke lexuar kalimthi për të njëqindtën herë titujt me shkronja të mëdha në krye të listave: "Regjimenti Lavdia", "Divizioni i Dytë", "Divizioni i Hekurt", "Batalioni Alpin", "Regjimenti 4 i Gardës", "Batalioni 3 Alpin", "Divizioni Fitorja", "Divizioni 7 i Fanterisë", "Batalioni Blu" (Ndëshkimor)... Gjenerali u ndal një çast mbi këtë të fundit. Në krye të listës ishte koloneli Z. Pastaj emrat e ushtarëve, radhitur sipas alfabetit, të ndarë në kompani dhe toga. Batalioni Blu, emër i bukur, mendoi.

Listat kishin filluar të shtypeshin në pranverë. Në zyrat e gjata të ministrisë, pranë dritareve të mëdha, daktilografistet e reja, të veshura e të krehura sipas modës, godisnin me gishtat e hollë makinat e shkrimit. Trak-trak, trak-trak-trak. Ishte pothuajse një mitralim nën sytë e tyre shpërfillës, të bërë me rimel.

I la mënjanë listat themelore dhe nxori listat e tjera, të mbushura plot me shënime dhe me kryqe të vogla anash. Këto ishin listat për gjendjen e eshtrave. Ushtarët nuk ndaheshin sipas njësive ushtarake, por sipas vendeve ku ishin vrarë dhe krahas çdo emri ishte shënuar kuota që u përgjigjej hartave topografike, si dhe gjatësia e ushtarit dhe shënimet për dhëmbët. Ata që ishin gjetur deri tani ishin shënuar me një kryq. Por kryqet ishin ende të rralla.

Iu kujtua se duhej t'i hidhte kryqet në listat themelore. Por ishte vonë.

Duke mos ditur ç'të bënte, nisi të lexonte përsëri. Në listat e përditshme, trojet kishin përkthim në kllapa dhe të gjithë këta emra luginash, grykash, pllajash, lumenjsh, qytetesh i dukeshin të pazakonshëm dhe të frikshëm. Gropa e Shurdhit. Përroi i Nuses. Pesë Puset. Kisha e Psallmit. Varri i Nënës së Sheros. Humbella e Bufit. Bokërimat e Nase Gjikës. Lugu i Qyqes. I dukej sikur këta i kishin ndarë midis tyre ata ushtarë, kush më shumë e kush më pak. Tani ai kishte ardhur që t'ua merrte prapë.

Përsëri iu ndalën sytë te "Lista e të humburve", në krye të së cilës ishte prapë emri i kolonelit Z. Koloneli Z., një e tetëdhjetë e dy, dhëmbi i parë i djathtë prej floriri, lexoi gjenerali dhe pastaj pa të gjithë listën. Një e shtatëdhjetë

e katër, mungojnë dy dhëmbë anësorë; një e gjashtëdhjetë e pesë, hequr dhëmbaliët e sipërme; një e nëntëdhjetë, urë metalike në dhëmbët e parë; një e shtatëdhjetë e një, dhëmbët e plotë; dy e dhjetë. Ky është, me siguri, më i gjati në këtë listë, mendoi. Sa është, vallë, më i gjati në të gjitha listat? Kurse më i shkurtri dihej: sipas rregullores - një e pesëdhjetë e një. Më të gjatët, në përgjithësi, ishin ata të Regjimentit 4 të Gardës, kurse më të shkurtrit alpinët. Ç'po merrej me gjepura!

Fiku dritën dhe u shtri. Gjumi nuk e zinte. Të mos e kisha pirë atë dreq kafeje në fund, tha me vete.

Vështronte murin përballë ku, herë pas here, rrëshqiste drita e ndonjë makine që kalonte në bulevard. Drita binte vija-vija, që prapa flegrave gjysmë të mbyllura, dhe gjeneralit iu duk sikur ishte përpara një aparati rëntgen, ku njerëz të panjohur bënin radiografi dhe pastaj iknin, duke ua lënë vendin të tjerëve.

Listat janë atje në tryezë, gjysmë të hapura, mendoi dhe ndjeu rrëqethje. Sa mirë sikur të kishte gruan me vete. Do të rrinin shtrirë kështu në errësirë, do të flisnin me zë të ulët dhe ai do t'i tregonte gjithçka. Vetëm se ajo do të kishte frikë si në ato ditët e fundit, para se ai të nisej për në Shqipëri.

Ishin ca ditë të ndryshme nga të tjerat, të mbushura me diçka të re dhe të panjohur, që po hynte për herë të parë në jetën e tij. Porsa kishin filluar vranësirat dhe ai qe kthyer nga plazhi, kur ishte shfaqur njeriu i parë. Gjenerali ishte duke punuar në studion e tij, kur shërbyesja e lajmëroi se dikush e priste në sallon.

I panjohuri rrinte në këmbë pranë dritares. Jashtë po binte mbrëmja. Hije me gjithfarë trajtash vërtiteshin

hutueshëm nëpër erë. Ai u kthye kur kërciti dera dhe, me një zë të shurdhër, tha "mirëmbrëma".

- Më falni që po ju shqetësoj, - foli me një zë të ngjirur e të thellë. - Mora vesh se ju do të niseni së shpejti për në Shqipëri për të riatdhesuar eshtrat e ushtarëve tanë.

- Po, - tha gjenerali. - Do të nisem pas dy javësh.

- Kam një lutje për ju, - vazhdoi i panjohuri dhe nxori nga setra një hartë të lerosur të Shqipërisë. - Unë kam qenë ushtar dhe kam luftuar atje dy vjet rresht.

- Në ç'regjiment? - pyeti gjenerali.

- Divizioni i Hekurt, batalioni i pestë, toga e mitralierëve.

- Pastaj? - tha gjenerali.

I panjohuri u përkul mbi hartën e vjetër dhe tregoi me gisht një vend.

- Ja, këtu, në një operacion të madh, në mes të dimrit, batalioni ynë u shpartallua dhe ne, që mundëm të shpëtonim, u shpërndamë nëpër natë në drejtime të ndryshme. Unë kisha me vete një shok timin të plagosur dhe ndaj të gdhirë ai vdiq, tek po e zvarrisja në hyrjen e një fshati të braktisur. E varrosa vetë, ashtu si munda, prapa kishës së vogël të fshatit dhe ika. Kështu ndodhi. Varrin e tij nuk e di asnjeri dhe prandaj unë erdha te ju, që, kur t'ju bjerë rruga nga ato anë, të mundni ta nxirrni nga toka edhe atë bashkë me të tjerët.

- Me siguri, emri i tij duhet të gjendet në listën e të humburve, - tha gjenerali. - Listat janë shumë të përpikta, por ju, sidoqoftë, bëtë mirë, sepse, për të gjetur "të humburit", ka shumë pak mundësi dhe këtu do të na ndihmojë vetëm rasti.

- Unë kam bërë edhe një skicë të thjeshtë, ashtu si kam mundur, - tha i panjohuri dhe nxori një copë letër, ku kishte

vizatuar diçka që i ngjante kishës dhe, prapa saj, dy shigjeta, nën të cilat ishte shënuar me ngjyrë të kuqe "varri". - Atje afër ka një krua, - vazhdoi ai, - dhe më tutje, nga e djathta, dy qiparisa, ja këtu, - dhe shënoi diçka tjetër pranë kishës.

- Mirë, - tha gjenerali. - Falemnderit!

- Unë duhet t'ju falënderoj, - tha tjetri. - Ishte shoku im më i mirë. - Ai donte të thoshte dhe diçka tjetër, ndoshta, ndonjë hollësi, ndoshta, ndonjë ngjarje të vogël, por pamja e rreptë dhe zyrtare e gjeneralit e bëri që ta linte frazën përgjysmë.

Pastaj i panjohuri kishte ikur dhe gjenerali as që e kishte marrë vesh ç'punë bënte dhe ç'emër kishte. Por ky ishte vetëm fillimi. Çdo pasdite, kur kthehej në shtëpi, në sallon e prisnin të tjerë të panjohur. Ishin njerëz të ndryshëm: gra, prindër pleq, veteranë dhe të gjithë rrinin të druajtur dhe me të njëjtën shprehje në fytyrë. Pastaj filluan të vinin edhe nga qytete e krahina të tjera dhe këta të fundit rrinin edhe më të druajtur në sallon, duke u shpjeguar me vështirësi, sepse të gjitha ato që dinin rreth njerëzve të tyre të vrarë në Shqipëri ishin përherë e më të pasakta.

Gjenerali merrte shënime për të gjitha, duke përsëritur vazhdimisht:

- Mos kini drojë, listat e përpiluara nga Ministria e Luftës janë të përpikta. Megjithatë, po marr shënim sqarimin tuaj, ndoshta, do të na ndihmojë.

Ata iknin, duke falënderuar, dhe të nesërmen vinin të tjerë, me petka të lagura, duke shkelur me drojë mbi qilimin e trashë, ku linin gjurmë këpucët e tyre. Ishin nga ata që kishin frikë se mos qenë harruar pa u vënë në lista njerëzit e tyre;

kishte të tjerë që tregonin telegramet e marra nga komanda ushtarake dhe në telegramet shënoheshin data dhe vendi ku ushtari "kishte rënë për atdhe"; kurse një pjesë nuk besonin se të vrarët do të gjendeshin sipas listave dhe iknin gjithë helm.

Të gjithë kishin nga një histori dhe ai ishte i detyruar t'i dëgjonte një për një, duke filluar nga gratë, që tani ishin martuar me të tjerë dhe pyesnin fshehurazi për burrat e tyre të parë, gjer te djemtë e rinj njëzetvjeçarë, të veshur sipas modës, që nuk i kishin njohur asnjëherë etërit e tyre ushtarakë.

Javën e fundit vizitorët u shtuan. Tani, kur kthehej nga ministria, e gjente sallonin të mbushur plot. Ai i ngjante mesores së një klinike, ku prisnin të sëmurët, vetëm se këtu kishte më shumë qetësi. Njerëzit rrinin të heshtur, duke vështruar me orë të tëra zbukurimet e qilimit.

Disa, fshatarë të ardhur nga larg, kishin me vete nga një bohçe, që e vinin te këmbët; kurse te porta përjashta, gjëja e parë që i binte në sy gjeneralit, kur ndalte makinën, ishin biçikletat e mbështetura në thurimën e hekurt dhe, herë-herë, ndonjë veturë, ndanë trotuarit. Pastaj ai hynte drejt e në sallon, ku ndihej era e rëndë e rrobave të lagura, që përzihej me parfumin e ndonjë gruaje elegante, dhe të gjithë çoheshin në këmbë me nderim, të heshtur si dhe më parë, pa thënë në fillim asgjë, sepse askush s'e dinte si flitej në një rast të tillë.

Pastaj, si hante drekë, ai shkonte në sallon dhe njerëzit flisnin me radhë. Sa të ngjashme ishin fjalët e tyre. Dhe ajo që u kishte ndodhur njerëzve të tyre ishte një gjë kaq e ngjashme, sa atij i dukej sikur çdo ditë ishte dita e djeshme, që po e shihte në ëndërr. Gratë, që vinin për burrat, ose djemtë

nuk e mbanin dot ngashërimin. Gjenerali bëhej përherë e më tepër nervoz.

- Mos qani, - i bërtiti një ditë një gruaje, - ky nuk është lokal vajtimi. Mjaft. Djali juaj ra në fushë të luftës, atje ku e dërgoi atdheu.

Një ditë tjetër, një burrë i gjatë, porsa hyri, tha me zë të lartë që nga dera:

- Misioni juaj është një dyfytyrësi.

Gjenerali u zverdh.

- Kështu flasin të shiturit. Marsh, përjashta!

Në mesin e javës, midis atyre që prisnin, ishte edhe një grua shumë plakë, e shoqëruar nga një vajzë e vogël. Plaka ishte fare e rrëgjuar.

- Kam djalin atje, - tha me zë të pafuqishëm, - djalin ■ vetëm, - dhe nxori rizën e nisi ta shpaloste me duart që i dridheshin. Prej andej nxori një telegram të zverdhur nga koha dhe ia zgjati. Ai e lexoi shprehjen e zakonshme të komandës ushtarake, që lajmëronte vdekjet dhe sytë i mbetën te fjalët e fundit "ra për atdhe, në Stalingrad".

- Zonjë, - i shpjegoi ngadalë, - unë do të shkoj në Shqipëri, nuk do të shkoj në Rusi.

Plaka e vështroi një copë herë me ata sy të shuar, por, siç duket, nuk kuptoi gjë.

- Të lutem për diçka, - tha ajo, - të marrësh vesh si e qysh u vra, kush iu gjend te koka kur dha shpirt, kush i dha ujë dhe ç'porosi la.

Gjenerali u mundua t'ia shpjegonte edhe një herë, por plaka nuk kuptoi asgjë dhe përsëriti fjalët e para. Të tjerët vështronin njëri-tjetrin në heshtje.

- Shkoni, nënë, - i tha, më në fund, me zë të ëmbël një burrë, - zoti gjeneral do të bëjë ashtu siç thatë ju. - Dhe plaka falënderoi dhe iku, duke u mbështetur te shkopi dhe te vajza e vogël.

Të nesërmen, një njeri i vrenjtur priti gjersa ikën të gjithë.

- Unë kam qenë gjeneral, - tha gati me pezëm, - dhe kam luftuar në Shqipëri.

Të dy e vështruan njëri-tjetrin me përbuzje. Njëri, sepse shikonte një ish-gjeneral të mundur, tjetri, sepse kishte përpara një gjeneral në kohë paqeje.

- Çfarë kërkoni? - e pyeti ftohtë gjenerali.

- Në fakt, asgjë, - tha tjetri. - Në fakt, nuk pres ndonjë gjë të madhe nga ju. Të them të drejtën, nuk kam besim. Në fund të fundit, të gjitha këto më duken qesharake. Por, gjersa e filluat këtë punë, çojeni gjer në fund, dreqi e mori.

- Mund të flisni më qartë, - tha gjenerali.

- S'kam ç'të them tjetër. Desha vetëm t'ju paralajmëroja që të keni kujdes. Të jeni krenar. Të mos e ulni kokën përpara tyre. Ata do t'ju provokojnë, ndoshta, do t'ju përqeshin, por ju duhet të dini si t'u përgjigjeni. Ju duhet të jeni syçelët. Ata do të përpiqen të fyejnë eshtrat e ushtarëve tanë. Unë i njoh mirë. Ata shpesh mahiteshin me ne. Na përqeshnin atëherë. Mendoni, tani ç'do të bëjnë!

- Unë nuk do të lejoj në asnjë mënyrë të ndodhë një gjë e tillë, - tha gjenerali.

Tjetri e vështroi me keqardhje, sikur t'i thoshte "i shkreti ti" dhe iku pa përshëndetur.

Tri ditët e tjera, që ishin ditët e fundit, salloni ishte plot. Gjenerali u lodh dhe donte të nisej sa më parë. E shoqja mezi e mbante veten.

- Sikur të hiqje dorë nga kjo detyrë, - i tha një natë, tek rrinin zgjuar në shtrat, - më duket sikur në shtëpi na ka hyrë vdekja.

Ai e qetësoi si mundi dhe atë natë fjeti më keq se herët e tjera. I dukej sikur nesër do të nisej për në luftë.

Vizitorin e fundit e takoi në mëngjesin e asaj dite që do të nisej me aeroplan. Në aeroport duhej shkuar herët dhe, kur ai doli në kopsht për të hapur derën e garazhit, pa dy njerëz që po flinin të mbledhur kruspull te porta, mbështjellë me velenxë. Ishte një burrë plak me nipin e tij, të ardhur nga skaji më i largët i vendit. Kishin udhëtuar shumë ditë, gjersa, më në fund, kishin arritur me trenin e fundit pas mesnate dhe, meqenëse nuk kishin guxuar të trokisnin në portë në atë orë, kishin rënë të flinin në trotuar, duke pritur mëngjesin.

Për të fundit herë, gjenerali përsëriti fjalët: "Listat janë të përpikta, mos kini drojë, do ta gjejmë" dhe fshatari plak falënderoi me kokë, ndërsa velenxa ishte ende te pragu, ngaqë ishin çuar nga gjumi të trembur, kur kishte kërcitur porta.

Kjo qe e gjitha dhe kështu kishin mbaruar ato dy javët e fundit para nisjes për në Shqipëri.

Kreu i pestë

Përsëri ndodheshin në rrugë. Binte shi i imët. Kishin javë që po endeshin në ca vende të ashpra, me fshatra të rralla. Vetura ecte përpara dhe prapa saj vinte kamioni me veglat dhe me punëtorët e komunales. Përballë, vazhdimisht kalonin fshatarë të veshur me rroba të zeza prej shajaku. Ata ecnin në drejtime të ndryshme në këmbë, mbi kuaj ose në karroceritë e kamionëve. Gjenerali vështronte spikamën e tokës me vëmendje. Mundohej të merrte me mend se ç'taktikë do të kishin ndjekur kundërshtarët në këto luftëra dhe ç'taktikë, në përgjithësi, përdornin vendësit.

Në një barakë, pranë qendrës së një lokaliteti, shiteshin gazeta. Njerëzit ishin grumbulluar te dritarja e vogël. Disa lexonin në këmbë, disa i shfletonin gazetat duke ikur.

- Shqiptarët janë një popull që e lexojnë shumë gazetën, - tha gjenerali.

Prifti lëvizi në këndin e tij.

- Kjo ndodh, sepse ata e ndjekin shumë politikën. Pas grindjes me Bashkimin Sovjetik, ata kanë mbetur në Europë krejt të vetmuar.

- Si gjithmonë.

- Tani ata janë në bllokadë.

- Një vend kaq i vogël e i varfër në bllokadë... Çudi!

- Vështirë se do t'i qëndrojnë dot kësaj.

- Ç'popull! - tha gjenerali. - Por, me sa duket, popuj të tillë më lehtë se dhuna, ndoshta, mund t'i mposhtë gjëja e bukur.

Prifti qeshi.

- Pse qeshni?

Prifti qeshi përsëri dhe nuk iu përgjigj.

Gjenerali vështroi pamjen e zymtë, të mbytur në mjegull. Faqe pllajash të zverdhura, një mori gurësh të vegjël e të mëdhenj mbulonin tokën. Ai ndjeu t'i futej në shpirt një trishtim i madh. Kishte dy javë rresht që shikonte veç pllaja të tilla gurore. Atij i dukej se ato ndrydhnin në lakuriqësinë e tyre të egër një të fshehtë tragjike.

- Ky është një vend tragjik, - tha. - Edhe veshjet i kanë tragjike. Këto xhoka të zeza, këto funde grash. Shikojini!

- I shoh.

- A s'janë tragjike?

- Po të dëgjoni këngët si i kanë! Zi, sterrë! Kjo lidhet me fatin e këtij vendi. Në të gjithë shekujt, ai ka qenë i zymtë.

Vetura po zbriste nëpër një rrugë malore. Bënte ftohtë. Herë pas here kamionët ngjiteshin tërmal me uturimë. Në një faqe mali po ndërtohej diçka. Ngaqë vendi ishte i zhveshur, kantieri dukej vigan midis mjegullës.

- Uzinë bakri, - tha prifti.

Aty-këtu, nëpër udhëkryqe, filluan prapë të dukeshin fortinot. Frëngjitë për qitje vështronin drejt e në rrugë. Sa herë që vetura merrte kthesën, binte për ca çaste në zonën e qitjes dhe gjenerali ua ngulte sytë të çarave të ngushta, nga kullonte ujët pikë-pikë.

Kaloi, thoshte me vete, kur vetura ikte më tej, por në kthesën tjetër përsëri dilte një fortino, sikur mbinte nga toka, dhe prapë vetura për një grimë binte nën qitje. Gjenerali vështronte ujin që rridhte në qelq dhe herë-herë, ndërsa dremiste, i dukej sikur qelqet copëtoheshin papritur në mijëra grimca dhe ai hapte sytë. Por fortinot ishin të heshtura dhe të braktisura. Po t'i shikoje me vërejtje, ato dukeshin nga larg si skulptura egjiptiane, me një shprehje herë përbuzëse e herë enigmatike, sipas skajimit të frëngjive. Në qoftë se frëngjia ishte e pingultë, shprehja e fortinos bëhej ■ egër dhe kërcënuese, si e një shpirti të keq. Kur e çara qëllonte horizontale, atëherë fortinoja kishte një mimikë mospërfillëse.

Afër drekës zbritën në fushë, në një fshat buzë rrugës. Shiu kishte pushuar. Si zakonisht, rreth veturës u mblodhën fëmijët. Ata i thërrisnin që larg njëri-tjetrit dhe vraponin nga të gjitha rrugicat drejt veturës. Pak më larg, u ndal kamioni dhe punëtorët e komunales u hodhën njëri pas tjetrit në tokë dhe zunë të çmpinin gjymtyrët.

Fshatarët ndaleshin dhe vështronin të huajt. Me sa kuptohej, e dinin përse kishin ardhur. Kjo dukej qartë në fytyrat e tyre. Sidomos te gratë. Këtë shprehje të ftohtë në sytë e vendësve, gjenerali tani e njihte mirë. Ne u kujtojmë atyre pushtimin, mendoi. Dhe, sa më të egra të kishin qenë

luftimet në krahina të ndryshme, aq më armiqësore ngjanin fytyrat.

Pranë fshatit, në një tokë djerr, kishte shumë varre. Ato ishin rrethuar me një mur të ulët, vende-vende të prishur. Ai u mbështoll fort me mbipetkun e gjatë. Prifti më tutje dukej si një kryq i madh. Duket fare qartë se si janë rrethuar, mendoi gjenerali. Me siguri do të jenë përpjekur të kalojnë nëpër urën e lumit dhe aty janë grirë krejt. Cili ka qenë ai oficer kokëtul që i ka futur këtu?

Specialisti shqiptar mbushi shkresat e zakonshme. Më tej ishin edhe disa varre të tjera. Ato ndodheshin fare pranë fshatit dhe në krye kishin nga një yll të kuq. Gjenerali i njohu menjëherë "varrezat e dëshmorëve", siç i quanin vendësit varrezat partizane. Këtu ishin groposur shtatë ushtarë të shtetit të tij, midis shqiptarëve. Në pllakat me yll të kuq ishin shkruar, plot me gabime drejtshkrimi, emrat e ushtarëve, kombësia dhe data e vdekjes, që ishte e njëjtë për të gjithë. Ndërsa në një pllakë guri qenë gdhendur fjalët: "Këta ushtarë të huaj ranë heroikisht, krahas partizanëve shqiptarë, në përpjekje me forcat e Batalionit Blu, më 17 mars 1943."

- Përsëri Batalioni Blu, - tha gjenerali, duke ecur midis varrezave. - Është e dyta herë që biem në gjurmët e kolonelit Z. Në këtë fshat, në bazë të listave, duhet të jenë dy ushtarë të këtij batalioni.

- Duhet të pyesim për kolonelin, - tha prifti.

Ndërkaq, ndanë varrezës, pa u ndier, ishin afruar ca fshatarë. Pastaj erdhën ca gra të veshura me rroba karakteristike. Edhe ato, si të tjerët, vështronin dyshimtas. Fëmijët seç i thoshin në vesh njëri-tjetrit, duke tundur kokat

e vogla flokëverdha. Të gjithë ndiqnin në heshtje lëvizjet e grupit brenda varrezës.

Erdhi një grua e shkuar në moshë, me bucelë në kurriz.

- Do t'i marrin? - pyeti me zë të ulët.

- Do t'i marrin, - iu përgjigjën shumë pështëritje.

Plaka rrinte në këmbë, pa e zbrítur bucelën nga kurrizi dhe vështronte si të tjerët. Pastaj ajo bëri ca hapa përpara dhe iu drejtua punëtorëve të komunales.

- I thoni atij që të mos i përziejë këta me të tjerët, biro, - tha plaka. - I kemi qarë me ligje, si djemtë tanë.

Gjenerali dhe prifti vështruan nga gruaja, por ajo qe kthyer e po ikte; bucela e saj u lëkund edhe për ca kohë, gjersa u zhduk në një rrugicë të fshatit.

Fshatarët heshtnin ndanë varrezës sikur të mos ishin aty. Vazhdonin të ndiqnin me sy lëvizjet e njerëzve që endeshin poshtë e përpjetë, me qafëzat e ngritura nga të ftohtët, sikur kërkonin diçka dhe nuk e gjenin dot.

- Gërmimet në të dyja varrezat do të fillojnë nesër, - tha gjenerali. - Sot do të kërkojmë dy ushtarët e Batalionit Blu dhe aviatorin e rrëzuar.

Për aviatorin dinin të gjithë. Mbeturinat e aeroplanit të rrëzuar ndodheshin ende përtej në fushë, në anën tjetër të fshatit, dhe aviatori ishte varrosur nga vetë fshatarët pranë aeroplanit. Nuk kishte mbetur asnjë shenjë tjetër veç një guri të madh, që, siç duket, tregonte kokën e varrit, ndërsa aeroplani ishte kthyer në një grumbull hekurishtesh të ndryshkura. Një fshatar tregoi se ata, pak nga pak, i kishin shkulur të gjitha pjesët që mund t'u hynin në punë, nga copat prej kauçuku, që i kishin përdorur gjatë luftës për ndriçim, gjer te pjesët e rënda metalike.

Dy varrmihësit nisën të gërmonin, ndërsa grupi u kthye përsëri në katund.

Shiu kishte pushuar prej kohe, por rrugët e fshatit ishin plot gjurmë qerresh, të mbushura me ujë. Aty-këtu çoheshin mullarë të përgjysmuar, të lagur. Midis qiparisave dukej përtej kambanorja e kishës së vjetër. Nga diku vinte uturima e një traktori.

Drekën e hëngrën te makina dhe pastaj shkuan të pinin një kafe, në klubin e kooperativës. Klubi ishte gjithë tym duhani. Një radio e vogël ishte hapur gjer në fund. Fshatarët flisnin me zë të lartë. Dukej që ishin fusharakë. Flokë të zbërdhulur nga dielli, lëkurë e rreshkur. Edhe kumbimin e të folurit e kishin ndryshe: më të butë.

Gjenerali pinte kafe dhe vështronte parullat e shkruara në mure, me ngjyrë të kuqe. Kuptoheshin fjalët "revizionizëm" dhe "plenum", si dhe emri i Enver Hoxhës nën një mbishkrim.

Specialisti hyri në klub i fundit, bashkë me një djalë të ri me setër kadifeje. Ata erdhën te tryeza ku ishin gjenerali me priftin dhe specialisti i njohu me njëri-tjetrin.

Djaloshi ia nguli sytë e përhimë, pak të çuditur, të huajit dhe vështroi specialistin.

- Puna qëndron këtu, - tha specialisti, - gjatë kësaj jave ne do të bëjmë gërmime në dy varrezat ushtarake pranë fshatit tuaj. Ne kemi punëtorët tanë, por, sidoqoftë, për të shpejtuar punimet, do të ishte mirë të na ndihmonit, po të kishte mundësi.

Djaloshi u përtyp pak.

- Tani jemi pak si të zënë, - tha ai. - Kemi plugimin e tokës, pastaj, edhe me duhanin s'jemi mirë. Kështu që...

- Kjo është punë vetëm për disa ditë, - tha specialisti. - Pastaj, kini parasysh se kooperativistët do të paguhen rregullisht. Ata (specialisti tregoi me kokë nga gjenerali dhe prifti) paguajnë tridhjetë lekë të rinj për çdo varr që hapet dhe pesëdhjetë lekë të rinj për çdo varr ku gjenden eshtra.

- Ne paguajmë mirë, - ndërhyri gjenerali.

- Nuk është puna atje, - tha kryetari. - Çështja është se a quhet e rregullt kjo punë nga qeveria, dua të them...

- Për atë mos ki drojë, - tha specialisti. - Unë kam një shkresë nga Kryeministria. Ja.

Kryetari e lexoi shkresën dhe u mendua një copë herë.

- Unë mund t'ju jap dhjetë njerëz për tri-katër ditë, jo më shumë.

Gjenerali e falënderoi dhe ata u ngritën.

Për dy ushtarë të Batalionit Blu, të vrarë dhe të varrosur aty, nuk dinte gjë asnjeri.

Më tepër se një orë, ai dhe specialisti shqiptar u munduan të përcaktonin, në bazë të shënimeve të hartës topografike, vendin e përpiktë të varrimit. Ai binte nën stallën e viçave të kooperativës dhe, si mënjanuan viçat, varrmihësit nisën të gërmonin. Viçat vështronin me sytë e qetë dhe të bukur njerëzit e huaj. Në stallë ndihej era e këndshme e barit.

Pa rënë mbrëmja, aviatori dhe dy ushtarët u gjetën. Aviatori u zhgropos më lehtë, kurse për dy të tjerët u desh të hapeshin shumë gropa dhe, kur ata ikën, stalla dukej sikur kishte pësuar një bombardim.

Rrëmihësit filluan të sheshonin truallin. Ata nuk nguteshin. Atë natë do të flinin te fshatarët, kurse gjenerali, prifti dhe specialisti vendosën të shkonin për të kaluar natën në një qytet të vogël fqinj.

Kur u nisën, kishte rënë mbrëmja. Makina ecte ngadalë nëpër udhën kryesore, duke ndriçuar plepat anës rrugës, ndonjë qerre që kthehej nga fusha, oborret e rrethuara me kallama.

- Ndalojeni makinën, - tha papritur prifti, në kohën që po kalonin përsëri pranë varrezës së ushtarëve.

Shoferi frenoi.

- Ç'ndodhi? - pyeti specialisti.

Prifti i tregonte me dorë gjeneralit diçka në murin e varrezës.

Ai hapi derën dhe zbriti. Gjenerali zbriti pas tij, duke e përplasur derën me forcë. Zbriti dhe specialisti.

- Ç'domethënë kjo? - tha gjenerali me zë të lartë, duke treguar me dorë murin. Në mur ishte shkruar me një copë thëngjill, me shkronja të mëdha e të shtrembra, fraza: "Kështu ■ pësojnë armiqtë".

Specialisti ngriti supet.

- Dikush e ka shkruar sot pasdite, - tha. - Në mëngjes nuk ishte.

- Këtë ne e dimë, - tha gjenerali, - por vetëm duam të dimë me ç'qëllim dhe nga kush nxiten të tilla... sulme. Është e turpshme që...

- Nuk shoh asgjë të turpshme, - tha i qetë specialisti.

Prifti kishte nxjerrë fletorkën dhe po shënonte, siç dukej, frazën.

- Si nuk është e turpshme? - thirri gjenerali. - Fjalë të tilla në muret e varrezës së atyre që kanë rënë në luftë. Unë do ta bëj çështje. Ky është një dhunim i rëndë. Një përdhosje.

Specialisti ktheu kryet me rrëmbim.

- Njëzet vjet më parë ju shkruanit parullat e fashizmit mbi gjokset e shokëve tanë të varur, kurse tani acaroheni për këtë frazë të thjeshtë, të shkruar, me siguri, nga ndonjë nxënës.

- Ne nuk flasim për njëzet vjet më parë, - e ndërpreu gjenerali.

- Në fund të fundit, është një e vërtetë e përgjithshme.

- Nuk flasim për njëzet vjet më parë.

- Ju flisni shpesh për grekët dhe trojanët. Përse nuk u dashka të flasim për njëzet vjet më parë?

- Këto biseda s'kanë fund, - tha gjenerali. - Këtu s'është vendi për to.

Të tre u drejtuan me hapa të shpejtë te makina. Dyert u përplasën njëra pas tjetrës me rrëmbim, si një breshëri, dhe shoferi shkeli gazin. Por nuk ecën më shumë se pesë minuta. Në të dalë të fshatit, përtej urës së drunjtë, rrugën ■ kishte bllokuar një qerre, së cilës i kishte dalë rrota. Dy fusharakë vërtiteshin rreth saj.

Ndërsa po përpiqeshin të vendosnin rrotën, fshatari e pyeti specialistin:

- Nga të kemi?

Specialisti ia tha.

- E morëm vesh përse keni ardhur, - tha fshatari, - sot gjithë graria e fshatit këtë punën tuaj kishte në gojë. Porsa panë makinat, krisi kjo bisedë.

- Shtyje dreqin, - tha fshataraku tjetër, duke shtyrë rrotën.

- Thoshin se do t'i nxjerrin nga varret ushtarët e huaj e do t'i çojnë në vend të vet, - vazhdoi i qetë fshatari. - Por bashkë me ta do të nxjerrin edhe ballistët e vrarë e do t'i shpien prapa diellit, në vend të huaj. E vërtetë është kjo?

Specialisti qeshi.

- Kështu dëgjuam, - tha fshatari. - Edhe të vdekur, le të jenë bashkë, siç ishin sa qenë gjallë. Aleatë atëherë, aleatë tani. Ja, kështu thanë.

Specialisti qeshi përsëri.

- Nuk është e vërtetë, - tha. - Askush nuk ka ndër mend të merret me ballistët e vrarë.

- Shtyje dreqin, - thirri prapë fshatari tjetër. Rrota nuk po qëndronte.

Tutje lehnin qentë. Një njeri po vinte nga fusha, me fener në dorë. Drita e fenerit luhatej si e trembur.

- Ju ka dalë rrota? - pyeti njeriu, duke ngritur fenerin dhe duke vështruar me habi veturën dhe njerëzit e huaj.

Ai qëndroi një copë herë në këmbë, pastaj tha "natën e mirë" dhe u largua. Drita e fenerit të tij luhatej mbi mullarët e heshtur ndanë udhës. Qentë vazhdonin të lehnin.

- Me këtë punë merresh gjithnjë? - pyeti fshatari specialistin.

- Kam ca kohë.

Fusharaku mori frymë thellë.

- Punë e rëndë.

Shoferi vërshëllente një këngë që sapo kishte dalë. Rrota, më në fund, po vendosej.

- Mirëmbrëmani! - thanë ca fshatarë që po vinin nga fusha, me shata në krahë.

Qerrja, më në fund, e liroi udhën dhe makina u nis me shpejtësi.

Mbi fushë kishte rënë nata e tetorit. Hëna, që gjer tani ishte munduar më kot të dilte, po e kullonte dritën e saj nëpër

shtresat e sfungjerta të reve e të mjegullës dhe ato, të ngopura e të njomura prej saj, pa mundur ta mbanin më, kishin filluar ta pikonin atë dritësim, qetësisht e njëtrajtshëm, mbi gjithë hapësirën e pamatë. Tani qielli dukej si i lyrshëm dhe, bashkë me të, horizontet, fusha dhe rruga automobilistike ngjanin si të pikuara me qumësht.

Qëllonin net të tilla vjeshte, kur qielli bëhej i padurueshëm, i fundosur i tëri në dritën shpërfillëse, të përqarë e plagosëse të hënës. Rrinim shtrirë në tokë dhe, me siguri, secili mendonte: ç'është ky qiell kështu, nëna ime!

KREU I GJASHTË

Vetura u ndal përpara "Albturistit". Nëpër rrugët e lagura, përpara vitrinave, dukej ndonjë kalimtar i rrallë. Të priste era e natës dhe ata hynë shpejt në hollin e hotelit. Ngaqë stina turistike kishte marrë fund, dhoma të lira kishte plot, madje, edhe nga ana e liqenit.

Gjenerali u afrua te dritarja dhe mënjanoi perden. Liqeni s'dukej. Larg në fushë ishte po ajo bardhësi tronditëse e hënës. Ai u ul buzë shtratit dhe ndezi një cigare.

Prifti trokiti pas pak.

- Poshtë në restorant po ha darkë ai gjenerallejtënanti që takuam para dy javësh në male, - tha.

Specialisti, që i priste poshtë, u dha të njëjtin lajm.

- Ata, me sa duket, po bëjnë gërmime në këtë qytet.

Dy javë më parë, ndërsa makina ecte ndanë një pllaje të

madhe, gjenerali, që herë dremiste, herë rrinte si i nemitur, papritur pa diçka të çuditshme.

Në pllajë, ca rrëmihës, si ata të tyret, po gërmonin tokën, në katër-pesë vende. Më tutje, ishte ndalur një veturë dhe pak më tej një kamion i mbuluar. Vetura dhe kamioni shëmbëllenin krejt me veturën dhe me kamionin e tyre. Pranë makinës rrinte në këmbë një ushtarak i mbështjellë me pallto. Një njeri i veshur me të zeza i kishte kthyer shpinën rrugës.

Ç'është kjo pamje? mendoi gjenerali si i mpirë. Mos jam në ëndërr? Atij iu duk sikur pa në pllajë veten e vet, priftin dhe varrmihësit. Kapsalliti sytë dhe fshiu me dorë avullin e qelqit. Pamja ishte e njëmendtë.

- Vështroni atje, - i tha me zë të ulët priftit. Prifti ktheu kokën dhe bëri një lëvizje habie.

- Ndaluni, ju lutem, - i tha shoferit gjenerali.

Shoferi u ndal. Gjenerali tregoi me dorë nga ana e djathtë.

- Shikoni atje, - i tha specialistit.

Specialisti ktheu kryet andej. Një copë herë i picërroi sytë, si për të parë më mirë.

- Ç'janë ata? Ç'po bëjnë? - tha gjenerali.

- Me sa duket, të njëjtën gjë si ne: po gërmojnë.

- Si është e mundur? Si ka mundësi të gërmojnë pa dijeninë tonë?

- Kërkojnë të tyret, - tha specialisti.

- O Zot, m'u duk se kisha përpara syve një vegulli.

- Qeveria jonë ka bërë kontratë me shtetin e tyre një vit më parë, por ata u vonuan shumë me përgatitjet dhe filluan vetëm në verë, - vazhdoi specialisti.

- E kuptova. Gjeneral është?

- Gjenerallejtënant. Tjetri është kryetar bashkie.

Gjenerali buzëqeshi.

- Tani mungon një gjeneral me hoxhë, - tha.

- S'është çudi, - tha specialisti, duke qeshur. - Edhe turqit mund të vijnë ndonjë ditë.

Ndërsa ata bisedonin, dy të huajt që rrinin në këmbë pranë udhës ishin kthyer dhe po vështronin me kureshtje.

- Zbresim, - tha gjenerali dhe hapi derën e makinës. - Këta janë kolegët tanë. S'është keq të njihemi.

- E përse? - tha prifti.

- Mund të shkëmbejmë përvojë, - tha gjenerali duke qeshur.

Kur u afruan, gjenerali vuri re se gjenerallejtënantit i mungonte krahu i djathtë. Me dorën e majtë mbante një llullë të trashë, të zezë. Civili ishte i shëndoshë dhe pa flokë.

U njohën dhe biseduan një copë herë me një anglishte të keqe, në kohën që shoferët e kamionëve seç po i kërkonin njëri-tjetrit.

Pas dhjetë minutash i thanë "mirupafshim" njëri-tjetrit dhe u nisën.

Tani ishte hera e parë që po i takonin, qysh prej asaj dite.

- Ja ku janë, - tha gjenerali, kur hynë në restorant. U përshëndetën që larg me kokë.

Darkën e hëngrën pothuaj në heshtje. Specialisti me priftin këmbyen tek-tuk ndonjë fjalë, ndërsa gjenerali rrinte i vrenjtur dhe si i fyer.

Pas darkës, specialisti u ngjit në dhomën e tij, kurse ata të dy u kthyen në hollin e hotelit. Gjenerallejtënanti me kryetarin e bashkisë po pinin cigare në një kënd.

- Çdo mbrëmje rrimë këtu, - tha kryetari i bashkisë. - Kemi një javë të tërë në këtë qytet dhe ja, kështu i kalojmë mbrëmjet. Ku të vemi? Në verë, thonë se këtu është bukur. Ka liqen, madje, ka edhe një lokal vallëzimi, kurse në këtë kohë s'ka as turistë të huaj dhe nga liqeni fryn ditë e natë erë e ftohtë.

- Mund të vinim në këtë qytet edhe më parë, - tha gjenerallejtënanti, - por vazhdonin ndeshjet e futbollit dhe nuk na lejuan të bënim gërmime në stadium pa mbaruar kampionati.

- Mendoni ç'pengesë e çuditshme! - tha civili.

- Kishin të drejtë, - tha gjenerallejtënanti, - megjithëse hapja e gropave mund të fillonte anëve dhe jo nga fusha e futbollit, por, sidoqoftë, nuk ishte e këndshme për ne që njerëzit të brohorisnin për golat në kohën që ne kërkonim eshtrat.

- Edhe për ta nuk do të ishte e këndshme, besoj, të kishin varre të hapura përpara syve, - tha gjenerali.

- Unë mendoj të kundërtën, - tha civili. - Ata do të kënaqeshin, ndoshta, nga kjo gjë.

- Ka të ngjarë që të kënaqeshin, - tha gjenerallejtënanti. - Megjithatë, s'mund ta vë dorën në zjarr.

Gjenerali vështroi dorën e tij të vetme, me të cilën mbante llullën, dhe mëngën boshe të kapotës ushtarake, të futur në anën e majtë të setrës.

Me siguri do ta ketë prerë përmbi bërryl, mendoi. Kjo hamendje kishte kohë që po e bezdiste.

- Nuk kuptoj si ka pasur mundësi të ndërtohet stadiumi mbi varrezat! - tha prifti. - E drejta ndërkombëtare e ndalon këtë gjë. Ju duhej të ankoheshit.

- U ankuam, - tha gjenerallejtënanti, - por doli se trupat e ushtarëve tanë nuk janë varrosur prej tyre, por prej vetë trupave tona dhe, ç'është më e keqja, janë varrosur natën; asnjeri s'e ka ditur këtë.

- Nuk e besoj fort këtë, - tha civili.

- Edhe unë s'para e besoj, por s'mund të vë dorën në zjarr, - tha gjenerallejtënanti.

Gjenerali përsëri ia nguli sytë krahut të tij cung.

- Neve s'na kanë ndodhur raste të tilla, - tha.

- Ku bëni gërmime tani? - pyeti civili.

Gjenerali tha emrin e vendit.

- Më duket se ju keni lista të përpikta. Kurse ne i kemi përpiluar listat në bazë të tregimeve gojore.

- Pothuajse kërkojmë në tym, - tha civili.

- Do ta keni vështirë.

- Shumë, - tha gjenerallejtënanti. - Me siguri, kemi për të gjetur vetëm disa qindra ushtarë dhe më të shumtët nuk kemi për t'i njohur dot.

- Njohja është e vështirë, kur nuk ka lista të përpikta.

- Ju, sigurisht, e keni gjatësinë e çdo ushtari dhe shënimet për dhëmbët.

- Po, - u përgjigj prifti.

- Përveç kësaj, ushtarët tuaj mbanin të gjithë një medaljon, më duket.

- Pikërisht.

- Kurse listat tona nuk e kanë gjatësinë e të gjithëve dhe kjo na pengon shumë.

- Lavdi Zotit, na ndihmon tokëza e rripit të mesit, - tha civili.

Në holl hynë dy djem dhe u ulën në ndenjëset pranë portës prej qelqi, që dilte në kopsht, andej nga duhej të ishte liqeni.

- Çfarë pastruesi përdorni ju për eshtrat? - pyeti civili.

- "Universal-62".

- Dezinfektant i mirë. Por më i mirë dihet kush është: toka.

- Është e vërtetë. Por ka raste që edhe toka nuk është në gjendje ta bëjë një gjë të tillë.

- Ju ka qëlluar të gjeni trupa të paprishur?

- Posi.

- Neve, gjithashtu.

- Janë shumë të rrezikshëm.

- Rreziku i infektimit është i përhershëm. Qëllon që mikrobi i bën qëndresë shumë vite asgjësimit dhe në çastin e zhgroposjes tërbohet.

- Ju ka ndodhur ndonjë fatkeqësi?

- Deri tani jo.

- A dëshironi një kafe? - tha gjenerallejtënanti.

- Unë, jo, ju falemnderit, - tha prifti. - Do të ngjitem të fle.

- Edhe unë po ngrihem, - tha civili. - Kam për të shkruar një letër.

Ata u thanë "natën e mirë" gjeneralëve dhe u ngjitën nëpër shkallët e mbuluara me qilim të kuq. Në holl ishte qetësi. Vetëm dy djemtë bisedonin në këndin tjetër dhe herë-herë dëgjohej ndonjë fjalë e tyre.

Gjenerali vështronte qelqnajën, prapa së cilës nxinte errësira.

- U lodhëm, - tha, - dhe kushedi sa do të lodhemi ende.

- Është truall i keq.

- Shumë i keq. Me rastin e kësaj pune që po kryej, jam duke studiuar ca çështje të taktikës së luftës së sotme në zonat malore. Mirëpo, sikur nuk po më ecën. Një truall i tillë...

Tjetri bënte sikur dëgjonte, por dukej që mendjen e kishte gjetkë.

- Ja kështu, - tha gjenerallejtënanti, - në stadiumin ku po bëjmë tani gërmime, vjen vazhdimisht një vajzë e bukur dhe pret të fejuarin, kur ai ka stërvitje. Kur bie shi, vesh një mbipetk blu dhe rri aty në një këmb, nën shtyllat e tribunës, duke ndjekur me sy lojtarët që stërviten. Stadiumi i zbrazët është i trishtuar. Shkallët prej çimentoje janë të lagura. Gropat nxijnë anëve. E vetmja gjë e bukur është ajo, me atë mbipetk të tejdukshëm blu. Unë rri dhe e vështroj sa kohë që është aty, ndërsa varrmihësit punojnë më tutje dhe ky është për mua i vetmi dëfrim në këtë qytet.

- Nuk është tmerruar kur ka parë si nxirren eshtrat? - pyeti gjenerali.

- Aspak, - tha tjetri. - Ka kthyer kokën nga ana tjetër, duke ndjekur me sy të fejuarin, që rend në fushë.

Ata nuk folën për një kohë të gjatë; thithnin cigaret, të rrasur në ndenjëset e rënda.

- Ne jemi varrmihësit më të mëdhenj të botës, - tha gjenerali pothuaj duke qeshur. - Kudo që të jenë fshehur këta ushtarë të vdekur, ne do t'i gjejmë. S'na shpëtojnë dot.

Gjenerallejtënanti ia nguli sytë.

- E dini? - tha. - Kam shumë net që po shikoj të njëjtën ëndërr.

- Edhe unë shoh ëndrra të këqija.

- Më duket sikur jam në stadiumin ku vazhdojnë gërmimet, - vazhdoi gjenerallejtënanti. - Vetëm se stadiumi më ngjan më i madh dhe shkallët janë të mbushura plot me njerëz. Midis tyre është ajo vajza me mbipetk blu. Pas çdo varri që hapim, mizëria e njerëzve brohoret dhe gjithë stadiumi ngrihet në këmbë, duke thënë me zë të lartë emrin e ushtarit. Unë mundohem të marr vesh emrin, por zëri i turmave vjen i mbytur si një bubullimë dhe nuk dalloj dot asgjë. Dhe merreni me mend që kjo më ndodh pothuaj çdo natë.

- Kjo ndodh kur njeriut i rri mendja te një gjë, - tha gjenerali.

- Po, po, është ■ vërtetë. Njohja e ushtarëve mbetet problemi ynë kryesor.

Gjeneralit iu kujtua një ëndërr e tij, pak a shumë ■ ngjashme. I qe bërë në ëndërr sikur ishte plakur dhe ■ kishin bërë rojtar në një "varrezë vëllezërish" pikërisht atje ku qenë rivarrosur ushtarët që ai kishte qëmtuar në Shqipëri. Varreza ishte e madhe, pa fund dhe në rrugicat midis varreve shkonin e vinin mijëra njerëz me ca telegrame të çuditshme në duar, duke kërkuar të afërmit e tyre. Por, me sa dukej, nuk i gjenin varret e atyre që kërkonin dhe atëherë fillonin të tundnin kokat me kërcënim, ashtu, mijëra e mijëra, siç ishin, dhe atij i hipte një frikë e madhe. Por pikërisht në atë kohë prifti i binte kambanës dhe të gjithë ata zhdukeshin dhe ai zgjohej.

Gjenerali deshi ta tregonte ëndrrën, pastaj ndërroi mendje, sepse pati frikë se mos tjetrit i dukej e shpikur.

- Punë të vështirë kemi përpara, - tha.

- Po, - tha tjetri. - Kjo që bëjmë ne është njëfarë dyzimi i luftës.

- Ndoshta, më keq.

Ata heshtën një copë herë.

- A ju bëjnë ngacmime? - pyeti gjenerali.

- Jo, nuk ka qëlluar, me përjashtim të një rasti kur na zunë vocërrakët me gurë.

- Ju zunë me gurë? - Gjenerali qeshi, pastaj, duke i afruar kokën te veshi, tha me zë ngacmues: - Ç'proçkë keni bërë?

- Oh, ishte një punë e ngatërruar, - iu përgjigj tjetri. - Hapëm gabimisht ca varre shqiptarësh, që na u dukën si tonat.

- Ashtu?

- Punë dreqi. As që dua ta kujtoj. Pimë dhe nga një kafe?

- Do të mbetemi pa gjumë gjer në mëngjes.

- Punë e madhe. S'kemi për të parë ëndrra. Në fund të fundit, çdo gjë që përsëritet është e mërzitshme.

Gjenerali tundi kryet.

- Ashtu është.

Ata porositën kafe.

KRYE PA NUMËR

Ç'të shkruaj tjetër? Gjithçka tjetër është një kronikë monotone. Shi dhe baltë dhe lista, procesverbale, gjithfarë shifrash e hamendjesh, një teknologji e tërë e zymtë. Veç kësaj, kohët e fundit po më ndodh diçka e habitshme. Porsa shoh një njeri, menjëherë, padashur, filloj t'i heq në fillim flokët, pastaj mollëzat, faqet, sytë, si diçka të panevojshme, madje, që më pengon të depërtoj në thelbin e tij; dhe e përfytyroj këtë njeri pa to, vetëm me kafkën dhe dhëmbët (të vetmet gjëra të qëndrueshme në fytyrë). Më kupton? Më duket sikur kam hyrë në mbretërinë e kalciumit.

KREU I SHTATË

- Kjo ndodhi në fillim të luftës, - tha kafetari, me një anglishte të shqepët. Ai kishte punuar diku në një bar në Nju-Jork dhe dukej sikur gjithë zhurmat dhe topitja e një bari të natës ishin futur në të folurën e tij. Gjenerali kishte kërkuar që t'i tregonte historinë e prostitutës ndonjë nga banorët e këtij qyteti malor të lashtë e të gurtë. Të gjithë kishin thënë se kafetari dinte të tregonte si rrallëkush, veçse i merrej pak goja dhe anglishten e fliste keq.

S'ka gjë se i merret goja, kishte thënë me vete gjenerali, dhe s'ka gjë se flet një anglishte të shkatërruar. A nuk është, vallë, çdo gjë e shkatërruar në këtë punë?

Emrin e prostitutës e kishin parë në mëngjes në varrezën ushtarake në rrethinën e qytetit. Ajo ishte e vetmja femër midis të vdekurve të gjetur gjer atëherë dhe gjenerali deshi

të dëgjonte historinë e saj, kur i thanë se ajo femër kishte një histori.

Gjenerali e kishte parë pllakën e bardhë që larg. Binte edhe më shumë në sy midis kryqeve të kalbura e të nxira, që përbri saj ngjanin edhe më të shtrembra, ashtu siç ngjanin më të ndryshkura helmetat.

- Pllakë mermeri, - kishte thënë gjenerali. - Ndonjë oficer madhor? Ndoshta, koloneli Z.?

Ata ishin afruar te varri dhe kishin lexuar mbishkrimin e gdhendur: "Rënë për Atdhe". Në pllakë ishin shkruar emri, mbiemri dhe vendlindja e një femre. Gjenerali nuk i tha asnjeriu se ajo ishte nga krahina e tij.

- Kjo ndodhi në fillim fare, - tha kafetari, me një zë të tillë sikur të fliste përpara një grumbulli të madh. Ngaqë e kishte treguar shumë herë këtë histori, ai kishte përpunuar njëfarë stili të vet në të treguar, duke hapur kllapa të shumta, për të shprehur herë pas here mendimin e tij për ngjarjen. Ishte njëfarë retorizmi, që, megjithatë, nuk arrinte të ngrihej gjer në teatralitet. - Unë isha ndër të parët që e mora vesh lajmin, - vazhdoi ai, - jo se më joshnin histori të tilla, por vetë puna ime në kafene më bënte të mësoja i pari çdo ngjarje të qytetit. Kështu ndodhi dhe atë ditë. Kafeneja ishte plot, kur u hap fjala, të cilën nuk u mor vesh kush e solli. Disa thanë se e solli një ushtarak që po shkonte për në frontin grek, i cili fjeti një natë në hotelin e qytetit pasi u deh e u bë tapë. Disa të tjerë thanë se e solli Lame Spiri, një horr që vetëm në gjëra të tilla e kishte mendjen. Por kjo s'kishte asnjë rëndësi. Ne u habitëm dhe u tronditëm kaq shumë nga ky lajm, saqë nuk menduam në e solli vërtet ai ushtaraku i dehur apo ai lapërdhari Lame Spiri.

E vërteta është se, në atë kohë, ne nuk habiteshim lehtë, sepse ishte kohë lufte dhe veshët na dëgjonin gjithfarë çarturish. Ne kujtonim se asgjë nuk mund të na çudiste më që nga dita kur, për herë të parë, pamë nëpër rruginat e qytetit topat me tyta të gjata, që kaluan me rrapëllimë të tillë, saqë dukej sikur do të shembej qyteti. E, aq më tepër, kur pamë një luftim aeroplanësh mbi kokat tona dhe sa e sa gjëra të tjera që erdhën më pas.

Pastaj pati një kohë që në qytet nuk flitej veçse për atë pilotin anglez të rrëzuar në të dalë të qytetit. Unë e pashë me sytë e mi dorën e pilotit, e vetmja gjë që kishte mbetur nga trupi i tij. E pashë kur ia treguan popullit në sheshin e bashkisë, bashkë me një copë këmishë të djegur. Dora ishte si një dërrasë e verdhë dhe në gishtin e mesit kishte një unazë, që nuk ia kishin hequr ende.

Kështu, pra, ne dëgjonim shumë gjëra të tilla dhe ishim mësuar me të papritura, megjithatë, lajmi se do të hapej shtëpia publike na tronditi keq. Mund të prisnim çdo gjë, por jo këtë lajm. Kaq e beftë ishte kjo, saqë, në fillim, shumica nuk e besuan. Qyteti ynë është shumë i vjetër, ai kishte parë kohëra dhe zakone të ndryshme, por një gjë të tillë nuk e priste kurrë. Dhe si mund ta duronte, në pleqërinë e tij, një turp të tillë ky qytet, që kishte jetuar tërë jetën me nder? Si? Kjo pyetje i çoroditi fare njerëzit. Diçka e panjohur dhe e frikshme po i vinte rrotull jetës sonë, sikur të mos mjaftonin pushtimi, kazermat e ushtarëve të huaj, bombardimet, uria. Nuk e kuptuam se edhe kjo ishte një copë e luftës, ashtu siç ishin një copë e luftës bombardimet, kazermat dhe uria.

Të nesërmen e asaj dite që u hap lajmi, një dërgatë pleqsh shkoi në bashki dhe, po atë natë, të tjerë njerëz u mblodhën

në kafene, për t'i bërë një letër mëkëmbësit të perandorit në Tiranë. Ata qëndruan shumë orë, ja, tek ajo tryeza atje, duke shkruar e shuar vazhdimisht, ndërsa të tjerët rrinin në këmbë rrotull tyre, porositnin kafe, pinin duhan, hynin e dilnin për të mbaruar punët e tyre dhe prapë ktheheshin e pyesnin se si vente puna e letrës. Por nuk ishte lehtë të bëhej kjo letër. Shumë familje u shqetësuan dhe dërgonin fëmijët për të parë se mos burrat po deheshin në kafene, ngaqë pakkush e besonte se të shkruarit e një e letre, qoftë edhe kur i drejtohej mëkëmbësmbretit, mund të ishte aq i mundimshëm.

Asnjëherë nuk e kisha mbyllur kafenenë aq vonë, sa atë natë. Më në fund, letra u mbarua dhe dikush e lexoi. Nuk më kujtohet mirë se çfarë shkruhej në të. Di vetëm se, midis të tjerave, thuhej se, për shumë arsye, që numëroheshin me radhë, qytetarët e ndershëm të qytetit tonë i luteshin mëkëmbësit që të shnjihej vendimi për të hapur shtëpinë publike, për hir të nderit të qytetit tonë, që ishte aq i vjetër sa nuk mbahej mend dhe i panjollosur kurrë.

Të nesërmen letra u dërgua.

Është e vërtetë që pati njerëz që nuk deshën të bëhej kjo letër dhe që, në përgjithësi, ishin kundër çdo lloj letre dhe kërkese të tillë ndaj pushtuesit. Por ne nuk i dëgjuam ata dhe kishim besim se diçka do të bëhej. Atëherë ishte fillimi i luftës dhe shumë gjëra nuk i kuptonim ose i kuptonim mbrapsht, ashtu siç qe e mbrapshtë çdo gjë.

Lutja jonë nuk u mor parasysh. Pas ca ditësh erdhi një telegram: "Shtëpia publike do të hapet, sepse ka karakter strategjik pikë". Telegrafisti plak, që e lexoi i pari telegramin, në fillim nuk e kuptoi fare këtë shprehje. Disa thanë se kjo

ishte një nga ato shifrat e fshehta të ushtrisë, që as dreqi vetë s'mund t'i zbërthente dot. Ti mund të lexoje në telegram fjalët "Shqipëri etnike" e pas tyre fshihej gruaja e trashë e kryetarit të bashkisë e kështu me radhë. Sipas kësaj logjike, dikush tha se qenkëshim mërzitur kot gjer tani dhe se s'paskësh qenë fjala për hapjen e shtëpisë publike, por të frontit të dytë!

Mirëpo ngushëllimi nuk vazhdoi gjatë. Shumë shpejt u bë e qartë: do të hapej bordelloja dhe jo fronti i dytë.

Pas ca ditësh erdhën edhe hollësitë. Shtëpinë publike do ta hapnin trupat pushtuese dhe vajzat do t'i sillnin nga jashtë shtetit.

Në ato ditë, në qytetin tonë nuk kishte tjetër bisedë veç kësaj. Ata që kishin qenë në mërgim rrëfenin gjithfarë kureshtish. Merrej me mend se ato që tregonin ishin të qena e të paqena. Flisnin për kuplaratë e Japonisë e të Portugalisë, sikur t'i dinin me pëllëmbë këto vende dhe sikur t'i njihnin me emra të gjitha kurvat e botës.

Ata që dëgjonin, tundnin kryet me dëshpërim, sepse shqetësoheshin për djemtë e, natyrisht, për dhëndurët. Kurse nëpër shtëpi gratë, me siguri, i brente dyshimi edhe më shumë dhe ishte vështirë të thoshe se për kë shqetësoheshin më fort, për djemtë apo për burrat. Më të moçmit e quanin këtë gjë shenjën më ogurzezë të kohës, zemra u ndillte zi dhe prisnin me zemër të ngrirë një ndëshkim edhe më të madh nga Zoti. Me siguri, pati dhe njerëz që u gëzuan, sepse bota ka gjithfarë karafilash, por asnjeri nuk guxoi ta shprehte hapur. Kishte burra që nuk shkonin mirë me gratë, por kishte edhe ndonjë pusht e, sidomos, ca djem të rinj, që lexonin gjithë ditën romane dashurie dhe s'dinin ç'të bënin kur vinte mbrëmja. Disa mundoheshin të ngushëllonin veten dhe të

tjerët, duke thënë se, këtej e tutje, ushtarët e huaj nuk do t'u binin më në qafë vajzave tona, sepse do të kishin të tyret. Po ky ishte një ngushëllim i paktë.

Më në fund, *ato* erdhën. I solli një makinë e bierë ushtarake. Më kujtohet si tani. Porsa kishte rënë muzgu dhe kafeneja ishte plot me njerëz. Në fillim nuk e kuptova pse lëvizën njerëzit dhe u afruan te qelqet për të vështruar përjashta. Pastaj disa u sulën te sheshi dhe të tjerët pyesnin se ç'po ndodhte. Shumë tavolina u zbrazën. Edhe nga kafeneja tjetër, që ishte përballë, kishin dalë njerëz që po rrinin në trotuar e vështronin. Makina ishte ndalur mu përpara shtatores së qytetit tonë dhe *ato* porsa kishin zbritur dhe vështronin gjithë habi përreth. Ishin gjashtë dhe ishin të lodhura e të kapitura nga rruga e gjatë. Njerëzit çakërritnin sytë rrotull tyre, sikur të shihnin kafshë të rralla, kurse *ato* vështronin të qeta, madje, disa buzëqeshnin me shpërfillje. Mbase u vinte çudi se si u gjendën ashtu papritur në këtë qytet të pazakontë të gurtë, sepse qyteti ynë në muzg duket si diçka e fandaksur, me pirgjet e kështjellës dhe minaret e heshtura, që ngrihen përpjetë, me majat e veshura me fletë hekuri, që shkëlqejnë nga rrezet e diellit në perëndim.

Ndërkaq, sheshi u mbush plot. Ndonjëri u thoshte ndonjë fjalë të huaj të mësuar nga ushtarët. Të tjerët heshtnin. Ishte vështirë të kuptonim edhe ne vetë se ç'kishim në shpirt ato çaste. Vetëm një gjë kuptuam mirë atë mbrëmje. Kuptuam se të gjitha ato tregimet për kuplaratë e Tokios apo të Honolulusë ishin diçka krejt tjetër nga kjo që kishim përpara, se kjo ishte një gjë krejt e ndryshme, shumë më e trishtueshme dhe më fatzezë se ato.

Grupi i tyre i vogël, i shoqëruar nga disa të huaj dhe nga një nëpunës i bashkisë, si një kope e bindur, u drejtua nga hoteli i qytetit. Atje fjetën atë natë këto bujtëse të çuditshme.

Të nesërmen i vendosën në një shtëpi dykatëshe me kopsht, në qendër të qytetit. Te porta e shtëpisë u vu një dërrasë e vogël, ku ishte shkruar orari për civilë dhe për ushtarakë. Këtë dërrasë, ne të gjithë e pamë më vonë, sepse ditët e para rruga e tyre u zbraz, sikur të kishte rënë kolera. Vështirë e patën sidomos banorët e rrugicës. Ata që mundën u shpërngulën, disa që kishin oborre hapën porta të prapme, që dilnin në rrugicën fqinjë. Të tjerët, bënë ç'bënë, ■ pajtuan me mynxyrën. Vetëm pleqtë e sidomos plakat kryeneçe u mbyllën brenda. U dërguan fjalë shoqeve të tyre: as të vij, as mos më eja, dhe e bënë me bé të mos dilnin më nga shtëpitë, veç kur t'i nxirrnin me tabut për t'i çuar në varrezë. Dhe kështu do të ndodhte vërtet, sepse, për kryeneçësi, plakave të qytetit tonë s'ua kalonte kush, kështu, pra, do të ndodhte, sikur një tjetër tabut të mos i ndryshonte gjërat. Por kini durim.

Rrugica, pra, u shëmtua në sytë tanë. Kaq e fortë ishte neveria për të, saqë më pas, kur historia ishte mbyllur, sa herë që na binte rasti të kalonim nëpër të, ajo na dukej e huaj krejtësisht, si ajo gruaja e përdhunuar, që, shumë kohë më pas, ende ruan gjurmët e turpit.

Këto ishin me të vërtetë ditë të zymta dhe të shqetësuara për të gjithë. Qyteti ynë nuk kishte pasur kurrë gra të liga dhe skandalet familjare, për arsye xhelozie apo tradhti, ishin një gjë fare e rrallë. Dhe ja, tani, papritur, kjo pikë e zezë mu në mes të qytetit. Trazimi i njerëzve, kur erdhi lajmi, nuk ishte

asgjë përpara këtij të tanishmit, kur shtëpia publike u hap vërtet. Tani burrat shkonin herët nëpër shtëpitë e tyre dhe kafeneja zbrazej shpejt. Gratë dyshonin, po t'u vononeshin burrat, dhe bëheshin si të marra. *Ato* ishin si një tumor në mes të qytetit tonë. Njerëzit u bënë nervozë dhe në sytë e shumë burrave dhe djemve të rinj dukej herë-herë një turbullirë.

Merret me mend që, në fillim, asnjeri nuk shkonte atje dhe, me siguri, *ato* do të jenë habitur dhe do të kenë thënë midis tyre se ç'popull i çuditshëm ishte ky që nuk e çante kokën fare për femra. Ose edhe ato vetë e kanë kuptuar se qenë të huaja në këtë vend dhe se nuk ishin veçse pjesë e ushtrisë pushtuese.

Siç pritej, i pari që shkoi në shtëpinë publike ishte ai horri i horrave Lame Kareco Spiri. Atë pasdite që ai u fut atje, lajmi u përhap sakaq, kështu që, kur doli, dritaret ishin plot me njerëz që vështronin me sy të shqyer sikur të qe ngjallur Krishti. Lame Kareco Spiri ecte krenar në rrugë dhe nuk i bënte tërr syri. Madje, tek po largohej, ia bëri me dorë njërës prej *atyre*, që po rrinte në dritare. Atë çast, nga një shtëpi, një plakë i hodhi një vedër me ujë. Ndërkaq, të gjitha prostitutat dolën në tremen e shtëpisë dhe vështronin, duke qeshur, mizërinë e njerëzve që kishin mbushur dritaret e shtëpive përballë. Plakat shkulnin faqet, i mallkonin, u jepnin munxat (kështu i thonë në qytetin tonë lëvizjes që bën njeriu, duke hapur të pesë gishtat e duke e tundur dorën në drejtim të atij që mallkon). Por *ato*, siç duket, nuk kuptonin gjë dhe qeshnin.

Kështu ishte në fillim. Por pastaj njerëzit u mësuan edhe me këtë gjë. Madje, kishte edhe nga ata që filluan të shkonin

fshehurazi, cubnisht, siç i thonë, për të kaluar natën me to. Kaloi ca kohë dhe *ato* u futën, si të thuash, në jetën tonë.

Shpesh qëllonte që mbrëmjeve dilnin në treme, pinin cigare dhe vështronin si të hutuara malet përreth dhe, me siguri, u kujtohej vendi i tyre. Rrinin shumë kohë kështu në gjysmerrësirë, ndërsa myezini, nga maja e minaresë, këndonte mbrëmjesoren me një zë të zvargur dhe njerëzit ktheheshin nga tregu për në shtëpi.

Kaloi ca kohë dhe nuk ndienim më ndonjë urrejtje kushedi çfarë për to. Kishte dhe njerëz që u vinte keq.

U duk sikur po mësoheshin dalëngadalë me praninë e tyre. Tani nuk u nxihej më jeta, kur i takonin rastësisht në ndonjë tregtizë apo të dielave në kishë, me përjashtim të plakave, që luteshin ditë e natë të binte ndonjë "bombë e inglizit" mbi atë shtëpi të nëmur. Besoj që kishte ditë që edhe *ato* do ta dëshironin një gjë të tillë.

Jo shumë larg këndej ishte fronti italo-grek dhe netëve dëgjohej bubullima e topave. Qyteti ynë ishte vend ndalimi, si për trupat e freskëta që shkonin në front, ashtu dhe për trupat që ktheheshin nga fronti.

Shpeshherë, te porta e shtëpisë publike varej një lajmërim: "Nesër civilët nuk pranohen" dhe të gjithë e merrnin vesh se të nesërmen do të kishte lëvizje në front. Lajmërimi, dihej, vihej fare kot, sepse askush nuk shkonte kur kishte ushtarë, me përjashtim të Lame Kareco Spirit, që, si bjerrakohës që ishte, e kapërcente pragun orë e pa kohë.

Në ato ditë, ne shkonim andej për të shikuar ushtarët e kthyer nga vija e parë e frontit, që prisnin në rreshta të gjatë përpara portës, të ndotur, të parruar e të palarë. Ata nuk e prishnin radhën edhe kur binte shi dhe, me siguri, ishte

më lehtë t'i shkulje nga llogoret, sesa nga ky rresht i gjatë, i shtrembër e i trishtuar, që dukej sikur s'do të mbaronte kurrë. Tek rrinin ashtu në shi, bënin mahi të turpshme, çmorriteshin, thoshin fjalë të ndyra dhe grindeshin për kohën që do të kalonin brenda. Kuptohet sa vështirë e kishin *ato*, por duhej të bindeshin, sepse, në fund të fundit, quheshin ushtarake.

Aty nga pasditja, rreshti zvogëlohej fare, derisa, më në fund, ikte dhe ushtari i fundit dhe mbyllej porta e çdo gjë binte në qetësi. Zakonisht, të nesërmen, pas këtyre ditëve të lodhshme, *ato* dukeshin të kapitura e të verdha në fytyrë e me ca sy më të hutuar se kurrë. Dukej sikur ata ushtarë të kthyer, tërë mërzinë, shiun, baltën dhe humbjen e llogoreve e shkarkonin mbi ato vajza të mjera dhe vetë iknin tutje, të lehtësuar, si të kishin flakur nga supet një barrë të rëndë, kurse ato mbeteshin këtu, në qytetin tonë, pranë frontit, për të pritur prapë ushtarë të tjerë, që, kështu, të pinin gjer në fund helmin e thyerjes.

Ndoshta, kështu do të kishte vazhduar gjithmonë dhe nuk do të kishte ndodhur asgjë e jashtëzakonshme, sepse, në fund të fundit, jeta bën punën e saj. Ndoshta, *ato* do ta kishin kaluar gjithë kohën e luftës në qytetin tonë, do të ngrysnin ditët e mërzitshme duke pritur e përcjellë rreshta të gjatë ushtarësh, që kushedi pastaj nga i çonte fati. Ndoshta, mund të kishte ndodhur kështu, por, një ditë, djali i Ramiz Kurtit la të fejuarën.

Qyteti ynë është i vogël dhe ngjarje të tilla bëjnë bujë. Aq më tepër, po të mendosh se rrallë mund të gjesh një qytet ku të ketë më pak ndarje se këtu te ne. Ndarja e djalit të Ramizit nga e fejuara shkaktoi një trazim të madh. Shumë

net me radhë u mblodh në shtëpinë e Ramiz Kurtit gjithë farefisi i tij për të pleqëruar këtë punë. Me kërcënime donin ta kthenin djalin prapë tek e fejuara. Djali ngulte këmbë tek e tija dhe s'donte që s'donte. E keqja ishte se ai nuk tregonte arsyen e kësaj ftohjeje. Rrinte gjithë ditën i ngrysur si korb dhe sa vente, tretej e zbehej në fytyrë, sikur t'i kishin bërë magji.

Ndërkaq, familja e vajzës dy herë dërgoi njerëz te Ramiz Kurti për të kërkuar shpjegime. E meqenëse kurrfarë shpjegimesh s'u dhanë, ata ikën gjithë vrer e kërcënim. Kjo do të thoshte se pas fjalëve do të kërciste pushka dhe, vërtet, pushka krisi, po ndryshe nga ç'e mendonim.

Pikërisht ato ditë, kur dy familjet po bënin bisedimet e fundit, ndërsa ndienin se si miqësia e tyre e vjetër, që kishte lindur bashkë me fejesën e djalit dhe të vajzës që në djep, po kthehej në armiqësi, në një armiqësi të gjatë, mortore, u mor vesh shkaku i vërtetë i prishjes së kësaj fejese. Ai ishte sa i thjeshtë, aq edhe i turpshëm: djali i Ramiz Kurtit shkonte në shtëpinë publike. Ai shkonte gjithmonë te njëra nga vajzat.

Më vonë, ne shumë herë vramë mendjen dhe u përpoqëm të kuptonim se ç'marrëdhënie, vallë, kishte ai me atë femër të huaj. Mbase e donte vërtet? Apo mbase dhe ajo e donte? Askush nuk e di se ç'pati midis tyre. E vërteta nuk u mor dot vesh kurrë.

Ditën kur u hap fjala, Ramiz Kurti, aty më të ngrysur, dyllë i verdhë në fytyrë dhe pa kësulë, zbriti me stap në dorë nga lagjja e sipërme dhe u drejtua për në shtëpinë publike. Sytë i kishte si të ngrirë në akull dhe edhe lëvizjet ashtu i kishte, si prej njeriu të ngrirë. E merrni me mend sa do të jenë

çuditur *ato,* kur e panë atë plak me fytyrë të verdhë, që shtyu me shkop portën e hekurt. Kur plaku ngjiti shkallët, njëra nisi të qeshte, por kushedi se pse gazi u mbeti të tjerave në buzë dhe në kthinën e pritjes u bë një heshtje vdekjeje. Plaku tregoi me stap *atë*, me të cilën shkonte biri i tij (thonë se e njohu nga flokët) dhe vajza, e bindur, u drejtua për në dhomën e saj, duke kujtuar se ai ishte një nga të zakonshmit. Plaku i shkoi pas. Pastaj, ndërsa po bëhej gati të zhvishej, vajza kishte ngritur kokën dhe kishte parë fytyrën e tij, me atë shprehje të frikshme, aq e huaj për epshin, si të një maske. Ajo bërtiti nga tmerri. Ndoshta, plaku nuk do të kishte qëlluar me revolver, sikur të mos ishte kjo britmë. Britma sikur e zgjoi tjetrin nga gjendja e ngrirë. Ai shtiu tri herë, pastaj hodhi armën dhe iku si i dehur përmes ulërimave të vajzave.

Ramiz Kurtin e varën pas tri ditësh. I biri u zhduk.

Atëherë ishte tetor dhe nga grykat e maleve frynte një erë e ftohtë që s'pushonte as ditë, as natë. Megjithatë, për të vdekurën u përgatit një varrim madhështor, me kurora, muzikë dhe të shtëna pushkësh. Fashistët mundën të mblidhnin një turmë njerëzish nga rrugët dhe nga kafenetë dhe i detyruan të përcillnin në varreza të vrarën. Ne ecnim dhe s'flisnim dhe era na përcëllonte fytyrat. Atë e kishin vendosur në një makinë ushtarake, në një arkë të bukur, veshur me cohë të kuqe. Banda i binte një marshi të përzishëm dhe shoqet e saj qanin.

Asnjëherë qyteti ynë nuk kishte përcjellë arkëmortin e një gruaje të huaj, sidomos të një gruaje të tillë. Ne ishim si të nemitur. Ndienim një zbrazëtirë në shpirt. Kushedi ç'fatkeqësi e kishte shtyrë të varfrën të vinte kaq larg bashkë

me këta ushtarë me helmeta, prapavijë më prapavijë, gjer në qytetin tonë, ku qe e thënë të vdiste dhe të shkaktonte fatkeqësira. Mbase, edhe ajo mendonte të rregullonte jetën e saj, sepse çdo njeri mendon për jetën e tij, sado të mjerë ta ketë.

E varrosën në varrezat e ushtarëve dhe mbi varr i vunë atë pllakën e mermertë, që e patë ju vetë në mëngjes, me ato fjalët e zakonshme "rënë për atdhe", që ia vinin te koka çdo ushtari.

Pas ca ditësh erdhi një urdhër dhe shtëpia publike u mbyll. Më kujtohet si tani ai mëngjes i ftohtë, kur *ato* erdhën me valixhe në duar te sheshi i bashkisë, duke pritur makinën ushtarake që t'i merrte. Kalimtarët u ndalën në trotuar për t'i parë. *Ato* rrinin pranë njëra-tjetrës, duke u dridhur nga të ftohtët.

Kur hipën në makinë dhe kur makina u nis, pati ndonjë që ua bëri me dorë, ashtu me gjysmë zemre. Edhe ato ia bënë me dorë, por jo ashtu siç ia bëjnë me dorë, zakonisht, gratë e tilla, por ndryshe, me dëshpërim e lodhje. Ne i vështronim tek largoheshin dhe nuk ndienim ndonjë lehtësi në shpirt që *ato* ikën. Sepse gjithmonë kishim menduar se, kur të iknin ato, do të bënim festë e do të shtronim gosti. Por ja që s'ndodhi ashtu. Ato ikën vërtet, por gjithçka tjetër mbeti.

Ato kushedi nga i degdisën, me siguri, në ndonjë qytetth të humbur, atje ku ndaleshin për një natë trupat që shkonin në vijën e parë dhe trupat që ktheheshin andej. Dhe, me siguri, jeta e tyre ishte mbushur prapë me rreshta të gjatë e të përbaltur ushtarësh, që zbraznin mbi to gjithë hidhërimin dhe baltën e luftës.

Kreu i tetë

Në këmbë, te hyrja e tendës, gjenerali ndiqte me sy herë varrmihësit e herë lëvizjet e mjegullës mbi pllajë. Nganjëherë, ajo ulej kaq shumë, saqë dukej sikur do të ngecej te kulmaku i tendës.

Varrezës nuk i dalloheshin kufijtë. Rrëketë qenë vërtitur si gjarpërinj anëve të saj, duke gërryer secila aq tokë sa mundte, për ta çuar diku poshtë në luginë. Flamurthet e ngulur në tokë tregonin që larg vendet ku po gërmohej. Herë pas here varrmihësit grumbulloheshin te fundaja, çka do të thoshte se ishte gjetur edhe një ushtar. Njëri prej varrmihësve, zakonisht ai më i riu, rendte të merrte dezinfektantin, kurse një tjetër vraponte te kamioni për të kërkuar thesin. Gjenerali e merrte me mend si përkulej specialisti për të matur eshtrat dhe se si prifti vinte një kryqth në listë përbri emrit. Në rastet

kur përmasat nuk përkonin me ato të listës, atëherë, pas kryqthit shtohej një pikëpyetje.

Kur grupi i vogël vonohej sipër eshtrave, gjenerali ndiente një zbrazëtirë në lukth. Domethënë, po e masin për herë të dytë, mendonte. Domethënë, në listë do të ketë përsëri pikëpyetje.

Pastaj, punëtori që kishte rendur te kamioni kthehej me thesin e tejdukshëm, një thes i kaltër najloni me vija të bardha dhe me një shirit të zi, prodhim i firmës "Olympia", bërë me porosi të veçantë. Specialisti, duke mbajtur pincën me gishtat e gjatë, e hidhte medaljonin në një arkëz metalike.

Një ditë na kontrolluan a i kishim të gjithë medaljonet. Dikush kishte kallëzuar se ai e kishte hedhur medaljonin e tij. Ku e ke medaljonin? e pyeti togeri, kur ai zbërtheu uniformën dhe tregoi gjoksin. Nuk e di, u përgjigj, më ka humbur. Të ka humbur? Kurse mua më thanë se ti e hodhe vetë. Horr. Do të vdesësh si qen dhe asnjeri s'do ta njohë trupin. Dhe për të gjitha këto kemi përgjegjësi ne. Marsh, në burg, ulëriu. Dhe pas dy ditësh i dhanë një medaljon të ri.

Kur grumbulli shpërndahej, do të thoshte se eshtrat ishin futur në thesin prej najloni dhe sipër ishin shënuar emri i ushtarit dhe numri rendor i listës. Punëtori që e kishte sjellë thesin e çonte prapë te kamioni, të mbushur, tashmë.

Goditja e veglave dëgjohej prapë, e lodhshme, e njëtrajtshme. Gjeneralit i vinte gjumë. Kush të jetë, vallë, ky që u gjet tani? thoshte me vete sa herë që njerëzit grumbulloheshin diku. Dhe çdo herë i kujtoheshin fytyra të ndryshme, të zymta, në sallonin e pritjes, atje larg, në shtëpinë e tij, në ato ditë me

vranësira, kur ai porsa qe kthyer nga plazhi. Të gjithë ata që vinin, flisnin për të afërmit, dikush më tepër, dikush më pak. Një pjesë kishin me vete fotografi të shumta, të panevojshme, të vegjëlisë, të ditës së fejesës ose midis shokëve në taverně. Disa sillnin paketa të tëra letrash, kurse të tjerë nuk kishin asgjë, veç telegramit të shkurtër të Ministrisë së Luftës.

Gjenerali u mbështoll më fort me kapotë dhe hodhi sytë nga verilindja. Atje është përmendorja, tha me vete. Te shembëtira, atje ku kryqëzoheshin dy udhët dhe bënte zhurmë jazi i një mulliri të braktisur.

Kur mjegulla fillonte të lëvizte, atij i dukej se në çdo çast do të zbulonte përmendoren, ashtu të lartë e të hollë, të veshur me pllaka guri të bardhë, dhe prapa saj harqet e rrënuara të një shtëpie të vjetër, mbeturina gërmadhash, togje gurësh të nxirë dhe tutje, më të dalë të fshatit, mullirin ■ djegur e të braktisur, me ujët e jazit, që gurgullonte, e vetmja gjë që s'kishte mundur të shkatërrohej. Në ballinën e përmendores ishin gdhendur me shkronja të shtrembra fjalët: "Këtu kaloi famëkeqi Batalioni Blu, që dogji dhe griu këtë fshat, vrau gra dhe fëmijë dhe vari burrat nëpër shtylla telefoni. Për kujtim të të rënëve, populli ngriti këtë përmendore". Kurse fshati ishte zhvendosur më poshtë dhe vetëm shtyllat e telefonit, të vjetra, me pjesën e poshtme të lyer me serë, disa herë me nga një shtyllë ndihmëse të mbërthyer pjerrtas, krejt ato shtylla, në të cilat koloneli Z. kishte varur njerëz me dorën e tij, siç tregonin, ishin ende në vendet e tyre, kush më poshtë e kush më lart, me fijet e ndera në hapësirë.

Po edhe shtyllat e telefonit i mbulonte napa e bardhë e mjegullës dhe që andej nuk dukej asgjë. Dukej sikur mbi

përmendoren, shtyllat e telefonit, mullirin e vjetër dhe mbi harqet gjysmë të rrëzuara, atje, përtej, ishte hedhur një mbulesë e bardhë si përpara një përurimi të madh.

- Do të ftoheni, - tha prifti, duke hyrë në tendë. - Ajri është plot lagështirë.

Gjenerali u fut brenda. Ishte koha e drekës.

- E, si shkoi?

- Mirë, - tha prifti. - Në qoftë se nesër vijnë të punojnë kooperativistët e fshatit matanë përroit, besoj se pas katër ditësh do të shkulemi që këndej.

- Ata, besoj, do të vijnë, me përjashtim të grave, që e kanë për mëkat të hapin varre.

- Mbase do të vijnë edhe ato. Ndoshta, kjo punë u jep kënaqësi të fshehtë.

- S'e besoj, - tha gjenerali. - E kush mund të ndiejë kënaqësi nga varret?

- Për ta, kjo është njëfarë hakmarrjeje e vonë.

Gjenerali ngriti supet.

- Veç kësaj, është një punë fitimprurëse, - vazhdoi prifti. - Ne paguajmë mirë dhe fshatari, me disa ditë pune të tillë, mund të blejë një radio të vogël. Ata i kanë shumë qejf radiot.

- E kam vënë re, - tha gjenerali, përmes gogësimës. - Na u mërzit kjo tendë, - shtoi pas pak.

- Moti po ftohet çdo ditë. Besoj se kjo është hera e fundit që ngremë çadër në këtë zonë.

- Më duket se kemi dhe një vend tjetër, lart në male, pranë një rruge ushtarake, tashmë të braktisur.

- Ashtu?

- Janë ushtarët që ruanin rrugën apo një urë, s'më kujtohet

mirë, - tha gjenerali. - Një mendje më thotë t'i lë për verën e vitit që vjen. Kush futet në male në këtë kohë!

Jashtë u dëgjua një zhurmë motori. Prifti doli të shikonte.

- Ç'është? - pyeti gjenerali, kur prifti u kthye.

- Asgjë, - tha prifti. - Sollën bombola të reja me dezinfektant.

Gjenerali nxori termoset. Hëngrën në heshtje drekën me ushqim të thatë dhe gjenerali u mbështet në shtratin fushor, kurse prifti hapi një libër dhe nisi të lexonte.

Libër, tha me vete gjenerali, si të shihte gjënë më të papritur. Ishte përpjekur edhe vetë të lexonte, por kishte qenë e pamundur. Merr ca libra, i kishte thënë e shoqja ditën e fundit. Veç jo të zymtë, por çlodhës. Histori dashurie? kishte thënë ai duke qeshur. E pse jo? ishte përgjigjur ajo. Zymti do të kesh sa të duash.

Ç'të ketë bërë vallë me vejushën ▪ kolonelit? tha me vete, duke vështruar profilin e priftit dhe flokët e tij të butë e pa asnjë thinjë.

Ç'bukuroshe që ishte! mendoi dhe vuri duart nën zverk, pa i hequr sytë nga pjerrësia e tendës. Pikat e shiut u ndien mbi të përsëri.

Qielli ishte i kaltër, i kaltër, mendoi, dhe ajo ishte aq e bukur nën atë qiell, saqë të vinte të pyesje gati me nervozizëm: përse duhet të ketë gra kaq të bukura?

Atij iu duk sikur kjo kishte ndodhur shumë kohë më parë dhe jo në gushtin e atij viti, në një nga ato pasditet e mrekullueshme, kur dielli skuqte si një sy i madh i lodhur dhe aty-këtu nëpër cepat e horizontit, të lehta e të pasigurta, dridheshin njollat e para të mbrëmjes. Bregu i detit mbushej

plot me njerëz që shëtisnin. Gjithë shoqëria e tyre rrinin në tarracën e hotelit të madh dhe vështronin diellin që perëndonte dhe varkat e pulëbardhat mbi det. Në mbrëmje, kur ndizeshin reklamat e mëdha të hotelit e ato të dancingjeve, ata ngriheshin dhe shëtisnin në breg, bashkë me fëmijët, ose uleshin në fronet ndanë ujit.

Atë pasdite, në tarracë kishte shumë njerëz dhe shishet shkëlqenin e dukeshin të purpurta në rrezet e diellit. Përse flisnin? Ishte vështirë ta kujtonte përse flisnin. Ishte një nga ato bisedat e zakonshme, që fikej bashkë me ditën e nuk linte prapa asgjë veç gotave të zbrazura në tryezë.

Tek po rrinin ashtu, ai ndjeu se përtej, nga një tryezë tjetër, po e vështronin me ngulm. Ktheu kokën ngadalë dhe, për herë të parë, ndeshi sytë e saj, pastaj sytë e një plake dhe të dikujt tjetër përbri. Ata seç thanë për të, pastaj lëvizën kokat dhe prapë e vështruan me ngulm, kurse gruaja e re i buzëqeshi lehtë. Pastaj, papritur, njëri nga burrat u ngrit dhe u afrua pak i tronditur.

- Zoti gjeneral.

Kjo ishte njohja e parë me familjen e kolonelit Z. Ata kishin ardhur në plazh vetëm për të. Ishte gruaja e re, e bukur, nëna plakë e kolonelit dhe dy kushërinj të parë. Ata e kërkonin.

- Ne e morëm vesh që pikërisht juve jua kanë ngarkuar këtë detyrë sublime dhe të shenjtë, - tha zonja plakë, - dhe jemi të lumtur që u njohëm me ju.

- Ne për këtë gjë kemi ardhur.

- E kemi kërkuar gjatë gjithë luftës, - tha plaka. - Tri herë kam dërguar njerëz për ta gjetur dhe të tria herët janë kthyer

duarbosh. I katërti na gënjeu, mori paret dhe u zhduk. Kur dëgjuam se do të shkoni ju, na u ngjallën prapë shpresat. Oh, kemi shumë shpresë, biri im, kemi shumë shpresë te ju.

- Unë do të përpiqem, zonjë. Do të bëj çmos.

- Ishte aq i ri dhe aq i virtytshëm, - tha plaka dhe iu mbushën sytë me lot. - Të gjithë thoshin se do të bëhej një gjeni në çështjet ushtarake. Të njëjtën gjë tha dhe ministri i Luftës, kur na erdhi në shtëpi për të na ngushëlluar. Ai tha se ishte një humbje e madhe, një humbje shumë e rëndë për të gjithë. Por ai ishte biri im dhe hidhërimi më i madh më përkiste mua, më fal, Beti. Sigurisht, edhe ty, e dashur. Ti u tregove kaq e denjë për të, kaq besnike. Të kujtohet kur u kthye nga Shqipëria me leje ato dy javë? Vetëm dy javë dhe dasmën tuaj e bëmë shpejt e shpejt, se nuk priste koha. Kishte një detyrë aq të rëndësishme, saqë nuk mund të mungonte më shumë se dy javë atje në atë vend të mallkuar. Të kujtohet, Beti?

- Po, nënë, më kujtohet.

- Të kujtohet si qaje në krye të shkallëve, ndërsa ai po vishte uniformën dhe unë përpiqesha të të qetësoja ty dhe veten dhe pastaj papritur telefonuan nga Ministria e Luftës? Aeroplani nisej pas gjysmë ore dhe ai vrapoi shkallëve, të puthi ty dhe mua dhe iku. Oh, më falni, - tha plaka, - më falni që po flas kështu, unë jam sentimentale, - dhe fshiu lotët. - Kështu kam qenë gjithmonë.

Ditët e tjera, ata u miqësuan edhe më shumë dhe familja e kolonelit hyri në shoqërinë e tyre. Shkonin me ta të loznin tenis, bënin banjë, shëtisnin me varkë dhe rrinin mbrëmjeve në dancingjet buzë detit. Gruas së tij nuk i pëlqente kjo miqësi

e re, por nuk e bënte veten. Asaj nuk i pëlqente që ai shëtiste shpesh me Betin anës detit dhe nuk i pëlqente asgjë që ai bënte në prani të saj. Desha të di, çfarë bisedon kaq gjatë me të? Për kolonelin? E pse jo? Që të flasë plaka gjithë ditën për të, këtë gjë edhe mund ta kuptoj, por ajo... Nuk është e hijshme të flasësh kështu. Ata kanë një hall. Ata më lutën për diçka. Duhet të jem i njerëzishëm. Ah, i njerëzishëm... Nuk e kuptoj këtë shpoti. Dhe, në përgjithësi, nuk e kuptoj dot se si mund të ketë shpoti në raste të tilla, kur në mes është vdekja. Mjaft. Gjithë ky pasion i tepruar për burrin e vdekur njëzet vjet më parë, me të cilin ajo ka bashkëjetuar vetëm dy javë, ka vetëm një shpjegim... Ah, e di ç'do të thuash: pasuria e konteshës plakë, trashëgimia. Mjaft, s'dua më të dëgjoj gjëra të tilla. Detyra ime është të gjej e të sjell eshtrat e kolonelit. Për të tjerat s'dua t'ia di.

Pastaj, papritur, Beti u zhduk nja dy ditë dhe, kur erdhi përsëri, ai vuri re në sytë e saj një ftohtësi dhe një lodhje.

- Ku ishit? - e pyeti kur e takoi përpara hotelit. Ajo ishte me rroba banje dhe me syze të zeza dielli, nga ato që i ngjajnë një maske. Megjithëse ishte nxirë nga dielli, ai e kuptoi se ajo u skuq kur tha emrin e priftit.

Nisi të tregonte se si e vjehrra donte që me çdo kusht të porosiste priftin, nga ana e saj, për të birin, se si ajo mundi ta gjente, më në fund, pas adresës dhe e vjehrra u qetësua dhe...

Por ai nuk e dëgjonte. Vështronte trupin e saj të zhveshur si i mpirë dhe, për herë të parë, pyeti veten: ç'të ketë bërë prifti me të?

Pastaj ditët kaluan plot me diell dhe nëna plakë e kolonelit tregonte po të njëjtat gjëra, për virtytet e të birit, që kishte

qenë i lazdruari i Ministrisë së Luftës, dhe për lashtësinë e familjes së tyre, kurse Beti, herë pas here, zhdukej nga plazhi dhe, kur kthehej, ngjante pak si e lodhur dhe e ftohtë dhe ai i bënte vetes të njëjtën pyetje.

Shoqëria e tyre qëndronte përsëri pasditeve në tarracën e madhe të hotelit, duke pirë gjithfarë pijesh freskuese, kurse artistja e kinemasë, e njohura e tyre e fundit, i thoshte atij shpesh:

- Ju, zoti gjeneral, më dukeni njeriu më i çuditshëm në gjithë këtë plazh. Se ç'keni një vel misterioz dhe, kur mendoj se, pas gjithë këtyre ditëve të mrekullueshme, do të shkoni të mblidhni të vdekur atje në Shqipëri, rrëqethem nga tmerri. Ju më dukeni si heroi i baladës së një poeti gjerman, që e kemi bërë në shkollë, por që s'më kujtohet emri. Pikërisht si heroi i saj, që ngrihet nga varri dhe vrapon me kalë nën dritën e hënës. Nganjëherë më duket sikur do të më trokisni në dritaren e dhomës natën. Oh, ç'tmerr!

Dhe ai qeshte dhe e kishte mendjen gjetkë, kurse të tjerët mahniteshin nga perëndimi i diellit dhe nëna plakë e kolonelit përsëriste vazhdimisht:

- Sa i pëlqente atij çdo gjë e bukur në këtë botë! - dhe fshinte sytë.

Kurse Beti ishte po aq e bukur dhe e pakuptueshme si më parë dhe qielli po aq i kaltër, vetëm se, herë pas here, horizonteve filluan të shfaqeshin retë, re të zeza shiu, që udhëtonin për në lindje, drejt Shqipërisë...

Gjenerali u ngrit. Në tendë nuk kishte njeri. Pikat e shiut nuk ndiheshin më dhe, siç dukej, jashtë kishte rifilluar gërmimi. Doli te hyrja e tendës dhe pa se përjashta ishte po

ajo mjegull e lagët që mbulonte shkarëzimat gjithë gurë. Ai ndoqi një copë herë me sy rabeckat që fluturonin ultas, pastaj iu duk se mjegulla nisi të lëvizte drejt verilindjes, atje ku duhej të ishin përmendorja dhe shtyllat e vjetra të telefonit, me fijet e ndera në hapësirë.

KREU I NËNTË

Prifti ndezi llambën me vajguri dhe e vuri mbi tryezën e vogël. Hijet e tyre zunë të lëkundeshin dhe të përthyheshin më dysh në kulmin e pjerrët të tendës.

- Ftohtë, - tha gjenerali, - kjo lagështirë e mallkuar po më hyn në palcë.

Prifti nisi të hapte një konservë.

- Do të durojmë gjer nesër, - tha.

- S'më durohet sa të shkulemi që këndej. Më duket vetja si njeri i egër dhe, veç kësaj, jemi krejt të palarë.

- Së paku, të mos bënte ftohtë.

- Kjo punë duhej filluar në verë, - tha gjenerali.

Ai e dinte se në verë kishte qenë e pamundur, megjithatë, i dukej se lehtësohej sa herë që shfrynte kështu.

- Koha është vërtet e papërshtatshme, - tha prifti. - Bisedimet u zgjatën tepër atëherë. Punë qeverish.

- Punë dreqi, - tha gjenerali.

Ai kishte hapur në tryezë planin e hollësishëm topografik të varrezës dhe po bënte shënime në të.

- Ku ndodhen, vallë, ata dy të tjerët, kolegët tanë? Gërmojnë ende, ndoshta, në atë stadiumin ku i lamë ne.

- E kanë vështirë, - tha prifti. - S'kanë asgjë në rregull.

- Kurse ne çdo gjë e kemi në rregull. Ne jemi varrmihësit më modernë të botës.

Prifti s'u përgjigj.

- Vetëm se jemi bërë të palarë, - tha gjenerali.

Jashtë, në errësirën e natës, u dëgjua një këngë. Në fillim fare ngadalë, e lindur nga zëra të ulët, të trashë, pastaj fort e më fort, kënga erdhi e u përplas te tenda, siç përplaseshin shiu apo era në ato net vjeshte, dhe u duk sikur tenda u rëndua dhe u rrëqeth.

- Po këndojnë varrmihësit, - tha gjenerali, duke ngritur sytë nga harta.

Ata vunë veshin një copë herë.

- Kështu e kanë zakon shqiptarët e disa krahinave, - tha prifti. - Kur mblidhen tre-katër burra bashkë, nisin e këndojnë. Zakon i lashtë.

- Ndoshta, ngaqë sonte është e shtunë mbrëma.

- Ndoshta. Veç kësaj, sot ata kanë marrë rrogat dhe, me siguri, kanë blerë ndonjë shishe raki te ndonjë kalimtar.

- I kam vënë re dhe unë që ngandonjëherë pinë ndonjë gotë, - tha gjenerali. - Mërziten, siç duket, edhe ata nga kjo punë.

- Kur pinë, zakonisht, fillojnë e tregojnë histori, - tha prifti. - Ai më i vjetri prej tyre u tregon ngjarje nga lufta.

- Ka qenë partizan?

- Me sa duket, po.

- Atëherë, kjo punë e bën që të rijetojë vitet e luftës.

- Sigurisht, - tha prifti. - Dhe kënga është për të, në këto çaste, një nevojë shpirtërore. A ka shpërblim më të madh për një luftëtar të vjetër, sesa nxjerrja nga varret e ish-armiqve të tij? Ky është njëfarë vazhdimi i luftës.

Kënga vinte e zvargur dhe e ngadaltë dhe isoja e mbështillte nga të gjitha anët si me një gunë të butë e të ngrohtë, si të donte ta mbronte nga errësira dhe lagështia e natës. Pastaj isoja u tret ngadalë dhe nga gjiri i saj u ngrit vetëm një zë.

- Ai, - tha gjenerali. - E dëgjoni? Përse flet kjo këngë?

- Është këngë e vjetër ushtarësh.

- Këngë e rëndë. A mund t'i dalloni fjalët?

- Sigurisht. Flet për një ushtar shqiptar të vrarë në shkretëtirën arabike. Kur Shqipëria ndodhej nën Turqinë, shqiptarët e bënin shërbimin ushtarak në vise të largëta.

- Ah, po. Ma keni thënë.

- Po të dëshironi, jua përkthej fjalët.

- Ju lutem.

Prifti dëgjoi një copë herë.

- Është e zorshme për ta përkthyer saktë, por, pak a shumë, fjalët janë këto: Unë mbeta i vrarë, o *kamaradët* e mi, mbeta në kuotën përtej Urës së Qabesë.

- Domethënë, këngë për shkretëtirën, - tha si nëpër gjumë gjenerali dhe në kujtesën e tij, si një qilim verbues e i pafund, u shpalos shkretëtira. Ai u mundua të ecte përsëri mbi këtë qilim, ashtu si vite më parë, kur marshonte i veshur me uniformën e togerit.

- Përshëndeteni nga unë nënën time, - vazhdoi të përkthente prifti, - i thoni, me këtë rast, që të shesë kaun e zi.

Përjashta kënga zvargej, sikur do të këputej, pastaj prapë e merrte veten dhe vinte e shtypte faqet e pjerrëta të tendës.

- Në qoftë se nëna ju pyet për mua...

- Hë, - tha gjenerali, - çfarë do t'i thonë nënës?

Prifti dëgjoi përsëri një copë herë.

- Pak a shumë, kuptimi është ky, - vazhdoi prifti, - në qoftë se nëna ju pyet për mua, ju i thoni se biri juaj u martua me tri gra, domethënë se mori tre plumba dhe se në dasmën e tij shkuan mjaft krushq e të njohur, dhe këta ishin sorrat dhe korbat, që filluan të hanin dhëndrin.

- E tmerrshme! - tha gjenerali.

- A nuk ju kam thënë?

Jashtë, kënga u tendos gjer në fund, si të donte të arrinte një cak të pamundur, pastaj u këput.

- Tani po fillojnë përsëri, - tha prifti. - Kur nisin, ata s'dinë të mbarojnë.

Ashtu ndodhi vërtet. Në fillim u dëgjua vetëm zëri i lartë, trondítës, i gërmuesit të vjetër, pastaj përsëri nisi t'ia kthente një tjetër dhe, në fund, ata që mbanin ison i hodhën gunën krahëve këngës dhe ajo u ngrit zotëruese në gjirin e natës.

Ata dëgjuan në heshtje një copë herë.

- Po kjo? - pyeti gjenerali. - Përse flet kjo këngë?

- Kjo është për luftën e fundit, - tha prifti.

- Në përgjithësi për luftën?

- Jo. Me sa kuptohet nga fjalët, një komunist është vrarë i rrethuar nga trupat tona. Kënga është për të.

- Ndoshta është ai që u hodh mbi tank, bustin e të cilit e kemi parë në dy-tri vende?

- S'e besoj. Të qe ashtu, do ta thoshte kënga.

Në tendë nisën një këngë të re.

- Ka diçka gërryese në këto këngë të zgjatura, të zgjatura, - tha gjenerali.

- Po, pikërisht gërryese. Janë zëra primitivë.

- Unë rrëqethem prej tyre. Ose, që të jem më i saktë, më fusin frikën.

- Kështu është gjithë epika e tyre, - tha prifti.

- Një dreq e merr vesh se ç'duan të thonë popujt me këngët e tyre, - tha gjenerali. - Mund të gërmosh dhe të futesh në tokën e tyre me lehtësi, por, në shpirtin e tyre, kurrë.

Prifti nuk foli dhe ata heshtën për mjaft kohë. Jashtë, kënga vazhdonte e shtruar si më parë dhe gjeneralit iu duk se ata ishin rrethuar nga të gjitha anët prej saj.

- Gjer kur do të këndojnë? - pyeti gjenerali.

- S'e di, - tha prifti. - Ndoshta, gjer në mëngjes.

- Dëgjoni, - tha gjenerali, - në qoftë se ata, në ndonjë këngë të tyre, e hedhin fjalën për ne, merreni shënim.

- Sigurisht, - tha prifti dhe shikoi orën. - U bë vonë.

- Mua s'më flihet, - tha gjenerali. - Le të pimë dhe mbase na vjen dhe neve për të kënduar, - shtoi duke qeshur.

Prifti ngriti supet, si për të thënë: ju e dini që unë s'pi.

Gjenerali tundi kokën me dëshpërim.

- Është koha më e përshtatshme për të mësuar alkoolin, - tha. - Dimër. Tendë në mal. Vetmi.

Jashtë, kënga herë ngrihej e herë ulej dhe ai nxori një shishe nga çanta e madhe.

- Ç'të bësh, - vazhdoi, - do të pi vetëm, - dhe hija e tij e madhe lëvizi në faqen e tendës, ndërsa po mbushte gotën.

Prifti u shtri për të fjetur.

Gjenerali piu dy gota, pastaj u ngrit, ndezi furnelën dhe vuri mbi të enën e kafesë. Kishte kohë që kishte mësuar ta ziente vetë kafenë, kur mbetej vetëm. Kafeja iu duk e hidhur.

Ndenji një copë herë me duar të kryqëzuara, pa menduar asgjë, pastaj doli përjashta. Vazhdonte të imtonte shi dhe nata ishte kaq e zezë, saqë iu duk se nuk ndodhej asgjëkund. Për habinë e tij, varrmihësit e kishin ndërprerë këngën, por ai, kushedi pse, pati frikë se do ta nisnin prapë.

Dhe, vërtet, pas pak kënga u çua prapë si një pirg. Zëri i varrmihësit plak u ngrit mbi të tjerët lart e më lart, derisa qëndroi një çast pezull dhe, befas, u këput e ra dhe humbi midis zërave të tjerë, si një shkëndijë që bie mbi prushin e vatrës.

Diku larg vetëtiu dhe, për një grimë, gjenerali pa tendën e bardhë atje tutje dhe, pranë saj, kamionin e madh që rrinte shtrembër mbi tokën e pjerrët dhe dukej sikur nga çasti në çast do të rrokullisej në rrëshqitë. Pastaj çdo gjë e mbuloi përsëri terri.

Ai dëgjonte këngën dhe mundohej të nxirrte me mend kuptimin e saj. Kjo ishte një këngë e gjerë dhe e trishtuar. Ik e ik...

Ndoshta, ai kujton shokët e tij të vrarë, mendoi gjenerali. Një nga vizitorët e atëhershëm, në sallonin e tij, i kishte thënë se ata i kujtonin shpesh në këngë shokët e vrarë. Kushedi ç'ka në kokë ky gropshar i vjetër, mendoi gjenerali. Hap varre poshtë e lart dhe qëmton kujtimet e tij të luftës.

Me siguri e urrente. E shihte urrejtjen në sytë e tij. Dhe s'kishte si të ndodhte ndryshe. Ishin dy armiq për vdekje të

lidhur me këtë punë si dy qé nën të njëjtën zgjedhë. Një ka i zi dhe një tjetër ka i zi. Gëzimi i njërit ishte trishtimi i tjetrit. Një varrmihës, që gjashtë ditë hapte varre dhe të shtatën ia merrte këngës. Një gjeneral, që bënte të njëjtën gjë gjashtë ditë, por që as donte e as dinte të këndonte, të shtatën.

Një copë herë u rrek të përfytyronte se si mund të ishte kënga e tij për ushtarët që mblidhte dhe tundi kryet gjithë hidhërim. Një kujë e vërtetë, me siguri.

KREU I DHJETË

Në ato pak orë nate që kishin mbetur, gjenerali bëri një gjumë të shqetësuar.

Në mëngjes u zgjua nga zërat e punëtorëve. Po shkulnin nga toka e ngrirë grremçat dhe tendën, për t'i hedhur pastaj në kamion, sipër arkave me eshtra. Shoferët kishin ndezur motorët për t'i nxehur.

Prifti ishte ngritur i pari dhe po ziente kafenë. Flaka e vogël, e kaltër ia ndriçonte herë-herë fytyrën. Nga jashtë hynte drita e zbehtë e agimit.

Gjenerali ndjeu mall për shtëpinë.

- Mirëmëngjes, - tha.

- Mirëmëngjes, - u përgjigj prifti. - Si fjetët?

- Keq. Bënte shumë ftohtë, sidomos pas mesnatës.

- Do ta pini kafenë në shtrat?

- Po. Falemnderit.

Prifti ia dha kupën me kafe të nxehtë dhe gjenerali e falënderoi prapë.

Pas pak dolën të dy. Punëtorët nisën të shkulnin tendën e tyre. Shiu kishte pushuar, po toka ishte e qullur dhe gropat e hapura ishin mbushur përgjysmë me ujë.

Nga lindja, prapa reve të larta, po ngjitej e turbullt në horizont njolla e diellit, herë më e shndritshme, herë më e zbehtë.

Në veturë ishte nxehtë dhe gjenerali zuri të dremiste.

Kishin më tepër se dy orë që po udhëtonin, kur shoferi frenoi papritur.

Gjenerali fshiu avullin te qelqi dhe pa në mes të rrugës një fshatar të vogël, veshur me rroba të zeza, të ngushta, që kishte nderë krahun drejt veturës. Kamioni frenoi me zhurmë dy hapa më tutje.

Shoferi i veturës nxori kryet.

- Nuk kemi vend, o çun, - i tha.

Por djali se ç'foli, shpejt e shpejt, dhe tregoi me dorë në anë të udhës.

- Ç'është ky njeri? - pyeti prifti.

Gjenerali u zgjat të shikonte më mirë. Ndanë udhës automobilistike, mbi një gur të madh, ishte ulur një fshatar plak, me gunë të zezë hedhur krahëve. Përbri kishte një arkë druri. Më tej, një gomar rrinte i qetë buzë udhës, i spërkatur i tëri me baltë.

- Ç'është kjo? - tha gjenerali.

- Kushedi. Tani do ta marrim vesh, - tha prifti.

Specialisti shqiptar kishte zbritur nga kamioni dhe po

bisedonte me të dy fshatarët. Plaku u ngrit rëndë-rëndë. Specialisti erdhi te vetura.

- E? - pyeti gjenerali.

- Një ushtar, - tha specialisti.

- Yni?

- Po, - tha specialisti dhe tregoi me dorë arkën. - Ka punuar te ky fshatar dhe pastaj e kanë vrarë.

Gjenerali hapi derën e veturës dhe doli. Pas tij doli prifti.

- Nuk e kuptova mirë, - tha prifti, që iu afrua i pari fshatarit.

- Ky ushtar ka shërbyer në mullirin e këtij fshatari, - tha specialisti. - Pastaj është vrarë.

- Aha, - tha prifti, - do të jetë ndonjë dezertor.

Specialisti e pyeti fshatarin, dhe ai iu përgjigj.

- Dezertor, - tha specialisti.

Gjenerali, i cili nuk i dëgjoi fjalët e tyre, iu afrua grupit të njerëzve, duke ecur ngadalë e me pamje të rëndë. Këtë lloj qëndrimi mundohej të merrte gjithmonë, kur kishte përpara fshatarë shqiptarë të veshur me shajak dhe me opinga.

- Si është puna? - pyeti gjenerali. Tani që kishte lënë prapa ditët e mërzitshme e të ftohta në mal dhe kishte veshur uniformën e re, po e kapte përsëri ndjenja e madhështisë.

Fshatari kishte fytyrë të hequr dhe sy të përhimë. Ai nxori i qetë qesen e duhanit, mbushi llullën dhe e ndezi me strall. Gjenerali vuri re se gishtat e tij ishin të rreshkur e të thatë si eshkë. Djali i vogël kishte shqyer sytë nga habia mu përpara gjeneralit.

- Kemi tri orë që presim këtu, - tha fshatari. - Kemi dalë nga fshati që pa gdhirë. Dje më thanë se makinat do të

shkonin këndej dhe vendosa të dilja e të prisja bashkë me nipin. Kemi ndalur shumë makina deri tani dhe të gjithë shoferët na thoshin se s'ishin nga ata që bartnin të vdekur. Madje, nja dy më morën për të luajtur nga mendja.

- Ju e kishit varrosur? - e pyeti gjenerali.

- Po, - tha plaku. - Kush tjetër do ta varroste? Ai jetonte te ne.

- Domethënë, jetonte te ju, - tha gjenerali. - Por, mundësisht, dua të di si dhe në çfarë marrëdhënie ishit ju me të? Ç'punë kishte ky ushtar i një ushtrie, të rregullt e të madhe, me ju? Dua të them, ç'i pëlqente dhe si kishte mundësi të rrinte vullnetarisht midis jush. Ju jeni katundar, apo jo?

Specialisti ia përktheu më thjesht dhe më shkoqur fjalët e gjeneralit.

Fshatari hoqi llullën nga goja dhe e vështroi gjeneralin në sy.

- Ai ishte shërbëtori im, - tha. - Këtë e di tërë fshati.

Gjenerali u vrenjt dhe u skuq nga fyerja. Vetëm tani ai e kuptoi si qëndronte puna. E vështroi mullisin pjerrtazi, sikur të thoshte fol, përse të mos flasësh, or fshatar, dhe ndezi një cigare, duke thyer dy-tri shkrepëse.

- Është një ushtar dezertor, - i shpjegoi prifti, - nga ata që kanë punuar si, si... ndihmës, për të mos thënë shërbëtorë te shqiptarët.

Gjenerali shtrembëroi fytyrën.

- Si e quanin? - e pyeti specialisti.

- S'e di, - tha fshatari. - Ne e thërrisnim "ushtar" dhe ashtu i mbeti gjer në fund.

- Kur i nxorët eshtrat? - tha specialisti.

- Pardje, - u përgjigj fshatari. - Dëgjova se po i mblidhnin dhe vendosa t'i nxirrja e t'i dorëzoja. Le të prehet, i gjori, në vend të tij, thashë me vete.

- Mos gjetët në trupin e tij një medaljon?

- Medalje? - pyeti mullisi i habitur. - S'qe ai për medalje, o bir. Për punë të thante, por për luftë s'besoj se ia thoshte.

- Jo, xhaxho, jo medalje, - e ndërpreu, duke buzëqeshur, specialisti, - medaljon. Një si pare të rrumbullakët me fytyrën e Shën Mërisë.

Fshatari ngriti supet.

- Jo, nuk gjeta gjë. Eshtrat i mblodha një nga një, por gjë tjetër s'gjeta.

- Ju keni vepruar mirë, - tha prifti. - Ju keni kryer detyrën ■ një të krishteri.

- E kush do ta bënte tjetër këtë punë? - tha fshatari. - S'do mend që mua më binte ta bëja.

- Ju falënderojmë - tha prifti, - në emër të nënës së këtij ushtari.

Plaku iu afrua priftit që, me sa duket, iu duk njeri i sjellë dhe filloi t'i shpjegonte, duke treguar herë pas here me dorë arkëmortin e punuar trashë, me dru lisi.

- Dje i bëra tabutin dhe sot, që pa gdhirë, u nisëm për udhë, bashkë me nipin. Mezi sosëm që nga mulliri gjer këtu. Kënetishtë kudo. Gomari na u rrëzua dy herë në baltak, shih si është bërë.

Prifti e dëgjonte me vëmendje.

- Po ushtarin, ju e keni vrarë? - pyeti papritur me një zë të qetë, pa ia shqitur sytë.

Fshatari bëri një lëvizje habie dhe hoqi llullën, si ta

lironte gjuhën nga një pengesë. Pastaj qeshi në mënyrë të panatyrshme.

- Je në vete? E pse do ta vrisja unë?

Edhe prifti buzëqeshi, sikur të thoshte "ja që ndodhin gjëra të tilla".

Mullisi, pa iu drejtuar kujt, nisi të rrëfente si u vra ushtari nga ndëshkimorët e Batalionit Blu në atë vjeshtë të paharruar. Pastaj, duke rikujtuar, siç duket, pyetjen e priftit, sytë iu bënë të menduar.

- Pse flasin kështu këta, o bir? - i tha specialistit me zë të ulët.

- Janë të huaj, xhaxho, kanë të tjera zakone.

- Njeriu mundohet, bën gjithë këtë rrugë dhe...

- Ohu, ç'e çan kryet, or xhajë, - i tha një nga punëtorët, që kishte zbritur nga kamioni për të ngritur arkën. - Tani mbetsh me shëndet, se po ikim.

Në kohën që fshatari plak bisedonte me specialistin dhe varrmihësit po ngrinin arkëmortin për ta vendosur në kamion, gjenerali, që po bëhej gati të hipte i pari në veturë, u kthye papritur.

- Ai po kërkon shpërblimin? - i tha specialistit.

Specialisti u skuq.

- Jo.

- Ai ka të drejtë plotësisht, - tha gjenerali. - Ne jemi gati të paguajmë.

- Ai nuk kërkoi asnjë shpërblim, - tha specialisti.

Gjenerali, që iu duk se gjeti një mënyrë për t'u hakmarrë sadopak për fyerjen e pakmëparshme, nguli këmbë.

- Sidoqoftë, i thoni se ne duam ta shpërblejmë.

Specialisti ngurroi.

- Ne dëshirojmë të shpërblejmë punën tuaj, - i tha prifti mullisit, me zë të ëmbël, - sa kërkoni?

Mullisi u vrenjt dhe ngriti kokën.

- Asgjë, - tha shkurt.

- Sidoqoftë, ju jeni munduar, keni shpenzuar disa orë punë, përveç drurit...

- Asgjë, - tha prapë fshatari.

- Po ju e keni mbajtur me bukë kaq kohë këtë ushtar. Ndoshta, mund të bëjmë ndonjë llogari.

Fshatari shkundi llullën me zemërim.

- Edhe unë i kam mbetur borxh, - tha, - s'i kam dhënë rrogën si shërbëtor. Mos doni t'jua jap juve?

Mullisi ktheu shpinën dhe u drejtua te vendi ku rrinte gomari.

Në kohën që makina po nisej, djali i vogël seç i tha në vesh gjyshit dhe plaku tundi dorën në drejtim të makinës.

- Prisni, or djaj, se gati harrova. Kam diçka të tijën që dua t'jua jap, - dhe futi dorën nën gunë.

- Kërkon paratë, - tha gjenerali, kur pa plakun që po ia bënte me dorë, - e shikoni? E dija unë.

- Çfarë? - tha specialisti, që zbriti.

- Një defter, - tha plaku. - Seç shkruante nganjëherë në të. Ja ku është.

Specialisti zgjati dorën për ta marrë. Ishte një fletore e zakonshme, e mbushur me shkrim të dendur.

- Do të jetë ndonjë amanet i tij, - tha plaku, - ndryshe as që do t'jua jepja fare. Kushedi ç'ka nxirë në të, i gjori. Mbase ia ka lënë ndonjërit me amanet dhentë e dhitë. S'm'u dha ta

pyesja. Po dhe në kishte bagëti, me siguri, do t'ia ketë ngrënë ujku.

- Falemnderit! - tha specialisti. - Këtu duhet të ketë emrin e tij, me siguri.

- Ne e thërrisnim "ushtar", - tha plaku. - Asnjë s'u kujtua ta pyeste për emrin.

Specialisti hipi në makinë.

- Udha e mbarë! - i tha plaku specialistit. - Të veni me shëndet.

- Përsëri ditar, - tha gjenerali, duke shfletuar fletoren që ia dorëzoi specialisti. - I sati ditar është ky që gjejmë?

- I gjashti, - tha prifti.

Makinat u nisën njëra pas tjetrës. Duke kthyer kokën pas, gjenerali pa se si fshatari plak qëndroi një copë herë në këmbë, pa ua ndarë sytë, pastaj ktheu shpinën, vuri gomarin përpara dhe u nis për udhë bashkë me të nipin.

KREU I NJËMBËDHJETË

Gjenerali, si zuri vend në makinë, ngaqë s'kishte ç'të bënte, hapi fletoren. Fleta e parë mungonte (në shumicën e ditarëve që kishin gjetur s'kishte gjithmonë fletë të para). Megjithatë, kur filloi të lexonte, e kuptoi se nuk mungonin, veçse disa fraza. Siç duket, në pjesën më të madhe të fletës së parë, i panjohuri kishte shënuar të dhënat për veten e vet, por pastaj, pasi qe penduar për këtë, e kishte shqyer fletën.

Gjenerali vazhdoi të lexonte:

gjithë puna është që fletoren të mos ma gjejë njeri. Këtu rreziku është i paktë: e para, në familjen e mullisit nuk lexon njeri, e dyta, kjo është gjuhë e huaj për ta.

Mbrëmë, kur mullisi më pa tek po shkruaja, hapi sytë dhe më pyeti:

- Ç'shkruan ashtu, ushtar?

Të gjithë këtu më thërrasin "ushtar". Asnjëri s'më ka pyetur si e kam emrin e vërtetë. "Ushtar" më thërret edhe gruaja e mullisit, edhe vajza e tyre e vetme, Kristina. Madje, më duket, ajo që më thirri e para me këtë emër ishte pikërisht Kristina. Kjo ndodhi atë ditë kur batalioni ynë u shpartallua prej partizanëve. Unë, në tërheqje e sipër, e hodha pushkën në shkurre dhe ia mbatha nëpër një rrahinë të shkretë. Ecja vazhdimisht buzë një vije uji, sepse e dija që vijat e ujit të nxjerrin gjithmonë në vende të banuara. Nuk u gabova. Vija e ujit ishte jazi i këtij mulliri. Kur u afrova te porta e tyre, vajza shqiptare, që mezi po e qetësonte qenin e madh, thirri e habitur: "Baba, këtu është një ushtar".

Që nga ajo ditë filloi për mua jeta e mëditësit. Nganjëherë edhe vetë çuditem se si e pruri çasti që unë, ushtar i Divizionit të Hekurt jam bërë tani shërbëtor te një mullis shqiptar dhe në kokë mbaj një qeleshe të bardhë, si ato që mbajnë katundarët e këtushëm.

- Unë të mbaj me bukë dhe të mbroj, - më tha mullisi, - në qoftë se të vjen ndoresh të më ndihmosh në punë. Një djalë, që më ndihmonte gjer tani, doli partizan. Vetëm mos bësh ndonjë lapërdhi, - vazhdoi ai. - Të piu e zeza po mora vesh gjë, të vara te kulmi i pullazit.

Kjo ishte marrëveshja jonë.

Qysh atëherë ka kaluar një muaj. Unë tani kryej gjithfarë punësh: çaj dru në pyll, pastroj vijën e mullirit, çukis mokrat, ndreq grunarët, mbush e zbraz thasët.

Shokët e batalionit dhe familja më dinë, me siguri, të vrarë. Sikur të më shihnin kështu siç jam, mua, ish-ushtarin

"e hekurt", të ngjyer e të zbardhur krejt nga mielli, me këtë qeleshe në kokë, do të shqyheshin gazit.

25 shkurt

Ditë e cingërimtë. Fryn një erë e marrë që duket sikur do ta shkulë mullirin nga themelet. S'kemi punë. Pak fshatarë në këtë dimër kuturisin të marrin udhën gjer në mulli për të bluar ndonjë thes misër. Arat janë të shkretuara fare këtë vit. Shumë syresh janë kthyer në guraja. Ata që vijnë për të bluar tregojnë gjëra të tmerrshme.

Ulërimë ere. Ditë e natë. Duket sikur botës i ka mbetur vetëm era.

mars 1943

Mullisi nuk sillet keq me mua. Dje ndreqa një pjesë të pullazit që e kishte shkalafitur era. Mbeti i kënaqur.

- Ty, ushtar, të vjen ndoresh për çdo gjë, - më tha. Dhe, si më shikoi me qesëndi nga koka në këmbë, shtoi: - Vetëm për luftë më duket se nuk ia thua.

U skuqa. Ishte hera e parë që dikush më përmendte dezertimin tim.

Ai më ra supeve.

- S'desha të të fyeja, - tha duke buzëqeshur, - e thashë ashtu kot.

Kjo bisedë s'më doli nga mendja gjithë ditën.

Kam vënë re se këtu e ndërojnë trimërinë. Me sa duket, unë iu duka frikacak. Një zdap i tillë, një e tetëdhjetë e dy i gjatë, dhe dezertor.

Sa keq në qoftë se ata mendojnë vërtet që unë jam tutës. Sa turp, sidomos nga Kristina! Ajo është shtatëmbëdhjetë vjeçe. Sa herë që e shikoj, më bëhet një zbrazëti këtu në gjoks, diçka e tillë si ajo rrota e biçikletës kur shfryhet papritur.

pasdite

Një ngjarje e jashtëzakonshme. Kisha shkuar për të prerë dru në pyll. Kur u ktheva, pashë një njeri te pragu i mullirit. Mbajta këmbët. Njeriu vërshëllente një këngë nga tonat. Kur u afrova, dallova mbeturinat e rrobës së tij ushtarake.

- Ej, mik, - i thirra.

Ai ndërpreu vërshëllimën dhe brofi në këmbë. U përqafuam, ndonëse nuk e kishim parë kurrë njëri-tjetrin. U ulëm te pragu.

Në pak çaste thamë gjithçka: divizionet nga kishim ikur, kohën, punët që bënim. Kishte ardhur me "të zotin" e tij, një katundar nga fshati fqinjë, për të bluar dy thasë misër. Më tha se filmi (domethënë lufta), me ç'tregonin bathët, do të mbaronte së shpejti, se askush s'do të guxonte të na kërkonte llogari pse ia kishim mbathur, përkundrazi, do të kërkonim ne llogari që na dërguan në këtë film. Pastaj më tha se kishte shumë ushtarë si ne, të pajtuar te katundarët shqiptarë. U shqyem gazit të dy, kur më foli për punët që bënin: nga kullotja e lopëve gjer te mëkimi i fëmijëve, si dado.

- Veç për femra e kemi keq, - tha. - Shqiptarët qenkan ruajna Zot, për punë nderi. Ngacmove një grua, të trodhën, për besë. Po ti, mik, më duket se e ke punën në vijë. - Ai më shkeli syrin dinakërisht. - Pashë gocën e tyt zoti. Ç'llokume!

- Je në vete? - i thashë. - As guxoj ta mendoj. Ti vetë e the se ç'të bëjnë.

- E thashë, e thashë, po këtu është ndryshe. Vend i bukur, i qetë, kaluar Zvicrës.

Nga brenda vinte zhurma e trokashkave të mullirit.

Ai drodhi një cigare, ashtu siç bëjnë fshatarët shqiptarë.

- Dëgjo, - më tha, - ke dëgjuar gjë për Batalionin Blu?

M'u drodh zemra.

- Jo, - thashë, - pse?

Mjaftoi përmendja e atij emri që hareja e pak-mëparshme të tretej.

- E shoh që u mërzite, - tha, - por mos e çaj trapin. Vërtiten andej nga Shqipëria Qendrore, bëjnë plojë kudo, por ti mos e çaj trapin.

- A mund të vijnë këndej?

- Ka mundësi. Kërkojnë sidomos dezertorët, por ti...

U ngrita për të mos e dëgjuar më atë "mos e çaj trapin", pas së cilës ai lëshonte me lehtësi një zezonë të re. Padronët tanë, mullisi im dhe fshatari, bisedonin shtruar brenda në mulli. Si u blua misri, dy të ardhurit hodhën nga një thes krahëve dhe u nisën, fshatari përpara dhe ushtari pas.

Sa herë që dëgjoj tringëllimën e këmborëve, gëzohem. Mërzitem vetëm.

Mullisi është njeri i drejtë, por ka një huq të keq, flet rrallë. Kam vënë re që shqiptarët në përgjithësi flasin pak, sidomos burrat. Mullisi gjithë ditën mban llullën në gojë. Më shumë bisedoj me gruan e tij, "teto Frosën". Ajo më pyet për gjithfarë gjërash, sidomos për të afërmit e mi. Unë i them se më merr malli. Ajo më vështron me dhembshuri. Tund kryet.

- Po tani që ti ke ikur, - më pyeti një herë, - kush vete me dhentë e me dhitë?

Unë qesha.

- Po ne nuk kemi as dhen, as dhi. Ne banojmë në qytet.

- Edhe po t'i kishit, tani që ike ti, do t'ua kishte shqyer ujku. Uh, mor bir, tani edhe njerëzit kanë zënë e shqyejnë njëri-tjetrin si bishat.

S'di ç't'i them.

Një ditë tjetër më pyeti për medaljonin.

- Po këtë në qafë ç'e ke, o bir? Më duket si pare e turkut.

Qesha.

- Këtë e kemi si shenjë ne ushtarët, që, po u vramë në luftë, të na njohin trupin. Ja këtu, nën fytyrën e Shën Mërisë, ka një numër, e sheh? Është numri im.

Teto Frosa vuri ca syze qesharake me njërin qelq të plasur.

- E kush jua ka dhënë këtë?

- Komandantët.

- Pika që s'u bie! - tha ajo dhe iku duke murmuritur.

Këto janë bisedat e mia me teto Frosën. Kurse Kristinën e shoh rrallë. Edhe më rrallë flas me të. Pikërisht me atë që dëshiroj të kuvendoj më tepër, sidomos tani që, pak a shumë, e flas jo keq shqipen. Por ajo nuk duket në mulli. Gjithë ditën bën punët e shtëpisë ose punon në vegjë. Edhe kur vjen të na lajmërojë për drekë, rri vetëm një grimë te dera. Më vështron ashtu shkarazi me ata sytë e butë, pastaj kthen kokën.

Nganjëherë nuk zbret fare poshtë, por thërret që nga dritarja e shtëpisë:

- Ushtar, thuaji babait se dreka është gati.

Nuk e fsheh që gjatë mbrëmjes mendoj për të. Nganjëherë, dal te porta dhe vështroj natën. Dëgjoj zhurmën e jazit të mullirit dhe ëndërroj gjithfarë gjërash. Nganjëherë, loz me qenin e tyre të madh, Xhuvin.

prill

Sot, Kristina më buzëqeshi. Natën që shkoi, në mulli ranë kusarët. Plagosën Xhuvin. Rëndë. Të gjithë janë të dëshpëruar.

rreth orës 3, maj

Kaloi një fshatar me një orë turke. Kisha kohë që nuk kisha parë orë.

Mendja më vete në shumë gjëra, por më shumë më rri te Kristina. Mendoj plot marrëzira. E di dhe vetë që janë ashtu. Megjithatë, i mendoj.

Dje në mesditë isha shtrirë pranë vijës së mullirit. S'dija ç'të bëja. Hidhja guralecë në ujë. Rreth e përqark fëshfërinin rrapet. Gurgullima e ujit të vinte në gjumë.

Papritur dëgjova zhurmë të madhe, hapa, zëra, vërshëllima, thundra kuajsh. Ngrihem e ç'të shoh? Tanët po vinin vargan-vargan që larg! Desha t'ia mbathja, po nuk di pse bëra të kundërtën: u dola përpara.

- Ky është ai mulliri? - pyeti njëri, duke bërë një shenjë të fshehtë.

- Po, - i thashë i trembur.

- Oburra, ta bëjmë hi! - thirri ai dhe u sul i pari. Pas tij të tjerë. Pas tyre dhe unë. Nuk di si m'u zgjidhën këmbët papritur, trupi m'u bë i shkathët e i shpejtë, në kokë më hipi një ethe dhe egërsi, krejt si vitin që shkoi, kur dogjëm gjashtë fshatra rresht, gjatë Operacionit të Dimrit.

U sulëm, pra, të tërë, duke ulëritur si të tërbuar. Dy veta i vunë zjarrin mullirit. Ca të tjerë po tërhiqnin zvarrë mullisin. E nxorën gjer te pragu dhe e pushkatuan.

Më vajti mendja te Kristina. Ngjita me vrap shkallët e shtëpisë. Nëpër shkallë po zbrisnin të lidhur këmbë e duar teto Frosën. Ajo më pa dhe më pështyu.

- Ah, qen, ah, spiun!

Po unë nuk ia vura veshin. Mendjen e kisha te Kristina. Brofa në dhomën ku flinte dhe u sula te shtrati. Kristina dridhej.

- Ushtar, mos, ushtar!

Por mua më kishte hipur gjaku në kokë. Shpejt, shpejt, thosha me vete, ndryshe koha ikën.

Hoqa mbulesën, i grisa me tërbim këmishën e hollë dhe rashë mbi të.

- Ushtar, o ushtar!

Befas u ngrita. Dëgjohej zëri i Kristinës që më thërriste. Përreth, si më parë, gurgullonte ujët e qetë dhe ndihej aroma e barit. Kisha fjetur pak.

- Ushtar, o ushtar!

Shkova drejt shtëpisë me hapa të plogët. Kristina kishte dalë te dritarja e mesit.

- Të kërkon nëna, - më tha.

Unë ende fërkoja sytë.

Sikur ta dinte ç'ëndërr kisha parë!

24 qershor '43

Nga Gjirokastra vijnë vazhdimisht qytetarë të ikur. Janë të lodhur, me trasta në krahë. Gratë mbajnë në duar fëmijët, pleqtë mezi zvarritin këmbët. I ka kapur një tmerr i madh. Thonë se do të digjet qyteti krejt. Disa thonë se do të hidhet në erë me mina.

Gjirokastra bombardohet rregullisht. Nganjëherë, hip në rrapin e madh dhe vështroj qytetin. Kam shërbyer një vit e ca atje, i njoh pothuaj të gjitha rrugët e rrugicat, të gjithë pijeshitësit e horrat. Njoh edhe nja dy kurva nga lagjja "Varosh".

Aeroplanët janë të përpiktë. Në fillim shfaqen nga veriu, te gryka e Tepelenës. Të parët që hapin zjarr janë kundërajrorët e Grehotit. Që këndej nuk dëgjohen krismat, por duket vetëm tymi i bardhë i predhave. Pastaj shtien topat e bregut të teqesë, por as ata nuk ua prishin flatrimin

aeroplanëve. Ata fluturojnë të qetë drejt qytetit dhe unë e marr me mend se si, në këto çaste, në Gjirokastër ulërijnë sirenat dhe njerëzit zbresin nëpër qilare dhe të vjen çudi se si gjithë këtë tmerr e shkaktojnë ato dy-tri gjëra të vockla, që fluturojnë duke shndritur e vezulluar nën rrezet e diellit, si ca pare argjendi të hedhura në qiell.

I fundit qëllon kundërajrori i kështjellës, një gërdallë e vjetër, me të cilën mahiten të gjithë. Që këtej duket mirë se si manovrojnë aeroplanët, si bien kryepingulthi mbi aeroportin ushtarak, lëshojnë bombat dhe pastaj ikin përsëri të qetë e shndritës, sikur të mos kishin asnjë lidhje me shtyllat e tymit të zi, që ngrihen fill pas tyre kudo.

Të gjitha këto duken ditën, kurse natën ka errësim të detyruar. Porsa bie mbrëmja, çdo gjë nis ta gëlltitë errësira. Në fillim treten rrugicat, shtëpitë e ulëta, ura e lumit, pastaj lagjet, duke filluar nga poshtë, urat e përrenjve, shtëpitë e larta dhe, më në fund, kështjella, kambanoret dhe minaret, me ato çerdhet e lejlekëve në majë.

Mbrëmë, tek vështroja qytetin që u fundos në terr, m'u kujtua një natë e tillë tre vjet të shkuar, kur kompanisë sonë, për herë të parë, i ra rruga të shkonte përmes Gjirokastrës, drejt jugut.

Ishte natë e errët, me duhmë. Ne ishim të rraskapitur, të palarë dhe të mërzitur dhe, porsa arritëm në kazermat e Grehotit, kërkuam të na çonin në shtëpinë publike. Komanda na e dha lejen. U gjallëruam në çast. Ashtu siç ishim, të parruar e të llangosur me baltë, pa i hequr fare armët nga supi, u vumë përsëri në rresht dhe dolëm nga porta e madhe. Shtëpia publike ndodhej në qytet, kështu që, pas atij marshimi

të gjatë, do të na duhej të bënim dy-tri kilometra të tjera për të arritur gjer atje. Por tani rruga na dukej e lehtë. Ecnim në rresht përmbi udhën e errët, duke bërë mahi të turpshme e duke thumbuar njëri-tjetrin. Ndiheshim të lumtur. Kishim dëgjuar të flitej shpesh për atë shtëpi e tani s'na durohej sa të arrinim. Një pallat princeshe s'do të na joshte aq fort.

Tek ura e lumit na kontrolluan rojat e postbllokut, pastaj filluam të ngjiteshim rrugëve të pjerrëta. Qyteti dukej si i vdekur. Këpucët tona alpine kërcisnin mbi gurë. Me siguri, njerëzit, që ishin prapa flegrave dhe portave të rënda të shtëpive, dridheshin, se kujtonin mos fillonte ndonjë plojë e re. Ku ta dinin ata se ku shkonim ne!

Më në fund, arritëm përpara "shtëpisë". Ne qëndruam përjashta, ndërsa oficeri ynë shtyu portën dhe hyri.

Ndërtesa ishte pa dritë. Brenda, me sa dukej, s'kishte asnjë vizitor.

- Mos kanë fjetur? - tha njëri prej nesh gjithë ankth.

- Në qoftë se flenë, duhet të ngrihen menjëherë.

- Ashtu është, - tha një tjetër. - Ne jemi ushtarë dhe duhet të nderohemi. Aq më tepër që jemi në kalim.

- Sot jemi, nesër s'jemi, - tha një tjetër, me zë të ngjirur, të hollë.

Por porta u hap, oficeri doli dhe ne u afruam të gjithë rreth tij.

- Dëgjoni, - tha oficeri. - Tani do të hyni. Vetëm, të mbani rregull, ndryshe do t'ju prapësoj. Hajde, në rresht!

Ne krijuam njëfarë rreshti dhe një Zot e merrte vesh ç'rresht ishte ai.

- Kujdes, - tha oficeri. - Brenda është errësirë, sepse dritaret janë të hapura nga shkaku i zhegut dhe prandaj

s'mund të ndezim dritë. Asnjëri të mos provojë të ndezë shkrepësen, ndryshe, do ta pësojë. Këtu pranë është një pikë përgjimi me mitraloz.

- Në rregull, - thanë dy-tre zëra. - Ç'na duhet drita? Bëjmë edhe pa dritë.

- E drejtë, s'na duhet dritë! Na duhet...

- Mbyll gojën, pusht, - hungëroi oficeri. - Mbani qetësi! Hajde, pesë-gjashtë të parët.

Të parët u futën, duke shtyrë njëri-tjetrin.

- Mos ngatërroni pushkët, - u thirri oficeri. Pastaj u kthye nga ne. - Gjashtë të tjerët të vijnë me mua, - tha.

Ndër këta të fundit isha dhe unë. Ecëm si të dehur mbi rrasat e oborrit, pastaj ngjitëm shkallët. Brenda ishte terr. Pas pak, pata përshtypjen se mbeta vetëm. Shokët sikur i përpiu errësira. Eca në terr dhe më zuri veshi një rënkim, pastaj një tjetër. Gjaku më hipi në kokë, u futa në derën e hapur dhe prapë ndjeva një frymëmarrje të rëndë. Dola menjëherë dhe hyra në një derë tjetër. Në errësirë, në kënd, pashë turbull diçka të bardhë. Hyra, bëra dy hapa, dhe qëndrova.

- Eja, - më tha një zë femre.

Unë shkova pak me druajtje, zgjata krahët dhe e preka. Ishte lakuriq. Duart e mia rrëshqitën në trupin e saj të njomur nga djersa dhe m'u veshën sytë. S'ishte e mundur të kuptoja se ku ishte shtrati.

- Hiqe armën, - më tha me zë të qetë.

Unë e hoqa pushkën dhe e mbështeta te muri, pastaj ajo u shtri vetë.

Në errësirë nuk ia dalloja dot fytyrën, por nga zëri dhe nga gjinjtë dukej që ishte e re.

- Më fal, - i thashë pas disa minutash, tek po pushoja i lodhur në krah të saj. - Më fal që jam kështu i palarë.

- S'ka gjë, - tha ajo me zë shpërfillës. Kjo do të thoshte se ishte mësuar prej kohësh me djersën e ushtarëve. - Për ku veni? - më pyeti.

- Në jug, - i thashë, - në luftë.

Ajo nuk foli më dhe këto qenë të vetmet fjalë që këmbyem.

Unë u mundova të dalloja tiparet e saj, por ishte e pamundur. U ngrita ngadalë, mora pushkën, e hodha krahaqafë dhe ktheva kokën edhe një herë drejt asaj gjëje të bardhë që s'lëvizte.

- Natën e mirë! - thashë.

- Natën e mirë! - u përgjigj me mospërfillje dhe unë dola. Gjeta me hamendje shkallët dhe zbrita. Ata që kishin mbaruar, prisnin përjashta, duke pirë cigare në heshtje, ulur ndanë portës, me pushkën midis gjunjëve.

Pas një ore, ne ecnim përsëri në rrugë dhe tani as flisnim më, as bënim mahi, por dëgjonim zhurmën e çrregullt të hapave tanë dhe ishim përsëri të mërzitur, të lodhur e të llangosur në baltë si dreqi.

- Errësirë e mallkuar, - sekush tha, sikur foli në gjumë. Asnjë s'u përgjigj.

Pas njëfarë kohe, kur divizioni ynë kaloi përsëri nëpër Gjirokastër, ne kërkuam të shkonim sërish në shtëpinë publike, por na thanë se ajo ishte mbyllur. S'e mbaj mend mirë shkakun, por më kujtohet që na thanë se kishte ndodhur një histori, ishte vrarë njëra nga vajzat dhe pastaj të tjerat i kishin hequr. Kur e dëgjova këtë gjë, m'u kujtua ajo vajza e errësirës, me të cilën shkova atë natë vere. Më shkoi mendja

se mos e kishin vrarë. Por, ndoshta, s'kishte qenë ajo. Atje kishte, më duket, pesë apo gjashtë vajza. Ose, e shumta, shtatë.

mesditë korriku

Sytë e Kristinës janë fare të pazbërthyeshëm. Si të të gjitha vajzave shqiptare. Dashuri? Nga ana ime, po. Nga ana e saj, asgjë.

Xhuvi nuk po e merr veten.

korrik

Natën, në rrugën automobilistike kaluan trupa. Drejt veriut. Dukeshin dritat e kamionëve. Siç duket, po zhvendosin ndonjë regjiment.

korrik 21

Fshati pranë është mbushur me ballistë. Natën këndojnë këngë të vjetra. Mullisi më ka thënë se, po të shoh qeleshet e tyre të bardha me shqiponja të mëdha të qepura përpara, të fshihem. Edhe Kristinës i ka thënë të fshihet. Një Zot e di ç'mund të ndodhë.

e diel

Kristina martohet për një javë. E mora vesh fare rastësisht. Unë as që e dija që ajo ishte prej kohësh e fejuar. Dje, ashtu kot, e pyeta teto Frosën tek po mbushte ujë në vijë.

- Përse kohët e fundit punoni gjithë ditën e gjithë mbrëmjen në avlëmend?

- Epo, erdhi koha, - tha ajo. - Erdhi koha, mor bir.

- Çfarë? - i thashë unë.

- Si çfarë? Do të martojmë vajzën javën që vjen, s'e di ti?

- Jo, - i thashë, - nga ta di? - Zëri im ishte kaq i dobët, saqë ajo ngriti sytë dhe më pa një copë herë. U mundova të fshihja turbullimin tim, pastaj thashë me vete, në djall të vejë, e pse ta fsheh që më vjen keq?

Më shikoi një grimë me vëmendje, pastaj më tha:

- Kështu është, mor bir, ja, vjen koha dhe bëhet vajza për burrë. Edhe ti do të kthehesh në shtëpi, sa të mbarojë kjo luftë, dhe do të të martojë nëna me ndonjë çupë të bukur.

Kur më tha këto fjalë, më erdhi të zija kokën me duar, sepse m'u duk sikur më ngushëlloi, dhe atëherë e ndjeva dhembjen që më gërvishti më fort.

Shkova dhe u ula te vija e mullirit dhe thashë me vete: Do të martohesh, Kristinë. Vetëm kaq.

20 gusht, pasdite

Mërzi.

Kristina u martua. Të dielën që shkoi erdhën krushqit dhe e morën. Ishin nja gjashtë burra me bërruce të zeza,

hipur mbi kuaj. Të gjithë të armatosur. Rrugët janë shumë të rrezikshme. Dasmë nuk u bë. Burrat u shtruan dhe pinë pak raki. Edhe mua më ftuan, por të ardhurit nuk këmbyen asnjë fjalë me mua. Sikur të mos isha.

Dy ditë më parë desha dhe unë t'i bëja ndonjë dhuratë Kristinës. S'kisha asgjë me vete. Mendova t'i jepja medaljonin. Nja dy-tri herë ma kishte parë me vërejtje.

- Merre, - i thashë, - për kujtim, nga unë.

Ajo e mori gjithë gëzim.

- Shën Mëria?

- Po, - i thashë.

- Kush ta ka dhënë? - pyeti ajo. - Nëna?

- Jo. Komanda.

- E pse?

- Që të më njohin kush jam, kur të vritem.

Ajo qeshi.

- Ku e di ti që do të vritesh?

- Në qoftë se vritem.

Ja, pra, kështu, ia dhashë të vetmen gjë që kisha. E ç'më duhej? Unë i humbur se i humbur jam. Unë jam i gjallë dhe i humbur, e ç'më duhet të më gjejnë kur të vdes?

Aty nga dreka krushqit u ngritën. Hodhën armët mbi supe dhe u hipën kuajve. Kali i Kristinës ishte i bardhë. Ajo qante. Edhe teto Frosa. Mullisi e mbajti veten. Pastaj u përqafuan me vajzën. Doja ta takoja dhe unë, por nuk pata guxim të afrohesha te kuajt. Ndoshta, nga hija e rëndë e krushqve. Qëndrova mënjanë. Qeni i madh, Xhuvi, vërtitej ngadalë midis tyre, me qafën e lidhur. E kisha smirë. Kristina e përqafoi dhe e puthi. Për mua s'u kujtua njeri.

Ikën. Në fillim u zhdukën kuajt. Pastaj bërrucet e zeza. Në fund, tytat e gjata të pushkëve.

ditë gushti

Ka ca net që në udhën e Gjirokastrës lëvizin vazhdimisht trupa. Me sa duket, diçka do të ndodhë së shpejti. Fshatarët, që vijnë në mulli, tregojnë se fshatrat janë mbushur përsëri me qytetarë të shpërngulur.

Veç kësaj, tregojnë se Batalioni Blu e ka lënë Shqipërinë Qendrore dhe po afrohet këndej. Netët janë prapë të frikshme. Më del gjumi dhe ngrihem e përgjoj.

Më ka marrë malli për Kristinën.

fillim i shtatorit

Po fryn erë e vjeshtës. Herë-herë më zë një trishtim i madh dhe më duket se nuk do të dal më që këndej.

Ulem nganjëherë te vija e mullirit. Ky është vendi ku më pëlqen më tepër të rri.

Rri dhe vështroj ujin e qetë që rrjedh, duke marrë me vete herë një gjeth, herë një shkarpë, herë asgjë, vetëm ca pasqyrime.

Gjatë marshimeve tona, vijat e ujit i takonim kudo. Nuk e di pse ato vija uji të qeta të katundeve shqiptare, të hapura me shat nga duart e njerëzve, më turbulluan aq shumë. Asgjë tjetër nuk më kujtonte në mënyrë kaq të përmbledhur ditën e

paqes, sesa ato vija uji. Ecja ndanë tyre me pushkë në krah dhe nuk e ndieja veten mirë. Ato më ngacmonin. Më dukej sikur më zgjonin një shtysë të vjetër. Ato më thërrisnin. Unë ndieja gurgullimën e tyre të përjetshme dhe, me siguri, pranë ndonjë vije uji fshati, më lindi, në fillim turbull-turbull dhe pastaj gjithmonë e më qartë, mendimi i dezertimit.

pasdite

Xhuvi ngordhi dje. Zi e vërtetë. Për të gjithë. Mullisi i ka sytë të kuq. Duket që ka qarë.

shtator, 5

Qetësi. Gjethe të verdha. Në mëngjes, mbi kokat tona, shumë lart në qiell, fluturuan qindra aeroplanë. Shkonin drejt verilindjes.

Kushedi nga ç'anë e botës vijnë dhe në ç'anë venë. Me siguri, do të bombardojnë. Qiejt janë të hapur. Krejt.

KREU I DYMBËDHJETË

Këtu mbaronin shënimet. Ishte shënuar edhe data 7 shtator 1943, por, pastaj, kushedi pse, ai i kishte vënë vijë përsipër. Siç duket, ishte penduar, se nuk kishte asgjë të veçantë për të shkruar ose i qe mërzitur kjo gjë.

Gjenerali e hodhi fletoren me përbuzje mbi ndenjëse.

- Ka ndonjë gjë interesante? - pyeti prifti.

- Shënimet e një qaramani sentimental.

Prifti e mori dhe e hapi faqen e parë.

- Emrin e tij nuk e ka shkruar gjëkundi, - tha gjenerali. - Ka shkruar vetëm gjatësinë. Një e tetëdhjetë e dy.

- Paska gjatësinë e kolonelit Z., - tha prifti.

Të dy vështruan një grimë njëri-tjetrin.

- Asnjë të dhënë tjetër s'ka, - tha gjenerali. - Emrin e qenit e ka shënuar, të vetin, jo.

- Çudi!

- Ka dhe diçka për Batalionin Blu, por për kolonelin Z. nuk shkruan.

Prifti nisi të lexonte.

Gjenerali mendonte si mund të shkruhej fundi i këtij ditari, sipas tregimit që fshatari plak i bëri priftit, si kaloi Batalioni Blu në ato anë, si ishin të gjithë të tërbuar dhe si një pasdite çatisën në mulli, ngaqë, me siguri, dikush u kishte thënë se aty punonte një dezertor. Si, pastaj, e gjetën ushtarin që ishte fshehur midis thasëve të miellit dhe ushtari ishte i tëri i bardhë, i lyer me miell, sikur të ishte mbështjellë para kohe me qefinin e vdekjes; si e morën pastaj, duke e shtyrë me tytat e armëve, dhe ai ecte vazhdimisht prapa, prapa, derisa iu afrua vijës së mullirit dhe, me siguri, do të rrëzohej në ujë, sikur të vazhdonte të sprapsej ashtu, por nuk arriti, se e qëlluan pikërisht dy hapa larg vijës, kështu që, kur u rrëzua, vetëm koka i ra në vijën e ujit, dhe si, më në fund, ujët krijoi një vorbull të vogël pranë kokës së të vrarit, sikur të kishte rënë në vijë një copë gur, dhe si rryma e lehtë i shtrinte flokët e qullur përpara, si ca leshterikë të zinj, të çuditshëm, në drejtimin e ecjes së saj.

Kjo ishte e gjitha, mendoi gjenerali, duke thithur cigaren.

- E? - tha gjenerali pas një ore, kur prifti e mbylli fletoren.

Prifti ngriti shpatullat.

- Ditar i zakonshëm, - tha.

Një copë herë nuk folën, ndonëse e dinin se të dy e kishin mendjen tek ajo që porsa kishin lexuar.

- E lexuat ç'kishte shkruar për vijën e ujit? - tha gjenerali. - Atij i qe dukur se atje gjeti shpëtimin, por atje rrinte vdekja.

Prifti nuk foli.

Shoferi i binte borisë fort. Në rrugë po kapërcente një grigjë e madhe dhensh. Dy barinj me kërraba të gjata mundoheshin ta ndanin grigjën përgjysmë, sa të kalonin makinat.

- Kanë zbritur në kullotat dimërore, - tha prifti.

Gjenerali vështronte barinjtë e gjatë, me bërruce dhe llabanë të zinj në kokë.

- Ju kujtohen ata dy togerët që u katandisën të ruanin dhentë e një fshati shqiptar? Nga ç'batalion ishin? Më duket nga alpinët.

- S'më kujtohet, - tha prifti.

- Një gjë e çuditshme ndodhi me ushtrinë tonë në Shqipëri, - vazhdoi gjenerali. - Me të vërtetë e çuditshme. Ose, që të jem më i saktë, e turpshme.

- Është e vërtetë, - tha prifti. - Kanë ndodhur gjëra qesharake.

- Por edhe ne vetë kemi takuar shumë raste. Sa herë jemi skuqur nga turpi, kur kemi dëgjuar se si ushtarakët tanë ishin katandisur të lanin rrobat e të ruanin pulat e fshatarëve shqiptarë. Dy orë më parë, ai bariu apo mullisi, çfarë dreqin ishte, më prishi gjakun.

Prifti pohoi me kokë.

- Ju thatë kanë ndodhur gjëra qesharake, por këto s'janë vetëm qesharake, këto janë, para së gjithash, të trishtueshme.

- Në luftë është vështirë ta ndash tragjiken nga qesharakja dhe heroiken nga e trishtueshmja.

- Disa përpiqen ta përligjin këtë, - tha gjenerali. - Ata duan të shfajësojnë trupat tona që mbetën këtu pas kapitullimit.

Vaporë s'kishte, detet ishin të mbyllura. Ç'të bënin këta të mjerë? Në fund të fundit, duhej të mbanin shpirtin me bukë. Shpirtin me bukë mbaje, por mos e bëj leckë dinjitetin e vendit tënd, - thirri me mllef gjenerali. - Oficeri i një ushtrie të madhe, qoftë edhe të mundur, të pranojë të ruajë pulat!

- Shumë prej tyre shitën në fillim armët, - tha prifti. - I shisnin ose i ndërronin me një trastë misër ose me dy kokrra vezë.

- Ju s'keni qenë këtu atëherë, apo jo?

- Jo, - tha prifti. - Unë s'kam qenë, por më kanë treguar. Më kanë treguar si shiteshin revolverët për një copë bukë, sepse shqiptarët nuk i çmonin revolverët, ngaqë parapëlqenin pushkët. Pushkët kishin çmimin më të shtrenjtë, që arrinte gjer në një trastë bukë. Kurse mitralozët, automatikët dhe bombat i merrnin pothuaj falas, duke i këmbyer me një palë opinga të grisura, dy kokrra qepë ose, shumë-shumë, me gjysmë kile gjizë.

- Pikë e zezë! - tha gjenerali.

Prifti deshi të vazhdonte, por gjenerali e ndërpreu përsëri.

- Prandaj shqiptarët janë të prirë të na përqeshin. E patë si më fyeu ai bariu apo mullisi, çfarë qe?

- Ata e adhurojnë armën. Për ata është e papërfytyrueshme shitja e pushkës, sidomos për një copë bukë.

- Po armët e rënda? - pyeti gjenerali.

- Armët e rënda, ndonëse nuk kishin vlerë, i merrnin gjithkah. Një kundërajror i lidhur pas një gomari nuk habiste kurrkënd në atë kohë.

- Pikë e zezë! - tha prapë gjenerali.

- Atë vit në Shqipëri ndodhën fatkeqësi më shumë se çdo vit tjetër, - vazhdoi prifti. - Fëmijët loznin me armë dhe,

pasi shaheshin me njëri-tjetrin, qëllonte që i hidhnin trutë në erë shoku-shokut me ndonjë bombë. Qëllonte që ditën grindeshin gratë e fqinjëve për hiçgjë, ashtu siç e kanë zakon gratë, kurse natën, nga dritarja apo pullazi, kërciste mitralozi.

- Më duket se e zmadhoni, - tha gjenerali.

- Aspak. Ishte një psikozë e rëndë, - vazhdoi prifti. - Shqiptarët ishin si të dehur. Gjithë xanxat e vjetra qenë ngritur në këmbë dhe ata ishin bërë më të rrezikshëm se kurrë.

- Ndoshta, sepse ata porsa kishin dalë nga përleshja dhe ishin të plagosur, - tha gjenerali. - Kështu bëhen tigrat pasi i kap plumbi i parë. Veç kësaj, në atë kohë, me sa duket, shqiptarët parashikonin rreziqe të reja. Fqinjët mund t'i sulmonin nga çasti në çast.

- Shqiptarët gjithmonë parashikojnë rreziqe të tepërta, - tha prifti.

- Një gjë nuk mund ta kuptoj dot, - tha gjenerali, - si ndodhi që ata nuk u ranë më qafë ushtarëve tanë pas kapitullimit? Madje, ndodhi e kundërta, ata i mbrojtën ushtarët tanë nga ish-aleatët tanë, që i pushkatonin në vend porsa i shihnin. Ju kujtohet kjo gjë?

- Sigurisht, - tha prifti.

- Është i vajtueshëm epilogu i ushtrisë sonë në Shqipëri, - tha gjenerali. - Gjithë ata ushtarakë me armë, grada, uniforma, medalje u kthyen në shërbëtorë, mëditës, dado. Më zë turpi, kur mendoj se ç'punë bënin. Ju kujtohet ç'na treguan për një kolonel?

- Po, - tha prifti. - Madje, kam menduar mos vallë edhe koloneli Z. është pajtuar në ndonjë shtëpi fshatare si lopçar dhe ende sot vete të kullosë dhitë.

Gjenerali nuk u besoi veshëve. Prifti, që gjer atëherë ia kishte plasur shpirtin me vetëpërmbajtjen e tij, po mahitej me të vdekurin?

- Do të ishte zbavitëse ta shikonte Beti në një gjendje të tillë, - tha gjenerali.

Ai priti që prifti ta shembte gjer në fund rivalin e tij, por tjetri, i penduar, me sa dukej, për teprimin, e kishte mbyllur gojën.

Pjesën tjetër të rrugës e bënë pothuajse pa folur. Rrugët ishin mbushur plot me gjethe të rëna. Fletët e verdha era i hidhte anash, kurse të kalburat mezi lëviznin. Herë-herë mbeteshin si të paralizuara, të rënduara nga ujët dhe nga balta dhe, ashtu të murrëtyera, dukej sikur prisnin vdekjen në vend.

Vetura kalonte përmbi to me shpejtësi.

KRYE PA NUMËR

Makinat po i afroheshin rrethinës së kryeqytetit. Nga të dyja anët e udhës dukeshin, aty-këtu, ndërtesa fermash, një aeroport i vogël, në pistën e të cilit kishte disa helikopterë, pajisjet e një radiostacioni.

Papritur, makinat e lanë rrugën kryesore dhe u kthyen njëra pas tjetrës, nëpër një rruginë fushe. Pamja ndryshoi në mënyrë të befasishme. Ishte një djerrinë e ulët, njëfarë ligatine gjithë baltë. Aty-këtu dukeshin ca shkurre të rralla. Një shtyllë e vjetër telefoni dhe asgjë tjetër. Në mes të shkretëtirës ishte baraka e gjatë, e mbuluar me pllaka ngjyrë hiri. Makinat ndaluan përpara saj. Një qen i madh leshtor, që rrinte te hyrja, nisi të lehte.

Dera e barakës u hap ngadalë dhe që andej doli duke u kollitur një njeri i gjatë, mbështjellë me një pallto të madhe gjithë arna. Ishte magazinieri.

Varrmihësit po zbrisnin nga kamioni arkat e mëdha. Specialisti hyri në barakë bashkë me magazinierin. Gjenerali me priftin i ndoqën pas.

Baraka ishte e ftohtë. Drita e paktë, që hynte nga dritaret, binte mbi thasët prej najloni të vendosur rresht nëpër raftet e gjata prej dërrase.

Punëtorët i futën arkat në barakë. Magazinieri filloi t'i nxirrte dhe t'i numëronte thasët prej najloni. Ai i vinte ata në rafte, duke murmuritur numrat me vete, si të përpiqej t'i mbante mend pa nevojën e syve.

- Këtë jo, - tha ai kur punëtorët i sollën arkën e rëndë që ua kishte dhënë fshatari në rrugë. Specialisti u përpoq t'i mbushte mendjen. - Jo, - tha përsëri magazinieri. - S'është e rregullt.

Punëtorët e kthyen arkën në karrocerinë e kamionit.

Kur gjithçka mbaroi, magazinieri mori nga rafti një fletore të trashë me mbulesë të ndotur. I hapi fletët me ngathtësi, duke hukatur dy-tri herë gishtat.

- Këtu, - i tha specialistit.

Specialisti shënoi diçka, pastaj vuri nënshkrimin. Dorëzimi kishte mbaruar.

KREU I TREMBËDHJETË

Shumë ditë më pas, në sallonin e hotel "Dajtit", ata rrinin përsëri ballë për ballë në tryezë. Nga taverna poshtë vinin prapë tingujt e muzikës dhe, diku pranë tyre, gjenerali ndiente jetën e huaj. Ai ishte më i hequr në fytyrë dhe sytë i kishte të prerë.

- Mbrëmë kam fjetur keq, - tha gjenerali, - kam parë në ëndërr atë prostitutën. Ju kujtohet ç'na tregoi kafetari?

- Natyrisht.

- M'u shti në ëndërr e vdekur, e shtrirë në arkë. Kurse përjashta prisnin radhën, te dera e shtëpisë publike, plot ushtarë, të shtrirë edhe ata në arkë.

- Ëndërr e keqe.

- Kurse mua e gjithë kjo m'u duk në ëndërr fare e zakonshme. Kalova andej dhe pyeta: "Këta ushtarë që presin,

a vijnë nga fronti apo shkojnë për në front?" Disa u përgjigjën se vinin, disa se shkonin dhe unë atëherë thashë: "Ata që shkojnë për në front të mos presin, le të luftojnë njëherë dhe pastaj të kenë të drejtë për dëfrim, kurse ata që vijnë nga fronti të rrinë në radhë".

- Ëndërr e keqe, - tha prapë prifti.

- Pastaj pashë kolonelin Z. Ju kujtoni se unë jam një e tetëdhjetë e dy i gjatë? më tha, duke qeshur me shpoti. Gaboheni, zotërinj, unë nuk jam aq. Po sa jeni? e pyeta. Ai qeshi përsëri dhe pastaj në mënyrë trillane tha: nuk e tregoj. - Gjenerali nxori cigaret. - Ja kështu.

- Kjo është nga lodhja.

- Po. Këtë herë jemi lodhur shumë. Më shumë se herët e tjera.

- S'ke ç'i bën, - tha prifti. - Do të lodhemi edhe më fort.

- U bëmë si ata shtegtarët e mesjetës. Ik e ik e rruga s'ka të sosur. Kurse ata atje, - gjenerali bëri me dorë në drejtimin ku, sipas tij, duhej të ishte vendi i tyre, - ata kujtojnë se ne i nxjerrim të vdekurit nga toka me sustë, - vazhdoi gjithë pezëm. - Ata s'dinë kurrgjë.

- S'kanë faj, - tha prifti.

Gjenerali trokiste me gishta në tryezë.

- Kam përshtypjen se keni lexuar kronika të vjetra, - tha ai. - A keni gjetur në to ndonjë rast të tillë?

- Jo, - tha prifti, pa dhënë të kuptohej nëse donte të thoshte se nuk kishte lexuar kronika të vjetra apo nuk kishte gjetur një rast të tillë në to.

- Domethënë, kronikat heshtin.

- A bëjmë një shëtitje? - tha prifti. - Sonte është kohë e mirë.

Zbritën shkallët e hotelit dhe ecën ngadalë në drejtim të Universitetit. Në Bulevardin e Madh kishte lëvizje të pazakontë veturash. Dritat e tyre ndaheshin te ura, në kryqëzimin me bulevardin "Marsel Kashen". Disa ktheheshin nga e majta, drejt rajonit ku ishte shumica e ambasadave të huaja, të tjerat iknin në drejtim të sheshit "Skënderbej".

Ata shkuan deri te ndërtesa e Kryeministrisë dhe u kthyen. Nga të dyja anët e bulevardit, punëtorët po shkulnin mimozat dhe, në vend të tyre, në gropa të mëdha, vinin pisha.

- Përgatiten për festë, - tha prifti, - punojnë edhe natën.

Te shkallët përpara hotelit takuan kryetarin e bashkisë. Ishte vetëm.

- Ku është kolegu im? - pyeti gjenerali.

- Në Shqipërinë Qendrore. Vazhdojmë kërkimet në ca fusha. Po ju?

- Do të pushojmë nja dy ditë.

Duke biseduar, ngjitën shkallët. Kryetari i bashkisë u tha mirupafshim dhe hipi në ashensor, ndërsa ata të dy shkuan e u ulën përsëri në sallon.

Gjenerali porositi fërnet dhe ndezi cigaren. Pastaj mbushi gotën dhe e piu. Përpara syve filluan t'i vallëzonin përsëri bokërimat e mërzitshme të tokës dhe mbi to varrezat.

Unë nuk e kuptoj përse eshtrat e shokëve tanë duhet të ndahen nëpër familjet. Nuk besoj që kjo të ishte dëshira e tyre e fundit, siç ngulin këmbë disa. Për ne, veteranët e luftës, këto ahte grash janë qesharake. Ushtari e ndien veten mirë vetëm midis shokëve, i gjallë apo i vdekur qoftë. Lërini bashkë shokët tanë. Mos i ndani nga njëri-tjetri. Varret e tyre

ne do të na mbajnë gjallë frymën e vjetër ushtarake. Mos i dëgjoni ata që e kanë zemrën si të pulës dhe që janë gati të vënë kujën për një pikë gjak të derdhur. Na besoni, ne, ushtarakët e vjetër.

Gjeneralit i ra pija në kokë.

Unë kam tani një ushtri të tërë të vdekurish, mendoi. Vetëm se ata tani, në vend të uniformës, kanë secili nga një thes najloni. Thasë të kaltër me dy vija të bardha dhe një shirit të zi, prodhim special i "Olympias". Në fillim ishin vetëm ca skuadra. Pastaj u krijuan kompanitë, pastaj batalionet dhe tani po plotësohen divizionet dhe regjimentet. Një ushtri e tërë e mbështjellë me najlon.

- Ç'të bëj me ta? - tha me gjysmë zëri.

- Ju nuk jeni mirë, - tha prifti. - Ndoshta keni ethe?

- S'kam asgjë, - tha gjenerali, duke e ndier se fërneti po i binte më shpejt se çdo herë në kokë, siç duket, nga lodhja. - Unë s'kam asgjë, - përsëriti, - vetëm se dua të pi, - dhe ktheu gotën. - Unë dua të pi, por ju, prift a kolonel, a dreqi e di ç'jeni, më pengoni. Ç'doni nga unë, ë?

Gjenerali u bë papritur i vrazhdë.

- Unë nuk i duroj dot përgjimet. Ç'doni nga unë, flisni, - gati sa s'bërtiti.

Burri i imët, që, si zakonisht, rrinte ulur në tryezën pranë radios dhe shkruante, ktheu kryet.

- Asgjë, zotni. Unë s'ju pengoj për asgjë dhe aq më pak ju përgjoj, - tha ftohtë prifti.

- Atëherë, rrini dhe vështroni se si pi unë.

- S'ka nevojë për skandale, - tha prifti.

Gjenerali ktheu gotën prapë. Tani prifti s'do ta pengonte më. Në fund të fundit, ai ishte kryesori.

E çoi mendjen tek ushtria e tij. Tek ushtria e tij e kaltër, me dy vija të bardha dhe një shirit të zi. Ç'të bëj me ta? mendoi. Ata janë shumë dhe, sigurisht, kanë ftohtë nën ato kapota najloni. Shumë. Gjeneralët e tyre të paaftë i braktisën fushave të luftës dhe m'i lanë të gjithë mua. Unë mund të fitoja me ta shumë beteja.

Mundohej të sillte ndër mend betejat që kishte mësuar në akademi dhe të gjente cilën prej tyre mund të fitonte me këta ushtarë. Mbi paketën e cigareve nisi të bënte planin, duke shënuar vendosjen e trupave, vijat e sulmit, goditjen kryesore. Prifti vështronte në heshtje shkarravinat dhe pinte kakao. Gjenerali nisi nga koha e vjetër. Në fillim rrethoi Cezarin, pastaj u preu rrugën ushtarëve të Karlit të Madh, pastaj, me një lëvizje të beftë, i doli përpara Napoleonit dhe e zmbrapsi. Por kjo nuk i pëlqeu. Nuk i pëlqeu, se ai mund të fitonte të gjitha betejat e kohërave të shkuara në saje të sipëranisë së armëve moderne dhe jo të zotësisë së tij. Atëherë, nisi të rikujtonte luftërat e fundit. Zbarkoi në shumë brigje dhe rrethoi disa kryeqytete. Ushtarët e tij të kaltër i hidhte nga brigjet e Normandisë në paralelin 38 të Koresë. I futi në xhunglat e Vietnamit dhe i nxori andej shëndoshë e mirë. Fitoi disa beteja, që historia i quante të humbura. Kjo ndodhte, ngaqë ai nuk i linte në baltë ushtarët e tij. Ai dinte të printe. Ai po bënte një studim të veçantë për luftën në zona malore. Veç kësaj, ushtarët ishin trima, oh, shumë trima. Ata janë trima, se nuk kanë më ç'të humbasin, mendoi dhe piu përsëri. Paketa ishte nxirë nga shkarravinat dhe atij prapë iu

kujtua një luftë. Një herë u tërhoq, por hodhi në sulm rezervat e të vdekurve, që ishin ende pa emra (dhe këta ishin më të egrit në luftë) dhe fitoi.

- Ja kështu, - murmuriti pothuaj i kënaqur. - Kush guxon t'i dalë përpara Armatës së Madhe të Najlonit?

Ishte krejtësisht i dehur.

KREU I KATËRMBËDHJETË

Gjenerali e ndiente veten të dërrmuar. Hapi flegrat e dritareve. Mëngjesi ishte i ftohtë. Qielli shpalosej i palëvizshëm kudo. U mbështet te dritarja dhe iu morën pak mendtë. S'jam mirë, mendoi.

Vështroi përjashta. Po mbaronte vjeshta. Parku përballë qe zhveshur krejt. Mbi stolat e blertë, me siguri, kishte kohë që nuk ulej njeri. Vetëm fletët. Po edhe ato kalbeshin shpejt. Gjenerali i njihte mirë uniformat e trupave të NATO-s. Por vetëm tani vuri re se ngjyrat e tyre nuk ishin, veçse motërzime të ngjyrave që merrnin fletët në vjeshtë.

Në qendër të parkut, pranë pistës së vallëzimit, ishin vënë grumbull njëra mbi tjetrën ndenjëset e lagëta. E zbrazët, pista dukej e madhe dhe e trishtuar. Te vendi i orkestrës dhe kudo kishin rënë gjethet. Pastruesi po i mblidhte me fshesë.

S'jam mirë, përsëriti me vete gjenerali, duke zbritur shkallët për të ngrënë mëngjes.

- Ju nuk jeni mirë, - i tha prifti, kur u ulën në tryezë. - Ndoshta, keni nevojë të pushoni ca kohë.

- As vetë nuk e di ç'kam, - tha gjenerali. - Por nuk jam mirë, vërtet. Më duket se mbrëmë, padashur, ju fyeva. Ju kërkoj ndjesë, isha i pirë.

- Ju lutem, - tha prifti me njerëzi.

- Ç'dreq kohe është kjo?

- Ndoshta, s'do të ishte keq që nesër të nisesha vetëm unë. Kërkimet në breg të detit besoj se do të jenë shumë më të lehta se në zonat malore, - tha prifti.

- Ashtu besoj dhe unë.

- Ju çlodhuni ca kohë. Do të ishte mirë që mbrëmjeve të shkonit në opera. Nganjëherë jepen koncerte simfonike.

- Nuk fle mirë, - i tha gjenerali. - Duhet të marr qetësues.

Ata dolën në bulevard dhe po shëtisnin në trotuarin e gjerë nën pishat e larta përpara hotelit. Bri tyre kalonin grumbuj-grumbuj djem e vajza, siç duket, studentë të Universitetit.

- Ç'është kjo punë e mjerë që na kanë ngarkuar të bëjmë? - tha gjenerali, sikur të vazhdonte një bisedë të lënë përgjysmë. - Do ta kisha më lehtë të rrëmoja nëpër varret e Egjiptit, sesa të gërmoj dy metra thellë në këtë tokë për të nxjerrë këta ushtarë.

- Ju gjithmonë mendoni shumë për këtë gjë, - tha prifti. - Ndoshta, nga ky shkak nuk e ndieni veten mirë.

- Këtu lufta s'ka qenë si çdo luftë, - tha gjenerali, - sepse këtu lufta nuk u bë në fronte. Ajo hyri si krimb kudo, ndaj edhe ishte e një natyre tjetër.

- Kjo ndodhi, sepse shqiptarët prej natyre janë të prirë për luftë, - tha prifti. - Ata e përqafojnë atë aq me zell e aq natyrshëm, saqë për një kohë të shkurtër ajo arrin t'ua helmojë gjakun, siç ndodh me njeriun e alkoolizuar. Psikika e tyre...

- Më keni folur një herë për këtë gjë, - tha gjenerali.

- Po, e mbaj mend. Ndoshta, ju kam lodhur.

- Aspak. Unë ju dëgjoj me kërshëri. E kishit fjalën për psikikën e luftës te shqiptarët.

- Po, - tha prifti. - Është diçka që nuk ka lindur sot. Shqiptarët gjatë gjithë historisë së tyre janë endur me hekura në krahë. Malësorët e tyre patriarkalë, që gjer dje ende jetonin si në mesjetë, kanë mbajtur gjithmonë në krahë armë nga më modernet. Merreni me mend ç'kundërti. Jua kam thënë dhe një herë, pa luftë dhe pa armë ky popull do të vyshkej dhe do t'i thaheshin rrënjët dalëngadalë.

- Kurse me armë dhe me luftë do të ripërtërihej?

- Ata kujtojnë kështu, kurse, në të vërtetë, nga arma do të zhduken edhe më shpejt.

- Sipas jush, lufta është për ta njëfarë gjimnastike mëngjesi, që u shpin gjymtyrët dhe u gjallëron frymëmarrjen.

- Përkohësisht, - tha prifti.

- Domethënë, me armë ose pa armë, ky popull është i dënuar të zhduket.

- Me sa duket, - tha prifti. - Prirjen e lashtë të shqiptarëve drejt luftës, qeveria e tyre e sotme e ka ngritur në parim, në politikën e saj, dhe është një fat për fqinjët që ata janë vetëm disa milionë.

Gjenerali ndezi një cigare.

- Ju kujtohen këngët që këndonin punëtorët e komunales

në ato net kur flinim në tendë, në mal? Ju kujtohet ç'mërzi dhe trishtim na pllakoste kur i dëgjonim?

- Më kujtohen, - tha gjenerali, - është vështirë t'i harrosh ca gjëra.

- Ato këngë ua këndonin kryesisht shkatërrimit dhe vdekjes, - vazhdoi prifti. - Ky është tipar i artit të tyre. Këtë e gjen në këngë, në veshje dhe në çdo gjë. Pak a shumë, kjo është veçanti e popujve ballkanikë, por te shqiptarët është më e theksuar. Madje, edhe flamuri i tyre kombëtar nuk simbolizon gjë tjetër, veçse gjakun dhe zinë.

- Me sa pasion flisni për këto gjëra! - tha gjenerali.

- Jam marrë shumë kohë me to, - u përgjigj prifti. - Oskar Uajldi thotë në një vend se njerëzit e klasave të ulëta kanë nevojë të bëjnë krime, sepse krimet u japin atyre disa ndjesira të forta, të cilat, ne të tjerëve, na i jep arti. Këtë thënie të tij mund ta perifrazosh fare mirë për shqiptarët, me të vetmin ndryshim që të zëvendësohet fjala "krim" me "luftë" ose "gjakmarrje". Sepse, që të jemi të paanshëm, midis shqiptarëve gjen pak kriminelë të zakonshëm. Vrasjet ata i bëjnë kryesisht sipas riteve të vjetra. Gjakmarrja e tyre është si një pjesë teatrale e shkruar sipas të gjitha ligjeve të tragjedisë, me prolog, me dramaticitet që vjen e rritet vazhdimisht dhe me epilog, që nuk mund të kuptohet pa vdekjen. Gjakmarrja e tyre është si një dem i tërbuar, që bën gjëmë, kur lëshohet në këto male. Por ata, megjithatë, këtij demi i kanë vënë në qafë shumë zbukurime e lajle-lule, sipas etikës së tyre, me qëllim që, kur ky dem të lëshohet e të mbjellë vdekjen kudo, ata, bashkë me vdekjen, të shijojnë edhe kënaqësi.

Gjenerali dëgjonte me vëmendje.

- Jeta e shqiptarit është si një shfaqje, - vazhdoi prifti, - e rregulluar sipas kanuneve të vjetra. Shqiptari jeton dhe vdes si në skenë, me të vetmin ndryshim se skena është pllaja ose mali, ku ai e kalon jetën e tij të zhveshur nga çdo gjë. Shpeshherë, ai vdes, sepse duhet të vihen në vend ca rregulla dhe jo sepse ka arsye. Jeta, që mbin me aq vuajtje e mundime në këta shkrepa, ajo jetë, që nuk e shuan dot të ftohtët, uria apo orteku i malit, merr fund papritur nga një fjalë e thënë pa kujdes, nga një mahi e tepruar apo nga shikimi i zjarrtë hedhur një femre. Gjakmarrja shpërthen, shpeshherë, pa as më të voglin pasion, por vetëm se kështu e kërkon kanuni. Edhe kur gjakësi vret viktimën, ai s'bën gjë tjetër, veçse çon në vend një nyjë të kodit. Këto nyja të vjetra u ngatërrohen atyre nëpër këmbë tërë jetën si litarë, gjersa një ditë u ngecin këmbët nëpër to dhe bien e nuk ngrihen më. Kështu që, gjatë gjithë shekujve, shqiptarët s'kanë bërë gjë tjetër, veçse kanë luajtur një pjesë teatrale të përgjakshme.

Ata ndien pas shpine hapat e dikujt dhe kthyen kokën. Ishte specialisti.

- Ju kërkova në hotel, - tha ai.

- Si është puna?

- Nesër duhet të rishikojmë disa procesverbale në drejtorinë e komunales.

Prifti e vështronte me vërejtje specialistin. Ai donte të kuptonte a i kishte dëgjuar ai fjalët e tij të fundit apo jo.

- Po bisedonim për doket tuaja, - tha me një ton të qetë.

Specialisti buzëqeshi me vete.

- Po më tregonte për gjakmarrjen, - tha gjenerali. - Shumë befasuese nga ana etnopsikike.

- S'besoj se është ashtu, - e ndërpreu specialisti. - Disa të huaj kujtojnë se gjakmarrja shpjegon psikikën e shqiptarit, por kjo s'është veçse, më falni, një dokërr.

- Ashtu? - ia bëri prifti.

- Disa të huaj përqendrohen me shumë zell te çështja e gjakmarrjes, jo pa arsye.

- Kjo është një çështje me interes shkencor, - tha prifti.

- Nuk mendoj ashtu. Qëllimi i vërtetë i tyre është që të përgatisin idenë e asgjësimit të njeriut shqiptar.

- O, nuk e besoj, nuk e besoj, - tha prifti, duke buzëqeshur ftohtë.

Specialisti bëri dhe ca hapa me ta, pastaj i përshëndeti dhe iku.

- Ç'gjuhë, - tha prifti.

- Ju i shpjegoni ca çështje vetëm duke u mbështetur në elemente psikologjike, por, sidoqoftë, mendoj se ka edhe arsye historike dhe ushtarake, - tha gjenerali. - A e dini ç'më kujton mua ky popull? Ato kafshët e egra, që, kur ndiejnë rrezikun, para se të hidhen, rrinë në një tendosje të madhe, shtrëngojnë të gjithë muskujt dhe të gjitha shqisat i kanë në alarm. Me sa duket, ky vend ka qenë shpesh pranë rrezikut dhe kjo gjendje i është bërë natyrë e dytë.

- Kjo që thoni ju është pikërisht ajo gjë që ata e quajnë syçeltësi, - tha prifti.

Prifti vazhdoi të fliste, por gjenerali nuk po e dëgjonte më.

- Ne sikur po flasim shumë për ta, - tha më në fund. - E ç'na duhen punët e tyre? Nuk e kanë zhdukur njëri-tjetrin një orë e më parë?

Prifti bëri një lëvizje, duke hapur pëllëmbët.

- A nuk shikojmë më mirë këtë punën tonë, - vazhdoi gjenerali, - këtë punën tonë shkretane, që na mori shpirtin dhe që s'po ia dalim dot në krye? A nuk e shikoni se edhe ne kemi ngecur? A nuk ka një mbrapshti në këtë punë, diçka të errët, që nuk shkon?

- Jo, - tha prifti, - nuk mendoj se ka. Ky është një mision i lartë.

- Jemi bërë si një tumor lëvizës, - tha gjenerali, - u vërtitemi njerëzve nëpër këmbë, pengojmë punët e tyre.

- E keni fjalën për atë rastin kur nga shkaku i gërmimeve tona vonuan ca ditë punimet e atij ujësjellësit?

- Jo, - tha gjenerali, - jo vetëm për atë rast. Ka diçka të kundërnatyrshme, do të thosha, të kundërkohshme në punën tonë.

- Nuk mendoj ashtu, - tha prifti.

- Po a keni menduar ndonjëherë se, ndoshta, këta ushtarë, që ne i kërkojmë me kaq zell, nuk do ta dëshironin këtë gjë?

- Kjo është e pakuptimtë, - tha prifti. - Misioni ynë është kaq njerëzor dhe çdokush do ta ndiente veten krenar.

Gjenerali kujtonte se ai do të fliste për shëlbimin e shpirtit dhe për dritën e skajjetshme, atë që shfaqej mu atje ku nisnin trevat e vdekjes. Por fytyra e tjetrit ishte e ashpër.

- Megjithatë, ka diçka që nuk shkon, ka një përqeshje.

- Jo, - tha prifti. - S'ka asgjë. Ndoshta, ju, si ushtarak, keni arsye të tjera që nuk e ndieni veten mirë shpirtërisht.

- Ç'arsye? - pyeti gjenerali.

- Përse të bisedojmë për këto gjëra? Ndoshta, ju vetë nuk doni t'ia pohoni vetes.

Gjenerali buzëqeshi me mundim.

- Prapë arsye psikike? - tha. - Siç duket, jeni marrë me psikanalizë. Kam dëgjuar të flitet shumë për këtë gjë, por, të them të drejtën, ende nuk e marr vesh ç'është. Ne ushtarakëve s'para na pëlqejnë këto stërhollime.

- Epo, - ia bëri prifti, sikur të thoshte "secili ka parapëlqimet e tij".

- Sidoqoftë, - tha gjenerali, - si e shpjegoni ju gjendjen time të vështirë shpirtërore? Ma ka ënda të dëgjoj arsyetimet tuaja, ju flisni bukur. Veç kësaj, ju jap fjalën se nuk do të fyhem, çfarëdo që të më thoni.

- Meqenëse ngulni këmbë, mund t'jua them mendimin tim, - tha prifti i qetë. - Ajo që ju krijon vazhdimisht një shtypje në psikikën tuaj është fakti që, në thellësi të ndërgjegjes, ju vjen keq që nuk ishit ju ai që udhëhoqi trupat në Shqipëri. Dhe mendoni se, ndoshta, po të ishit ju, gjithçka do të ndodhte ndryshe, se ju nuk do t'i çonit ushtarët në humbje dhe vdekje, por do t'i shpëtonit. Prandaj i hapni shpesh hartat dhe rrini me orë të tëra mbi to. Ju vajtoni çdo operacion të dështuar, rijetoni çdo thyerje dhe, padashur, e vini veten tuaj në vend të oficerëve fatkeqë, duke përfytyruar vazhdimisht gjënë më të pamundur: kthimin e humbjeve në fitore.

- Mjaft, - tha gjenerali. - Mos vallë, më merrni për një të sëmurë psikik?

Prifti buzëqeshi.

Gjenerali u vrenjt.

- Unë nuk kam arsye të fshehta, - tha ai ngadalë. - Unë nuk isha ndonjë vajzë naive që të kujtoja se mbledhja e eshtrave të ushtarëve i ngjan një operete. E dija se kjo ishte një punë e rëndë dhe e zymtë.

Ai thoshte të vërtetën. E kishte kuptuar që në fillim se ndodhej përpara një detyre të jashtëzakonshme. Siç kishte thënë ministri, në këtë punë do ta ndihmonin dashuria dhe urrejtja. Kur ishte kthyer nga Ministria e Luftës në shtëpi, ditën që i ngarkuan këtë mision, ndiente në shpirt një muzikë. Ishte muzikë funebre dhe mallëngjyese, njëkohësisht. Pastaj hapi dosjet dhe nisi të shfletonte. Nga ato lista të gjata, pothuajse të pafundme, filloi të frynte një erë hakmarrjeje. U afrua te globi dhe gjeti Shqipërinë. Provoi një gëzim të egër që ajo ishte e vogël sa një pikë. Pastaj ndjeu urrejtje. Kjo pikë e vogël u kishte ngrënë kokën kaq djemve të bukur dhe trima. Dhe deshi sa më parë të nisej e të vinte tek ai vend i egër i prapambetur, siç tregonin për të. Ai do të endej midis atij populli, që e përfytyronte si një turmë parakësh, dhe vështrimi i tij përbuzës do të thoshte: shikoni ç'keni bërë, o të egër. Përfytyronte madhështinë e bartjes së eshtrave, sytë e topitur, krejt të hutuar të shqiptarëve, si sytë e fajtorit të paditur, që, pasi ka thyer një vazo të çmuar, rri e vështron mënjanë me pikëllim.

- Megjithatë, isha krenar, - tha gjenerali me zë të lodhur, duke vazhduar fillin e mendimit, - ne do t'i kalonim arkat e ushtarëve tanë midis tyre, duke u treguar se, madje, edhe vdekja jonë është më e bukur se jeta e tyre. Ja, kështu mendoja atëherë. Por erdhëm këtu dhe punët qëndronin ndryshe. Ju e dini këtë më mirë se unë. Në fillim iku krenaria, pastaj hija e rëndë, pastaj gjithë përfytyrimet e tjera dhe tani ne endemi këtu midis shpërfilljes së përgjithshme, dy bufonë të mjerë të luftës, më fatkeqët e gjithë atyre që luftuan dhe u thyen në këtë vend. A nuk është kështu?

Prifti nuk u përgjigj dhe gjenerali u pendua që foli.

Ata ecën një copë rrugë në heshtje dhe në trotuaret vazhdimisht binin gjethet e fundit. Gjenerali e ndjeu veten keq dhe të vetmuar. Ai nuk deshi të bisedonte për këto gjëra. Të fliste më mirë për ato ditë të zymta që i kaluan humbëtirave, ku të njomte shiu dhe të rrëqethte era, për vështrimet e akullta të fshatarëve të veshur me shajak të zi, për atë natë kur prifti kishte thirrur i llahtarisur në gjumë, për një fushë përleshjesh, që tani ishte mbushur nga ujët e liqenit të një hidrocentrali dhe varrezat ishin zhdukur nën të dhe uji dukej i kuq në çastet e muzgut, krejt i kuq dhe, më në fund, për atë kafkën që i kishte të gjithë dhëmbët prej floriri dhe që, kur punëtorët e nxorën, dhëmbët i ndritën befas në diell dhe u duk sikur kafka buzëqeshi me cinizëm për të gjitha këto.

Të dyja hullitë anës udhës ishin mbushur me gjethe të verdha dhe shtatoret e parkut të madh dukej sikur mërdhinin midis drurëve të zhveshur.

Kur u ngjitën në majë të bregut, panë liqenin artificial që shtrihej midis bregoreve, i gjatë dhe me gjire të shumta, të vogla e të mëdha. Në majën e kodrës ishte një kishë dhe, ngjitur me të, një lokal vallëzimi. Rreth pistës së rrumbullakët të dansit çoheshin qiparisat e lartë, që fëshfërinin nga era. Aty pranë ishte lënë një grumbull i madh arkash të zbrazëta, mbi të cilat ishte shkruar "Birra Korça".

Ata i kthyen krahët liqenit dhe po vështronin Tiranën. Mbipetku i gjeneralit kërciste nga era.

Gjenerali vështronte Bulevardin e Madh, që e ndante qytetin në dy pjesë. Një plep lëkundej aty përpara, duke zënë me një degë të tij herë pamjen e ndërtesës së Kryeministrisë,

herë atë të Komitetit Qendror. Kur era frynte më fort, dega kalonte mbi orën e madhe të qytetit, që dukej si e ngjitur me minaren e xhamisë, mbulonte një pjesë të sheshit "Skënderbej" dhe gati sa s'prekte Bankën Kombëtare.

- Në atë librin për Shqipërinë thuhej se Bulevardi i Madh i Tiranës është ndërtuar në atë mënyrë që t'i ngjante shpatës perandorake, - tha gjenerali, duke treguar me dorë përpara. - Kam disa minuta që po mundohem të kap ngjashmërinë dhe nuk po e gjej dot.

- Shikojeni me kujdes, - tha prifti, - bulevardi jep bishtin e sëpatës, ndërtesa e lartë e rektoratit është pjesa e fundit e bishtit që del mbi të dyja presat, Instituti i Arteve ngjan si presa e prapme, kurse stadiumi, - prifti zgjati dorën nga ana e djathtë, - është presa harkore e saj.

- Me një fjalë, kjo ishte si një vula jonë në qendër të kryeqytetit.

- Pas luftës, kur komunistët u ngritën për herë të parë me aeroplan, e vunë re këtë gjë dhe, natyrisht, u përpoqën ta zhduknin ngjashmërinë, por s'ka qenë e lehtë.

Ata ecën pranë kishës, në rrugën e shtruar. Në një nga stolat ndanë udhës ishin ulur një djalë e një vajzë. Ajo i kishte vënë kokën në sup dhe vështronte si e humbur, ndërsa ai i përkëdhelte gjunjët.

- Zbresim, - tha gjenerali. - Më ka ngrirë shpina.

Kreu i pesëmbëdhjetë

Makinat e lanë udhën automobilistike dhe i ranë mespërmes fushës, duke ecur përskaj vreshtave të fermës. Gjenerali mbante në gjunjë një hartë dhe herë pas here vështronte përjashta. Ai e dinte se në atë çast, në kabinën e kamionit që vinte pas, edhe specialisti mbante mbi gjunjë të njëjtën hartë dhe, ashtu si ai, përpiqej të përcaktonte me saktësi vendin ku duhej të ndalonin.

Nga e djathta ishte një radhë plepash të lartë dhe, po të vështrosh në atë drejtim, mund të dallosh, tutje, ndërtesat e fermës së një beu dhe, më tej, një krua. Pikërisht në këmbët e plepave, përbri cungishtës, është vendi. Që t'i mbanim mend varret, i hapëm në formë V-je, me majën të kthyer në drejtim të detit. Pesë nga një krah, pesë nga tjetri dhe nëntogeri në krye.

- I thoni të ecë në drejtim të plepave, - tha gjenerali.

Prifti ia përktheu fjalët shoferit.

Kur zbritën, frynte erë dhe plepat fëshfërinin. Prifti eci i pari në drejtim të vendit ku duhej të ishin varret dhe papritur lëshoi një britmë habie.

- Si është puna? - pyeti gjenerali, duke iu afruar.

- Shikoni, - tha prifti. - Shikoni atje.

Gjenerali vështroi në atë drejtim.

- Ç'do me thënë kjo? - tha i zemëruar.

Në këmbët e plepave ishin dy rreshta gropash të hapura, që bashkoheshin me njëra-tjetrën në trajtën e një V-je. Gropat, siç duket, ishin mihur një ose dy javë përpara, sepse ishin mbushur përgjysmë me ujë.

- Asgjë nuk po kuptoj, - tha prifti.

- Dikush ka hapur varret para se të mbërrinim ne, - tha gjenerali. Zëri i dridhej.

- Po vjen specialisti, - tha prifti. - Të shohim ç'do të na thotë.

- Ç'ka ndodhur? - tha specialisti, kur u afrua.

Gjenerali, pa folur, i tregoi me dorë gropat. Specialisti vështroi një copë herë dhe ngriti supet.

- E çuditshme, - tha me ngadalë.

- Dikush ka hapur varret pa lejen dhe pa dijeninë tonë, - tha prifti. - Ç'mund të na thoni?

Specialisti përsëri ngriti supet.

- Kur do të pushojnë këto provokime? - thirri gjenerali. - Do ta bëj çështje menjëherë.

- Tani për tani s'mund të them asgjë, - tha specialisti. - Por do ta sqaroj. Kini pak durim, ju lutem.

- Ju lutem, - tha gjenerali gjithë pezëm.

Punëtorët dhe dy shoferët, që ishin afruar, po vështronin me habi.

Specialisti i numëroi përsëri gropat dhe një copë herë vërtiti nëpër duar hartën topografike.

- Dëgjo, - i tha, duke iu drejtuar shoferit të kamionit. - Shko gjer në fermë dhe sill ndonjë njeri me vete, kushdo që të jetë. I thuaj se jemi nga Kryeministria dhe kemi një çështje me rëndësi. Asgjë nuk mund t'ju them tani për tani, - përsëriti specialisti, duke iu kthyer gjeneralit. - Vetëm ju siguroj se, në qoftë se dikush ka guxuar ta bëjë një gjë të tillë me qëllim fyerjeje, do të ndëshkohet.

- Me çfarëdo qëllimi që ta ketë bërë, - tha prifti, - ky është një dhunim i rëndë.

Ndërkaq, punëtorët rrinin në këmbë përpara gropave dhe flisnin për skajimin e tyre të pazakonshëm.

- Hera e parë që na takon një varrezë të tillë në formë V-je! - tha njëri prej tyre.

- Kështu fluturojnë krillat, - tha varrtari i vjetër. - Keni parë kur ikin në vjeshtë?

U dëgjua kamioni që po afrohej. Në kabinë, përveç shoferit, ishte edhe një njeri tjetër.

- Tani, besoj, do të sqarohet çdo gjë, - tha specialisti.

Shoferi zbriti dhe i hapi derën të panjohurit. Ai zbriti dhe i vështroi të gjithë me radhë me vëmendje.

- Në këtë fermë punon? - e pyeti specialisti.

- Po.

- A di gjë për këto varre ushtarësh?

- Atë që dinë të gjithë, - tha tjetri.

- Për shembull?

- Po ja. Varre ushtarësh të huaj. Kanë njëzet e ca vjet këtu.

- Po si shpjegohet...

- Para dhjetë ditësh erdhën e i hapën.

- Pikërisht këtë duam të dimë, - tha specialisti. - Kush i hapi varret para dhjetë ditësh?

Njeriu vështroi përsëri me radhë gërmuesit, gjeneralin, priftin, pastaj makinat.

- A i keni parë ju njerëzit që i hapën varret? - pyeti specialisti.

Tjetri ngurroi të përgjigjej menjëherë.

- Ju po më merrni për ndonjë gjysmak? - tha papritur.

- Si? Ç'domethënë kjo?

- Ju e dini më mirë se unë.

Specialisti ngriti supet. Rreth e rrotull u bë një heshtje e rëndë.

- Të lutem, ma thuaj shkurt dhe qartë: kush i hapi varret para dhjetë ditësh?

Njeriu i fermës e vështroi me përçmim.

- Ju i hapët, - tha me zë të prerë.

Balli i specialistit u mbush me djersë.

- Ju të gjithë, - vazhdoi tjetri dhe tregoi me dorë varrmihësit, gjeneralin, priftin dhe shoferët.

Të gjithë vështruan njëri-tjetrin.

- Ku e paske gjetur këtë? - i tha dikush me zë të ulët shoferit të kamionit.

- Dëgjo, - i tha specialisti, - nuk është e hijshme...

- Lëri ato, - tha njeriu i fermës dhe sytë i shkreptinë nga zemërimi, - mos u mundo të më ngatërrosh. Kujton se je njeri me shkollë dhe mund të lozësh teatër me të tjerët?

Ai i vështroi të gjithë me mllef, ktheu krahët dhe nisi të largohej.

- Prit, o shok, - i thirri punëtori i vjetër.

- Ej, ti, ndal aty, - i bërtiti shoferi i kamionit.

- S'ju vjen turp, - tha njeriu i fermës, duke u kthyer. - Kujtoni se njerëzit janë leshko? Kujtoni se nuk ju pamë kur erdhët para dhjetë ditësh dhe gërmuat nga mëngjesi në mbrëmje?

- Edhe kjo na duhej, - tha prifti me zë të ulët.

- Kush ka gërmuar? Ne?

- Ju, posi! Me po këtë veturë ngjyrë bari dhe me po këtë kamion të mbuluar.

- Ah, prit, - tha befas specialisti, - ju u ndodhët këtu kur u bënë gërmimet?

- Jo. Ju pamë që nga larg.

Specialisti ngriti kryet.

- Më duket se e kuptova, - tha. - Me siguri, do të jenë ata të tjerët. Ç'na polli!

- Si është puna? - pyeti gjenerali.

- Më duket se para nesh ka kaluar ai gjenerallejtënanti me civilin e tij.

- Ata e kanë bërë këtë?

- Jam i sigurt. S'ka si të jetë ndryshe.

Njeriu i fermës, duke shoqëruar fjalët me lëvizje duarsh, po u tregonte diçka punëtorëve dhe shoferëve.

- Si ka mundësi? - tha gjenerali.

- Ata nuk kanë harta dhe shënime të rregullta. Ndoshta, i kanë marrë për varre të ushtarëve të tyre.

- Sidoqoftë, mund të pyesnin vendësit. Pastaj, medaljonet, - tha prifti.

- Kjo po më habit edhe mua, - tha specialisti, duke kafshuar pak buzën e poshtme.

- Ky është dhunim i rëndë, - tha gjenerali.

- Nuk është hera e parë që ata e bëjnë këtë gjë, - tha specialisti. - Më kanë treguar se diku, në jug, kishin hapur gabimisht dy varre ballistësh, kurse në një vend tjetër kishin hapur një varrezë të vjetër myslimanësh.

- Dhe i kishin marrë eshtrat?

- Po.

- E pabesueshme! - tha gjenerali.

- A janë në vete këta njerëz? Ç'i shtyn ta bëjnë këtë gjë?

- Mund të ketë një arsye, - tha specialisti i menduar. - Dyshoj për një arsye.

- Çfarë?

Specialisti u lëkund.

- Asgjë s'mund t'ju them, më falni.

- Ndoshta, ata i kanë bërë llum punët e tyre, - tha gjenerali. - Ndoshta, nuk po gjejnë kurrgjë dhe tani filluan të grabitin varret e të tjerëve.

- Ata na e kanë thënë vetë. Kërkojnë në tym.

- Dhe e keqja është se i deportojnë menjëherë eshtrat e gjetura, - tha specialisti.

- Ky është kulmi, - tha gjenerali. - Domethënë, nuk do t'ua tërheqim dot këta të njëmbëdhjetë?

- Më duket e vështirë, në qoftë se eshtrat janë nisur.

- Domethënë, eshtrat e ushtarëve tanë do t'u ndahen familjeve të një populli tjetër, në vend të njerëzve të tyre, - thirri gjenerali. - Kjo është për të luajtur mendsh!

- Siç duket, kanë bërë premtime, - tha prifti, - dhe meqenëse...

- Dhe meqenëse nuk gjejnë të tyret, oburra, të vjedhim, ku të mundim. Ah, ç'punë e bukur!

- Gjenerali vente e vinte ndanë gropave.

- Të ikim, - tha papritur, - ç'të bëjmë më këtu?

Hipën nëpër makina dhe u nisën në drejtim të detit, pikërisht në atë drejtim nga ishte kthyer maja e varrezës në formë V-je.

KREU I GJASHTËMBËDHJETË

Bregu i detit ishte i zymtë dhe i shkretë. Bunkerët prej betoni çoheshin drejt e në rërën e lagur. Shumica ishin të dëmtuar nga goditjet dhe nga koha. Nëpër të çarat u dukeshin, si brinjë, hekurat e ndryshkur.

Nga deti frynte erë e ftohtë.

Gjenerali vështronte nga veriu, atje ku zbardhnin vilat e para të plazheve, stacionet verore të hekurudhës dhe radha e shtëpive të pushimit dhe e hoteleve të mëdha, shumica e të cilave tani ishin mbyllur.

Po mblidhnin eshtrat e ushtarëve të ditës së parë të luftës. Gjatë gjithë javës lëvizën nëpër bregdet, duke u ndalur në të gjitha pikat, ku ishte bërë zbarkimi i trupave. Çdo pikë kishte varrezën e saj.

Atij i kujtohej mirë dita e parë e luftës, pranvera e vitit 1939. Atëherë ishte në Afrikë. Në mbrëmje, radioja kishte

dhënë lajmin: trupat fashiste zbarkuan në Shqipëri. Populli shqiptar i priti me paqe dhe lule divizionet e lavdishme, që i sillnin qytetërimin.

Më vonë arritën gazetat dhe më vonë revistat dhe në revistat kishte shumë fotografi dhe shkrime për zbarkimin. Ata lexonin për pranverën e bukur të atij viti, për kthjelltësinë e detit dhe të qiellit shqiptar, për plazhet, dashurinë e shqiptarkave, veshjet dhe vallet e moçme. Radiot jepnin lajme përditë dhe netëve ushtarët ëndërronin të shkonin atje, në atë breg plot paqe, nën ullinjtë e përjetshëm.

Gjeneralit iu kujtua se edhe ai pati atëherë dëshirë ta çonin në Shqipëri.

Megjithëse fati, prapëseprapë, ma ruajti pjesën time të luftës, që ta bëj më vonë, tha me vete. Ta bënte pikërisht tani, pas njëzet vjetësh, në kohën kur bota ishte në paqe.

Asnjëherë nuk e gjente dot nëse kishte qenë më mirë apo më keq për të.

Punëtorët, pasi i hodhën veglat përbri arkave, hipën dhe vetë në kamion.

U nisën.

Kaluan pranë vilave të plazhit, që tani dukeshin të trishtuara, me flegrat e dritareve të mbyllura. Në det zgjateshin pistat e vallëzimit, me ndenjëset dhe tryezat të grumbulluara në kënd, të vëna pirg njëra mbi tjetrën, si kujtime të verës, që s'duheshin më.

- Bunkerë kudo, - tha gjenerali.

- Atyre u pëlqen të përsëritin se Shqipëria është një kështjellë në breg të Adriatikut, - tha prifti.

Gjenerali ktheu kokën nga bregu.

- Më keni thënë se deti u ka sjellë shqiptarëve fatkeqësi dhe prandaj ata nuk e duan.

- Ashtu është, - tha prifti. - Shqiptarët janë si ato qeniet që i tremben ujit. Ata kanë qejf t'u qepen shkrepave dhe maleve. Atje e ndiejnë veten të sigurt.

Linja e bregut po largohej vazhdimisht dhe tani nuk dukeshin më as stacionet verore të hekurudhës, as vilat e bardha të shpërndara tutje-tëhu.

- Tani na ka mbetur për të kërkuar vetëm një ushtar i ditës së parë, - tha gjenerali. - Në qoftë se ai është varri i parë, siç dyshoj, atëherë mund të thuhet se është ky rrezikzi, që e paska hequr këmbën zvarrë, siç thonë pleqtë e këtushëm.

- Ushtar i ditës së parë... - përsëriti prifti. - Pastaj kemi një tjetër udhëtim të vështirë, në mos gaboj, në zonë gjysmëmalore.

- Pikërisht, - tha gjenerali. - Pastaj dy dalje të tjera. Më pas një tjetër, e parafundit. Dhe pastaj, e fundit. - Ai mori frymë thellë. - Është ende herët për kthim. Madje, tepër herët.

Prifti tundi kokën në shenjë pohimi.

Nuk të durohet, tha me vete gjenerali. Të presin.

- Sivëllezërit tanë s'i kemi takuar prej kohësh, - tha me zë të lartë.

- Kushedi ku gërmojnë!

- Me siguri në ndonjë stadium tjetër, në mos në ndonjë bulevard!

- Keq do t'i kenë punët, - tha prifti. - Të ngratët!

- S'po çaj kryet për ta, - tha gjenerali. - Kryesorja është të mos na vjedhin ndonjë ushtar tjetër.

Një copë herë folën për këtë.

Kuvendi i fretërve, ku ishte varrosur ushtari i vetmuar, ndodhej në një kodrinë, atje ku rruga bigëzohej.

Ata iu ngjitën shpatit. Në krye gjenerali me priftin, pas tyre të tjerët, me vegla në krahë.

Përpara ndërtesës së kuvendit ishin ca varre të vjetra, me kryqe guri dhe me mbishkrime në gjuhën latine. Porta ishte e mbyllur. Sipër harkut të saj ishin gdhendur fjalët: *Societas Jesus*.

Specialisti trokiti shumë herë derisa nga brenda u dëgjuan hapa. Një frat i thinjur, veshur me zhgun, u shfaq më në fund te pragu.

Frati e vështroi me vëmendje grumbullin e habitshëm dhe iu desh njëfarë kohe sa të kuptonte kërkesën e tyre.

- Urdhrin shtetëror dhe lejen e monsinjorit e kemi me vete, - tha specialisti.

Frati i hetoi letrat, me sytë e bardhë, plot qeska anëve dhe, ndërsa lexonte, lëvizte buzët, sikur përtypej.

- Mirë, - tha. - Tani po ju çoj vetë te varri.

Ata të gjithë shkuan pas tij, i erdhën rrotull murit të jashtëm që rrethonte kuvendin dhe dolën nga prapa, atje ku ishte kisha. - Ja varri, - tha ai.

Varri ishte i thjeshtë dhe te koka kishte një kryq guri dhe një helmetë. Helmetës i ishte gërryer ngjyra prej kohësh, anët e saj ishin futur në baltë dhe, me siguri, në pranverë, kur mbinte bari i ri, ajo mbulohej prej gjelbërimit.

Njëri nga punëtorët e hoqi helmetën me lopatë. Dy të tjerë nisën të shkulnin kryqin e gurtë dhe të tjerët u bënë gati të gërmonin.

- Përse ky varr ka qëlluar vetëm? - pyeti gjenerali.

- Këtë ushtar e vrau Nik Martini, - tha ati plak, me një zë të thellë e të dobët.

Kur plaku shqiptoi emrin e Nik Martinit, gjenerali vështroi priftin në mënyrë pyetëse.

- Malësor i panjohur, - e sqaroi prifti.

Me dorën që i dridhej, frati po tregonte bregun, prej nga, me sa dukej, malësori kishte qëlluar.

- U bë ndonjë përpjekje këtu? - pyeti gjenerali.

- Jo, - tha frati. - Ky vend, që këndej e në det, siç e shihni, është njelmishtë. Askujt nuk ia merrte mendja se trupat mund të zbarkonin në këtë humbëtirë. Kurse Nik Martini, i Martin Nikës, e dinte.

Ai fliste sikur të tjerët ishin në dijeni të gjithçkaje.

- Kur e pashë tek përpinte rrugën, ndonëse ishte me pushkë krahut, nuk më shkoi mendja për vrasje, ngaqë malësorët ashtu ecin zakonisht dhe nga fytyra nuk kuptohen kurrë nëse janë nisur për treg apo për mort.

Kur e pa se të tjerët po e ndiqnin, frati tregoi takimin e tij me Nik Martinin, fjalët që i tha: ku po shkon Nik Martini? dhe përgjigjen e tjetrit: të qes pushkë. Pastaj ngjitjen e të dyve në kambanore, prej nga dukej bregu i detit, që nxinte nga zbarkuesit. Dhe, prapë, fjalët që i tha: ti s'mund të qesësh pushkë nga shtëpia e Zotit, Nikë. Dhe zemërimin e Nikës, dhe kërcënimin e fratit me shkishërim, së fundi, ikjen e malësorit drejt bregores dhe ngulimin e tij atje.

- Luftoi vërtet? - pyeti gjenerali.

- Po, zotni. Qiti pushkë një kohë të gjatë, gjersa e qëlluan me mortajë.

- E vranë?

- Jo. Ashtu kujtuan, kur i heshtoi pushka. Por, më pas, si të mbinte nga dheu, shtiu prapë, nga ajo suka përbri. Aty u vra ky rrezikziu, - tha, duke treguar dheun që po hapej.

- E pastaj? - tha gjenerali. - Ç'u bë me atë malësorin? Mbeti gjallë?

- Nik Martini? - Prifti plak ngriti sytë e bardhë, të shuar në drejtim të kodrinave. - Jo, - tha, - vdiq. Atë ditë ai doli dhe luftoi i vetëm në tri-katër vende të ndryshme, gjersa u lodh dhe u këput. Thonë se, kur iu mbaruan fishekët dhe pa se si kamionët me ushtarë po vraponin drejt Tiranës, ia dha një vikame, ashtu siç bëjnë malësorët kur u vdes njeri. E rrethuan nga të gjitha anët dhe e copëtuan me kama.

Për ca çaste u bë heshtje.

- Nik Martini nuk ka varr, - tha prifti plak, që ndoshta kujtoi se ata do të kërkonin tani edhe varrin e tij. - As shenjë, as kryq. Vetëm një këngë ka për të. E këndojnë shpesh, sidomos prapamalasit, në ato dy katundet përtej, - ai tregoi, me dorën që i dridhej, diku nga veriperëndimi. - Vitin që shkoi erdhi një dërgatë nga Instituti i Folklorit. Midis këngëve që mblodhën ishte, në mos gaboj, edhe kënga për Nik Martinin. Pastaj folkloristët u grindën. Disa thoshin se ajo këngë qenkësh më e vjetër dhe gabimisht ishte quajtur e Nik Martinit. Të tjerët thoshin se me këngët kështu ndodhte përherë: ato ishin gjithmonë të vjetra, si cungjet. Veç degët dhe kurorën e kishin të re.

Frati plak vazhdonte të fliste, ndonëse kishte kohë që nuk e dëgjonte kush.

- E çuditshme, - tha gjenerali gjysmë ore më vonë, kur vetura ikte drejt Tiranës. - Si mund të dalë të luftojë një njeri i vetëm?

- Ata e kanë për nder të luftojnë fillikat, - tha prifti. - Madje, sa më të vetmuar ta bëjnë luftën, aq më të lavdishëm ndihen.

Gjenerali ndezi një cigare dhe psherëtiu.

- Mbaroi dhe një ditë e luftës, - tha me zë të ulët.

Prifti nuk tha asgjë. Ai po vështronte fushat nga të dyja anët e udhës. Mbi to kishin nisur të frynin erërat e dimrit. Më tutje u shfaq përsëri Adriatiku, këtë herë nga e djathta, i gjerë dhe i pafund.

Përballë bregut të detit ngriheshin një radhë kodrinash me shpina të buta. Në faqet e tyre, përbri ranishtes, ishin varret e vendësve, që u vranë ditën e parë.

Copëza-copëza, ata kishin dëgjuar çfarë kishte ndodhur atë ditë në brigjet e dy deteve të Shqipërisë. Lajmi ishte hapur gjithkund se armiku kishte dalë në det dhe nga të gjitha krahinat ishin nisur grupe, nga pesë, nga dhjetë dhe nga njëzet veta bashkë, me pushkë në krah, për të luftuar. Ata vinin nga larg, pa i thirrur kush, kapërcenin grykat e bornajat, gjersa gjenin luginat, dhe në ecjen e tyre kishte diçka të kryehershme, të mbetur, ndoshta, si shtysë gjaku brez pas brezi, që nga kohët e legjendave, kur e keqja dilte gjithmonë nga deti si një përbindësh dhe duhej shfarosur mu në breg të detit, pa e lënë të ngulte kthetrat në tokë. Kjo ishte një frikë e lashtë nga ujërat e kaltra dhe, në përgjithësi, nga vendet e përfushta, sepse e keqja depërtonte gjithmonë nga rrafshulëtat dhe ata, duke zbritur nga lartësitë, për t'u bashkuar me mbeturinat e ushtrisë mbretërore që mbaheshin ende, porsa ndienin erën dhe hapësirën e detit, ndienin njëkohësisht rrezikun dhe uturimën e dallgëve, e merrnin për muzikë të luftës.

Kështu kishin zbritur atë ditë dhjetëra grupe të tilla. Pastaj, te ranishtja përziheshin bashkë, njerëz me borsalina dhe me syze, me malësorë të gjatë të flamurëve, që jetonin ende si në mesjetë dhe, midis këtyre të fundit, kishte, ndoshta, shumë nga ata që nuk e dinin se cili shtet po sulmonte dhe me cilin armik po vriteshin, sepse për ta kjo nuk kishte ndonjë rëndësi. Kryesorja ishte që e keqja kishte dalë nga deti dhe duhej kthyer prapë në det. Shumica e tyre nuk kishin parë ndonjëherë ujanë me sy dhe, me siguri, kur u dilte përpara Adriatiku, thërrisnin të mrekulluar: "Sa i bukur që është!", të befasuar që e keqja mund të vinte andej. Pastaj të zbriturit kishin vështruar me shpërfillje kryqëzorët që nxinin me topat gjigantë të drejtuar nga bregu, aeroplanët që fluturonin ultas, barkat e zbarkimit dhe, fill pas kësaj, pa e bërë të gjatë, kishin rënë në përpjekje, ashtu siç e lypnin doket, dhe qenë vrarë njëri pas tjetrit, kush më përpara, kush më pas.

Pastaj, aty më të thyer të ditës, kishin arritur të vonuarit, ata të krahinave më të largëta. Ashtu, të lodhur e të këputur nga udha e gjatë, ishin futur në luftë, ndonëse pa asnjë shpresë, në kohën që po përëndonte dielli, pikërisht në atë kohë kur pushtuesit me pompa të fuqishme lanin gjakun nëpër rrugët e Durrësit.

Të vonuarit vazhduan të arrinin gjersa ra muzgu dhe midis tyre kishte edhe të vetëm fare, që shfaqeshin si hije majë brigjeve dhe, pasi zbuloheshin nga projektorët, korreshin nga mitralozët dhe mbeteshin të shtrirë përmbys gjer në mëngjes, me flokë të qullur nga vesa e natës.

Të nesërmen i varrosnin dosido atje ku kishin rënë dhe varret e tyre u shfaqën atë pranverë kudo, si kope dhensh

të shpërndara kodrave, kundruall detit, dhe asnjeri nuk e mori vesh si quheshin dhe nga ç'anë erdhën, që, së paku, në mungesë të emrit, t'u vinin te koka emërtimin e krahinës. Dihej veç që kishin qenë prej gjithkundi, që nga trevat ku, në rast vdekjeje, qanin vetëm gratë, gjer te bjeshkët veriore, ku gjëmën e bënin burrat dhe ku jo vetëm gjindja vishej me të zeza, por vishnin ashtu edhe kullën prej guri të të vrarit dhe pastaj i ngrinin një këngë dhe, në këtë rast, në këngë, patjetër, do të kishte diçka nga deti i largët e i pabesë.

PJESA E DYTË

Erdhi pranvera dhe kaloi. Mbi tokën ■ huaj kishte mbirë bari. Ai mbulonte brigjet, shfaqej në luginë e faqe malesh dhe, pa u sprapsur përpara asgjëje, pushtonte çdo rrip të ngushtë toke.

Gjithë atë fillim vere, gjenerali me priftin, të ndjekur nga specialisti shqiptar dhe varrmihësit, u vërtitën poshtë e përpjetë nëpër Shqipëri. Megjithatë, ushtrinë nuk arritën ta zhvarrosnin dot. Kështu i zuri vera dhe në verë nuk pushuan më shumë se dy javë, sepse punët nuk shkonin mirë.

Në konferencën e shtypit, që ai e mbajti në vendin e tij, në prag të nisjes së dytë për në Shqipëri, nuk e fshehu nervozizmin përpara gazetarëve. Po, ishte kërkuar vërtet një shtyrje afati për zgjatjen e kohës së kërkimeve, prej qeverisë shqiptare. Po, ishte e vërtetë se ky kërkim po zgjatej më shumë se ç'ishte parashikuar. Po, ishte jashtë çdo dyshimi se

kishin dalë vështirësi të papritura. Jo, s'ishte punë pengesash nga qeveria vendëse. Jo, kurrfarë zvarritjeje e as kursim parash nga qeveria e vet.

Pyetjet e gazetarëve ishin, si zakonisht, bezdisëse e plot dyshim. Ndërsa përgjigjej, mezi e mbante veten të mos u kthehej gjithë përçmim: është e lehtë të bëni pyetje që këndej, o bandillë. Po ejani njëherë me mua në ato gropa...

Duke u përpjekur të ishte sa më i kursyer, u detyrua të përmendte, megjithatë, disa nga pengesat. Nuk foli për ftohtësinë e vendësve, për këngët e zymta, për moskuptimin, por i përmendi prapë gjithë të tjerat: truallin e thyer, dimrin në alpe, kanalet ujitëse që, siç mund ta dinin ata, në vendet komuniste ishin më të mëdha se ç'duhej, tërmetin e një viti më parë, që kishte dëmtuar shumë nga varret.

Tek fliste për këtë të fundit, për herë të parë në sallë ra heshtja. Ajo ishte e tillë, saqë, për një grimë, atij iu duk se midis tij dhe sallës u bë një ndërprerje e plotë: as ai, as salla nuk e dëgjonin më njëri-tjetrin.

Këtë ndjesi shurdhërie e kishte provuar kur, për herë të parë, në arkivat shqiptarë, kishte ndeshur të dhënat për tërmetin. Si një goditje e beftë, ai i kishte trandur të vdekurit, një vit përpara mbërritjes së tij në Shqipëri. Do të besoje në një shkundje në gjumë, njëfarë paralajmërimi për ardhjen e tij...

Konferenca e shtypit, si dhe gjithë trazimet e atyre ditëve: vërshimi i njerëzve në shtëpi, letrat, telegramet, thirrjet në telefon, mbetën të gjitha si një zhurmëri e largët, kur ai, së bashku me priftin, në fund të gushtit i hipën prapë avionit për në Shqipëri.

Pamja ishte po ajo e herës tjetër, as më shumë, as më pak armiqësore, dhe te pista e shkretë ishin po ata njerëz, me po ato fjalë që shqiptonin përmes së njëjtës buzëqeshje të ftohtë dhe me të njëjtat gabime gjuhësore, si një vit më parë.

KREU I SHTATËMBËDHJETË

Sytë e gjeneralit ndalën një grimë sipër frazës: "Zakonisht, e kalojmë ditën duke pirë cigare te parmakët e urës". U bë gati ta prishte, por dora i mbeti pezull sipër letrës. Buzët iu mblodhën në atë mënyrë siç bëjnë njerëzit kur pranojnë thyerjen dhe, pa e prekur frazën, e vazhdoi letrën, që po i shkruante së shoqes, gjer në fund.

Qysh se kishte vënë re se jo vetëm në bisedat, por edhe në gjithçka tjetër kishin nisur t'i futeshin dromca të huaja, fraza vizitorësh në sallonin e shtëpisë së tij, copëza letrash a ditarësh të ushtarëve të vdekur, vetvetiu kishte bërë një përpjekje për të ndalur atë vërshim. Mirëpo, ky kishte qenë aq i fortë, saqë fjalë, fraza, disa herë rrëfime të tëra të treturish, sa vente po bëheshin zotëruese. Ato po shtynin gjithçka tjetër dhe ai e ndiente se çdo ditë po dorëzohej.

Nganjëherë e qetësonte veten me mendimin se kjo ishte një gjë që pritej. Madje, frika se duke përdorur fraza e fjalë hijesh ai po bëhej, ndërkaq, pjesëtar i asaj bote, nuk kishte më kuptim. Ai ishte, ndërkaq, i tyre, kishte hyrë dalëngadalë, ditë pas dite e stinë pas stine në atë gjithësi e prej saj, çfarëdo që të bënte, s'dilte më dot.

Tani po mësohej me të, madje, kishte ditë që, në vend të ankthit të dikurshëm, ndiente njëfarë paqeje. Dhe, bashkë me të, gëzimin e ftohtë që ajo botë e kishte pranuar.

Zakonisht, ne e kalonim ditën ose duke pirë cigare, mbështetur në parmakët e urës, ose te baraka e vogël prej druri, i zoti i së cilës kishte shkruar në hyrje me shkronja të shtrembra "Kafe-Arançata". Ishim gjashtë ushtarë që ruanim urën. Kjo ishte një rrugë ushtarake e hapur nga austriakët, qysh në Luftën e Parë Botërore, dhe e lënë pas dore më pas. Ne erdhëm që në ditët e para pas meremetimit. Ushtarët, që kishin rindërtuar urën, kishin ngritur për ne një fortino dhe një kazermë të vogël. Kështu që i gjetëm të gjitha gati. Mitralozin e rëndë e vendosëm në fortino, kurse të lehtin, për çdo rast, e mbanim në kazermë.

Vendi përreth ishte i shkretë dhe i trishtuar. Bokërima me gurë të vegjël dhe tek-tuk ndonjë pemë e rrallë. Fshati ishte i vogël fare, as dhjetë shtëpi. Këto ishin ca shtëpi prej guri, që, në vend të dritareve, kishin frëngji të ngushta si ato të fortinos sonë.

Në fillim mërziteshim shumë. Makinat ushtarake kalonin rrallë, kurse fshatarët silleshin me ne në mënyrë armiqësore. Gjithë ditën vërtiteshim te parmakët e urës dhe hidhnim gurë në përrua. Natën bënim rojë.

Por një ditë, nëpër rrugën malore erdhi një njeri me tri mushka të ngarkuara me dërrasa, arka dhe letër sere. Ky ishte një spekulant nga qyteti. Brenda dy ditësh ngriti barakën mu pranë urës dhe në hyrje shkroi me ngjyrë të zezë "Kafe-Arançata".

Që atë ditë, ne u bëmë blerësit e tij të rregullt. Ndonëse sipër hyrjes shkruante kafe dhe arançata, në të vërtetë, ai shiste raki dhe verë të kuqe. Herë pas here, ushtarakët që kalonin me makina ndalonin për të kthyer ndonjë gotë. Baraka sikur e gjallëroi atë vend të zymtë. Qëllonte që edhe fshatarët vinin nganjëherë e pinin. Por atyre nuk u pëlqente rakia e, aq më pak, vera. Ata e kishin hallin gjetkë. Vinin që të këmbenin vezët e tyre me fishekë. Ne e kishim të ndaluar rreptësisht këtë, por, prapëseprapë, të gjithë e bënim. Natën, kur kishim rojë, zbraznim kot një breshëri plumbash dhe të nesërmen thoshim se kishim tretur dyfishin e fishekëve. Fishekët që hiqnim mënjanë i këmbenim me vezë.

Por këto breshëri nate ishin ogurzeza. Dukej sikur e ndollëm vetë të keqen. Partizanët filluan të na trazonin vërtet pas ca kohësh. Po të mos ishte bunkeri, do të na kishin zhdukur qysh në krye.

I pari u vra mbi urë, tek bënte rojë natën. Partizanët, siç duket, provuan të hidhnin urën në erë, por nuk mundën, sepse ai dha alarmin. Në mëngjes e gjetëm të vrarë te parmakët. Kishte rënë në një skajim të pazakontë, me gojë hapur. E keni parë filmin "Vdekja e çiklistit"? Kur e pashë atë film, desh bërtita në sallë. Ishte një gjë e ngjashme.

Pas dy javësh u vra i dyti. Rrethanat ishin pothuaj të njëjta. Ne dyshonim se qëllonin fshatarët, por nuk ishim të sigurt. Tani nuk u jepnim më fishekë. Po ç'e do! Ishte vonë.

Kur vranë të tretin, u vendos që roja të mos dilte mbi urë. Bashkë me ushtarët që zëvendësuan rojat e vrara sollën dhe një projektor dhe e vendosën në bunker. Tani, herë pas here, natën, ura ndriçohej prej tij. Nën dritën e projektorit, ajo dukej e frikshme dhe ndjellazezë, me ata qindra hekura të zinj të kryqëzuar, si një dyzetkëmbësh i zi. Qëllonte që e vështroja në mesnatë, të ndriçuar nga drita e ftohtë dhe e bardhë, dhe thosha me vete: Kjo urë do të na e hajë kokën me radhë të gjithëve.

Partizanët nuk po i ndaheshin urës.

Ushtari i katërt u vra atë natë që u plagosa unë. Nuk më kujtohet asgjë, veç, kur erdha në vete, pashë që më kishin hipur në një mushkë dhe mushka po ecte ngadalë mbi urë. Dërrasat kërcisnin nën thundrat e saj. Ishte mëngjes. Një mëngjes i hirtë dimri. Vështroja me një sy të mpirë kllapat e panumërta metalike të urës, që më kalonin pranë syve, dhe ndieja se edhe zemrën time po ma shtrëngonte diçka e ftohtë si hekuri.

Kur mushka doli nga ura, ktheva kokën me mundim dhe pashë për herë të fundit urën, bunkerin, shtëpitë e ngrysura të fshatarëve në pllajë, varret e shokëve në këmbët e urës (varrin e ri ende s'kishin filluar ta hapnin) dhe barakën e drunjtë aty pranë, me ato shkronjat e neveritshme "Kafe-Arançata".

Gjenerali ishte ulur mbi një copë betoni dhe po pinte cigare. Punëtorët po gërmonin te shkarëzima në këmbët e urës. Copa shkëmbinjsh ishin shpërndarë andej-këndej, bashkë me hekurat e ndryshkur e të shtrembëruar. Ura e re

ishte ndërtuar disa dhjetëra metra më poshtë, atje ku kalonte rruga e re. Mbi maloren e vjetër kishin mbirë shkurret.

Shpërthimi duhet të ketë qenë i frikshëm, mendoi ai. Ura ishte prerë mespërmes dhe copat e rënda të betonit kishin fluturuar deri te bunkeri dhe më tej, mbi çeltinën matanë përroit. Pranë urës ngrihej baraka e vjetër prej druri, në hyrjen e së cilës mund të lexoheshin ende fjalët "Kafe-Arançata".

Para një jave, kur ata erdhën aty, baraka, ashtu si ura, bunkeri dhe një pjesë e rrugës ishin të prishura. Letra prej sere që mbulonte pullazinën qe grisur vende-vende dhe shumë dërrasa ishin shkulur. Por, dy ditë më vonë, nga qytetthi aty pranë erdhi një shitës-shëtitës. Ai solli me vete cigare, konjak dhe një furnelë për të zier kafe. Kjo ishte me fitim, sepse, përveç pesë punëtorëve të përhershëm, ishin pajtuar përkohësisht edhe shtatë të tjerë dhe të gjithë këta burra, bashkë me shoferët, specialistin dhe priftin me gjeneralin do të jetonin këtu dy javë të gjata e të lodhshme. Shitësi u vendos te baraka e vjetër, pasi mbërtheu ca dërrasa në dy-tri vende dhe vuri gurë mbi copat e letrës prej sere, që të mos e ngrinte era.

Baraka e gjallëroi vendin. Mëngjeseve, punëtorët, para se të fillonin punën, pinin kafe ose kthenin ndonjë gotë fërnet. Gjatë ditës, aty rrotull vërtiteshin fshatarët, duke vështruar me orë të tëra punëtorët që gërmonin.

Edhe tani, gjenerali po shikonte se si dy prej tyre diç i shpjegonin varrtarit të vjetër, duke treguar me dorë një vend diku në këmbët e urës.

Cili prej tyre vallë ka shtënë mbi rojat? mendonte gjenerali, sa herë që vendësit hynin e dilnin te baraka. Kishin një javë që rrinin aty dhe tani ai njihte për fytyrë shumicën.

Prifti me specialistin po ngjiteshin te shpatina. Grykat e maleve ishin të mbytura në mjegull.

- Kohë e keqe, - tha gjenerali.

Prifti pohoi me krye.

- Shqiptarët kanë një proverb, - tha, - "kohë e keqe, te miku i mirë".

- Në këtë rast, ne s'përfitojmë, - tha gjenerali, - as ne nuk trokasim e as ata s'na e hapin portën.

- Ç't'i bësh, - tha prifti.

- U mbërthyem te kjo dreq urë e s'po ikim dot. Nuk e duroj dot këtë pamje dhe as këta fshatarë që vërtiten poshtë e lart për të parë si i nxjerrim ne të vdekurit.

- Vërtiten, - tha prifti. - Siç duket, kjo punë i kënaq.

- Ata i kanë njohur rojat e urës, kanë qenë fqinjë për një kohë të gjatë, kanë këmbyer vezët me fishekë, ndonjëri prej tyre ka shtënë me siguri mbi ta. Tani, sigurisht, ua ka ënda të shikojnë gërmimet.

- Ata vijnë rrotull, sikur duan të mburren përpara nesh për vrasjen e rojave, - tha prifti. - E keni parë një plak me mustaqe bigë, që del çdo mëngjes me një kobure të madhe ngjeshur për brezi?

Gjenerali rrudhi fytyrën.

- Ai që ka dy-tri medalje në gjoks dhe që ecën me kokë përpjetë? E kam parë, natyrisht. Specialisti më tha se ka humbur një djalë në luftë.

- Ashtu?

- Është shumë i vjetër nga mosha. Porsa ka marrë vesh që erdhëm ne, paska vënë medaljet, paska ngjeshur koburen dhe ka dalë përjashta. Tani këtë e bën përditë.

- Madje, edhe punëtorët shqiptarë i vështron me përbuzje, - tha prifti. - Pardje, specialisti e pyeti për diçka dhe ai nuk iu përgjigj.

- Është plak fanatik. Siç duket, edhe ata i duken si aleatët tanë. - E di? - vazhdoi gjenerali, me zë të ulët. - Njeriu duhet të parashikojë çdo gjë. Unë u trembem torollakëve të tillë. Ja, i shkrepet, nxjerr koburen e të qëllon mu në mes të ditës!

- Çdo gjë mund të ndodhë, - tha prifti. - Nga një gjysmë i lënë si ai, çdo gjë mund të presësh.

Tutje, nga grykat e maleve filluan të dëgjoheshin prapë bubullimat.

Gjenerali ndezi një cigare.

- Kureshtjen e këtyre fshatarëve për gërmimet unë pak a shumë e kuptoj, - tha ai. - Një ushtar, që ka shërbyer si rojë te kjo urë, më ka treguar diçka përpara se të niseshim për këtu. Qëparë, tek rrija ulur, m'u kujtuan, ndoshta, për të dhjetën herë fjalët e tij.

- Ne u kujtojmë këtyre vitet e luftës, - tha prifti.

- Natyrisht. Fati i këtij fshati të vogël u lidh gjatë luftës me urën. Ajo ishte fatkeqësi për ta. Pas shkatërrimit të saj, këtu u bë plojë nga ndëshkimorët tanë. Sikur të mos ishte ura, jeta e këtij katundthi, të veçuar nga bota, do të rridhte ndryshe. Por ura u bë dhe ndodhën të gjitha këto. Tani, papritur, vijmë ne dhe kërkojmë eshtrat e rojave të urës. Kjo gjë i vë kujtimet e tyre në lëvizje dhe ata, edhe po të duan, s'rrinë dot të qetë. Vërtiten poshtë e lart, blejnë cigare në barakë dhe baraka, ndoshta, më shumë se çdo gjë u ngjall klimën e atyre viteve.

Prifti e dëgjonte me vëmendje.

- Kthimi mbrapsht i kohës... Hm, kjo është gjithmonë thikë me dy presa, - tha më në fund.

Gjeneralit iu duk se tjetri nuk kishte ndonjë dëshirë që kjo bisedë të vazhdonte.

Pas buke, gjenerali u mor një copë herë me listat. Ato ishin mbushur tani me gjithfarë shënimesh të vogla anash. I paidentifikuar. Kuota 1184. Shih procesverbalin e hapjes. I paidentifikuar. Mungon koka. Shih procesverbalin e hapjes. I paidentifikuar. Krahu i djathtë më i shkurtër. Kuota 1099. Numri 19, 301. Figuron dy herë i vrarë. Nuk përkojnë dhëmbët. I paidentifikuar.

Pasdite nisi një shi i imët. Punëtorët rrinin në barakën e ftohtë, të mbushur me tym duhani, dhe vështronin shiun.

KREU I TETËMBËDHJETË

Në mbrëmje, varrmihësi i vjetër u sëmur. E kishte ndier veten keq që pasdite, por nuk i kishte dhënë rëndësi. Ndaj të ngrysur, ishte zverdhur në fytyrë dhe kërkoi të shtrihej. Të gjithë kujtuan se ishte ftohur. E çuan në shtëpinë e një fshatari, ndezën një zjarr të madh dhe e vunë pranë vatrës. Por në mbrëmje u bë më keq.

Ende pa gdhirë mirë, specialisti e zgjoi gjeneralin për t'i kërkuar makinën.

- Kryepunëtori është keq. Duhet çuar me ngut në spitalin më të afërt.

Prifti u zgjua, gjithashtu.

- Ç'të ketë vallë? - pyeti ai. - Dukej që dje pasdite që nuk ishte mirë.

- S'e di, - tha specialisti. - Dyshoj se është infektuar. Në dorën e majtë ka një gërvishtje të vogël.

- Infektim? - Gjenerali ngriti kryet.

Specialisti doli.

- Ç'të jetë? - pyeti gjenerali.

- Edhe unë dyshoj për mahisje, - tha prifti. - Mbrëmë fytyra i kishte marrë ngjyrën e baltës.

- Ç'prapësi!

- Ka mundësi nga ndonjë kopsë e ndryshkur kapote ose nga ndonjë eshtër e thyer.

- Por ai ishte punëtor me përvojë. Ai mësonte të tjerët si të gërmonin.

- S'do ta ketë vënë re, - tha prifti. - Ndoshta, i ka pasur duart me baltë dhe nuk e ka vënë re gërvishtjen.

- Do të ishte mirë ta kishin nisur që mbrëmë.

- Një pjesë e rrugës është e keqe. Edhe ditën mezi kalohet.

- Sidoqoftë.

- Po edhe sot arrijnë. S'besoj të jetë gjë [redacted] rrezikshme. Tani ka mjete të forta kundër infeksionit.

Gjenerali u mbështoll përsëri me velenxë.

- Si është koha jashtë? - pyeti.

- E vrenjtur, - tha prifti.

Kur ata dolën, disa punëtorë kishin filluar nga puna. Të tjerët pinin kafe në këmbë, përpara barakës.

- Mungesa e specialistit do të na ngadalësojë punimet, - tha prifti. - Punëtorët nuk dinë ku të gërmojnë.

- Mendoni se edhe skeletet e tjera mund të jenë të infektuara?

- Pse jo?

- Ndoshta, duhet hedhur gëlqere nëpër gropat e hapura, - tha gjenerali.

- Duhet të pyesim specialistin. Ai i di këto gjëra.

Ata shkuan te baraka dhe porositën kafe.

- Njëzet vjet mikrobi qëndron i fshehur nën tokë dhe papritur shpërthen. E frikshme, - tha gjenerali.

- Ashtu është, - tha prifti. - Porsa bie në përkitje me ajrin dhe diellin, zhvillohet.

- Si bisha që zgjohet nga gjumi i dimrit.

Prifti e pinte kafenë ngadalë.

- Më duket se pasdite do të kemi shi.

- Ditë e mërzitshme, - tha gjenerali.

Me të vërtetë, dita qëlloi e mërzitshme. Gjithë paradreken ata erdhën rrotull, pa ditur ç'të bënin. Pasdite filloi prapë shiu.

- Në qoftë se ndodh gjë, duhet t'i paguajmë familjes, - tha gjenerali.

- Pension të përjetshëm?

- Po. Kështu është shënuar në kontratë. Më duket, pika katër, nyja njëmbëdhjetë.

Prifti shkoi në tendë dhe u kthye me një grumbull fletësh në duar.

- Ashtu është, siç thoni ju, - tha, - pika katër, nyja njëmbëdhjetë. Në rast fatkeqësie, zhdëmtimi është për gjithë jetën.

- Ndoshta, e kalon, - tha gjenerali.

- Dhashtë Zoti!

Specialisti u kthye të nesërmen në mëngjes. Shoferi i kamionit e pa i pari veturën që po ngjitej me vështirësi në rrugën malore.

- Po vijnë, - thirri, - u kthyen.

Gjenerali, prifti dhe punëtorët, që ishin futur në barakë nga shkaku i shiut, dolën përjashta.

Duke iu shmangur gurëve të hedhur në mes të rrugës, po ngjitej me ngadalë makina ngjyrë bari.

- Do të jetë shëruar, - tha dikush.

Kur makina u afrua edhe ca, ata vunë re se ajo ishte spërkatur e gjitha me baltë.

Specialisti doli i pari. Ishte i verdhë në fytyrë e me sy të prerë. Hodhi njërën këmbë përjashta, pastaj tjetrën dhe i vështroi të gjithë me shpërfillje, sikur të mos e kishte mendjen aty.

- E? Çfarë ka ndodhur? - pyeti dikush në mes të heshtjes. - Ku e keni Gjolekën?

Specialisti ktheu kokën nga ai, si të çuditej për pyetjen.

- Gjolekën? Vdiq, - tha ngadalë.

- Vdiq? Ç'thua, o njeri?...

Shoferi, që u hodh në tokë pas tij, bëri ca hapa si i dehur. Sytë i kishte të kuq dhe duart gjithë baltë.

- Çfarë? Nuk e besoni? - thirri me zë të ngjirur. - Shkoni në morgun e spitalit që të bindeni...

U desh një copë herë sa të qetësoheshin e të flisnin shtruar.

- Kur? - pyeti dikush.

- Në mesnatë.

- Ishte një mahisje e lemerishme, - tha specialisti, sikur të fliste me vete.

Grumbulli i njerëzve eci në heshtje drejt barakës.

- Bëju nga një kafe, nuk e sheh si janë dërrmuar? - i thirri dikush shitësit.

- Do të merrni dhe nga një konjak? Ju bën mirë.

- Na jep dhe nga një konjak.

- Tregona, vëlla, si ndodhi?

Shoferi ktheu gotën me fund.

- Na i mbush dhe një herë, - i tha shitësit. - Ç'natë e keqe. Gjithë rrugës kur shkuam rrinte i heshtur. Herë kishte të ftohtë, herë të nxehtë. Pastaj filluan t'i merreshin mendtë. Shtrihu, i thamë, dhe ai u shtri, por prapë s'gjente karar. Unë e shkelja gazin gjer në fund. Sesi nuk u përmbysëm gjëkundi, një Zot e di. Fol, Gjolekë, si e ndien veten, e pyetëm disa herë, por ai nuk e hapi gojën, vetëm na vështronte sikur të thoshte: keq, vëlla, keq. Më në fund, arritëm në qytet. E shtruam me ngut në spital. Shkonim çdo gjysmë ore e pyesnim si u bë. Fytyrat e infermierëve ishin të shqetësuara. Duhet ta kishit sjellë më përpara, na tha njëri prej tyre. E kuptuam që puna ishte keq. Kërkuam ta vizitonim, por nuk na lanë. Ra nata. Bridhnim nga kafeneja në kafene. S'na vihej në hotel. Aty nga ora njëmbëdhjetë shkuam edhe një herë që të pyesnim. U çuditëm kur na thanë që të hynim menjëherë. Si është? pyetëm infermierin. Keq, tha ai. Nuk do ta arrijë dot mëngjesin. Atëherë e kuptuam pse na futën brenda. Po jepte shpirt. Fytyra i qe bërë e murrme. Herë pas here dridhej dhe tendosej në shtrat. Na vështroi dhe tundi kokën. Pastaj i nguli sytë një copë herë mbi të gërvishturën e dorës, sikur të thoshte: "Më more në qafë, moj e poshtër". Aty nga mesnata e zunë dridhjet e fundit. Vuajti shumë, i shkreti, gjersa dha shpirt. Ja, kështu ndodhi. Mbushma dhe një herë, pash Zotin! E mori dreqi këtë punë. Oh!

Në barakë u bë heshtje. Dëgjohej se si era përplaste një copë të shqyer të letrës së serës.

- S'na besohet, - tha njëri. - Ishte njeriu gjallë dhe s'është më.

- Na iku Gjoleka. Iku si pa kuptuar.

- Ishte i mirë, - tha njëri, - i dashur, i thjeshtë.

- Kush do t'ia thotë gruas?

- Oh, lëre.

- Ajo e shkreta nuk ia pëlqente këtë punë. Sikur e ndiente të keqen. Kur do të mbarojnë këto varre? i shkruante gjithmonë nëpër letra. Dhe ai i përgjigjej: Ja dhe ca dhe do të mbarojnë.

- E shkreta, - tha shoferi. - Një herë, kur i çova një letër dorazi, më qau hallin, shqetësohej, zemra i ndillte keq. E kishte pritur kaq vjet në kohën e luftës dhe tani prapë i dukej sikur i kishte shkuar në male.

- I pëlqente nganjëherë të thoshte gjysmë me të qeshur: u mora me fashistët sa qenë gjallë dhe tani prapë po merrem me ta.

- E, luftoi kaq vjet me ta, i mundi dhe në fund e pësoi që e pësoi prej tyre. Dreq o punë!

- U hakmorën me të, për besë.

- U hakmorën pas njëzet vjetësh. Ky i vrau me plumb, ata me një kopsë, pas shpine.

- Armiku armik mbetet, edhe i vdekur qoftë.

- Ashtu është.

- Rrinë aty si dy korba të zinj dhe nuk flasin, - tha shoferi me zë të ngjirur, duke vështruar me urrejtje në drejtim të priftit dhe të gjeneralit. Ata rrinin të dy në këmbë pranë gërmadhave të urës, mbështjellë me palltot e mëdha. - E, u kënaqët tani, ë?

- Shët! - tha dikush. - Mos bëj marrëzira, Lilo!

Në barakë u bë prapë qetësi e thellë dhe dëgjohej se si era herë e shtrinte, herë e tendoste copën e grisur të letrës me serë.

- Na e vranë, - ia bëri njëri me zë të ngashëryer. - Na e morën Gjolekën.

Nata ra e zymtë si rrallëherë. Gjenerali mori dy herë qetësues përpara se të mbyllte sytë. Ishte një gjumë i turbullt, i ndërprerë shpesh.

Vdekja e porsandodhur ia kishte prishur krejt drejtpeshimin. Nganjëherë, midis përhumbjes, i dukej se kapte tërë përmasat e pambarim të asaj mbrapshtie.

Ishte një vdekje e freskët, ndaj ngjante gjithsesi e papranueshme dhe gjithë rrezikim. Ishte krejtësisht e huaj midis asaj mbretërie kuarci të ftohur, tashmë, ç'prej njëzet vjetësh.

Gjenerali ndiente frikë, pa e ditur se nga. Ndërsa rrotullohej në shtratin fushor, dy-tri herë iu duk se dëgjoi priftin që po lutej.

KRYE PA NUMËR

Asgjë. Përpara se specialisti ta thoshte atë fjalë, prifti mori me mend.

- Asgjë, - tha tjetri me zë të lodhur, duke shkelur me kujdes mbi plisat e mëdhenj.

- Çudi, - tha prifti.

- Po gërmojmë në dy vende të tjera anash. Diku duhet të jetë, këndej rrotull.

Gjenerali u afrua. Çizmet i ishin lyer me baltë të kuqe, të pashqitshme. Ai bëri të njëjtën pyetje si të gjithë.

- Asgjë, - tha specialisti.

- Do të detyrohemi ta lëmë, - tha gjenerali. - Ç'gradë kishte?

- Toger.

- Kushedi ku është zvarritur që këndej, i plagosur.

Pikat e shiut binin të rralla mbi baltën e kuqërremtë të hedhur në të dyja anët e gropave. Gërmuesit kërkuan gjer në mesditë, kur njëri prej tyre thirri që larg.

- E gjetëm!

Specialisti u nis gati me vrap drejt gropës së hapur rishtazi. Prifti shkoi pas tij.

Ata u vërtitën shumë kohë rreth gropës së hapur, gjersa prifti u kthye me një shprehje të mërzitur në fytyrë.

- U munduam kot, - tha me zë të lodhur. - Nuk ishte yni.

- Çfarë? - pyeti gjenerali.

- Specialisti thotë se ka mundësi të jetë aviator anglez.

Specialisti u afrua.

- U munduam kot, - tha.

- Ç'do të bëjmë? - pyeti njëri nga punëtorët.

- Të ikim, - tha gjenerali. - S'kemi ç'të bëjmë më këtu.

- Ç'ta bëjmë anglezin? - pyeti specialisti.

- Mbulojeni përsëri, - tha prifti. - S'ke ç'i bën.

- S'kemi ç't'i bëjmë, - përsëriti gjenerali. - Mbulojeni. - Specialisti e vështroi një copë herë gropën.

- Mbulojeni prapë, - u tha punëtorëve.

Dy nga punëtorët i hodhën eshtrat në gropë dhe filluan t'i mbulonin me dhé, ndërsa grupi i njerëzve po largohej në këmbë. Kur gjenerali ktheu kokën për herë të parë, ata po punonin ende dhe që larg dukeshin lopatat që uleshin e ngriheshin. Pas pak, kur gjenerali u kthye prapë, ata, siç duket, kishin mbaruar dhe po zbrisnin bregut me lopata në krahë, varri i mbuluar rishtazi nuk dukej më.

- Humbëm një ditë kot, - tha gjenerali. - Fare kot.

KRYE PA NUMËR

Rrasht pas rrashti e unazë pas unaze, skeleti i rrëshqanorit të madh po plotësohej. Kishte ende ndërprerje aty-këtu. Të panjohurit ishin ende të shumtë. Bashkë me eshtrat e borizanit të fundit, nxjerrë nga gropa e përbashkët, gjeneralit iu duk se ndjeu tingullin e vetmuar të borisë së tij.

Gropat e përbashkëta kishin qenë tmerri i gjeneralit. Për fat, kishin qenë gjithsej tri, në dy prej të cilave shkoqitja ishte kryer, më në fund. Kishte mbetur e treta, më e vështira, rrëzë një pllaje të zhveshur.

Muaj më parë kishin humbur disa ditë në atë zonë, të gabuar prej të dhënave të një katundari, që ngulte këmbë se kishte parë me sytë e tij eshtra të shumta në zgafellat e një kështjelle të rrënuar. Ndonëse armët ua kishin marrë prej kohësh, dukej që larg që ishin ushtarë të tjetër epoke.

Specialistit iu desh fare pak kohë për ta bindur gjeneralin të hiqnin dorë nga hulumtimi. Asnjë medaljon me fytyrën e Shën Mërisë në asnjë skelet, kishte thënë ai, duke i zgjatur një copëz hekuri, në trajtë ylli me shumë cepa.

Ishte gjetur veç ajo shenjë dhe, me sa dinte specialisti, ajo ishte shenja e "munaxhimit", domethënë e astrologut, në ushtrinë turke.

Një copë herë, gjenerali e mbajti në dorë yllin e hekurt, pa e marrë dot me mend kurrsesi se ç'kishte kërkuar astrologu në guvat e thella, atje ku më pak se kudo mund të jepje e të merrje me qiellin.

Krye pa numër

Gropa e tretë dhe e fundit e përbashkët ishte te vendi i quajtur Logu i Shurdhit. Ishte më ▪ koklavitura e të gjithave, ndaj ia kishte nxjerrë gjumin gjeneralit qysh tre muaj më parë, kur gjendeshin ende tepër larg. Pastaj e la pa fjetur dy javë më parë, tek po i afroheshin krahinës ku ndodhej. Dhe, natyrisht, javën e fundit, në kohën që hulumtonte, ndërkaq, të dhënat për të. Koka i dhembte vazhdimisht. Lëmshi, që në çastin e fundit dukej se po ftillohej, ngecte befas si në një makth. Të gjitha të dhënat për të ishin kundërthënëse. Shënimet e ministrisë së shtetit të tij, dëshmitë e ushtarakëve, letrat ku përmendej, një bisedë telefonike njëzet vjet më parë, një reportazh në shtypin vendës për përmbytjen e zonës, rrëfime të katundarëve pleq, dëshmia e një ushtari grek, që kishte bërë burg në Shqipëri, sipas atyre që kishte dëgjuar

nga bashkëvuajtësi shqiptar i qelisë, rrëfimet e arixhinjve, dëshmia e një polici, tregimi i një skizofreni - të gjitha këto dukej sikur ishin grumbulluar enkas për të kundërshtuar njëra-tjetrën.

Nganjëherë e qetësonte veten, duke menduar se, në fund të fundit, ajo gropë s'ishte veçse një imtësi në gjithë atë gërmajë të pafund. Por vinte e nesërmja dhe e ndiente se, pa e shkartisur atë gropë, asgjë s'mund të quhej e kryer. I dukej se në të, si në një nyjë, ishin lidhur të gjitha: trazimi i tij, qetësimi i ndërgjegjes, gjumi, koloneli Z., mbrapshtia që s'i ndahej.

Disa nga vendësit thoshin se gropa kishte qenë e dimrit të parë të luftës, të tjerë e bënin më të vonshme. Disa bënin fajtorë arixhinjtë, të cilët, pasi kishin kërkuar medaljonet, që i kujtonin prej argjendi, i kishin hedhur pastaj kufomat me ngut njëra mbi tjetrën. Për përmbytjen, mendimet ndaheshin, gjithashtu. Ajo kishte sjellë ngatërresa vërtet, po ato kishin qenë për gjithë varrezat e krahinës. Madje, kishte gjyqe që vazhdonin ende. Sa për arixhinjtë, dihej se, sa herë kishte kësi ngatërresash, fajësoheshin gjithmonë ata. Lavdi Zotit që hebrenjtë nuk ndiqeshin në këtë vend. Më besoni mua, kurrkush s'e thotë të vërtetën, ngaqë ka drojë prej saj. Ajo gropë ka qenë përherë aty. Veçse ka qenë më shumë e zbrazët se e mbushur. Dhe do të jetë përherë ashtu, si ajo bujtina në anë të udhës. Unë vetë, nuk e fsheh, e ndiej që na pret të gjithëve. Ç'e dëgjoni atë, zotërinj, nuk e kuptoni që është i çmendur? Plakun Hill pyesni, ai është kujtesa e këtij katundi. Falemnderit bir, unë jam i lashtë tani, edhe të dua, s'gënjej dot... Më shumë flas me baltën se me njerëzit... Balta

s'gënjen kurrë... e mbin barin çdo vit... dhe të gjithëve na pranon... siç na ka premtuar... Ajo gropë te Logu i Shurdhit... S'ka të vërtetë aty... Ka veç asgjë dhe terr... Ose, më mirë, ka një gjë që ju të gjallët s'e merrni dot vesh... Mos më pyesni më mirë... Edhe po të dua, s'kam gjuhë ta them... Mosni më mirë...

KRYE PA NUMËR

Ishte njëherë një gjeneral dhe një prift, që kishin dalë për *kësmet*. Jo, nuk kishin dalë për *kësmet*. Ata kishin dalë për të mbledhur eshtrat e ushtarëve të tyre të vrarë në një luftë të madhe. Ec e ec, kapërcyen shumë male e shumë fusha, duke kërkuar e duke mbledhur këto eshtra. Vendi ishte i ashpër e i keq. Frynin erëra e binin shira pa pushim. Por ata nuk u kthyen nga udha dhe ikën më tutje. Mblodhën sa mblodhën dhe u kthyen të numëronin ato që kishin mbledhur. Doli se mungonin ende shumë eshtra. Atëherë, mbathën opingat e veshën zhgunet dhe u nisën prapë për udhë. Ec e ec, kapërcyen shumë male e shumë pllaja. Moti ishte i egër e i keq. U lodhën e u këputën e u plasi shpirtin kjo punë. As era, as dëbora nuk u tregonin ku gjendeshin ushtarët që kërkonin. Mblodhën sa mblodhën dhe u kthyen prapë të njehsonin ato

që kishin mbledhur. I njehsuan dhe doli që kishin mbetur pa u gjetur ende shumë ushtarë. Atëherë, të lodhur e të rraskapitur, u nisën prapë për udhë të madhe. Ec e ec e udha s'kishte të sosur. Ishte dimër, binte borë.

Po ariu?

Atëherë u doli përpara ariu.

Zakonisht, përralla që gjenerali e përsëriste me vete pothuaj çdo mbrëmje dhe që mendonte t'ia tregonte, porsa të kthehej në shtëpi, njërës prej mbesave të tij, mbaronte me pyetjen e saj "po ariu?". Mbesa e vogël, si shumica e vocërrakëve, bënte kësi pyetjesh, kur dëgjonte përralla.

KREU I NËNTËMBËDHJETË

Më në fund, ditën e dhjetë ata filluan të uleshin. Udha automobilistike zbriste poshtë e më poshtë, duke lënë sipër vetes pllajat dhe retë.

Ky kishte qenë shtegtimi i fundit dhe më i vështiri. Krahinat e largëta ngjanin edhe më shumë të tilla, për shkak të dimrit. Aty-këtu shfaqeshin katundthe të ngrira, që dukej sikur mezi ç'prisnin të fshiheshin prapë në mjegull.

Malet, me ato të çarat tragjike, që dëbora, në vend t'i mbulonte, i bënte edhe më kërcënuese, bënin sikur largoheshin, për t'u gjendur befasisht përbri. Megjithatë, hija e tyre sa vente zbutej. Curret dhe shkëmbinjtë, aty-këtu, ngjanin përherë e më të veçuar, larg bjeshkës së mirëfilltë. Në këmbët e tyre, brigada djemsh e vajzash të reja po hapnin toka të reja. Dëbora herë mbetej e herë niste përsëri, një

dëborë shpërfillëse, që dukej se ndrydhte, megjithatë, një ndriçim të marrtë.

Ushtarët alpinë, që po kërkonin, e kishin gjetur vdekjen pikërisht midis një dëbore të tillë. Ndryshe nga ç'i qe dukur në fillim: e fisme, lehtësisht e gërmueshme, dëbora paskësh qenë po aq e mbrapshtë sa edhe balta. Ashtu siç ua kishte bërë të vështira orët e fundit të jetës viktimave njëzet vjet më parë, po aq, në mos më tepër, po i pengonte kërkuesit e tyre. E kishte mbuluar me kujdes gjithçka, thua se nuk donte që t'ia zbulonin atë që kishte nën vete.

I mësuar, tashmë, me këtë qëndresë të shurdhër, gjeneralit, përherë e më tepër, ajo po i dukej e natyrshme. E panatyrshme ishte, me sa dukej, këmbëngulja e tij për t'ua shkulur trupat me të cilët ato, dëbora dhe balta, ndoshta, ishin mësuar tashmë.

Të ikim që këndej, o Zot, sa pa na ndodhur ndonjë papritur, lutej herë pas here me vete. Kishte ardhur që nga larg për të prishur gjumin e madh të një ushtrie të tërë. Me harta, me lista, me vegla të hekurta kishte goditur mbi truallin sipër tyre, pa qenë i sigurt nëse ata e donin apo jo atë trandje.

Rruga automobilistike gjarpëronte, i mbështillej kular çdo bregoreje, për të zbritur, kurse atij i dukej se ajo rrotullohej në vend. Gjithmonë i ngjante se po kalonin nëpër po atë rrugë që kishin kaluar një ditë më parë dhe, herë pas here, ishte i bindur se ajo rrugë malore kështu do t'i rrotullonte pa mëshirë, pa i nxjerrë kurrkund. Filloi të mos u besonte numrave të gurëve kilometrikë, disa prej të cilëve ishin thyer e të tjerë, pasi ishin shkulur, ishin vënë prapë pa kujdes, shtrembtazi e ndonjëherë kryeposhtë. Frika se mos

tani që puna po merrte fund nuk do të dilte dot kurrë nga këto male, e kapte herë pas here, sidomos në muzg.

Dy netët e fundit i kishin kaluar në katunde plot me qen ulërakë. Pastaj kishte gdhirë dita kur duhej të nxirrnin ushtarin e fundit. Një parandjenjë e zymtë nuk i ndahej. I dukej sikur, së paku, këtë ushtar duhej t'ia linin tokës. Ishte gati i bindur se ajo e donte atë shpërblim, pas gjithë atij ngacmimi e asaj gërryerjeje që i kishin bërë për dy vjet rresht.

Kaq shumë i ishte ngulitur në kokë kjo, saqë, po të mos kishte drojë nga prifti dhe nga specialisti shqiptar, do të gjente njëfarë vjege për të ikur një orë e më parë, pa e hapur gropën e atij alpini.

Si i humbur, po ndiqte me sy gërmuesit që goditnin dheun e ngrirë. Ata hukatnin duart vazhdimisht dhe ai mendonte se ja, ashtu, me ato duar dhe me ato vegla, ata e kishin nxjerrë nga toka gjithë ushtrinë.

Goditja e fundit e hekurit erdhi në veshët e tij si një krismë. Pak kohë pas saj, specialisti thirri që larg: "Një e gjashtëdhjetë e tre. Aq sa në listë!"

Mendimi se duhej të ishte treguar pak më dorëlëshuar me tokën përzihej me ngushëllimin se toka s'kishte, ndoshta, nevojë për atë lëmoshë, ngaqë ajo kurrë dhe në asnjë rrethanë nuk dilte e humbur. Kishte ende në gjirin e saj me dhjetëra ushtarë të pagjetur dhe çfarëdo që të ndodhte, sado dërgata të tjera të vinin për t'i kërkuar, ajo do të mbante, gjithsesi, atë çka i përkiste...

Kështu përpiqej ta qetësonte veten, por mjaftonte të dukej ndanë rruge një dërrasë me fjalët: "Kujdes nga rrungajat!" që frika t'i kthehej sërish. As muzika e radios në makinë, madje, as lajmet nuk e detyronin dot trurin e tij të flakte hamendjet

më të pabesueshme. Midis tyre, ajo më e marrëzishmja ishte detyrimi për ta dorëzuar prapë gjithë atë ushtri, që e kishte mbledhur me aq mund. Të niseshin prapë të dy me priftin, shtegtarë të zymtë, kodër më kodër e zgrip më zgrip, për t'i vënë prapë skeletet një për një aty prej nga i kishin nxjerrë.

Ai shkundte kryet, për t'u çliruar nga ai gjysmankth. Tani kjo histori mbaroi, thoshte me vete, gati me zë.

Ishte, vërtet, dita e fundit dhe ata po uleshin. Dëborën e thatë, që s'jepte asnjë shenjë zbutjeje, nisi ta zëvendësonte dëbora e flashkët e ultësirave dhe, pak më poshtë, në lugina, si një i njohur i vjetër, i priste shiu.

Së shpejti, ai do të kthehej në atdhe. Me eshtrat do të merreshin të tjerët gjer në fund. Puna e tij mbaronte me këtë rrugëtim. Pastaj nëpunës dhe llogaritarë të të dyja vendeve, do të mblidheshin me ditë të tëra, për të bërë shkresa dhe njehsime, gjersa të hartohej procesverbali përfundimtar. Ndërkaq, do të shtrohej një banket zyrtar me përfaqësues të të dyja palëve, ku do të mbaheshin fjalime të shkurtra zyrtare dhe, pas banketit, do të bëhej një meshë e madhe për kujtim të shpirtrave të ushtarëve. Agjencitë e lajmeve do të jepnin lajmin e mbarimit të misionit dhe ai përsëri do të fliste në konferencë shtypi përpara qindra gazetarëve të bezdisshëm.

Ndërkaq, zdrukthëtarë të panjohur do t'i kishin mbaruar ato mijëra arka të vogla, sipas përmasave të caktuara në marrëveshje. Pika 17, shtojcat B dhe D. Arkëza druri, kompensatë e dyfishtë, 70 x 40 x 30 cm. Lyer me ngjyrë vaji të bardhë. Numrat me të zezë.

Kurse te baraka, atje midis djerrinës së shkretë, në rrethinë të Tiranës, Karonti i zi, me atë pallton e madhe plot

arna, do të hapte për herë të fundit fletoren e trashë, duke hukatur gishtat. Qeni mitologjik do të rrinte kërcënues te hyrja, ndërsa vartësit e tij do të vendosnin me kujdes në secilën arkë nga një thes najloni. Do të përziheshin kompanitë, batalionet, regjimentet në mizërinë e pafund të arkave. Do të humbte midis aradheve të ushtarëve e vetmja grua, e çliruar, më në fund, nga shenjat femërore, sepse, në fund të fundit, vetëm anatomistët mund të kuptonin nga rrashti në qoftë se i vdekuri ka qenë burrë apo grua.

Vargu i kamionëve të ngarkuar me arka, i shoqëruar, ndoshta, nga dy motoçikleta të policisë rrugore, do të udhëtonte drejt portit të Durrësit. Atje gjithçka do të ngarkohej mbi një anije dhe anija do të nisej rëndë-rëndë për të çuar në atdhe gjithë këtë ushtri të madhe, të kthyer tani në disa tonelata fosfori dhe kalciumi.

Pastaj, atje në bregun tjetër do t'i shkarkonin përsëri, për ta nisur secilin arkëmortth sipas një drejtimi të caktuar. Ndoshta, shumë familje do t'i prisnin eshtrat drejt e në port, atje ku ushtria ishte nisur dikur dhe ata e kishin përcjellë me lule, me tundje duarsh e lot në sy. Kontejnerët, të kapur nga grremçat e vinçave, do t'i shkarkonin tani në grupe të mëdha: dyqind, katërqind e, ndoshta, me batalione të tëra, drejt e në tokë. Që andej, ushtria do të shpërndahej krejt. Thasët e "Olympias", të ngarkuar në vagonë të postës, në kamionë, autobusë, biçikleta, motoçikleta, vetura, limuzina apo thjesht në shpina njerëzish, do të ndaheshin në drejtime të ndryshme për të mos u bashkuar më kurrë.

Ata që nuk u gjetën dot, do të mbeteshin në Shqipëri. Ndoshta, ndonjë dërgatë tjetër do të vinte më vonë dhe do

të nisnin t'i kërkonin prapë. Ishin rreth dyzet të humbur, me kolonelin Z. në krye. Dërgata e re do të bënte prapë këto ecejake të mërzitshme e të pafundme, derisa t'i qëmtonte një nga një. Ç'do të mendonte, vallë, për të oficeri që do të kryesonte dërgatën? Do të bënte qortime të tërthorta, siç bëheshin zakonisht për paraardhësit, apo do ta ulte kryet përvuajtshëm. Kujdes, i drejtohej disa herë me vete kolonelit apo kapitenit të panjohur (në fund të fundit, s'mund të dërgonin një tjetër gjeneral për dyzet veta). Kujdes, djalosh, dyzet të humbur mund të bëjnë atë që s'ta bën dot një ushtri dyzetmijëshe.

Rruga zbriste e zbriste pa pushim. Rrotullimet e saj bëheshin gjithmonë e më të gjera dhe gjeneralit i dukej se, më në fund, gjithçka po shpleksej. Në shpirt po i zbriste njëfarë qetësie.

Herë pas here, tek zbrisnin, gjenerali kthente kokën pas. Malet po largoheshin gjithmonë e më tepër. Spikamat e tyre bëheshin më pak kërcënuese. Gjenerali i vështronte në një mënyrë të tillë, sikur t'u thoshte: Tani mbaroi trysnia juaj. Ju ika, ju ika. Pastaj, në orët e dremitjes në makinë, befas, e zinte një frikë e turbullt. I dukej sikur malet do të zgjatnin dorën e tyre të akullt për ta kthyer përsëri atje në grykat e tyre, ku era vërshëllente si në skëterrë.

Por ai s'do të kthehej më kurrë atje.

Kurrë.

Frikën e fundit e provoi pikërisht atëherë kur kujtoi se ndodheshin, më në fund, në ultësirë. Uturima e motorit e zgjoi nga dremitja dhe me tmerr vuri re se, në vend të fushës së shumëpritur, përpara tyre ngrihej një grykë e ngushtë mali.

Makina, në vend që të zbriste, po shkarrangjitej mundimshëm drejt asaj gryke. U bë gati t'i thoshte shoferit: ndal, ku po na çon, ti po na kthen përsëri në male? por fytyra e qetë e priftit përbri tij e bëri të përmbahej. I mpirë, nuk i hiqte dot sytë nga dy shpatet e thikëta të grykës, drejt së cilës po aviteshin si drejt një porte.

Qetësohu, i tha dy-tri herë vetes. Në rrugët e Shqipërisë, uljet e ngjitjet e befta ishin të zakonshme.

Te gryka e pa që ishte vërtet ashtu. Që nga lartësia u dukën shtëpitë e një katundi të madh gjysmëfushor, drejt të cilit makina nisi të zbriste me shpejtësi.

Megjithatë, ajo grimë kohe midis dremitjes dhe zgjimit kishte mjaftuar për të ndërtuar rrufeshëm, ashtu siç ngriheshin makthet, krusmën e fundit të këtij shtegtimi: malet që, e kishin lënë sa e kishin lënë e, pastaj, në çastin e mbramë, në kufirin ku mbaronte pushteti i tyre, kishin dashur ta kthenin mbrapsht. Kishte bërë, ndoshta, ndonjë gabim atje midis tyre, kishte shkelur, ndoshta, ritet shekullore. Dhe tani, për të ndrequr gabimin, duhej të bënte diçka. Të kthente, ndoshta, një pjesë të ushtrisë. Ose krejt ushtrinë e gjetur. Ose... ose... të linte veten peng, që ushtria të lejohej...

S'jam mirë nga nervat, tha me vete, pa i hequr sytë nga tymtarët e katundit. E ndiente se ata tymtarë, më shumë se çdo qetësues, mund t'i sillnin paqe në shpirt.

- Një katund, - i tha priftit, që, gjithashtu, vështronte me vëmendje përjashta.

- Po. Një fshat i madh, - u përgjigj tjetri. - Më duket se do të kalojmë natën në të.

Zbritën në katund bashkë me mbrëmjen. Ishte hera e parë gjatë dhjetë ditëve që gjeneralit i qeshi buza. Më në

fund, mbaroi. Atë natë, siç kishte thënë prifti, do të flinin aty dhe të nesërmen në mëngjes do të niseshin për Tiranë. Dhe, pas disa ditësh, në atdhe. Një valë gëzimi, ndonëse e druajtur, po përpiqej ta pushtonte.

Në fshat ende nuk ishin ndezur dritat. Vetura kaloi nëpër udhën me baltë, e ndjekur nga një turmë fëmijësh.

Gjenerali vështronte që pas qelqit këmbët e vogla, që lëviznin shpejt përpara veturës, ktheu kokën nga pas, për të parë vocërrakët e tjerë që i ndiqnin dhe qeshi. E kishte vënë re se ishte ai që tërhiqte gjithmonë kërshërinë e fëmijëve dhe jo prifti. Ndonëse e dinte se shkaku i joshjes ishte rroba ushtarake, i vinte mirë për këtë. Veçanërisht sonte.

Ndjenja e madhështisë, që përpëlitej ende diku, po mundohej të ngrinte krye.

Vargani i zhurmshëm, si i ra mespërmes fshatit, u ndal përpara zyrave të kooperativës. Shoferi dhe specialisti ngjitën me vrap shkallët e ndërtesës. Pas veturës u ndal kamioni dhe varrmihësit u hodhën njëri pas tjetrit në tokë. Por vogëlanëve, as kamioni nuk u tërhoqi vëmendjen. Ata afronin kokat te qelqet e makinës, për të parë se ç'ishin ata të dy që kishin mbetur brenda dhe që dukeshin të ngrirë e të zinj. Njëri prej tyre pinte cigare. Kuqëlimi i zbehtë i cigares ishte e vetmja gjë që mund të dallohej nga jashtë. Ai zbulonte herë pas here një palë mollëza burri nën sprethin e zi të kapelës ushtarake. Fytyrat e vocërrakëve përherë e më fort shtypeshin te qelqet, të habitura krejt.

- Ka një dyshim se në këtë katund duhet të jetë zhdukur koloneli Z., - tha prifti, duke shfletuar fletoren e tij të shënimeve.

- Ka mundësi, - u përgjigj gjenerali,

- Duhet të pyesim për të, - tha prifti, - duhet bërë diçka.

Gjenerali thithi cigaren dy-tri herë rresht.

- Të them të drejtën, sonte nuk dua të mendoj për të, - tha ngadalë. - Sonte, në përgjithësi, nuk dua të merrem me asnjë gjetje. Unë them me vete, lavdi Zotit që i gjithë ky kalvar, më në fund, mbaroi, kurse ju po më ngucni përsëri.

- Është detyra jonë, - tha prifti.

- E di, e di, por tani s'ma ka ënda të mendoj më për të. Sonte është një natë e madhe. Unë habitem me ju. Sonte për ne është festë. Tani dua të qetësohem. Një banjë me ujë të ngrohtë. Ja, kjo është ëndrra ime kryesore sonte. Gjysmën e ushtri... gjysmën e mbretërisë për një banjë, - shtoi duke qeshur.

Gjenerali ndihej mirë. Gjithë ai shtegtim i lemerishëm kishte mbaruar. Ky nuk kishte qenë një shtegtim. Ky kishte qenë një marshim përmes errësirës dhe vdekjes. Si thoshte ajo kënga e vjetër e ushtarëve zviceranë? "Jeta jonë është një udhëtim, nëpër dimër, nëpër natë".

Gjenerali fërkoi duart.

Tani shpëtoi. Tani mund t'i shikonte që larg me shpërfillje malet mizore.

"Si një zog tragjik dhe i vetmuar..." Nuk po i kujtohej mirë fraza e përcjelljes, që i kishte thënë dikur zonja e madhe.

Specialisti doli nga ndërtesa e kryesisë.

- Do të flini në atë shtëpinë atje, - dhe tregoi me dorë një shtëpi të vogël me treme druri.

Shtëpia ishte dykatëshe, me oborr dhe, që nga dritaret, dukej një pjesë e fshatit. Gjenerali dëgjonte tringëllimën e vedrës dhe zërat e grave, që mbushnin ujë në kroin aty pranë,

pëllitjet e veçuara të lopëve, një radio që porsa u hap dhe prapë zërat e vogëlanëve, që loznin e rendnin nëpër shesh.

Kjo natë e fundit do të kishte shkuar si të gjitha të tjerat dhe asgjë të veçantë s'do të kishte për t'u mbajtur mend, sikur gjenerali të kishte thithur edhe atë mbrëmje erën e veçantë të këtyre fshatrave shqiptare, një erë e lehtë, gati e pakapshme, por që ai tani do ta njihte midis gjithë të tjerave. Tani prifti kishte dalë për të pyetur për kolonelin Z. dhe gjenerali, që nga dritarja, po shikonte gratë që mbushnin ujë në krua. Çdo gjë do të shkonte si përherë, ndonëse tutje, diku nga mesi i katundit, nisi të dëgjohej befas lodërtia dhe violina, që e mbushën natën e fshatit me një mister të bukur.

Gjenerali e njohu lodrën e dasmës. Sikur të mos ishte fundi i vjeshtës, do t'i ishte dukur ajo lodër një kundërti e trishtuar. Por ishte mbarim vjeshte dhe ai kishte lexuar, në librin për Shqipërinë, se fshatarët shqiptarë, zakonisht, i bënin dasmat në vjeshtë, fill pas mbledhjes së tëmotjeve. Ishte viti i dytë që ata po endeshin fshatrave, mu në stinën e dasmave. Tani po afrohej dimri dhe po bëheshin dasmat e fundit, ato që, për një arsye ose një tjetër, ishin shtyrë.

Shpesh, netëve, gjeneralit i kishte qëlluar të dëgjonte që larg këtë gjëmim të lodrës përmes zhurmës së shiut dhe tingullin e violinës, herë gëzueshëm e herë gjithë brengë, ashtu siç binin në këto vise. Duke dëgjuar me kokë të futur nën velenxë, ai mendonte se sa i huaj mund të ishte njeriu në një vend tjetër. Mund të ishe më i huaj se drurët që rriten anës rrugës, ndonëse ata janë drurë e jo njerëz. Dhe, sigurisht, shumë më i huaj se dhentë, se qentë e stanit dhe viçat, që tundnin këmborët mbrëmjeve.

Pra, edhe kjo mbrëmje, ndonëse një mbrëmje me dasmë, do të kishte shkuar si çdo mbrëmje tjetër, sikur gjenerali t'i kishte menduar të gjitha këto dhe pastaj të dëgjonte ç'rrëfente prifti rreth kolonelit Z., si kishte shkuar në klub dhe qe ulur në tryezë me ca fshatarë, ç'i kishin treguar vendësit për zhdukjen e kolonelit dhe se si ai dyshonte për gjithçka. Por mbrëmja e fundit ishte një mbrëmje e pazakontë dhe gjenerali nuk e kishte mendjen tek ato që thoshte prifti.

- Tani mjaft, - e ndërpreu priftin për të tretën herë. - Mjaft më me këto! Tani duam pak pushim. Dhe pakëz dëfrim... Apo jo?

Prifti nuk u përgjigj. Rrinte buzëvarur dhe dukej se nuk do ta hapte më gojën.

- Sonte është një natë e bukur. Pak muzikë, pak konjak...

- E ku të shkosh? - foli, më në fund, tjetri. - Këtu s'ka asnjë lokal përveç klubit të kooperativës. Ju i dini si janë klubet.

Por gjenerali nuk e dëgjoi gjer në fund. Ai tha diçka, që e la pa mend priftin. Diçka që tjetri nuk mund ta pranonte kurrsesi. Ishte hera e parë që e kundërshtonte kaq prerë. Por gjenerali në mënyrë të vrazhdë i dha të kuptonte se ai ishte kryesori dhe se, po të ishte nevoja, mund ta urdhëronte, ashtu siç urdhërohet vartësi.

- Ne jemi krenarë për misionin tonë, apo jo? Ju kaq herë e keni përsëritur këtë gjë. Ne sonte e mbaruam këtë mision të... të shenjtë... Dy vjet rresht na ra bretku nëpër male dhe gropa. Tani meritojmë pak pushim. Ju, ndoshta, nuk doni. Unë dua. Unë dua të dëfrej, të dëgjoj muzikë, të shoh teatër. Ju më keni thënë se dasmat e tyre janë si shfaqje teatrale, apo

jo? Apo më keni thënë vetëm për ceremonitë e varrimit? S'ka rëndësi. Rëndësi ka që unë sonte dua të zbavitem. Në qoftë se do të kishte mort, do të shkonim në mort. Apo jo? Pastaj, ju më keni thënë se te shqiptarët mikpritja është zhvilluar gjer në një marrëzi, kështu që, sido që të vijë puna, nuk ka rrezik se do të na dëbojnë.

Ndërsa ai fliste, sytë e akullt të priftit nuk i ndaheshin. Gjenerali fliste vazhdimisht që të mos bëhej heshtje. Por, më në fund, heshtja u bë. E thellë si një gropë.

- Jo, - tha ngadalë prifti, duke zgjatur krahun në atë drejtim, ku, ndoshta sipas tij, ishte dasma. - S'duhet shkuar atje. Ne kemi zi. Ne s'duhet t'i braktisim ata.

Mos na lër. Kjo ishte një thirrje e vjetër. Për një vit e gjysmë rresht, herë më dobët, herë më fort, gjenerali e kishte ndier vazhdimisht këtë thirrje të skeleteve. Ata donin ta mbanin pranë. Për hir të tyre, ai kishte braktisur për dy vjet rresht jetën. Sa herë që ishte përpjekur të ndahej prej tyre, qoftë edhe për disa orë, kishte ndier murmurimën e tyre të shurdhër të pakënaqësisë. Ai ishte gjenerali i tyre, por sonte, pikërisht kundër tyre, po rebelohej.

Ky mendim i fundit e mpiu krejt... Gjenerali po ngrinte krye kundër ushtrisë së vet... Kishte ndodhur gjithmonë e kundërta: trupat rebeloheshin kundër gjeneralit... Por, në atë mbrapshti të përgjithshme, gjithçka ishte kokëposhtë.

Krahu i priftit ishte ende i zgjatur përpara.

- Unë nuk braktis asgjë, - tha me zë të ngjirur gjenerali. - Unë dua vetëm të çlodhem pak.

Pa pritur përgjigje, ai veshi pallton e rëndë dhe doli.

Prifti i shkoi pas.

KREU I NJËZETË

Dasma bëhej te një shtëpi në qendër të fshatit. Që larg, ata panë dritat e mëdha, nën të cilat shiu dukej sikur të lagte më shumë. Ndonëse ishte kohë e keqe, porta e shtëpisë ishte e hapur dhe në strehën e saj të gjerë kishte njerëz. Gjithë rrugica deri te shtëpia ishte e gjallë, pështëritëse dhe plot tinguj. Ata të dy ecnin pa folur, mbështjellë me palltot e zeza, dhe në rrugicë ndiheshin hapat e tyre, hapat e mëdhenj dhe të rëndë të gjeneralit, që shkelte pa kujdes përmes pellgjeve, dhe e ecura e lehtë dhe më e shpejtë e priftit.

U ndalën për një çast te porta, në strehën e së cilës disa djem të rinj, veshur për festë, pinin cigare dhe bisedonin me zë të ulët. Pastaj hynë brenda, gjenerali i pari, dhe prifti pas. Shtëpia ishte plot gra dhe fëmijë, që bënin zhurmë. Lodërtia kishte heshtur dhe që brenda vinin zërat e burrave.

Në mesore u bë një pështjellim i vogël: dikush lajmëroi për diçka dhe një burrë plak me fytyrë të habitur u doli përpara. Ai i përshëndeti, duke vënë dorën në zemër, dhe i ndihmoi të hiqnin palltot, që i vari pastaj pranë gunave të fshatarëve. Kur ata hynë në dhomën e madhe, të shoqëruar nga i zoti i shtëpisë, të gjithë lëvizën, pështëritën, zgjatën kryet si një korije plot drurë dhe lule ngjyra-ngjyra, që gjallërohet papritur nga një erë e fortë.

Gjenerali nuk e priste që pamja t'i bënte një përshtypje kaq të madhe. Ai u hutua aq shumë, sa në fillim nuk pa asgjë të qartë, por një lëmsh ngjyrash, sikur dikush t'i kishte rënë me një shuplakë syve dhe sytë t'i lëshonin xixa.

Dikush e çoi në tryezë, dikush i tha diçka dhe ai tundi disa herë kokën e përshëndeti në drejtim të papërcaktuar, duke pështëritur nëpër dhëmbë ca fjalë në gjuhën e tij.

Vetëm kur lodra filloi të binte prapë plot buçimë dhe kur violina ia mori me një tingull të mprehtë e njerëzit përsëri u ngritën në valle, ai nisi të përqendrohej. Pastaj ndjeu tringëllimën e qelqeve dhe zërin e dikujt përbri, që i tha në gjuhën e tij: "Ngrijeni gotën!". Ai e ngriti dhe piu. Po ai zë se ç'filloi t'i shpjegonte diçka, por gjenerali ende nuk ishte në gjendje t'i kuptonte gjërat qartë dhe çuditej dhe vetë se si e humbi kështu toruan.

Tani dasma iu duk si një qenie e stërmadhe, që merrte frymë, lëvizte, ofshante dhe e mbushte gjithçka përreth me një aht dehës.

Kaloi mjaft kohë, derisa e mblodhi veten plotësisht. Tani ndiente se si vocërrakët ia kishin ngulur sytë, që u shkëlqenin nga një heshtje e gëzuar. Ata mblidheshin kokë më kokë,

tregonin me gishtat e vegjël në drejtimin e gjeneralit dhe se ç'numëronin, ndoshta, kopsat e arta të uniformës apo vijat e gradave, pastaj flisnin me njëri-tjetrin, tundnin kokat e vogla dhe, siç dukej, nuk ishin në një mendje.

Gjenerali po vinte re gjithçka. Ai i pa me radhë pleqtë me mustaqe të mëdha, që rrinin këmbëkryq mbi nim, bisedonin shtruar dhe thithnin llullat e gjata, nusen e veshur me të bardha, që ishte e tëra si një hutim i bukur, dhëndrin e djersitur, që lëvizte sa andej-këndej, grumbujt e vajzave që qeshnin e pëshpërisnin këndeve, sikur nuk dinin gjë tjetër në këtë botë, veçse të qeshnin e të pëshpërisnin; trishtimin e shtirur të cigareve të djemve të rinj, muzikantët zeshkanë të mbytur në djersë, gjithë ato gra që hynin e dilnin nga njëra kthinë në tjetrën me ca kokëçarje pa mbarim dhe, më në fund, plakat e veshura në të zeza, me fytyra të nemitura, si një radhë ikonash.

Pastaj, gjenerali filloi të ndiqte me sy lëvizjet e shkathëta të këmbëve dhe përplasjen e thundrave në tokë, fërfëritjen e fustanellave të bardha e pala-pala të burrave, krejt të bardha, si dëbora e alpeve ku ai kishte kaluar, ngritjen e dollive, me fraza të gjata e të ngatërruara që, të përkthyera, nuk kishin kuptim, këngët e ashpra të burrave, që të kujtonin rrokullisjen e muzgjeve në male, dhe këngët e zgjatura, të përmallshme grarishte, që dukej sikur mbështeteshin në supet e mëdha të këngëve të burrave dhe ecnin bashkë kokulur përulësisht.

Gjenerali vështronte përreth dhe nuk mendonte dot asgjë. Vetëm pinte raki e buzëqeshte vazhdimisht, pa ditur edhe vetë se kujt i buzëqeshte.

Unë nuk e di i cilës ushtrie je ti, sepse asnjëherë nuk i kam njohur rrobat e ushtrisë dhe tani jam shumë plakë për t'i mësuar, por që ti je i huaj dhe që je një prej atyre që na kanë vrarë, kjo duket që larg. Nga shenjat që mban, dukèt që ke mjeshtërinë e mallkuar të zaptimit dhe je një prej atyre që më kanë bërë mua gjysmë njeriu, një copë plakë të shushatur, që vjen në këtë dasmë të huaj dhe rri në këmd e lëviz buzët si e lajthitur. Asnjeri nuk e di ç'them unë, sepse të gjithë janë të gëzuar dhe unë, gazngrata, nuk dua t'ua prish zemrën të tjerëve. Ngaqë nuk dua të prish gëzimin, po rri këtu në skutë dhe po lëviz buzët, duke të nëmur ngadalë, fare ngadalë, që të mos dëgjojë kush. Dua të di përse erdhe ti në këtë dasmë dhe si të bënë këmbët që erdhe. Je ulur në tryezë dhe po qesh, siç qeshin ata që kanë një dërrasë mangët. Përse nuk ngrihesh të hedhësh pallton krahëve dhe të ikësh në shi andej nga erdhe? Nuk e kupton që je i tepërt këtu, o i mallkuar?

Kënga grarishte vazhdonte. Në gjoksin e tij, gjenerali ndjeu një avull të ngrohtë. Atij iu duk se po çlodhej në një banjë dritërash e tingujsh. Dhe këto dritëra dhe tinguj, që derdheshin mbi të si nga një krua i ngrohtë, po ia hiqnin me vrull nga trupi i tij gjithë atë baltë varrezash, që mbante erë myk dhe vdekje.

Tani që i kaloi hutimi, gjenerali u këndell. Ai donte të kuvendonte, të thoshte ose të dëgjonte fraza të bukura. Sytë e tij kërkuan dhe gjetën priftin. Ai rrinte përballë në tryezë, si mbi gjemba, me sytë të ngulur në një pikë.

Gjenerali u përkul për t'i folur.

- E shikoni sa mirë është këtu?

Prifti nuk tha asgjë.

Gjenerali tendosi trupin. Ai ndiente vështrimet e njerëzve, që binin rreth e rrotull si ca shigjeta të heshtura. Binin kudo, kryesisht, mbi shenjat e gradat, por rrallë, shumë rrallë mbi sytë e tij. Shigjetat e errëta e të rënda të burrave dhe shigjetat e shkathëta, vezulluese e të pasigurta të grarisë.

"Si një shpend i plagosur, por krenar, do të fluturosh ti..."

- Bukur, apo jo? - i foli prapë priftit. Por prifti përsëri nuk i ktheu përgjigje. Ai vetëm e vështroi, sikur t'i thoshte "mbase" dhe i hoqi sytë. - Këta njerëz po na nderojnë, - tha gjenerali. - Kjo duket haptas.

- Vdekjen e nderojnë kudo.

- Vdekjen... S'besoj se e kemi të vulosur në fytyrë, - tha gjenerali. Ai deshi të buzëqeshte, por s'mundi. - Lufta ka kohë që ka mbaruar, - vazhdoi. - Të shkuara të harruara. Jam i sigurt që asnjeriut në këtë dasmë nuk i shkon mendja te punët e armiqësisë. Shikoni ç'hare.

Prifti nuk foli. Gjenerali vendosi të mos i fliste më, megjithatë, diçka nga rroba e zezë e tij nisi t'i vallëzonte përpara syve.

Siç duket, prifti e ndien veten të tepërt këtu, mendoi. Po ai vetë, a ishte i tepërt? Kjo ishte shumë e vështirë për ta gjetur. Tani, ç'ishte për t'u bërë ishte bërë. Ne erdhëm. Jemi apo s'jemi të tepërt, tani e kemi vështirë të ikim. Është më lehtë të tërhiqesh nën zjarrin e mitralozëve, sesa të ngrihesh e të ikësh nga kjo dasmë.

Ti e kupton dhe vetë që je i tepërt këtu. Ti e ndien që një njeri po të mallkon në këtë dasmë, se mallkimi i nënës nuk vete huq kurrë. Ndonëse të nderojnë, ti e kupton që nuk duhej

të kishe ardhur këtu. Mundohesh të fshehësh atë që kupton, por nuk e fsheh dot. Të dridhet dora kur ngre gotën e rakisë dhe në sy të kalojnë hije plot frikë.

Lodërtia buçiti prapë. Gërneta ia mori me të qarë. Violinat e ndoqën pas. Erdhën dasmorë të rinj, të vonuar, me guna të lagura qull. Vërshimi i lumit i kishte penguar gjithë mbrëmjen. Ata u përqafuan me radhë me të gjithë dhe u ulën rreth tryezës.

Këta e kanë dasmën përmjëmend të shenjtë, mendoi gjenerali, ndryshe nuk do të udhëtonin nëpër këtë rrebesh. Shi me grykë pusi, si i thonë. Nga ata që i mbushin gropat pa u hapur mirë.

Thonë se ti mbledh të vrarët e vendit tënd. Mbase ke mbledhur shumë dhe do të mbledhësh edhe shumë të tjerë, mbase do t'i mbledhësh të gjithë, por dije mirë se njërin nuk ke për ta gjetur kurrë, në jetë të jetëve, ashtu si në jetë të jetëve unë pragshuara nuk do t'i gjej më kurrë vajzën time dhe burrin tim. Sa do të doja të rrëfeja për atë që ti nuk do ta gjesh dot kurrë, por nuk e bëj, sepse nuk jam shlligë që të helmoj këta dasmorë e këto dasmoresha. Se ajo ishte vajza ime e unë isha nëna e saj. Se si thoshin të moçmit: u bëre nënë, u bëre gjëmë... Ashtu si unë, o i nëmur. Ç'shi që binte atë natë, ja, si sonte. Ujët buiste kudo. Nuk ishte e mundur të hapje gropë, se gropa mbushej përgjysmë me ujë, një ujë i zi, i llumtë, si të buronte nga nata. Megjithatë, unë e hapa gropën. Po nuk do të flas, jo.

Gjenerali ndezi një cigare dhe, për çudi, cigarja e tij iu duk e vogël dhe e pafuqishme përpara llullave të mëdha prej shqope, të zeza e të gjata, në duart e rreshkura të pleqve. I thithnin herë pas here midis fjalëve që thoshin, sikur të mbanin me to ecurinë e shtruar të bisedës.

I zoti i shtëpisë, ai plaku i vjetër që e priti në fillim, erdhi e u ul pranë gjeneralit, me llullë në dorë, si gjithë pleqtë e tjerë. Kishte një medalje të verdhë, që i tundej mbi rrobën e zezë prej shajaku. I njihte këto medalje, që mbanin shpesh në gjokse fshatarët dhe i dukej gjithmonë se, pas çdo medaljeje të tillë, ishte fytyra e zbehtë e një ushtari të vrarë nga ushtria e tij. Gjenerali i buzëqeshi fytyrës plot rrudha të plakut, që i kujtoi një copë trung të plasaritur. Një njeri që e kishte përkrah, ai që i kishte thirrur në fillim "ngrijeni gotën!", i përktheu fjalët e para të plakut. I zoti i shtëpisë i kërkoi ndjesë që nuk e mbajti me kuvendim, sepse miqtë ende s'kishin mbaruar së ardhuri dhe atij i duhej t'i priste të gjithë.

Gjenerali tha disa "Ju lutem, ju lutem" dhe "Ju falemnderit", duke tundur kokën. Plaku heshti dhe thithi llullën ngadalë. Pastaj pyeti me zë të qetë.

- Nga të kemi?

Gjenerali ia tha.

Plaku tundi kokën i menduar dhe gjenerali e kuptoi se ai nuk e kishte dëgjuar kurrë qytetin e tij të lindjes, ndonëse ishte qytet i madh e i famshëm.

- Ke grua, fëmijë? - pyeti përsëri plaku.

Gjenerali iu përgjigj dhe plaku i tha:

- Të të rrojnë, me grua e me fëmijë.

Ai thithi përsëri llullën dhe në ballë iu vruguan ca rrudha

të thella. Dukej se diç donte të thoshte. Gjeneralit iu duk se plaku do të thoshte pikërisht atë gjë, të cilën ai trembej ta dëgjonte në këtë vend.

- E di përse ke ardhur, - tha tjetri, me zë fare të qetë dhe gjeneralin e shpoi një si thikë mu në zemër. Qysh se kishte hyrë në atë dasmë ishte përpjekur ta bënte veten që të harronte përse ndodhej atje, sepse kështu i dukej se edhe të tjerët do ta harronin. Do të donte të ishte sonte këtu, thjesht si një turist që tërhiqet nga ritet e një populli të lashtë, për t'ua treguar pastaj më vonë miqve të tij pasdarkave. Por ja, më në fund, biseda e mallkuar kishte plasur dhe gjenerali për herë të parë u pendua që kishte ardhur në dasmë. - Po, - vazhdoi plaku. - Bën mirë që mbledh ushtarët e vrarë, sepse çdo rob i Perëndisë duhet të prehet në vend të vet.

Gjenerali tundi kokën i heshtur, në shenjë pohimi.

Plaku shkundi llullën, pastaj i nguli sytë hirnores.

- Të ka qëlluar mot i keq, - tha.

Gjenerali bëri prapë "po" me krye.

Tjetri mori frymë thellë.

- Si i thonë fjalës: shi dhe mort gjen kudo...

Gjeneralit iu dukën fjalët e tjetrit misterioze, por nuk guxoi të kërkonte t'ia përkthenin prapë.

Plaku u ngrit rëndë-rëndë dhe kërkoi ndjesë, sepse i duhej të priste e të përcillte miq të tjerë.

Gjenerali piu i lehtësuar. Tani ndihej prapë mirë. Tani mundësia e ngacmimit kaloi dhe ai mund të rrinte i shkujdesur dhe të pinte sa të donte.

- E shikoni? - i tha përsëri priftit. Gjeneralit filloi t'i trashej pak gjuha. - Ata na nderojnë. E thashë unë, të shkuara, të harruara. Çfarë thatë?

- Thashë se në këto raste nuk kuptohet mirë ku mbaron zakoni dhe ku nis nderimi, - u përgjigj prifti.

- Për gjeneralët ka gjithmonë nderim. - Gjenerali ktheu dhe një gotë. - E dini ç'mendoj? - tha gati me dinakëri, duke i afruar fytyrën priftit. - Ma ka ënda të ngrihem e të kërcej valle.

Prifti u mahnit.

- Vërtet e keni?

- Pse jo?

Prifti tundi kryet i ngrysur.

- Unë nuk ju kuptoj sonte.

Gjenerali u zymtua.

- Mjaft më jeni qepur si një dado. Lërmëni të qetë, dreqi mori. Nuk dua të më kufizojë askush. Dua të dëfrej.

- Ngadalë, - tha prifti. - Po na dëgjojnë.

- Kur do të thyhet ky zakon i pështirë që gjeneralët të jenë vazhdimisht nën përgjim?

Prifti vuri dorën në ballë, sikur të thoshte: Ç'na polli tani.

- Do të ngrihem dhe pikë.

- Po ju nuk dini të kërceni, do të bëheni qesharak.

- Unë s'bëhem qesharak. Këto janë valle të thjeshta. Pastaj, përpara kujt do të bëhem qesharak, përpara këtyre fshatarëve?

Prifti përsëri vuri dorën në ballë.

Më thanë se sonte në klub ti pyete veçanërisht për të. Siç duket, ke kohë që e kërkon dhe nuk e gjen dot. Po përse ke pyetur dhe e ke kërkuar aq shumë atë kolonel të zi? Mos vallë, e ke pasur mikun tënd? Me siguri e ke pasur mik, përderisa e kërkon ashtu. Gjithë mbrëmjen nuk lanë njeri pa

pyetur në katund, sepse të gjithë e dinë që ai dergjet në dhé diku këtu rrotull, por askujt nuk ia merr mendja ku ndodhet. Do të ikësh pa e marrë mikun tënd, mikun tënd të zi, që më sterrosi jetën. Të ikësh sa më parë, sepse edhe ti je i mallkuar si ai. Tani rri urtë si një qengj dhe të qesh buza tek shikon se si kërcejnë njerëzia, por unë e di se ç'ke në mendje. Ti mendon se do të vijë dita që të sulesh në anët tona me ushtri dhe të na djegësh e të na pjekësh e të na vrasësh siç bënë shokët e tu. Nuk duhej të vije në këtë dasmë. Të të dridheshin gjunjët, kur të niseshe për këtu. Së paku, për hirin tim, të mua plakës së shushatur, të mua gjëmëzezës. Po ç'bëhet kështu? Ti po ngrihesh në valle? Ti guxon të ngrihesh në valle? Po vë buzën në gaz? Po ngrihesh! Dhe njerëzit të pranojnë! Daleni! Ç'bëni kështu! Kjo është e tepërt! Është mëkat nga Zoti!

Lodërtia buçiti prapë si gjëmim topi. Gërneta ia mori me të qarë, violinat e ndoqën pas me zëra të hollë, si zëra grash. Në mes të dhomës lindi dhe filloi të rritej amëza e valles, në fillim me dy, pastaj me tre, pastaj me shumë njerëz.

Gjenerali vështroi vallen. Pastaj priftin. Pastaj prapë vallen. Pastaj priftin. Vallen. Priftin. Vallen. Por...

Gjenerali u ngrit. Tani, ç'ishte për t'u bërë, u bë. Ai qëndroi në këmbë si i mpirë, gati për t'u futur në rrethin e valltarëve. Atij iu duk se ky rreth ishte i zjarrtë. Dy-tri herë zgjati duart dhe i tërhoqi në çast sikur t'i digjeshin. Vallja vërtitej përpara tij si një fugë. Plaku, që e hiqte, ulej e ngrihej mbi gjunjë, përplaste njërën këmbë përdhé, sikur thoshte: "kjo është kështu dhe kështu do të mbetet", vërtiste rizën e bardhë, kur shkëputej prej shokut, rrotullohej dhe thyente

gjunjët dhe dukej sikur do të binte përdhé, i kositur nga drapri, pastaj prapë ngrihej dhe prapë këputej e binte si i goditur nga rrufeja dhe prapë ringjallej në çast nën gjëmimin e bubullimave. Lodra sa vente, gjëmonte më me tërbim, zëri i gërnetës vinte valë-valë sikur po ngashërehej fyti i një vigani dhe fijet e violinave vërtiteshin të gjallë si gjarpërinj. Goditja e lodrës sa vente bëhej më e shpeshtë dhe tani përmes ngashërimit të violinave dukej sikur dikush rrokulliste shpella. Gjenerali vazhdonte të rrinte në këmbë. Atij po i merreshin mendtë nga kjo furi e tërbuar, e rrezikshme dhe e ndritshme. Ai nuk e kuptoi sa vazhdoi. Vështroi një grimë, si nëpër mjegull, fytyrat e djersitura të muzikantëve, grykën e gërnetës, që drejtohej poshtë e lart përmes tymit, si një tytë kundërajrori, sytë e mbyllur, si në ethe, të vallëzuesve. Pastaj lodra heshti, fijet u shkrehën dhe gjithçka ishte e magjishme e çdo gjë do të shkonte bukur gjer në mesnatë e, ndoshta, dhe më vonë, por, pikërisht atëherë, kur njerëzit po kthehesin nëpër vende, u ndie një rënkim. Gjeneralin sikur e shpoi diçka. Dasma ishte plot zhurmë, por, për çudi, të gjithë e ndien atë rënkim. Askujt nuk mund t'ia merrte mendja se ahti i plakës Nicë mund të ishte aq i fortë.

- Oi, oi! - qau ajo me zë të hollë. U bë papritur një heshtje kaq e thellë, sa jo vetëm vajtimi, por edhe gulçimi i saj ndihej qartë. Por heshtja vazhdoi vetëm një çast. Gjenerali pa se si menjëherë drejt plakës vrapuan njerëzit, se si atje u bë diçka; u thirr dikush dhe u duk sikur u qetësua ajo plakë e mjerë, që kushedi pse u ngashërye.

Sikur plaka të qetësohej, ashtu siç kujtoi gjenerali dhe ata që nuk ishin afër saj, çdo gjë do të shkonte në rregull

dhe, ndoshta, gjenerali do të qëndronte atje deri në mesnatë dhe, ndoshta, edhe më vonë, por plaka Nicë vajtoi përsëri. Siç dukej, asnjë nuk mund ta qetësonte dhe jo vetëm kaq; u dëgjua një e thirrur e saj, zërat e lartë të të tjerëve dhe prapë kukama e saj u ngrit mbi zërat dhe u duk sikur e preu me thikë gëzimin. Rreth plakës Nicë vrapuan të tjerë njerëz, burra dhe gra, dhe gjeneralit iu duk se, sa më shumë njerëz të grumbulloheshin rreth saj, aq më i fuqishëm do të bëhej vajtimi i saj. Muzikantët u ranë veglave, por plaka Nicë klithi edhe më fort dhe veglat heshtën si të trembura. Gjenerali pa se si grumbulli rreth saj lëvizi, sikur diçka po e zvarriste dhe se si, më në fund, plaka Nicë u shkëput nga njerëzit dhe u hodh përpara. Ai e pa për herë të parë atë fytyrë thatime, të verdhë, me sy të çakërritur plot me lot, atë trup fare të shkarpët. Ç'bën ajo, ç'do ajo, pse qan? pyeti gjenerali, që u zhdeh papritur. Por askush nuk u përgjigj. Njerëzit u sulën pas plakës Nicë, dy gra e zunë për krahu dhe deshën ta kthenin me të mirë pas, por ajo thirri dhe u shkëput dhe erdhi e ndaloi përpara gjeneralit. Ai pa fytyrën e shtrembëruar nga pezmi dhe nuk kuptoi asgjë. Ajo seç i thërriti, lëvizi duart, i ulëriu mu në fytyrë dhe ai ndenji përpara asaj dyllë i verdhë. Kjo vazhdoi vetëm një grimë, sepse njerëzit e hoqën plakën. Ajo u shpëtoi prapë nga duart, por këtë herë, në vend që t'i afrohej gjeneralit, rendi drejt derës dhe doli.

Pas ikjes së saj, gjenerali mbeti qiri në këmbë dhe asnjeri nuk ia përktheu fjalët e gruas, ngaqë askush nuk e dinte që prifti kuptonte shqip. Ata u grumbulluan rreth nuses, që po qante, dhe rrotull zonjës së shtëpisë, që ishte zbehur dhe po bënte kryq.

- Jua thashë që në fillim, - tha prifti, që u gjet në krah të gjeneralit. - Nuk duhej të vinim këtu.

- Ç'ndodhi? - pyeti gjenerali.

- Tani s'është koha. Pastaj.

- Ju kishit të drejtë, - tha gjenerali. - E teprova.

Gjithë ky grumbull njerëzish, që në fillim i ishte dukur si një korije e shumëngjyrshme, fjalëshumë, tani ishte kthyer papritur në një pyll të ngrysur dimëror. Tundeshin kokat, krahët, duart, gishtat e thatë përkuleshin sa andej-këndej, si degët e zhveshura nga rrebeshi, dhe pastaj, mbi të gjitha këto, me një "kra" të thatë fluturonte shqetësimi.

- Ç'duan që vijnë në dasmat tona? - tha njëri nga djemtë e rinj.

- Shët, se është turp.

- Çfarë turpi? - tha një tjetër. - Guxojnë edhe të ngrihen në valle.

- Nuk mund t'i dëbonim. Kështu është zakoni i të parëve.

- Ç'zakon? Po për Nicën e shkretë, ç'thotë zakoni i të parëve?

- Shët, se mos dëgjojnë.

- Mos ki frikë, - u hodh një tjetër, - edhe sikur të dinin shqip, nuk do të kuptonin asgjë nga brenga e saj.

Gjenerali me priftin nuk dëgjuan asgjë. Ata vetëm vështronin me radhë fytyrat e njerëzve. Gjenerali i hoqi shpejt sytë nga burrat e të rinjtë dhe i ndali mbi fytyrat e plakave, që, të mbështjella me shalle të mëdha, të zeza, dukeshin si kori i një tragjedie të vjetër.

Gjenerali ndjeu frikë. Ai qe penduar shumë që kishte ardhur këtu. E kaluara nuk harrohej kollaj dhe shqiptarët

ishin hakmarrës. Përse kishte ardhur këtu? Ç'kishte qenë ai trill prej të çmenduri? Gjer tani puna kishte shkuar mirë. Ai kishte lëvizur kudo i shoqëruar nga vendësit dhe i mbrojtur nga ligjet. Kurse sonte kishte marrë një guxim të çartur. Këtu ai ndodhej jashtë mbrojtjes dhe ligjeve. Këtu mund të ndodhte çdo gjë dhe askush nuk përgjigjej për asgjë.

- Të ikim, - tha papritur. - Të ikim menjëherë.

- Po, po, - tha prifti. - Të ikim. Ne ata na fyen shumë rëndë. Ajo plaka tha gjërat më të zeza për ne.

- Atëherë, përpara se të ikim, duhet t'u japim një përgjigje. Çfarë tha ajo plakë?

Prifti u mat të fliste, por drejt tyre erdhi i zoti i shtëpisë.

- Rrini, - tha ai, duke treguar me dorë tryezën. Pastaj u bëri me shenjë grave që shërbenin dhe ato sollën prapë raki e ushqime. Gjenerali dhe prifti vështruan njëri-tjetrin, pastaj të zotin e shtëpisë. - Ndodhin kësi gjërash, - tha plaku, - po ju rrini. Uluni.

Ata u ulën. Kështu u dukej sikur binin më pak në sy.

Tani, në kthinën e madhe qe vendosur pak a shumë rregulli dhe njerëzit po uleshin përsëri nëpër tryeza. Pranë gjeneralit erdhi e u ul ai njeriu që ishte munduar të përkthente dollitë.

Ai shpjegoi se plaka Nicë ishte një plakë e shushatur, mbetur qyqe, sepse, në luftë, batalioni ndëshkimor i kolonelit Z. i kishte varur të shoqin. Pastaj tregoi se koloneli ia kishte marrë vajzën e saj në tendën e tij dhe se vajza, katërmbëdhjetë vjeçe, ishte mbytur në pus, tek po kthehej në mëngjes herët. Pikërisht natën tjetër koloneli u zhduk. Thoshin se ai kishte shkuar përsëri natën te shtëpia e Nicës, sepse nuk e dinte që

vajza kishte vdekur, dhe roja priste përjashta. Pastaj ai vonoi shumë, shumë më tepër nga ç'duhej, por roja kishte urdhër të priste gjer në agim. Në mëngjes, në shtëpi nuk kishte asnjeri dhe asnjeri nuk mori vesh ku shkoi koloneli Z. Disa thoshin se ai ishte thirrur me ngut në Tiranë, disa thoshin të tjera gjëra, kurse vetë oficerët e batalionit heshtnin dhe batalioni iku të nesërmen larg.

Të gjitha këto, ai i tha copa-copa, me fraza të ndërprera, që i binin si varé në kokë.

Ndërkaq, muzika kishte filluar të binte prapë, por në fillim askush nuk u ngrit të vallëzonte. Pastaj u ngritën gratë dhe secilit i dukej se të gjithë e kishin harruar plakën Nicë, me përjashtim të vetes së vet. Gjenerali rrinte në tryezë si i mpirë dhe nuk ishte i aftë të mendonte asgjë. Sytë e tij takuan prapë sytë e priftit.

- Ç'tha ajo plakë? - pyeti gjenerali.

Prifti e vështroi gjatë me sytë e tij ngjyrë hiri dhe gjenerali e ndjeu veten keq.

- Ajo tha, midis të tjerash, se ju jeni miku i kolonelit Z. dhe nuk ju sheh dot me sy.

- Unë miku i kolonelit Z.?

- Po, ashtu tha pikërisht.

- E përse? Ndoshta, ngaqë ne e kërkuam kolonelin në mbrëmje, - tha i menduar gjenerali, sikur të fliste me vete.

- Ndoshta, - u përgjigj thatë prifti.

Gjenerali u ngrys edhe më tepër. Ai nuk shikonte më asgjë përreth dhe nuk dëgjonte asgjë.

- Unë do të ngrihem, - tha papritur. - Unë do të ngrihem e do t'u them të gjithëve këtu se nuk jam miku i kolonelit Z. dhe se unë si ushtarak e përbuz kujtimin e tij.

- E pse do ta bëni këtë gjë? Për t'u pëlqyer këtyre fshatarëve?

- Jo, - tha gjenerali. - Unë do ta bëj këtë gjë për hir të emrit dhe të nderit të ushtrisë sonë.

- Mos vallë, u njollos emri i ushtrisë sonë, sepse e shau atë një plakë shqiptare?

- Unë dua të sqaroj se jo të gjithë oficerët tanë e katandisnin veten të vriteshin nga gratë.

Prifti lëvizi vetullat.

- Ne nuk kemi ardhur të gjykojmë, - tha ngadalë. - Gjykimin e bën ai atje lart.

- Ata kujtojnë se unë vërtet jam miku i tij, - vazhdoi gjenerali. - A nuk e ndieni se si na vështrojnë? Shikoni përreth. Shikoni sytë e tyre.

- Ju keni frikë? - tha prifti.

Gjenerali e vështroi rreptas. Deshi të thoshte diçka të rëndë, por nisi të binte lodra dhe fjala i mbeti në buzë.

Në të vërtetë, gjenerali ndiente frikë. Shumë larg kishte shkuar sonte me trillet e tij. Tani duhej të tërhiqej me kujdes. Kjo turmë e egërsuar duhej të zbutej me diçka. Ai duhej ta ndante menjëherë veten e tij nga koloneli Z. Ai duhej ta flakte kolonelin ashtu siç flaket një copë baltë që të ngjitet pas thundrës.

Vërtet dukej sikur gjendja po qetësohej, por kjo ishte një gjë e sipërfaqshme. Ai e ndiente se si brenda dasmës ziente diçka. Kjo dukej nga shikimet e vëngërta, nga murmuritjet. Veç kësaj, atje te hyrja, pranë gunave dhe palltove, në gozhdët e ngulura në mur, ishin varur radhë-radhë pushkët e dasmorëve. Prifti i kishte thënë se, zakonisht, në dasmat shqiptare ndodhnin vrasje.

Tani ata duhet të bënin diçka, sa nuk ishte vonë. Po të iknin drejt e nga dasma, s'ishte çudi që ndonjë i dehur t'i qëllonte pas shpine. Njeriu që ikën me vrap, e nxit qenin që ta ndjekë. Prandaj duhej tërhequr me kujdes.

Gjenerali hodhi sytë e turbulluar përreth dhe pa përsëri tërë atë mizëri njerëzish që lëviznin, vallëzonin, qeshnin; pastaj vështrimi iu ndal te radha e grave plaka, që rrinin po ashtu si në fillim, me fytyra të nemitura, të anuara pak, kor i përjetshëm në një dekor të përjetshëm, dhe uli kokën i lodhur e nuk foli më.

Lodërtia binte prapë me një gjëmim të shurdhër dhe gërneta ngjirej e ngashërehej dhe e përshkonte dasmën tejpërtej. Burrat ia kishin marrë këngës në tryezë dhe gjenerali ndjeu prapë muzgjet që rrokulliseshin nëpër male dhe këngën e përmallshme kokulur, grarishte, që shtrëngohej dhe i merrej fryma prej këngës së burrave, siç i merrej fryma një gruaje kur e përqafon një burrë.

- Më duket se është koha për të ikur, - tha gjenerali.

Prifti pohoi me krye.

- Është pikërisht koha, - tha.

- Të ngrihemi me kujdes.

- Me shumë kujdes.

- Gjithë puna është që të mos tërheqim vëmendjen.

- Ngrihuni ju i pari. Unë po ju ndjek pas.

- Gjithë puna është të mos biem në sy.

Po afronte mesnata dhe hareja ishte në kulm dhe, ndoshta, të gjithë e kishin harruar plakën Nicë, kur ajo erdhi prapë. Ajo erdhi pikërisht në kohën që ata të dy po bëheshin gati të ngriheshin. Ndoshta, nga të gjithë ata njerëz që ishin brenda, gjenerali ishte i pari që e ndjeu. Ai e ndjeu atë si

gjahtari i vjetër që ndien tigrin në xhungël. Kur te dera njerëzit lëvizën dhe pëshpëritën dhe prapë lëvizën, tërë qenia e tij thirri "erdhi" dhe ai e kuptoi që u zverdh. Por këtë herë plaka Nicë nuk qante, askush nuk ia dëgjoi zërin, megjithëse të gjithë e ndienin se ajo ishte atje te dera. Muzika binte, por askush nuk e dëgjonte atë. Te dera u grumbulluan shumë njerëz. Asnjëri nuk e kuptoi si ndodhi që plaka Nicë u fut brenda. Ndoshta, ishte pamja e saj që i bëri njerëzit t'i linin rrugë, ndoshta, lutjet e saj, por, sidoqoftë, ajo hyri dhe të gjithë lëshuan thirrje dhe zëra. Ajo ishte e lagur qull, e ngjyer e tëra me baltë, krejt e bardhë në fytyrë, si një e vdekur, dhe në krahë mbante një thes.

Gjenerali, pa i zotëruar dot gjunjët, u ngrit në këmbë, sepse e ndjeu që gruaja kërkonte atë. Ai i doli vetë përpara, ashtu si ajo kafsha që, porsa ndien së largu thirrjen e armikut, mpihet prej zërit të tij dhe, në vend që të ikë, vrapon t'i dalë vetë përpara.

Njerëzit u mblodhën përreth dhe nuk dinin ç'të bënin. Askush nuk mendonte dot asgjë. Plaka Nicë qëndroi në vend, i nguli gjeneralit një vështrim të papërqendruar, sikur nuk vështronte atë, por hijen e tij. Përmes kollitjes, ajo i tha disa fjalë, prej të cilave ai kuptoi vetëm fjalën "vdekje".

- Përkthemani! - thirri gjenerali, sikur kërkonte ndihmë. Por asnjëri nuk ia përktheu. Gjenerali hodhi sytë përreth dhe ndeshi në vështrimin e priftit. Prifti u afrua.

- Ajo thotë se dikur ka vrarë një oficer madhor nga tanët dhe pyet a jeni ju ai gjenerali që mbledh eshtrat e ushtarakëve, - tha prifti.

- Po, zonjë, - tha me zë të mbytur gjenerali. Ai mblodhi të gjitha forcat për të mbajtur kokën lart.

Atëherë, plaka Nicë se ç'tha diçka tjetër, që prifti nuk arriti ta përkthente, sepse fjalët e fundit të saj u mbuluan nga një murmuritje e fuqishme dhe, para se ta ndalonte njeri, ajo hodhi në dysheme, mes ulërimave të grave, mu në këmbët e gjeneralit, thesin që mbante në shpinë. As që ishte nevoja që prifti të përkthente diçka dhe as që duhej më asnjë përkthim, sepse çdo gjë ishte e qartë. Sytë e gjeneralit rrëshqitën nga plaka Nicë te thesi dhe nuk mund të kishte gjë më të tmerrshme se ai thes, që ra me zhurmë të shurdhër në dysheme, llangosur me copa të mëdha balte të zezë. Gratë u hodhën të lemeritura mënjanë dhe mbuluan fytyrat me duar, kurse plakat bënë kryq dhe pëshpëritën me tmerr:

- E kishte varrosur te pragu, - sekush bërtiti.

- Korba ti, moj Nicë!

Plaka Nicë u kthye dhe iku e lagur qull dhe e ndotur me baltë siç ishte dhe asnjeri nuk mendoi më ta ndalte, sepse ç'ishte për t'u bërë, ishte bërë tashmë.

Gjenerali nuk i hiqte sytë nga thesi dhe veshët i buçisnin nga zhurma, tmerri e thirravaja. As ai vetë nuk e kuptoi pse u bë papritur një qetësi e thellë ose, ndoshta, nuk u bë fare qetësi, por ashtu iu duk. Në këmbët e tij dhe në këmbët e gjithë dasmorëve nxinte dhe heshtte ai thes i vjetër, i arnuar me copa, të cilat, për çudi, ai i vuri re. Dikush duhet të merret me të, mendoi truri i tij i mpirë. Atëherë, në mes të heshtjes u përkul ngadalë dhe me duart që i dridheshin e kapi nga gryka dhe e ngriti thesin e përbaltur. Pastaj, me po ato lëvizje të ngrira, e hodhi thesin në krahë dhe doli nga dera përjashta në shi, i kërrusur e i mpirë, sikur të mbante mbi supe turpin dhe peshën e gjithë botës. Prifti e ndoqi pas.

Prapa krahëve të tyre sekush ia dha kujës.

Kreu i njëzetenjëtë

Gjenerali ecte përpara, duke shkelur nëpër gropat me ujë. Prifti i shkonte pas. Kaluan rrugicën e ngushtë, dolën te sheshi i fshatit, i ranë përqark kishës së vjetër dhe papritur humbën udhën në terr. U kthyen pas, pa folur asnjë fjalë, gjenerali përpara dhe prifti pas dhe kaluan prapë te kroi i fshatit, te klubi dhe përpara kishës, por shtëpinë nuk e gjetën dot. Dy herë dolën në të njëjtën pikë dhe këtë e kuptuan nga kambanorja, që nxinte mbi kokat e tyre. Frynte kaq shumë, saqë dukej se era dhe shiu do ta lëviznin kambanën dhe ajo do të gjëmonte papritur atje lart.

Dora që mbante thesin i qe mpirë.

Sa e lehtë që je ti, Beti, më thoshte një mbrëmje në park. Shëtisnim të përqafuar dy net para martesës sonë. Ishte një natë vjeshte e ngrohtë, dehëse. Pasdite kishte rënë shi dhe në

rrugicat e parkut kishte hurdha të vogla me ujë. Ai më mbante në krahë si fëmijë dhe përsëriste vazhdimisht: Vërtet je kaq e lehtë, Beti, apo më duket kështu nga lumturia? Këpucët e tij ushtarake shkelnin rëndë-rëndë dhe pa kujdes mbi pellgjet, duke copëtuar në mijëra grimca pasqyrimin e hënës në to. Do të doja gjithë jetën të të mbaja kështu në krahë, Beti. Ja, kështu. Ecte dhe më puthte flokët dhe përsëriste: Sa e lehtë je!

Ti, tani, je vetë më i lehti i gjithë njerëzve në botë, mendoi gjenerali. Tre-katër kilogramë, jo më shumë. Megjithatë, ma dërrmove shpinën.

U kthyen prapë dhe erdhën shumë herë rrotull fshatit si dy të dehur, duke u munduar të largoheshin sa më shumë nga kisha, që u dilte gjithmonë përpara, derisa desh u përplasën te turinjtë e veturës që mezi dallohej në terr.

Tani u kujtuan se vetura ishte ndalur përpara shtëpisë së tyre.

E gjetën shtëpinë. Gjenerali shtyu portën dhe hyri i pari në oborr. Flegrat e portës u përplasën pas tij. Shtyu derën e brendshme dhe e lëshoi thesin në tokë. Thesi ra me një zhurmë të butë dhe ai ndezi shkrepësen.

Në dritën e zbehtë të saj, ngjiti me zhurmë shkallët, hyri në dhomë, hodhi pallton e qullur përdhé dhe ra pa u zhveshur mbi shtrat. Dëgjoi derën që u hap dhe u mbyll përsëri dhe pastaj dikë që u përmbys në shtratin tjetër.

Prifti, mendoi.

U mundua të flinte, por ishte e pamundur. Atëherë, u përpoq të vinte rregull në mendimet, por edhe këtë s'mundi ta bënte.

Dua të fle, mendoi. Të fle. Të fle. Të jem i heshtur, si kamioni që është përjashta. Gjumë.

Mbylli sytë fort, por kjo nuk e ndihmoi. Sa më shumë që i shtrëngonte qepallat, aq më tepër errësira bëhej e pafuqishme, sepse aty-këtu e shponin njolla dhe rripa drite të prerë herë nga një qiell tjetër, herë nga një hapësirë plazhi e kaltër, e largët.

Dua errësirë, mendoi. Dua errësirë të plotë, të mirëfilltë, që të fle.

Por rripat e kaltër, bashkë me njollat e kuqe e të verdha, nuk iknin. Ato ishin aty, përpara tij, dy gisht larg, në çdo drejtim që të kthente kokën dhe brenda në gjirin e territ.

U ngrit, mori një zgjumth, e piu dhe ra prapë. Por, fill pas dremitjes së parë, u zgjua i trembur. Atje larg, përtej sheshit, lodra kishte nisur të binte përsëri.

Ende vazhdon kjo dasmë e mallkuar? tha me vete. Ç'po bëhet kështu?

Mbuloi kokën me velenxë, që të mos dëgjonte, por s'ishte e mundur. Iu duk sikur një krijesë e vogël, fare e vogël, si ato të përrallave, ishte ulur galiç në trurin e tij dhe po i binte një lodre, nga ato që mbanin ushtarët e vegjël prej plumbi. Kudo që ta fuste kokën dhe sado që të zinte veshët, ai ishte atje, i ulur këmbëkryq, dhe i binte, i binte vazhdimisht me të njëjtën shpeshti: dam dara dam, dam dara dam, bum buru bum, bum, bum, bum.

Atij iu duk se nën të po marshonin ushtarët.

Po marshon armata ime e madhe, mendoi. Pastaj, papritur ngriti kokën dhe thirri me vete: Mjaft.

E futi kokën përsëri në nënkresë, por pas një grime e ngriti prapë.

- Prift, ej, prift, kolonel, çohuni, - thirri gjenerali.

Prifti brofi i tronditur.

- Çfarë po ndodh?

- Të ikim këndej sa më parë, çohuni!

- Të ikim? Ku?

- Në Tiranë.

- Është ende natë.

- S'ka gjë. Të ikim.

- Po pse? - tha prifti.

Gjenerali vente e vinte nëpër dhomë.

- Si pse? A nuk e dëgjoni? A nuk e dëgjoni lodrën? Atje tutje gjithçka po vazhdon dhe unë kam një parandjenjë të keqe.

- Trembeni? - tha prifti.

- Po, - tha gjenerali. - Nga çasti në çast më duket sikur ata do të vijnë grumbull drejt këtu, duke i rënë lodrës për të na dëbuar, ashtu siç dëbohen shpirtrat e këqij.

Gjenerali po mbërthente valixhen.

- Ikim, - tha prifti.

Gjenerali vazhdonte të merrej me valixhen.

- Një valle, - murmuriti. - Desha të kërceja një valle me ta dhe desh u bë gjëma. Ç'është ky vend kështu, nëna ime!

S'duhej të kishim shkuar, mendoi. Kurrsesi.

- Vetëm një valle dhe desh u kthye në valle të vdekjes, - tha me zë.

Prifti seç murmuriti dhe të dy dolën nga dhoma njëri pas tjetrit. Çizmet e gjeneralit kërcisnin nëpër shkallët e drunjta, duke bërë një zhurmë të çrregullt. Ai doli i pari në oborr dhe eci drejt portës. Prifti u vonua pak. Kur gjenerali ktheu kokën, pa se prifti mbante mbi sup diçka.

Thesi, mendoi.

Dolën në rrugë. Shiu kishte pushuar dhe errësira nuk ishte aq e dendur.

- Sa është ora? - pyeti prifti.

Gjenerali ndezi shkrepësen.

- Katër e gjysmë.

- Pas pak do të gdhijë.

Diku nisën të këndonin këndesat. Nga malet frynte një erë e akullt. Kamioni nxinte atje përtej.

Ata qëndruan pranë veturës dhe hodhën sytë nga lindja. Dukej sikur dikush i binte herë pas here lindjes me një furçë me ngjyrë të bardhë, që e pinte sakaq errësira e natës dhe, në vend të saj, mbetej një gjurmë gri, e lagët dhe e ftohtë.

- Ata flenë te kjo shtëpi, - tha prifti, duke treguar shtëpinë përballë.

- Zgjojeni shoferin, i thoni se unë nuk e ndiej veten mirë dhe duhet të nisemi sa më parë për në Tiranë.

Kur prifti shtyu portën, në oborrin fqinj lehu një qen. Pastaj lehu një tjetër dhe, pas pak, gjithë qentë e fshatit.

Por edhe midis të lehurave, gjenerali e dallonte gjëmimin e lodrës dhe një zhurmëri të largët.

Porta e oborrit kërciti përsëri dhe prifti doli që andej, duke mbajtur thesin në krahë.

Ç'i je qepur thesit? mendoi gjenerali.

- Po vishet, - tha prifti. - Tani do të vijë.

- Qentë, - tha gjenerali.

- Po. Kështu e kanë qentë e fshatrave. Po të lehë një, lehin të gjithë.

Le të lehin, mendoi gjenerali. Kjo s'është asgjë. Sikur ata ta dinin ç'ka në kamion, do të fillonin të ulërinin.

- Erë e mallkuar, - tha me zë.

Qentë pushuan njëri pas tjetrit.

Diku palli një lopë, si nëpër ëndërr.

Porta e oborrit kërciti dhe ata panë shoferin që doli në gjysmerrësirë. Shoferi hapi dyert e veturës, duke u kollitur nga ajri i ftohtë. Gjenerali u fut brenda.

- Hapeni derën e përparme, ju lutem, - tha prifti.

Shoferi e hapi.

- Ç'është kjo? - pyeti ai.

- Një thes, - tha prifti. - Na duhet.

Shoferi rregulloi me këmbë thesin dhe prifti ■ ul përbri gjeneralit.

Dritat e makinës rrëshqitën nëpër gjerdhet e errëta në të dyja anët e udhës. Porsa vetura lëvizi, gjenerali u mbështoll me pallto dhe mbylli sytë. Tani nuk dëgjohej asgjë veç zhurmës së butë të motorit dhe ai donte me çdo kusht të flinte. Por, në vend që të flinte, papritur nisi të rikujtonte me hollësitë më të vogla ato që kishin ndodhur në dasmë.

Dua të fle, mendoi. Nuk dua të kujtoj asgjë. Nuk dua të hyj më atje.

Por, me mend, hyri përsëri në dasmë. Hoqi pallton e lagur, zuri vend në tryezë.

Ishin të gjithë atje, sikur ta prisnin. Iu duk se ky kthim ishte e vetmja mënyrë për t'u çliruar prej tyre. Për ata, gjithashtu, ndoshta, për t'u shqitur prej tij.

I trembur, hapi sytë përpara se t'i shfaqej gruaja e tmerrshme.

Jashtë ishte ende natë.

Rruga automobilistike, e zgjuar papritur nga drita e makinës, dilte për një çast nga kaosi i natës, e përgjumur dhe e zbehtë, dhe prapë zhytej në të. Ndanë saj shfaqeshin

herë pas here gurët kilometrikë, krejt të bardhë. Kjo ishte një bardhësi e keqe, që të ngjethte mishtë. Gjeneralit i dukeshin ata si gurë memorialë.

Përbri tij, prifti kishte varur kryet mbi gjoks dhe po dremiste.

Shoferi frenoi papritur. Priftit i takoi koka në shpinoren e përparme.

- Ç'bëhet kështu? - tha i hutuar.

Gjenerali vështronte si i mpirë. Vetura ishte ndalur përpara një ure. Poshtë dëgjohej zhurma e ujërave.

- Përse ndaluat? - pyeti prifti.

Shoferi diçka murmuriti për motorin dhe doli përjashta, duke përplasur derën.

Dritat e makinës binin paralel me parmakët ■ urës. Shoferi hapi mbulesën e motorit dhe u kërrus i gjithi mbi të. Ai hyri përsëri në makinë dhe diç po kërkonte. Duke kërkuar, mënjanoi thesin, që e pengonte. Pastaj ■ nxori thesin përjashta dhe ngriti ndenjësen.

Gjenerali hapi derën dhe doli. Ai filloi të vërtitej me hapa të mëdhenj rreth makinës. Prifti nuk lëvizi. Shoferi shau nëpër dhëmbë dhe përsëri kërkoi diçka brenda. Gjenerali u pengua për të dytën herë te thesi.

Ky thes, mendoi papritur. Ky thes desh na hëngri kokën. Gjer tani çdo gjë na shkoi mirë, por ja, na doli ky thes ogurzi dhe çdo gjë filloi të na vejë së prapthi.

- Ky thes është ters, - tha me zë të lartë.

- Çfarë thatë? - pyeti prifti.

- Thashë se ky thes është ndjellakeq, - përsëriti gjenerali dhe po në atë çast i ra me majën e këpucës. Thesi u rrokullis në zgrip me një zhurmë të shurdhër.

- Çfarë bëtë?! - thirri prifti dhe doli me vrap nga makina.

- Ai thes ishte shenjë e keqe, - tha gjenerali, përmes frymëmarrjes së rëndë.

- Ne, lavdi Zotit që e gjetëm. Kemi dy vjet që e kërkojmë.

- Për atë thes desh lamë kokën, - tha gjenerali i lodhur.

- Çfarë bëtë?! - thirri prapë prifti dhe ndezi elektrikun e dorës.

- Unë nuk desha ta hidhja, dreqi e mori! Vetëm e shtyva.

Ata u afruan të dy tek ana e urës dhe vështruan poshtë, atje ku gurgullonte ujët. Dritat e elektrikëve mezi e ndriçonin humbellën.

- S'duket asgjë, - tha gjenerali.

U afrua shoferi. Të tre i mbajtën sytë një copë herë poshtë.

- Do ta ketë marrë ujët, - tha gjenerali. Në zërin e tij ndiheshin lodhja dhe pendimi.

Prifti e vështroi me sy të egër, pastaj e lëvizi disa herë ndriçuesin, si të kërkonte një vend për të zbritur në shkarëzimë.

Gjenerali u kthye te makina.

Prifti qëndroi njëfarë kohe i përkulur tek anët e urës, pastaj u kthye edhe ai.

KREU I NJËZETEDYTË

Po mbaronte java. Kjo ishte dita e fundit e qëndrimit të tyre në Shqipëri. Gjenerali u ngrit vonë. Hapi flegrat e dritares. Mëngjesi ishte i zymtë.

Ora po i afrohej dhjetës. Në orën njëmbëdhjetë e gjysmë do të bëhej mesha, kurse në orën shtatë të mbrëmjes, banketi.

Mbi tryezë ishte grumbulli i letrave, telegrameve dhe gazetave të ardhura nga atdheu.

Në letrat kishte, si gjithmonë, gjithfarë historish, emra vendesh dhe herë-herë vizatime brigjesh ose drurësh, të bëra shkel e shko. Kurse frymën e shkrimeve në gazetat e jepnin pak a shumë titujt: "Zhgroposja e një ushtrie", "Gjenerali i hijeve së shpejti në atdhe", "Premtimet e qeverisë lidhur me të vdekurit".

I trazoi një copë herë, pa u përqendruar dot në asnjërën. Mori frymë thellë, veshi pallton dhe doli.

Në holl kërkoi kryekamerierin.

- Ju kanë lajmëruar për një banket të vogël sot pasdite?

- Po, sër, - u përgjigj tjetri. - Në orën shtatë, në sallën e tretë, çdo gjë do të jetë gati.

Gjenerali pyeti për priftin. Kishte dalë.

Në holl dhe te portineria kishte gjallëri. Dy telefonat binin vazhdimisht dhe tek ashensori priste një grumbull njerëzish. Ca zezakë pinin cigare tek rrinin këmbë mbi këmbë te ndenjëset e mëdha. Një grumbull kinezësh, të shoqëruar nga një vajzë, po hynin në restorant. Të tjerë bujtës të porsambërritur, me pamje veriore, prisnin në këmbë.

Gjenerali hyri në sallonin nga e djathta, ku pinte zakonisht kafenë, dhe pa se nuk kishte vend. Ishte hera e parë, gjatë kohës së qëndrimit në "Dajti", që shihte kaq të huaj.

U kthye të dilte dhe përsëri u ndesh në holl me afrikanë të tjerë, që po hynin nga porta kryesore, me çanta në duar.

Përjashta, pranë pishave të larta, ishin ndalur shumë vetura.

Ç'është kjo gjallëri? tha me vete tek po dilte. Ktheu nga e djathta dhe eci nëpër shëtitore drejt ministrive.

Në sheshin "Skënderbej" pa flamurët. Në shtyllat e larta, në ballinat e ministrive dhe në shtyllat e Pallatit të Kulturës po ngjitnin kudo parulla dhe drita. Befas, i ra ndër mend se, pas dy ditësh, ishte festa kombëtare e Shqipërisë.

Trotuaret ishin plot me njerëz. Ndaloi si të tjerët përpara afisheve të kinemasë, por nuk e kishte mendjen aty dhe, sa bëri dy hapa më tutje, i harroi filmat që loznin.

Vështroi orën. Ishte njëmbëdhjetë. Përpara Bankës dhe prapa kafenesë "Studenti", nëpër vendqëndrimet e

autobusëve, shpejtonin turma të tëra njerëzish. Këtu mbaronin linjat që vinin nga rrethinat. I ra ndër mend se kisha ku do të bëhej *De Profundis*-i, ishte një stacion më tutje dhe ai vendosi ta bënte rrugën në këmbë. Ecte në trotuarin e mesit dhe mendja bënte ç'bënte i rikthehej te eshtrat e kolonelit.

Tani nuk i kujtohej qartë si kishte ndodhur. Mbante mend vetëm se kishte qenë në një gjendje tejet të ngrysur dhe të përgjumur. Krejt qenia e tij kishte qenë e shtypur si nën një mokër të rëndë. Kurse tani që ajo natë e rëndë kishte kaluar, bëma e tij po i dukej fare pa kuptim.

Sidoqoftë, kjo punë mund të ndreqej disi. Ai do të bisedonte me priftin. Ushtarë me gjatësinë një e tetëdhjetë e dy, që ishte gjatësia e kolonelit, kishte shumë. Kurse puna e dhëmbëve mund të ndreqej lehtë. Kujt do t'i shkonte ndër mend se eshtrat e kolonelit ishin të zëvendësuara? Për çudi, marrëveshja e mundshme me priftin sa vente i dukej më lehtë.

Ai deshi të sillte ndër mend ushtarët që ishin po aq të gjatë sa koloneli Z., por nuk mundi. Çdo herë që specialisti shqiptar kishte thënë me zë të lartë: "një e tetëdhjetë e dy", ai kishte përsëritur me vete fjalët: "aq sa koloneli Z.". Por tani nuk i kujtohej asnjë.

Tani i kujtohej vetëm ai aviatori që zbuluan rastësisht në një tragë fshati, ai aviatori anglez, që e kishin mbuluar përsëri atje ku e kishin gjetur.

Pastaj i erdhi ndër mend ushtari i ditarit. Ai ishte një e tetëdhjetë e dy. Gjenerali mendoi ç'do të ndodhte sikur të zëvendësoheshin eshtrat e kolonelit Z. me ato të ushtarit të ditarit. E mori me mend si do t'i prisnin eshtrat e atij ushtari

të gjorë familja dhe gjithë farefisi i kolonelit, si do t'i bënin një përshpirtje dhe një varrim madhështor, si do të qante Beti, e veshur me të zeza, duke e mbajtur për krahu nënën plakë të kolonelit dhe si nëna do t'u fliste të gjithë të pranishmëve për birin e saj. Pastaj do t'i çonin eshtrat e atij ushtari dezertor në varrin madhështor të vrasësit të tij, do të gjëmonin kambanat, ndonjë ministër do të mbante fjalim dhe gjithçka do të ishte kundër natyrës, e përdhunuar, përqeshëse, mëkatare. Dhe, në qoftë se në botë kishte vërtet hije dhe fantazma, ai ushtar do të ngrihej nga varri që atë natë.

Jo, tha me vete gjenerali. Më mirë të gjendej ndonjë tjetër. Me siguri do të kishte. Shpejtoi hapin. Mesha fillonte pas disa minutash. Kisha dukej që larg, e bukur, ndërtuar me stil modern, drejt e në rrugën e madhe. Përpara shkallëve të saj, ndanë trotuarit, ishin ndalur një grumbull veturash luksoze të zeza.

Kishin ardhur diplomatët e ambasadave të huaja. Gjenerali ngjiti me shpejtësi shkallët e mermerta. Mesha porsa kishte filluar, kur ai hyri. Mori ujët e bekuar nga e djathta, bëri kryq dhe u hoq mënjanë. Ia nguli sytë priftit që po fliste, por nuk dëgjonte pothuaj asgjë, vetëm shikonte cohërat e zeza që ishin varur kudo, siç bëhej zakonisht në përshpirtje të tilla, dhe arkëmortin e zbrazët të vendosur në mes të kishës, veshur, gjithashtu, me cohë të zezë. Cohërat dhe kostumet e zeza të njerëzve e thithnin dritën e dobët të qirinjve dhe, meqenëse dritaret ishin të larta dhe drita hynte nëpër qelqet e ngjyrosura, kisha dukej më e zymtë nga ç'ishte.

Prifti po lutej për shpirtrat e ushtarëve. Fytyra e tij ishte e zbehtë nga pagjumësia dhe sytë e përhimë i kishte të lodhur.

Diplomatët rrinin me fytyra të ngrira. Në kishë, përmes erës së qirinjve, ndihej një parfum i lehtë.

Njëra nga gratë filloi të qante në heshtje.

Zëri i priftit shpërndahej në të gjitha anët e kishës, i kumbueshëm e solemn:

- *Requiem aeternam donat eis*[1]!

Gruaja që ishte përpara gjeneralit u ngashërye edhe më fort.

- *Et lux perpetua luceat eis*[2]! - vazhdoi prifti, duke ngritur sytë lart, ku ishte trupi i kryqëzuar i Krishtit. Pastaj zëri i tij u bë më i kumbueshëm dhe më i thellë:

- *Requiescat in pace*[3]! - përfundoi ai. Jehu i zërit u kthye rëndë-rëndë nga të gjitha këndet e kishës.

- Amen! - tha gjakoni.

Për ca çaste, gjeneralit iu duk sikur dëgjoi fëshfërimën e zbehtë të flakës së qirinjve.

Pushofshin në paqe, përsëriti me vete dhe ndjeu papritur si ia mbyti zemrën mallëngjimi.

Dhe kur prifti ngriti lart naforën, në kohën kur të gjithë kishin rënë në gjunjë përpara tij dhe kur pastaj ngriti kupën e verës së kuqe dhe filloi të hante bukën e të pinte verën për shpirtin e tyre, gjenerali përfytyroi ushtarët, ashtu mijëra e mijëra siç ishin, me gavetat e aluminta në duar, tek prisnin të merrnin ushqimin e darkës përpara kazanit të madh të gjellës, në atë orë kur dielli perëndonte dhe rrezet e tij shkëlqenin

[1] Pushim të përjetshëm jepu! (Lat.)
[2] Dhe drita e amshuar i ndrittë ata! (Lat.)
[3] Pushofshin në paqe! (Lat.)

mbi gavetat dhe çelikun e helmetave me një ndriçim të kuq, të përjetshëm.

Dhe drita e amshuar i ndrittë ata, përsëriti ai me vete, pasi ra në gjunjë, duke vështruar pllakat e ftohta të mermerta, me një vështrim të ngrysur, të humbur.

Ra kambana dhe të gjithë u ngritën.

- *Ite missa est*[4], - kumboi zëri i priftit.

- *Deo gratias*[5], - tha gjakoni.

Njerëzit filluan të dilnin. Përjashta u ndie zhurma e lehtë e motorëve dhe, kur gjenerali doli, veturat e diplomatëve po lëviznin njëra pas tjetrës. Ai priti autobusin te stacioni që ishte përpara kishës. Kur hipi, qëndroi në këmbë pranë qelqit të pasmë.

- Mermi biletën, qytetar! - tha biletashitësja.

Ai e kuptoi fjalën "biletë" dhe u kujtua. Kërkoi një copë herë në çantë gjersa gjeti një monedhë qindëshe.

- S'keni të vogla? - i tha biletashitësja.

Ai e mori me mend pyetjen dhe tundi kokën në shenjë mohimi.

- Tre lekë, - tha tjetra dhe tregoi me gishta, - s'keni tre lekë të vogla?

Gjenerali tundi kokën përsëri.

- Ai është i huaj, moj shoqe, - tha një djalë i gjatë me zë të ngadalshëm.

- E mora me mend, - tha biletashitësja tek po mblidhte të hollat për t'i kthyer mbetjen.

[4] Mesha mbaroi. (Lat.)
[5] Me hir të Zotit. (Lat.)

- Do të jetë ndonjë shqiptar i ardhur nga Amerika, - tha një plak që rrinte ulur. - Ka nga ata që e kanë harruar fare gjuhën shqipe.

- Jo, mor xhaxho, ai është i huaj, - tha ai djali i ngadalshëm.

- Dëgjomë mua, ti, - tha plaku, - e di mirë unë këtë punë, nga ata është.

Gjenerali e kuptoi se po flisnin për të dhe kujtoi se e morën për amerikan.

Ata vazhduan të flisnin mu në hundë të tij, duke u nxehur me njëri-tjetrin, madje, duke e treguar gjeneralin me gisht, pa u shqetësuar fare për praninë e tij.

O Zot, edhe hije po të isha do të tregonin më shumë vëmendje, tha me vete. Aty për aty, mendimi se ai dhe ata ishin qenie të dy botëve të ndryshme, që as e përkitnin e as e ndienin njëri-tjetrin, e përshkoi ftohtësisht.

Kur autobusi u ndal përpara Bankës dhe njerëzit po zbrisnin, ai takoi përsëri vështrimin e plakut.

- Oll rajt, - i tha plaku me zë të lartë dhe i buzëqeshi tërë kënaqësi tek po ikte.

Gjenerali çau përmes fshatarëve që po prisnin autobusin dhe doli përsëri në Bulevardin e Madh.

Në Rrugën e Dibrës kishte më shumë njerëz, sidomos përpara tregtizave të frutave, te mëngjesoret dhe te shitorja e madhe.

Qëndroi një copë herë përpara vitrinave, pastaj hyri, ngaqë i ra ndër mend të blinte një kujtim.

Nisi t'i shikonte me radhë, pa u ngutur.

Ç'blinin vallë ushtarët për kujtim kur largoheshin nga Shqipëria?

Befas, ai njeriu i vockël zuri t'i binte përsëri lodrës brenda në kokën e tij, në fillim ngadalshëm, pastaj gjithmonë më shpejt, më shpejt, më shpejt. Vetëm se tani nuk qe ulur më galiç në kokën e tij, por rrinte në këmbë, i bardhë, i zi e i shkëlqyer, me xhokë të kuqe dhe me rripa të zinj. Qëndronte në këmbë, duke i rënë lodrës, i tëri prej porcelani, vezullues dhe gjenerali nuk ia hiqte sytë.

Ai e tregoi me dorë.

- Malësorin me lodër? - pyeti shitësja.

Gjenerali pohoi me krye.

Vajza e nxori nga vitrina, e mbështolli dhe ia zgjati.

- Tetëmbëdhjetë lekë e njëzet qindarka, ju lutem.

Ai pagoi dhe doli duke u drejtuar nga Rruga e Barrikadave.

KREU I NJËZETETRETË

Bam-bara-bam; bam-bara-bam.

- Hello!

Gjenerali u kthye i hutuar.

- Hello! - u përgjigj.

Në trotuar, përpara hotelit, rrinte gjenerallejtënanti. Mëngën e majtë të pallto e kishte të mbështjellë si zakonisht dhe në dorën e vetme mbante llullën. U përshëndetën. Gjenerallejtënanti thithi llullën dhe, si e hoqi nga goja, nisi të vështronte tymin.

- Pikësëpari, ndonëse me vonesë, desha t'ju kërkoja ndjesë për atë ndodhinë e pakëndshme që ndodhi vitin që shkoi, - tha, pa e vështruar në sy. - Më dorëzuan ankesën tuaj. Po jua them sinqerisht se nuk ishte faji im dhe më erdhi shumë keq që ndodhi ashtu.

Gjenerali e vështroi me sy të humbur.

- Kush ishte fajtori? - pyeti.

- Shoqëruesi im. Ai i ngatërroi të gjitha. Dhe jo vetëm këtë gjë. Po ejani të ulemi gjëkundi dhe do t'jua tregoj fill e për pe ç'ka ngjarë.

- Më falni, por tani nuk kam kohë të ulem gjëkundi. Bisedojmë në këmbë.

- Atëherë, më mirë po e lëmë për në mbrëmje. Po pa më thoni njëherë, si ia kaluat?

- Keq, - tha gjenerali. - Rrugët ishin shumë të vështira. Veç kësaj, na vdiq një punëtor.

- Vdiq? Pse? Ju ndodhi ndonjë e papritur?

- Jo. U infektua.

- Nga se?

- Nuk u mor vesh mirë. Ndoshta, nga ndonjë eshtër, ndoshta nga ndonjë cifël hekuri.

Gjenerallejtënanti bëri një shenjë habie.

- Sigurisht, do t'i paguani dëmshpërblim familjes.

Gjenerali pohoi me krye.

- Asnjëherë nuk kam parë kaq shumë male, - tha pas pak.

- Keni për të parë edhe më.

- Jo, ne mbaruam, - tha gjenerali. - Kjo ishte dalja e fundit.

- Mbaruat? Sa mirë. Atëherë, unë kam për të parë edhe më.

- Male kudo dhe vajza e djem të rinj që hapin brezare. A i keni parë?

- Posi. Gërmojnë, vazhdimisht gërmojnë.

- Hapin toka të reja buke, - tha gjenerali. - Në një vend pashë që kishin mbjellë edhe të dyja shpatinat e hekurudhës.

- Ç'nuk mbjellin. Siç duket, toka nuk u mjafton.

- Janë në bllokadë. Besoj se e keni dëgjuar. Bashkimi Sovjetik u ka prerë grurin.

- Diçka më ka zënë veshi, - tha gjenerallejtënanti. - Me siguri, gëzohen që ne po heqim ushtarët.

- Po. Varrezat e zgropëta i mbjellin menjëherë.

- Kësaj i thonë të deheroizosh tokën, - tha tjetri.

Gjenerali qeshi.

- Deheroizim i tokës, hm. Përnjëmend, një gjë e habitshme për ballkanasit. Po ju, si i keni punët? - pyeti.

- Keq, - tha tjetri. - Kemi më shumë se një vit e gjysmë që vërtitemi poshtë e lart e, megjithatë...

- Ju keni disa vështirësi, ma keni thënë.

- Po, madje të rënda, - tha gjenerallejtënanti, duke marrë frymë thellë. - Dhe sikur të mos mjaftonin këto, na doli edhe ajo ngatërresa.

- Ç'ngatërresë?

- Ngatërresë e madhe. Nuk e shikoni që jam vetëm? Po prisni. Desha t'ju pyesja. Ku e keni kolegun tuaj, atin e shenjtë?

- Besoj është lart në hotel, - tha gjenerali.

Gjenerallejtënanti qeshi.

- Më shkoi mendja për keq, - tha. - Sepse ai, kryetari im i bashkisë, më duket se e pësoi. - Gjenerali e vështroi në mënyrë pyetëse.

- E thirrën me ngut, - tha gjenerallejtënanti. - Ka disa javë që janë pezulluar kërkimet për shkak të tij. - Ai priti që tjetri të tregonte njëfarë kërshërie, por, kur e pa që gjenerali pothuajse nuk e kishte mendjen aty, shtoi: - Një punë e ndyrë.

- Ka përvetësuar para nga fondi i zhvarrimit? - pyeti, më në fund, gjenerali fare qetësisht.

- Më keq, - tha gjenerallejtënanti. - Ka ndodhur diçka më e keqe. - Ai priti përsëri lindjen e kërshërisë dhe, kur e pa që nuk kishte asnjë shpresë për një gjë të tillë, vazhdoi të fliste vetë.

Gjenerali dëgjoi atë që pothuajse e kishte dyshuar prej kohësh. Premtimet e familjeve për të shpërblyer gjetësit e eshtrave. Grykësia e këtyre të fundit, që donin të përfitonin me çdo kusht nga ky rast. Mashtrimi me skeletin e parë, mbi arkëzën e të cilit u vu tjetër emër. Pastaj mashtrimi i dytë, i pestë, i dhjetë. Gjersa një ditë...

Gjeneralin po e tërhiqte, më në fund, tregimi i tjetrit.

- Ç'ndodhi pastaj? - pyeti.

Tjetri bëri një lëvizje me dorë, si të thoshte: ajo që pritej.

- Ndodhi ajo që pritej, - vazhdoi. - Me sa dukej, njëra nga familjet ka dyshuar e para dhe ju e dini se ç'ndodh në kësi rastesh: sa të nisë pështpërima, gjithçka rrokulliset pastaj si rrungajë. Komisionet e hetimit, gazetarët që nuk presin veçse skandale, opozita...

- Aha, ju kuptoj, - tha gjenerali pa kurrfarë dhembshurie. - Domethënë, ju keni pagëzuar emrat e ushtarëve të panjohur me emra për të cilët keni pasur porosi.

- Jo unë, të tjerët, - e ndërpreu gjenerallejtënanti.

- Natyrisht.

- E keqja është se, ndryshe nga ju që po i grumbulloni trupat, desha të them skeletet, për t'i nisur bashkërisht, ne kemi bërë të kundërtën: i kemi nisur grupe-grupe. Po të kishim vepruar si ju, nuk do të ndodhte gjithë ky gramshalesh.

- Ky është më keq se një gramshalesh... - tha gjenerali.

Padashur, ai përfytyroi atë që ishte tmerri i çdo gjenerali: shthurjen e ushtrisë. Shenjat e para të krisjes, ngarendjen e ushtarëve, shqyerjen e gradave prej oficerëve, për të mos u njohur, së fundi, rrëmujën e përgjithshme. Kishte kujtuar se kjo mund t'i ndodhte veç një ushtrie të zakonshme, por kurrsesi një armate të ngrirë. Dhe ja, e papritura i paskësh ndodhur kolegut të tij.

Iu kujtua konferenca e fundit e shtypit në atdhe, ku shkrepëtimat e fotoaparateve ua shtonin pafytyrësinë pyetjeve të gazetarëve. Zoti gjeneral, siç jemi njoftuar, ju keni lista të përpikëta për gjithçka? Ah, ju u besoni krejtësisht atyre listave dhe shifrave për gjatësinë e ushtarëve? Ata përsëritnin fjalët "lista" e "numra", pa e fshehur se, për ta, ato mishëronin burokracinë dhe cinizmin e pashpirt të zyrtarëve ushtarakë.

Birbo kafenesh, shau ai me vete. Falë atyre listave ▪ numrave, në armatën time s'pati asnjë bjerrje... Ishin të gjithë aty, në vendet e tyre, oficerët, dhe ushtarët, dhe korrierët, dhe pararojat, dhe priftërinjtë dhe, natyrisht, ndërlidhësit, që u vranë ndërsa bërtisnin "alo!, alo!", si t'i përgjigjeshin thirrjes së vdekjes.

- Në të vërtetë, një punë dreqi, - tha gjenerali pas një heshtjeje të gjatë.

Tjetri vazhdonte ta vështronte hutueshëm.

- Mërzitem, - tha gjenerallejtënanti. - Jam fare vetëm. Sa jua kam smirë që po niseni nesër.

Gjenerali ndezi një cigare.

- Sidomos kur vjen mbrëmja, s'di ç'të bëj fare. Kjo është më keq se të bredhësh maleve dhe të flesh në tendë.

- Ç'të bësh.

- Një vit e gjysmë rresht kemi bredhur si gjeologët mal më mal e luginë më luginë. Dhe ja, tani, kjo ngatërresë në fund.

- Mirë e thatë, si gjeologët.

- Dhe të mendoni ç'mineral kërkojmë, - tha gjenerallejtënanti. - Një mineral që e krijon vdekja.

Gjenerali buzëqeshi.

- Tani do të më falni, - tha, duke parë orën. - Dita e sotme është për mua plot kokëçarje.

- Shkoni, gjeneral, nuk dua t'ju mbaj. Besoj se do të shihemi nga mbrëmja.

- Këndej do të jem, - tha gjenerali. - Sa të mbaroj punët e mia dhe do të kthehem përsëri.

Gjenerali hodhi cigaren në një kuti dhe u mat të hynte në ashensor, por, në momentin e fundit, u kthye.

- Ndoshta, mund të bëhet gjë për ata njëmbëdhjetë ushtarët? - pyeti.

Gjenerallejtënanti ngriti supet.

- Është vështirë. Vërtet shumë vështirë, - shtoi pas pak.

- Pse? Ju duhet të keni adresat e shtëpive ku i keni dërguar.

Gjenerallejtënanti nënqeshi hidhur.

- Një fjalë goje, koleg, por pa mendojeni pak më shtruar se ç'dramë do të jetë për ato familje, kur t'u kërkohet që të kthejnë përsëri eshtrat.

- Sidoqoftë, - tha gjenerali.

- Veç kësaj, kjo s'është gjë përpara ngatërresave të tjera juridike, - tha gjenerallejtënanti. - Por, sidoqoftë, e bisedojmë në mbrëmje gjerë e gjatë.

- E bisedojmë, - tha gjenerali dhe hyri në ashensor.

KREU I NJËZETEKATËRT

Ora ishte tetë e gjysmë, kur mbaroi banketi. Gjenerali priti sa u larguan të ftuarit dhe, kur mbeti vetëm me priftin, ktheu dy gota konjak njërën pas tjetrës.

Mbaroi dhe kjo, mendoi i lehtësuar, duke dalë në rrugë. Pak ftohtë, por, sidoqoftë, mbaroi.

Ai kishte falënderuar autoritetet shqiptare në emër të popullit të tij, të mijëra nënave, për të gjitha lehtësirat e krijuara gjatë kërkimeve dhe deputeti shqiptar, ai që i kishte pritur në fillim në aeroport, kishte thënë se ata kishin kryer një detyrë ndaj një populli tjetër, me të cilin dëshironin të jetonin në paqe. Pastaj kishin çikur gotat dhe, nën tringëllimën e lehtë, të kristaltë, ishte ndier gjëmimi i largët i topave. Atë buçimë të mbytur nuk mund ta mbulonte askush, mendoi gjenerali, dhe të gjithë sa ishin atje e ndienin, por asnjëri nuk mund ta thoshte.

Ai ecte tani midis turmave që mbushnin rrugët dhe, nga të katra anët, ndiente të folurën e huaj dhe gumëzhimën e qytetit.

Në sheshin "Skënderbej" kishte koncert.

Ai çau midis turmës dhe u ngrit pak në majat e gishtave që të mund të shihte më mirë. Nga prapa, dy projektorë derdhnin dritë mbi shpinat e njerëzve dhe diku më tutje gjëmonte një motor. Me sa dukej, merrnin film.

Gjenerali vështronte valltarët që po kërcenin në skenë dhe mendjen e kishte gjetkë.

Buçima ishte atje, përsëriti me vete, në qelqet e bardha, të kristalta dhe jo vetëm oshtima e topave, por edhe kërkëllima e mitralozëve, tingulli i bajonetave dhe zhurma e gavetave të ushtarëve ndajnatë, në atë orë që ndahej darka. Gjithçka ishte atje, dhe të gjithë e dinin dhe e ndienin, sepse ishte e pashmangshme.

Atij i dhembën sytë nga drita e projektorëve. Tani mijëra kokat e njerëzve lëshonin hije shqetësuese në drejtim të kundërt të dritës. Ndjeu një rrëqethje në shpirt dhe filloi të çante prapë në mes të turmës së dendur. Projektorët lëviznin vazhdimisht, duke derdhur rripa drite verbuese, herë më lart, herë më poshtë. Kokat e njerëzve ktheheshin gjithë shqetësim, me ato hije të gjata konike, si të ngjitura pas kafkës.

Gjenerali doli, më në fund, nga turma dhe eci drejt hotelit.

Atij iu kujtua se si në tryezë ata rrinin ballë për ballë, përfaqësues të dy popujve dhe shteteve, dhe, midis tyre, kishte vetëm ca shishe me pije dhe ca pjata me fruta.

Vetëm kaq ka midis nesh? kishte thënë me vete, kur kishin ngritur gotat për të parën herë. Vetëm këto shishe me

etiketa të bukura dhe këto fruta të mbledhura nëpër kopshtet dhe vreshtat ndanë detit? Atij i qenë kujtuar rrafshulëtat e mbuluara me muzgun e mbrëmjes, drita e hënës mbi to dhe, më tutje, të lehurat e qenve dhe zjarre të vetmueshëm barinjsh, që mund t'i merrje për regëtimë yjesh. Tutje, të lehurit e vetmuar të qenve. Dhe, më tutje, regëtinte ndonjë zjarr.

- Ju keni një telegram, - i tha njëri nga portierët, duke i zgjatur çelësin e dhomës.

- Falemnderit!

Ai u kujtua se këto dy ditët e fundit po thoshte shumë herë "falemnderit".

Mbi letrën e verdhë ishte ngjitur shenjëza e kuqe që tregonte ngut.

Ai e hapi me shpërfillje dhe lexoi: "Morëm vesh për mbarimin e misionit fisnik, lutemi, lajmëroni për kolonelin. Familja Z."

Ndjeu se si gjaku po i ngjitej në kokë dhe tëmthat po i rrihnin fort. Megjithatë, u përpoq të mbante gjakftohtësinë. Shkoi ngadalë gjer tek ashensori dhe hyri brenda.

Ç't'u desh t'i hyje kësaj pune? tha me vete, duke u vështruar në pasqyrë. Fytyra e tij ishte e lodhur dhe e zbehtë, me ato rrudhat e përhershme në ballë, tri rrudha të thella, e mesit pak më e gjatë dhe dy të tjerat më të shkurtra, si ato vijat që shtypnin daktilografistët në fund të ndonjë kumtese.

U lodhe, i tha vetes, u këpute.

Hyri në dhomën e tij, hapi dritën dhe gjëja e parë që i r në sy ishte malësori i vogël prej porcelani, që i binte lodrës.

U shtri dhe u përpoq të flinte.

Jashtë gjëmuan fishekzjarrët. Dritat shumëngjyrëshe hynin të prera rripa-rripa nëpërmjet fiegrave dhe rrotulloheshin në të katër muret e dhomës. Dhe atij prapë iu kujtua ajo dhoma e madhe në kuartierin ushtarak, njëzet e ca vjet më parë, kur ai rrinte bashkë me të tjerët në tryezën e gjatë të komisionit mjekësor ushtarak. Shpesh qëllonte që nëpër duart e anëtarëve të komisionit kalonin radiografitë e rekrutëve. Ata i kthenin drejt dritës dhe brinjët e errëta rrotulloheshin, ja, kështu, mbi kokat e tyre dhe pastaj dëgjohej vetëm një fjalë, e thënë me një tingull të lodhur e të mërzitshëm: "i aftë". Ata thoshin, zakonisht, "i aftë" edhe atëherë kur midis brinjëve kishte ndonjë njollë të vogël. Vetëm kur njollat ishin tepër të mëdha, dhe s'kishe si të mos i vije re, murmurisnin: "i paaftë". Dhe kjo vazhdonte gjithë ditën dhe gjithë ditën rekrutët me kokat e qethura i nisnin drejt për në kazerma dhe që andej në luftën që porsa kishte filluar.

Rripat e dritës ishin të padurueshëm. Ai mbylli sytë që të mos i shihte më, por me sytë e mbyllur iu kujtua më qartë dhoma e madhe, e zhveshur, e rekrutimit dhe ushtarët e hutuar, që rrinin në këmbë para tryezës, të gjatë, krejt lakuriq, si qirinj të bardhë.

Gjenerali u ngrit. Ishte ora e darkës. Doli për të pyetur për priftin. I thanë se kishte dalë. Atëherë, hyri prapë brenda, ngriti telefonin dhe kërkoi gjenerallejtënantin.

Zbritën të dy ngadalë e pa folur nëpër shkallët e mermerta. Poshtë në holl ishte po ajo gjalléri e mëngjesit.

Në sallon mezi gjetën një vend për t'u ulur. Nga dritarja dukeshin bulevardi, njerëzit që shëtisnin dhe ndriçimi i fishekzjarrëve, që ulej mbi kokat e njerëzve dhe mbi drurët e parkut, si një borë e dendur ngjyrash.

Gjenerali porositi raki. Tjetri konjak.

Shkallët prej dërrase, që të çonin në tavernë, kërcisnin vazhdimisht.

Ata çikën gotat dhe pinë. Pastaj heshtën për një kohë të gjatë. Gjenerali mbushi përsëri gotat. Kjo iu duk më e lehtë se të hapte ndonjë bisedë.

Fishekzjarrët gjëmonin përjashta.

- Festojnë fitoren, - tha gjenerali.

- Po.

Ata vështruan përjashta sesi qielli ndriçohej, sikur nga lart zbriste një helmetë gjigante e skuqur, që xixëllonte e pastaj befas zbehej, ftohej dhe shuhej në gjirin e natës.

- Ama punë që na ngarkuan, - tha gjenerali.

Ata bënë hamendjen e përsëritur se cila nga të dyja: lufta vetë apo ky shtegtim mortor pas saj ishte më i rëndë.

Gjenerali vështroi mëngën e zbrazët të setrës.

S'ke nevojë ta thuash se ke qenë në luftë, mendoi.

- Kjo është vetë lufta, - tha gjenerallejtënanti. - Këto eshtra janë thelbi i saj, ajo çka mbetet në fund, si ato kripërat që mbeten në fundin e një ene ku kryhet një reaksion kimik.

Gjenerali buzëqeshi hidhur. Poezi, mendoi dhe mbushi gotat.

- Keni dëgjuar se si kërkuesve të perlave që zhyten thellë në ujë qëllon që u plasin mushkëritë? Ja, kështu edhe neve, kjo punë na plasi shpirtin.

- Është e vërtetë, na plasi shpirtin.

- U lodhëm, - tha gjenerali.

Tjetri mori frymë thellë.

- U thyem nga hija e luftës. Po sikur të ishte ajo vetë?

- Vetë lufta? Ndoshta, do të ishte më mirë.

Ata folën prapë për luftën dhe për fantazmën e saj, pa e gjetur dot kurrsesi se cilën prej tyre do të parapëlqenin.

Nga poshtë dëgjohej muzika dhe aparati i kafe-ekspresit lëshonte herë pas here një vërshëllimë të butë avulli.

- Ju kujtohet ai stadiumi, për të cilin ju fola atë natë kur u njohëm? - tha gjenerallejtënanti.

- Ai stadiumi ku nuk ju lejuan të gërmonit para se të mbaronte kampionati i futbollit?

- Pikërisht ai.

- Më kujtohet, - tha gjenerali. - Diçka më kujtohet. Si kishit filluar të hapnit gropa anëve dhe si gjithë ditën binte shi.

- E vërtetë, - tha gjenerallejtënanti. - Ishte ashtu, vërtet. Gropat nxinin rreth e përqark fushës së futbollit dhe në shkallët gjata derdheshin ujërat. Pastaj ne filluam të gërmonim brenda në fushë, atje ku rri portieri, ku lozin mbrojtësit, ku vërtiten sulmuesit, me një fjalë, kudo, dhe fusha ishte bërë e gjitha shoshë. Por unë nuk e kisha fjalën aty.

- Ku e kishit fjalën?

- Ju tregova për atë vajzën që vinte e priste të fejuarin çdo pasdite, kur ata kishin stërvitje?

- Diçka më keni treguar, - tha gjenerali, - po s'më kujtohet mirë.

- Ajo vinte çdo pasdite dhe, kur binte shi, e mbante kokoren e mbipetkut të ngritur dhe rrinte atje në këmb, te shtyllat e tribunës, duke ndjekur me sy të fejuarin në fushë.

- Tani më kujtohet, - tha gjenerali. - Më kujtohet që më treguat se vishte një mushama blu.

- Po, po, - tha gjenerallejtënanti me gjallëri. - Ajo kishte një mbipetk të bukur blu, kurse sytë i kishte edhe më të

kthjellët, ndonëse pak të ftohtë, por mua më dukej se nuk kisha parë sy më tronditës. Kështu, pra, vinte çdo ditë, ndërsa ne gërmonim vazhdimisht dhe gropat e rrethonin fushën nga të gjitha anët.

- Ç'ndodhi pastaj? - pyeti gjenerali me shpërfillje.

- Asgjë, - tha gjenerallejtënanti, - asgjë e veçantë. Kur afronte mbrëmja, ata djemtë e linin stërvitjen dhe atëherë, njëri prej tyre i hidhte asaj krahun mbi supe dhe iknin të dy, ashtu të përqafuar. Dhe atëherë, më besoni, ndieja një mërzi në shpirt dhe bota më dukej e shkretë dhe pa kuptim, si ai stadiumi i ngrysur ziplot. Në moshën time kështu, e besoni?

Ç'gjë e shëmtuar, mendoi gjenerali.

- Kështu qëllon nganjëherë në jetë, - vazhdoi gjenerallejtënanti. - Pikërisht atje ku s'e pret, vjen e lind një ëndërr e marrë dhe pa kuptim, si ajo lulja që lind buzë një gremine. Ç'punë kisha unë, gjeneral i huaj dhe, për më tepër, në këtë moshë dhe invalid, ç'punë kisha unë, që kam ardhur këtu për të mbledhur eshtrat e ushtarakëve të kombit tim, me atë vajzë të re, të huaj?

- Sigurisht, asnjë punë s'kishit me të, - tha gjenerali. - Por, për të menduar, mund të mendonit. Njeriut shpesh i qëllon të ëndërrojë gjëra të paarritshme, sidomos kur është puna për femrat. Verën e parafundit, në plazh...

- Nganjëherë më dukej se mendoja për të, - e ndërpreu tjetri, - por, nganjëherë, nuk e kuptoja as vetë përse trishtohesha. Nuk ishte vetë vajza që më turbullonte, por diçka tjetër, diçka e papërcaktuar. Më kuptoni?

- Diçka kuptoj, - tha gjenerali. - Me sa duket, më shumë se rinia, ju turbullonte vetë shfaqja e jetës. Kemi kaq kohë

që vërtitemi si hienat, duke nuhatur vdekjen atje ku është strukur dhe duke e ndjellë me gjithfarë mënyrash që të dalë përjashta. Dhe gati po harrojmë çdo gjë të bukur. Në plazh, verën e parafundit, siç ju thashë, më ndodhi diçka që...

- Në moshën time, hm, - e ndërpreu prapë tjetri.

Gjeneralit i erdhi të kërcëllinte dhëmbët. Nuk i duronte dot njerëzit që donin të flisnin veç për veten. Ashtu, me nofullat shtrënguar, dëgjoi prapë të njëjtat fjalë për shkallinat e stadiumit dhe për vajzën me mbipetk të kaltër.

Ah, ç'dashnor, tha dy-tri herë me vete.

Kur e kuptoi se... historinë e tij të plazhit... verën e parafundit... edhe sikur tjetri ta linte, s'kishte më dëshirë për ta treguar (kishte qenë një çast që kishte besuar vërtet se kishte ndodhur njëfarë historize atje në plazh, por ajo kishte qenë aq e brishtë, saqë kishte mjaftuar shpërfillja e dëgjuesit që të tretej si vesa), kur e humbi, pra, shpresën për të hapur zemrën, u egërsua së brendshmi.

Tani do të më shikosh, tha me vete. Dashke vëmendje për ndjenjëzat e tua, kurse për të tjerët bëhesh shurdh. S'kishte dashur të dëgjonte një historizë plazhi? Tani do t'ia prishte gjakun ndryshe. Gruaja plakë e dasmës, me grathoren e zezë të lyer me baltë e me klithmat e saj, i rrinte vazhdimisht në kokë.

- Një natë shkova në një dasmë të tyre dhe desha të ngrihesha në valle, - filloi të tregonte gjenerali, por tjetri nuk e la të vazhdonte.

- Unë, - dhe tregoi me dorë veten, - me këta flokë të zbardhur, me një dorë të prerë, e dini ç'bëra kur u kthyem pas një muaji përsëri në atë qytet? Shkova vetëm në stadium

pasdite, pikërisht në atë orë kur ata kishin stërvitje. Por stadiumi ishte mbyllur. Megjithatë, kërkova të hyja. Rojtari më hapi portat e mëdha të hekurta dhe hyra. Stadiumi ishte i shkretë dhe i zymtë si asnjëherë. Gropat tani ishin mbyllur, vetëm se në tokë kishin mbetur shenjat, si ato plagët e mbyllura në lëkurë. Unë erdha rrotull pranë shtyllave të tribunës, atje ku rrinte e priste ajo vajza, dhe ndjeva një trishtim të madh në shpirt dhe m'u duk, në atë çast, se tërë jetën time do të ma shtypnin ato shkallë të gjata, të lagëta, lakore, ato shkallina të zbrazëta prej betoni, që vërtiteshin e vërtiteshin rreth e rrotull dhe dukej sikur s'mbaronin kurrë. Më dëgjoni?

- Ju dëgjoj, - tha gjenerali. - Ju dëgjoj. - Kurse me vete tha: ç't'u bë mirë.

Ishte mbushur me mllef dhe mezi ç'priste çastin e hakmarrjes. Plaka Nicë i dukej se bënte pjesë në aradhen e fantazmave ndëshkuese. Le ta përballojmë të dy, tha me vete, ashtu si baltën e reshjet që na mbytën.

- Në atë dasmën që të thashë, ku u ngrita në valle...

Këtë herë ishte trokitja e derës që ia preu fjalën. Megjithatë, duke u ngritur të hapte derën, gjenerali e vështroi tjetrin me qortim.

Kishin sjellë prapë një telegram.

- Dërgojnë telegrame, kujtojnë se me to mund të zgjidhet diçka, - tha gjenerali. - A e dini ç'më ka thënë një plakë shqiptare në një dasmë? Ti ke ardhur këtu që të shikosh se si ne i martojmë bijtë tanë, që pastaj të vish për të na i vrarë.

- Fjalë të tmerrshme.

- Fjalë të tmerrshme? Ju thoni "fjalë të tmerrshme"? Po ç'do të thoshit, sikur të dinit atë që ndodhi pastaj?

- Nuk e di, - tha tjetri.

- Dhe më mirë të mos e dini.

- Pini, koleg, - tha gjenerallejtënanti. - Për shëndetin tuaj! Të mbërrini shëndoshë e mirë në atdhe! Sa jua kam smirë.

- Falemnderit, koleg!

Gjenerali e ndiente se po dehej. Pezmi i ishte zbutur disi, ndonëse jo krejt. U mat të fliste prapë për plakën Nicë, por, për çudi, përmendi punëtorin e mahisur.

- Ma thatë një herë, - tha tjetri.

- Po që vdiq, a e dini?

- Edhe këtë e di, - tha gjenerallejtënanti, duke e vështruar në bebe të syrit, si të tregonte se s'trembej nga kësi gjërash.

Ma thatë një herë, ma thatë një herë, mendoi gjenerali. Për atë punën e stadiumit më ke çarë veshët nja dhjetë herë e unë s'ta kam prerë fjalën.

Tani salloni, dalëngadalë, po zbrazej nga njerëzit dhe shkallët e tavernës, atje në fund, kërcisnin më rrallë, por muzika dëgjohej vazhdimisht.

- Ku është ati juaj i shenjtë? - pyeti papritur gjenerallejtënanti.

- Nuk e di, - tha gjenerali. - Se ku vërtitet këndej dhe, me siguri, vazhdon t'u përgjigjet telegrameve.

Tjetri përsëri ia nguli sytë e tij të habitur dhe deshi të pyeste "pse?", por pastaj ndërroi mendje.

Gjenerali u përkul te supi i tjetrit, si për t'iu lutur për diçka. U mëdysh ca çaste, pastaj i tha:

- Atë stadiumin, po deshe, mos ma përmend më... Bashkë me... setrat e kaltërta e ç'janë ato të tjerat.

- Ju jap fjalën, koleg. Një herë... Jo, nuk do ta përmend më stadiumin. Një herë dëgjuam një këngë, që e morëm në

fillim si një provokim. Por kënga ishte e vjetër dhe, për më tepër, ishte këngë dashurie.

- Ashtu? - ia bëri tjetri.

- Kënga thoshte pak a shumë kështu: Ti, moj Hanko, që je kaq simpatike, mos shëtit nëpër varre, se me bukurinë tënde i ngjalle të vrarët.

- Shih, shih, - ia bëri gjenerali.

Ata biseduan shumë për gjëra të ndryshme dhe kurdoherë në bisedën e tyre futeshin lufta dhe varrezat. Çdo mendim yni ka nga një dërrasë veshur me llamarinë si ato, mendoi gjenerali. Një dërrasë me shkronja të shuara e të ndryshkura, që mezi lexohen. Ajo kërcet kur fryn era, dhe era fryn gjithmonë, si në atë luginën ku të gjitha kryqet dhe shenjat tjera ishin të përkulura nga perëndimi. Ata kishin pyetur për shkakun dhe fshatarët kishin thënë se këtë gjë e kishte bërë era, që frynte gjithmonë po në atë drejtim.

Salloni ishte zbrazur pothuaj krejt, kur erdhi telegrami tjetër. Gjenerali e mori nga dora e portierit dhe e hapi pa e parë nga vinte.

E mblodhi shuk pa e lexuar gjer në fund dhe e hodhi në hirnore.

- Ju sonte po merrni telegrame tepër misterioze, koleg.

Gjenerali nuk u përgjigj.

Gjenerallejtënanti psherëtiu.

- U trembem telegrameve të natës, - tha.

Muzika dëgjohej ende, por te shkallët prej dërrase njerëzit dukeshin tani rrallë e më rrallë.

- Sa është ora? - pyeti gjenerali.

- Po afron mesnata.

Ata ngritën gotat dhe për diçka tjetër, që gjenerali nuk e kuptoi mirë. Ç'rëndësi ka, mendoi ai, përse pimë? Le të mendojë ai tjetri përse.

Një grimë i ra prapë ndër mend plaka Nicë. Kujtove se shpëtove prej saj? iu drejtua me vete tjetrit. He, he, kujtove se më le vetëm. Por e ke kot, prej saj nuk shpëton dot kurrë.

- Desha t'ju pyesja, - tha duke iu afruar te veshi, - a keni pirë ndonjëherë me ndonjë prift?

- Prift? Jo, me sa më kujtohet. Besoj, s'më ka rënë rasti. Megjithatë, s'mund ta vë dorën në zjarr.

Gjenerali vështroi prapë mëngën e zhytur shkel e shko në setër.

Ti ke vetëm një dorë, mendoi, dhe po e përdor pak si tepër.

- Jo, me sa mbaj mend, - përsëriti gjenerallejtënanti.

Gjenerali tundi kryet një copë herë.

- Ja, kjo është jeta e njeriut, - tha i menduar, - sot udhëton nëpër shi, nesër pi me një prift. Apo jo?

- Natyrisht.

- Jo, po më thoni, a keni ndonjë kundërshtim?

- Si mund të dyshoni, koleg?

- O, më falni. Jam pak i nxituar.

- Ju lutem, ju lutem!

- Hm.

Tek po vështronte hirnoren, gjenerali bëri me vete një lëvizje habie.

KREU I NJËZETEPESTË

Gjenerali kujtoi se po murmuriste kolegu i tij, ndaj u habit kur tjetri e pyeti:

- Ç'po murmuritni ashtu?

- M'u kujtuan fjalët e dikujt në atë dasmën e mallkuar... shi dhe mort gjen kudo...

- Fiu, - vërshëlleu tjetri krejt i habitur.

- Më pas, prifti im, që është edhe kolonel, edhe përkthyes, edhe dashnor, edhe ku di unë çfarë, më shpjegoi se kjo thënie e vjetër s'mbaron me kaq.

- Fiu, - ia bëri prapë tjetri.

- Shi dhe mort gjen kudo, tjetër gjë kërko, o njeri... Ju lutem, mos vërshëlleni prapë. Me fjalë të tjera, ka një si qortim, një si këshillë. Mirëpo unë, ashtu si ju, ne, nuk dimë tjetër gjë. Të tjerët kërkojnë naftë, krom, shtatore antike.

Kurse ne, të gjorthit, veç këtë punë dimë. Apo jo? Ne... Standard Mort Company, apo jo? Ha, ha, ha.

Tjetri dëgjonte gojëhapur.

- Kjo punë u ngatërrua keq, - tha mendueshëm. - Me krom, me kompani nafte... Ka kaluar mesnata, - shtoi pas pak. - Më duket se duan të mbyllin sallonin.

- A shkojmë në dhomën time? - tha gjenerali. - Unë jam shumë i lumtur që ndodhem në shoqërinë tuaj, koleg i dashur.

- Gjithashtu, koleg.

Ata u ngjitën, duke iu marrë këmbët, në shkallët e hotelit, secili me nga një shishe në dorë.

- Nuk duhet të bëjmë zhurmë, - tha gjenerali. - Shqiptarët flenë shpejt.

- Ma jepni mua çelësin! Më duket se ju dridhen duart.

- Kryesorja është të mos bëjmë zhurmë.

- Kurse unë dua zhurmë, - tha gjenerallejtënanti. - Qetësia më fut tmerrin. Kjo ishte një luftë e heshtur, si një film pa zë. Më mirë të gjëmonte topi. Po flas si në teatër?

- Shët. Dikush u koll.

- Ma jepni mua çelësin. Ç'luftë e heshtur që ishte. Krejt luftë e vdekur.

- Hyni, ju lutem, - tha gjenerali. - Uluni. Jam shumë i gëzuar.

- Jam tepër i lumtur.

Ç'vdeknajë e pafund, mendoi gjenerali.

Ata u ulën në tryezë ballë për ballë dhe po e vështronin me sy të mallëngjyer njëri-tjetrin. Gjenerali mbushi gotat.

- Jemi dy zogj të mërguar që po pimë konjak, - tha gjenerallejtënanti i prekur.

Gjenerali tundi kokën. Pastaj heshtën përsëri një kohë të gjatë.

- Ne u grindëm për çështjen e thesit, - tha gjenerali dhe vrenjti vetullat.

I nguli sytë kolegut dhe, siç dukej, po mundohej të kujtonte diçka.

- Unë e vërvita në humnerë, - tha me ton të fshehtë.

- Po ju thatë se prifti është në dhomën e tij.

- Jo priftin, - tha gjenerali, - thesin.

- Aha, e kuptova. Shumë e drejtë.

- Ai nuk deshi që unë ta hidhja, - vazhdoi gjenerali, - kurse unë nuk desha ta merrja thesin me vete, se ishte ndjellakeq.

- Shumë e drejtë. E ç'rëndësi ka, fundja, një thes? - tha gjenerallejtënanti, duke thithur cigaren.

- Por atij nuk i mbushej mendja.

- Prandaj dhe ju e vërvitët atë në hon.

- Jo atë, thesin.

- Ah, më falni!

Ata heshtën prapë. Ishin njëherë një veturë e një kamion, që po ecnin në shi, mendoi gjenerali.

- Ishin njëherë një veturë e një kamion, që po ecnin në shi, - tha me zë të lartë.

- Ç'është kjo? - pyeti tjetri. - Po merreni me çështje transporti?

- Jo, është një përrallë tjetër për mbesën.

- Ashtu? Jeni mbledhës përrallash?

- Natyrisht.

- E merrja me mend. Problemi i përrallave më ka joshur gjithmonë.

- Shumë problem i madh.

- Problem i pazgjidhshëm.

- Çoroditës, do të thosha.

- Pa fjalë, - tha befas me ton të prerë gjenerallejtënanti.

Gjenerali i nguli sytë i habitur, por shpejt harroi.

- E dini atë këngën "Fluturoi një varg me pata"? - tha. - Një natë pashë një ëndërr të çuditshme. Sikur në qiell fluturonte një varrezë në trajtë V-je.

- Ëndërr zbavitëse.

- Unë kam katër priftërinj të vdekur, - tha gjenerali.

- Unë s'kam asnjë, - tha i pikëlluar tjetri.

- Ti s'ke as kurvë.

- As kurvë.

- Mos u mërzit, ndoshta do t'i gjesh më vonë.

- Ndoshta, - psherëtiu gjenerallejtënanti. - Ç'nuk gjen njeriu nën tokë. - Ku është banja?

- Pas perdes.

Gjenerali qëndroi shumë kohë vetëm në tryezë. Më në fund, tjetri u kthye.

- Në një luginë ne gjetëm të përziera me eshtrat e ushtarëve eshtrat e një mushke, - tha gjenerallejtënanti. Ai ishte zverdhur nga pija.

- Unë mblodha humbjet tuaja, gjeneralë të këqij, - tha gjenerali.

- Mos i fyeni. Sidoqoftë, ata e kanë pasur vështirë.

- Ne e patëm më vështirë.

- Ndoshta.

- Procesverbal hapjeje, numër njëqind e katër, tip B, - tha gjenerali.

Një copë herë qëndruan pa folur.

- Eshtrat e mushkës ishin të ndryshme krejt. Çdo njeri do t'i njihte.

- Natyrisht. Kjo është e thjeshtë. Më duket se njeriu ka pesëqind e shtatë eshtra.

- S'është e vërtetë, koleg, - tha gjenerallejtënanti i ngrysur. - S'është e vërtetë. Unë kam më pak.

- S'është e mundur.

- Është, - nguli këmbë tjetri, me zë të ngjirur. - Unë kam disa eshtra mangët. Unë jam i gjymtë.

- S'ka nevojë, - e qetësoi gjenerali. - S'ka nevojë, koleg.

- Unë jam i gjymtë, - përsëriti gjenerallejtënanti. - Ju nuk më besoni, por unë do t'jua tregoj që tani.

Ai u mundua të hiqte setrën me njërën dorë, por gjenerali e zuri për supesh.

- S'është nevoja, koleg, s'është nevoja. Unë ju besoj plotësisht. Më falni, ju lutem, më falni shumë. Jam tepër fajtor. Jam një njeri i kurrfartë, në fund të fundit.

- Unë duhet t'jua tregoj juve dhe gjithë atyre që nuk besojnë. Qysh tani do t'jua tregoj.

- Shët, - tha gjenerali. - Më duket po trokasin në derë.

Ata heshtën dhe trokitja u përsërit.

- Kush troket vallë në këtë orë?

- U trembem trokitjeve të natës, - tha gjenerallejtënanti. - Kështu trokitën atë natë, kur u nisa me ngut në front. Tak, tak, tak. Pastaj, kur u ktheva, mezi e hapa portën. Sepse ishte hera e parë që e hapja portën me një dorë, - vazhdoi me një ton të fshehtë.

Gjenerali shkoi të hapte derën, duke u lëkundur.

Ishte portieri, me një tjetër telegram.

- Tepër misterioz po më dukeni sonte, koleg, - tha gjenerallejtënanti. - Gjithë këto telegrame natën, nuk janë shenjë e mirë.

Tani atje tringëllijnë telefonat e bardhë, mendoi gjenerali. Tani ata i thërrasin njëri-tjetrit alo, alo, alo, alo, dhe pastaj vrapojnë përjashta dhe sulen te njëri-tjetri si të tërbuar.

Gjenerali u përpoq të përfytyronte turbull se si ata mblidheshin në shtëpinë e kolonelit, si lajmëronin miqtë e tjerë në klubin e tyre, si dilte te shkallët nëna plakë e kolonelit, duke kryqëzuar duart, dhe si Beti hidhej nga shtrati e trembur dhe të gjithë pështpërisnin: i poshtri, ende s'e ka gjetur, i poshtri.

Unë s'jam i poshtër, Beti, mendoi ai.

- Ata nuk flenë sonte, - tha me zë të lartë.

- Ç'kërkojnë? - tha gjenerallejtënanti.

- Thesin, - tha gjenerali.

- Unë ju këshilloj ta jepni thesin dhe të marrë fund ky çrregullim. Gati-tu!

Një mut, mendoi gjenerali.

Gjenerali e mblodhi shuk telegramin dhe e hodhi në dysheme.

- A e dini? - tha. - Dyshoj se prifti im është spiun.

- Mund të jetë. Por s'mund ta vë dorën në zjarr.

Ata heshtën për një kohë të gjatë. Pas flegrave dukej diçka e turbullt, e bardhë.

- Po gdhin, - tha gjenerallejtënanti.

Nga ballkoni përjashta dëgjohej zhurma e butë e shiut.

- U trembem telegrameve, - tha si i humbur gjenerallejtënanti. - Në to ka gjithmonë diçka të keqe dhe të fshehtë

dhe diçka që nuk thuhet. Më kujtohet, në front, një oficer i shtabit mori telegram nga një miku i tij, i cili kishte kohë që kishte vdekur.

- Gjëra të frikshme po thoni, koleg.

- Shët, - tha gjenerallejtënanti. - Dëgjo!

- Çfarë?

- Vër veshin. A nuk dëgjoni diçka?

Gjenerali përgjoi.

- Shiu, - tha.

- Jo, nuk është shiu.

Nga larg, fare larg, dëgjohej një zhurmë e thellë. Pastaj çë zëra të prerë, të shkurtër dhe prapë shiu.

- Ç'është kjo?

- Dalim në ballkon, - tha gjenerali dhe u ngrit.

Përjashta, ajri i lagët i natës u ra në fytyrë dhe zhurma ■ largët u ndie më qartë.

Binte një shi i imët, i butë. Bulevardi dukej i zbehtë nën dritat e ftohta neon. Kurse parku nxinte përballë hotelit, i madh dhe i frikshëm.

- Këndej, - pështpëriti gjenerallejtënanti, - shiko.

Gjenerali ktheu kokën andej nga tregonte tjetri me dorë dhe u rrëqeth. Atje tutje, nga ana e Universitetit, ata panë në bulevard katrorë të mëdhenj, të errët, që lëviznin duke u afruar.

Tani zhurma e rëndë e hapave ndihej më e qartë dhe zërat e prerë, të shkurtër të komandës tingëllonin të ftohtë në errësirën e natës.

Gjeneralët rrinin të dy të mbështetur te parmaku, me kokat të kthyera andej. Kur katrorët iu afruan urës, ata dalluan

shkëlqimin e ftohtë të helmetave, rreshtat e ushtarëve dhe shpatat e zhveshura të oficerëve. Hapat e rëndë dukej sikur tronditnin dheun me britmat e shkurtra të oficerëve midis.

Katrorët e zinj afroheshin vazhdimisht. Gjithë bulevardi tani nxinte prej tyre, kurse pasqyrimi i dritave të bulevardit mbi helmetat ngjante i turbullt e plot mister, si i një bote të prishur.

- Një armatë, - tha gjenerallejtënanti. - Ç'është kjo?

- Armata e tyre, - u përgjigj gjenerali. - Siç duket, bëjnë prova për paradën ushtarake.

Tutje u dëgjua një gumëzhimë e mbytur motorësh.

- Tanket, - tha gjenerali.

Tanket u dukën tutje te ura, të mëdha dhe të zeza, me grykat ■ topave të ndera në errësirë.

Tani gjithë bulevardi qe mbushur me trupa dhe hekur, që lëviznin drejt sheshit "Skënderbej" nën britmat e oficerëve. Ato ishin gjithmonë të shkurtra, të dala si prej fytesh të prera.

Kur katrori i fundit u zhduk prapa ministrive dhe bulevardi mbeti përsëri nën dritat neon, i heshtur dhe i zbehtë si nga pagjumësia, ata u futën brenda.

- Një armatë e tërë, - tha gjenerallejtënanti.

- Kam ftohtë.

- U lagëm, u bëmë qull.

- Pini, gjeneral, ndryshe, do të ftoheni.

Tani të dy ishin më të kthjellët.

Gjenerali ngriti kokën.

- Tek i shikoja, m'u kujtua armata ime dhe mendova si mund të parakalonin ushtarët e mi, të veshur me thasë të kaltër, me shirita të zinj.

- Kurse unë jam edhe më keq, - tha gjenerallejtënanti. - Kam një turmë të çrregullt e plot rrëmujë. Në ushtrinë time s'e merr vesh i pari të dytin.

Kur të mbërrish në atë vdeknajë, mendoi gjenerali. S'dinte nga i vinte ajo frikë e shurdhër.

- Kur të mbërrish në atë vdeknajë, - tha me zë.

- Çfarë? - pyeti tjetri.

Gjenerali zuri kryet me duar, me një lëvizje të pazakonshme për të. Ishte një lëvizje e huaj, madje, më shumë se e huaj, e ardhur si nga një botë e vjetër grash.

Jo, tha me vete. Nuk e duronte dot atë renditje fjalësh me një si muzikë mortore midis.

Kur të mbërrish në atë... vend... kërkoma djalin... bir.

Në mendjen e tij, kontesha Z. dhe plaka Nicë, të turbullta krejt, merrnin e jepnin me njëra-tjetrën. Jepma djalin, grua e huaj... Merre, moj konteshë... merre...

Ishte midis të dyjave fare i vetëm.

- A e dini përse u grinda me priftin? - tha, duke marrë frymë me vështirësi, sikur të ngjitej nga një pus.

- Jo, - tha gjenerallejtënanti.

- Për një skelet, - tha gjenerali. - Na mungon një skelet një e tetëdhjetë e dy i gjatë.

- Punë e madhe, - ia bëri tjetri. Pastaj papritur ngriti kokën dhe sytë i shkëlqyen.

- Një e tetëdhjetë e dy? A doni t'ju shes unë një të tillë?

- Jo, - tha gjenerali.

- Pse jo? Unë kam plot. Jua jap si mik, për njëqind dollarë.

- Jo.

- A nuk thatë që ju duhej një skelet një e tetëdhjetë e dy? Unë kam plot të tillë. Kam edhe një e nëntëdhjetë e dy, po deshët. Edhe dy metra. Madje, edhe dy e dhjetë. Ushtarët tanë ishin më të gjatë se tuajët. Do?

- Jo, - tha gjenerali. - Nuk dua.

Gjenerallejtënanti ngriti supet.

- Puna juaj, - tha. - Unë timen e bëra.

Gjenerali u ngrit dhe me vështirësi shkoi deri te valixhja. E hapi dhe e zbrazi përdhé. Listat, hartat, procesverbalet dhe shënimet u përzien me peshqirët dhe këmishët. Ai kapi një grumbull listash dhe, duke iu marrë këmbët, doli nga dhoma.

- Ku shkon ky njeri? - tha gjenerallejtënanti.

Gjenerali bëri ca hapa në mesoren e shkretë dhe u ndal përpara një dere.

Këtu fle prifti, mendoi.

- Prift, - tha me zë të ulët, duke përkulur kokën te vrima e çelësit. - Prift, a më dëgjoni? Jam unë. Erdha të pajtohemi. Kot që u grindëm për kolonelin. Si mund ta prishim miqësinë për një thes? Ne mund ta rregullojmë këtë çështje, atë i shenjtë. E krijojmë prapë kolonelin. Pranon? Prano, prift! Është për të mirën e të dyve. Ti do të thuash sa e lehtë je, Beti. Mirë. Thuaj! Ajo është puna jote. Të mungon skeleti! Ja ku e ke. Kam sjellë listat, prift, a më dëgjon? Ja ku i kam. Ka plot ushtarë, një e tetëdhjetë e dy. Ngrihuni të zgjedhim një! Është një i kompanisë së dytë të mitralierëve. Ja dhe një tjetër, tankist. Gjeta dhe një tjetër. Ngrihuni t'i shikojmë listat një për një! Ja dhe një tjetër. Këtij i mungojnë dy dhëmbët e parë. Por s'ka gjë, ne mund t'ia bëjmë te dhëmbtari. Gjeta dhe një tjetër. Edhe dy të tjerë. Më dëgjoni? Të gjithë janë një

e tetëdhjetë e dy. Nuk të gënjej, prift. Një e tetëdhjetë e dy. Një e tetëdhjetë e dy. Çfarë? Ah, prit... Më duket se edhe unë vetë jam një e tetëdhjetë e dy...

Gjenerali murmuriti shumë kohë, me kokën të përkulur te vrima e çelësit. Pastaj, papritur, dera u hap me rrëmbim. Një grua e trashë me rrobënate e vështroi gjithë përbuzje.

- Si s'ju vjen turp! Unë në këtë moshë...

Gjenerali çakërriti sytë. Dera u përplas përpara hundës së tij dhe ai mbeti në këmbë një copë herë. Pastaj u ul dhe u përpoq të mblidhte me mundim listat që i kishin rënë përdhé gjatë kohës që fliste.

Ndaj të gdhirë, kur sollën telegramin e fundit, ata ishin ende duke pirë. Gjenerali e hapi telegramin, por nuk dalloi dot asnjë shkronjë. E mbajti një copë herë në dorë, herë duke i kapsallitur sytë e herë duke rrudhur ballin, por prapë nuk kuptoi gjë. Radha e shkronjave iu duk si një rrip mjegulle, i prerë nga një qiell i bardhë e pa kuptim. E mblodhi shuk dhe, duke iu marrë këmbët, iu afrua dritares.

- I pa i-dent-if-ikuar, - thirri dhe e flaku telegramin përjashta.

Telegrami filloi të binte, duke u lëkundur në gjysmëterrin e ftohtë.

KREU I PARAFUNDIT

Në mëngjes herët, te portineria e hotelit zbriti një nga pastrueset e katit të katërt.

- Kam gjetur këto letra, - tha gruaja, duke i zgjatur portierit fijet e letrave të daktilografuara. - Nuk di të kujt janë.

- Ku i gjete?

- Në katin e tretë, në korridor. Disa përpara dhomës 429, disa përpara 403-shit. Dikujt do t'i kenë rënë gjatë natës.

Portieri bëri një gjest habie. Pastaj balli i tij u rrudh plot dyshim.

- Lëri këtu, - tha. - Kush i ka humbur, do t'i kërkojë vetë.

Letrat ngjanin si lista emrash të shtypura në makinë. Krahas emrave kishte dhjetëra kryqe të vogla me ngjyrë të kuqe ose blu dhe gjithfarë shënimesh të bëra me dorë, me një shkrim nervoz.

KREU I FUNDIT

Mbi tokën e huaj binte dëborë e shi përzier bashkë. Flokët e rëndë e të squllur të dëborës shkrinin menjëherë, porsa preknin betonin e sheshit përpara ndërtesës së aeroportit. Mbi dheun e zhveshur, ato qëndronin pak më gjatë, por prapë nuk arrinin të krijonin qoftë edhe një shtresëz të bardhë, sepse shiu e shkatërronte aleaten e tij, porsa të dy preknin tokën.

Gjenerali me uniformën e madhe vështronte atë borëtim jetëshkurtër. Herë pas here ngrinte sytë drejt qiellit. Por, pavarësisht se ç'i ndodhte në tokë pjellës së vet, qielli vazhdonte të lëshonte drejt humbjes mijëra flokë dëbore të rinj.

- Ftohtë, - tha deputeti shqiptar që kishte dalë t'i përcillte.

- Po, ftohtë, - u përgjigj gjenerali.

Ata ndiqnin me njëfarë padurimi avionin që po avitej,

ndërsa spikerja lajmëronte udhëtarët e vonuar të shpejtonin. Dhe vërtet, pak çaste më pas, uturima e avionit u bë aq zotëruese, saqë ata mund të thoshin të njëjtat fjalë: ftohtë, ftohtë vërtet, për besë, ftohtë, pa pasur frikë nga përsëritja, ngaqë asgjë nuk dëgjohej më. Kështu, me ca shtëllunga avulli, që kushedi ç'fjalë fshihnin përpara gojës, iu afruan shkallës së aeroplanit.

Frynte vazhdimisht.

Tiranë, 1962-1963

Çdo vit, pothuaj gjatë një dhjetëvjeçari, Kadareja u ka dhënë lexuesve të vet nga një roman, që i befason dhe i shtang ata, i prek në shpirt, u ngjall ndjenja e mendime të thella... Ka ardhur koha që Kadareja ta marrë çmimin që meriton... Jepjani Kadaresë çmimin Nobel!

Magazine litteraire

Një nga romancierët më të shquar të kohës sonë, në të gjithë botën dhe në të gjitha gjuhët.

Bruce Bawer, *Wall Street Journal*

E kemi thënë më parë dhe do ta themi prapë: kur do ta njohë Stokholmi kalibrin e jashtëzakonshëm të këtij shekulli?

Figaro Littéraire, Paris

Ismail Kadare është një shkrimtar që krijon hartën e një kulture të tërë, të historisë, pasionit, folklorit, politikës dhe katastrofat e saj. Ai është një shkrimtar universal, me një traditë narracioni që e ka origjinën që nga Homeri.

John Carey

Është kjo anë vizionare, që përbën forcën madhore të nja njëzet librave të Kadaresë, romancier që rrok Historinë me një frymë të fuqishme shekspiriane.

Histori e Letërsisë Europiane
Hachette, Paris

Një parabolë transparente e jetës nën diktaturën komuniste, e thënë me të njëjtin humor të qetë, me sarkazëm, dhe me një sy depërtues që e karakterizon autorin. Fabula politike ka qenë gjithmonë forca e veçantë e Kadaresë. Aftësia e tij e brendshme si një shkrimtar i aventurës e bën atë që të shmangë grackën e abstraksioneve.

Dominique Fernandez, *Nouvel Observateur*